



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2, 3 DHE 7 PRILL 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2., 3. I 7. APRILA 2015. GODINE**

**PRILL - APRIL
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike,
5. Shqyrtimi i rekomandimit për transferimin e mjeteve nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2015,
6. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
7. Debat parlamentar lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe për Programin qeverisës, sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë,
8. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje N/zakona o Kosovskoj agenciji za uporođenje i verifikaciju svojine,
4. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-09 o izmenama i dopunama zakona br.03/L-087 o javnim preduzećima,
5. Razmatranje preporuke o transferi sredstava iz budžeta Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova, u budžetu opštine Djakovica za 2015. godinu,
6. Izbor članova Nezavisnog saveta za civilnu službu Kosova,
7. Parlamentarna rasprava o radu premijera g-dina Isa Mustafa, i o programu Vlade za prvih 100 dana, po zahtevu poslanika Glauk Konjufca uz podršku 6 drugih posalnika,
8. Preporuke Komisije za ljudska prava, nestala lica i peticije u vezi Peticije o poskupljenju električne energije.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritarë,
Zëvendëskryeministër,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputeti deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Glauk, a pate diçka të thuash? Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ashtu siç kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, jemi dakorduar që përpara fillimit të rendit të ri të ditës ta paraqesim një mocion si opozitë, me ç'rast jemi të koordinuar në paraqitjen e kësaj kërke, që të zhvendosen të gjitha pikat tjera të rendit të ditës, me qëllim që të vendoset si pikë e parë e rendit të ditës ajo që e konsiderojmë ne të një interesi shumë të rëndësishëm publik, e që është debati parlamentar për punën 100-ditëshe të Qeverisë, për punën e deritashme të pushtetit, plus për Programin qeverisës, që do të duhej ta bënte kryeministri bashkë me ministrat, të cilët i ndihmojnë në dikasteret dhe në punën që e ushtron ai.

Kështu që në emër të tri subjekteve politike opozitare, unë kërkoj që të gjitha pikat tjera të rendit të ditës të kësaj seance, që po fillon, të zhvendosen, kurse të fillojmë me këtë pikën e debatit parlamentar.

KRYESUESI: Kjo është e vërtetë që kemi diskutuar në Kryesi, por seanca është ajo që mund ta vendosë, edhe pse kjo duhet të vendoset diku lidhur me rendin e ditës. Sidoqoftë, unë po e shkel pak rregullin, meqenëse është diskutuar edhe në Kryesi. Zoti Beqiri është paraqitur rreth kësaj çështjeje. Zoti beqari e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe unë të them të drejtën, por filloi pak më herët, e kisha ndërmend që në emër të Grupit Parlamentar të paraqes mocion pikërisht për ndryshimin e rendit të ditës dhe këtë po e bëj edhe tani, ndoshta nuk është vonë, që të ketë riformulim të rendit të ditës, përkatësisht që pika e parë të jetë Programi qeverisës dhe raporti 100-ditësh i Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe të hiqen nga rendi i ditës dy pikat e rregullta, e që është pika që ka të bëjë me deklaratimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare. Kështu që, po e them edhe në emër të grupit, ne kërkojmë që të jetë pikë e parë kjo dhe ato dyja të hiqen, e të tjerat të vijnë sipas radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Si mocion, unë jam i detyruar ta hedh në votim, meqenëse është diskutuar dhe në njëfarë mënyre ka pasur një dakordim në Kryesi se të vendoset kështu. Po ia jap fjalën edhe kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Grabovci. Nuk e di nëse e ke dëgjuar mocionin për çka po bëhet fjalë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës pajtohet me propozimin e Lidhjes Demokratike që kjo pikë të kalojë si pikë e parë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Atëherë, pothuajse s'ka nevojë që ta hedhim në votim këtë çështje fare, ose e hedhim. Nuk ka problem. Grupi Parlamentar "6+" për çka jeni, se në emër të tri grupeve foli Glauku. Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Edhe Grupi "6+" është që të bëhen ndryshime në rend të ditës, që në rend të ditës të futet raporti i 100-ditëshit të punës të zotit Isa Mustafa.

KRYESUESI: Doni ta hedhim në votim, apo jo? Ka nevojë, formalisht. A është dikush kundër? Një votë është kundër që të shmangemi nga rendi i ditës. Në rregull! Zoti Kurteshi.

Atëherë konstatoj që pika e parë e rendit të ditës - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare të shtyhen për në fund të seancës, ose në qoftë se nuk del kohë mbeten për seancën tjetër.

Fillojmë me pikën e shtatë që ka qenë e planifikuar, e që del si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe për Programin qeverisës, sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë

Deputeti Glauk Konjufca, i mbështetur edhe nga gjashtë deputetë të tjerë nënshkrues, në bazë të nenit 15, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe për Programin qeverisës.

E ftoj zotin Konjufca që në emër të gjashtë deputetëve të tjerë nënshkrues në cilësinë e propozuesit të çështjes ta marrë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit,

100-ditëshi i parë i qeverisjes në çdo vend demokratik është shndërruar në një praktikë të nxjerrjes së bilancit fillestar të punës së Ekzekutivit.

Kjo periudhë mund të konsiderohet si njëfarë mëngjesi i Qeverisë. Por, nëse nisemi nga ajo fjalë e urtë se dita e mirë shihet në mëngjes, Qeveria e Isa Mustafës nuk duket aspak premtuese.

Thonë që një fillim i mbarë është gjysma e punës, por më duket që ky ishte një fillim goxha i mbrapshtë. Pse?

Gjatë këtyre 100 ditëve, po filloj me atë që mua si qytetar i Kosovës dhe si deputet i këtij Kuvendi më ka mbetur në mend nga dita e parë të kësaj Qeverie, kur pesë minuta pasi kryeministri e mori detyrën e re iu drejtua me një fjalim aspak të lavdishëm deputetëve rebelues, të cilët nuk e kishin votuar atë.

Kjo më kujtohet prej ditës së parë të qeverisjes. Kjo më ka mbetur në mend.

Në ditën e 50-të, në mes të 100-ditëshit, çfarë më ka mbetur në mend? Më ka mbetur në mend deklarata e kryeministrit se njerëzit të cilët po ikin nga Kosova, ikje kjo masive, janë njerëz me 'iPhone' dhe të cilët nuk i kanë punët bash keq. Kjo ka ndodhur në ditën e 50-të të qeverisjes.

Në ditën e 100-të të qeverisjes çka më mbeti në mend? Ajo ishte dje dhe deklarata e kryeministrit se ushtria e Kosovës nuk do të shkelë në një pjesë të territorit të vet, në një pjesë të shtetit të Kosovës.

Kështu filloi, kështu u zhvillua dhe kështu përfundoi 100-ditëshi i kësaj Qeverie.

Gjëja më e rëndësishme për një Qeveri pa dyshim që mbetet përbërja e saj. Përbërja e Qeverisë në çdo vend të botës e përcakton kualitetin e qeverisjes, prandaj shtrohet pyetja: Cila është përbërja politike e qeverisjes në Kosovë? Kjo Qeveri dominohet, siç e dimë, nga dy subjektet më të mëdha politike në Kosovë, nga PDK-ja dhe LDK-ja, të cilat unë mendoj që prej vitit 2001 janë përgjegjëse për pesë gjëra shumë të rëndësishme në Kosovë.

1. Ngecja e zhvillimit ekonomik,
2. Lulëzimi i korrupsionit kronik nëpër institucione tona,
3. Degradimi i sistemit arsimor,
4. Erozioni i sovranitetit shtetëror dhe
5. Ngufatja e drejtësisë, të mos i jepet shans drejtësisë.

Këto dy subjekte politike të koalicionit qeverisës kanë qenë në pushtet që nga viti 2001, herë të dyja, herë veç e veç. Prandaj, është më se paradoksale kur i dëgjoj zyrtarët e tyre të ankohen se problemet nuk mund të zgjidhen shumë shpejt, sepse janë grumbulluar nga e kaluara, ndërkohë që vetë e kanë pasur përgjegjësinë kryesore që të zgjidhin probleme.

Zonja dhe zotërinj,

Për këtë arsye jeni zgjedhur edhe e keni formuar Qeverinë që të zgjidhni probleme, të cilat nuk po mund t'i zgjidhni.

Prandaj, konstatimi i parë që dua ta bëj në këtë debat parlamentar është ky: Përvoja na tregon se kjo trashëgimi politike që ndodhet në pushtet nuk e ka vullnetin politik për të vepruar në drejtim tjetër, përpos atij që e kemi parë tash e 15 vjet.

Kurse për rezultatet të cilat janë, ku ndodhemi ne sot, nuk ka nevojë ta bindim askënd, sepse rezultatet, zonja dhe zotërinj, ato përjetohen. Rezultatet në shtetin e Kosovës jetohen vetë.

Çështja e dytë me rëndësi që duhet ta ngre është kredibiliteti dhe besueshmëria e Qeverisë. Një prej aseteve më të çmueshme të çdo qeverie është besimi dhe optimizmi që ajo ngjall te çdo qytetar. Qytetarët e presin ardhjen e së resë dhe një ndryshim cilësor në shoqëri. Forca politike e re e ndërron atë të vjetrën, prandaj rritet shpresa dhe besimi e ngjall një dinamikë tjetër shoqërore, e cila reflektohet edhe në zhvillim ekonomik, edhe në gjëra pozitive.

Bashkimi në koalicion për të satën herë ndërmjet binomit ekzistues qeveritar i ka fundosur si mos më keq shpresat e popullit të Kosovës. Njerëzit nuk presin nga pushtetarët e njëjtë që ta ndërrojnë radikalisht mënyrën e tyre të qeverisjes. Kur qytetarët e humbin besimin në institucione, atëherë kjo shfaqet në dy forma, ose si revoltë, ose si dëshpërim. Të revoltuarit protestojnë, kurse të dëshpëruarit po e lëshojnë atdheun e tyre.

Prandaj, nuk është fare e rastësishme që ky 100-ditëshi i parë i Qeverisë u karakterizua nga protestat qytetare dhe ikja masive e qytetarëve nga Republika e Kosovës.

Le të mos mburret asnjë njeri, le të mos mburret asnjë zyrtar qeveritar me punën e vet për sa kohë që para hundës së Qeverisë qytetarët janë duke e lëshuar vendin. Kur njerëzit ikin në vendet tjera për çështje ekzistenciale, siç po na ndodh neve, kjo tregon se pushtetarët e kanë shndërruar Kosovën në vend të pajetueshëm për një pjesë të madhe të atyre që shtetit po ia kthejnë shpinën, sepse ndihen edhe të braktisur, edhe të pafuqishëm.

Një Qeveri e cila nuk e gëzon besimin dhe optimizmin qytetar, nuk e presin ditët e mira. Depresionit politik kolektiv sidomos i ka kontribuar edhe mënyra se si këto dy forca politike e kanë formuar Qeverinë.

Kryeministri Mustafa gjatë gjithë fushatës, gjatë gjithë verës së kaluar, deri në muajin nëntor, e mbajti popullin e Kosovës në projektin e shpresës për rrëzimin e pushtetit të krimit të organizuar. Në fund, me vetë ata të cilët i quajti krim i organizuar, hyri në koalicion. Pra, Isa Mustafa e ka marrë postin e kryeministrit duke e keqpërdorur një besim të partnerëve të vet politikë dhe ky është një problem i madh, edhe i kredibilitetit, por edhe i moralit publik, që duhet ta institucionalizojmë si standard më në fund në jetën tonë politike. Dhe, tash, kush mund të besojë që kjo Qeveri përnjëmend mund të bëjë gjëra të mira, pas gjithë këtyre veprimeve që i kemi parë.

Ne për arsye të këtij debati parlamentar, si opozitë e bashkuar, të tri subjektet politike opozitare, sepse ky debat është thirrur në emër të të gjithëve, i kemi përgatitur 11 rekomandime për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të cilat ju ftoj t'i votoni dhe për të cilat e hapi një diskutim, si dhe ju ftoj që të merrni pjesë, të kontribuoni me sugjerimet tuaja, me dhënien e ideve të ndryshme që t'i pasurojmë ato dhe t'i bëjmë më të pranueshme, edhe për Qeverinë, edhe për deputetët e mazhorancës. Rekomandim thonë:

1. Qeveria e Kosovës, kryeministri dhe ministrat t'u përgjigjen sipas normës kushtetuese kërkesave të deputetëve dhe të komisioneve parlamentare. Të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe sipas afateve ligjore t'i respektojnë kërkesat për interpelanca, për debate dhe për pyetje nga deputetët dhe nga grupet parlamentare.

2. Të paraqesin në Kuvend paraprakisht dhe sipas rastit edhe në komisionet përkatëse çfarëdo marrëveshje me palë a me shtetet tjera, veçanërisht për procesin e dialogut në Bruksel, si dhe për rastin e Gjykatës Speciale.
3. Ministri i Drejtësisë t'i raportojë Kuvendit në seancën e radhës lidhur me gjendjen në Këshillin Prokurorial dhe për grevën e fundit të gjyqtarëve.
4. Të aplikohen masa të menjëhershme të rritjes së kontrollit mbi Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës për ta luftuar kontrabandën dhe evazionin fiskal.
5. Të fillojnë menjëherë së zbatuari taksat doganore ndaj produkteve bujqësore e ushqimore të subvencionuara në vendet e tyre të origjinës. Këto taksa duhet të kenë synim rritjen e konkurrencës së prodhimeve vendore në treg, si dhe zëvendësimin e importeve.
6. Ta publikojnë menjëherë kontratën për autostradën Prishtinë - Han i Elezit, si dhe komisionet përkatëse t'i paraqesin kostot e shpronësimeve deri më tani.
7. Për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, si dhe të mosbuxhetimit adekuat të sektorëve me probleme të mëdha, si shëndetësia dhe ai i mbrojtjes sociale, të marrë masa për t'i llogaritur kostot e ndërprerjes së kontratës me "Behtel&Enka". Në përputhje me premtimin e dhënë minatorëve të Trepçës, por edhe në përputhje me interesin e vendit dhe të potencialit për zhvillim ekonomik, ta shpallë ligjërisht Kombinatin "Trepça" ndërmarrje publike, si dhe t'i bëjë publike afatet për përfundimin e strategjisë dhe hartimin e Ligjit të veçantë për "Trepçën", ashtu siç është premtuar.
8. T'i bëjë publike të gjitha të dhënat e procesit të tenderimit për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", si dhe ta sqarojë publikun në lidhje me kompaninë e vetme "County Global", që pritet të përfitojë nga ky proces.
9. Në rishikimin e buxhetit në qershor të këtij viti ta planifikojë rritjen e buxhetit për sektorin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve, si një nga sektorët ku preket drejtpërdrejt shëndeti ynë publik dhe standardi i jetesës së qytetarëve në shkallë të vendit.
10. Qeveria në afat sa më të shpejtë t'ua paraqesë deputetëve strategjinë konkrete për punësim. Ky hap do të krijonte kushte për eliminimin e shkaqeve të vërteta të migrimit të qytetarëve nga vendi ynë.
11. Qeveria ta bëjë më në fund publik vendimin me shkrim për shkarkimin e ish-ministrit për Komunitete dhe Kthim, Aleksandar Jablanoviq.

KRYESUESI : Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Qeverisë të Republikës së Kosovës.

Unë kam nderin që sot para jush dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës ta prezantoj Programin qeveritar dhe rezultatet e mëdha të cilat i ka a rritur Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë 100-ditëshit të punës fillestare të saj. Vlerësoj se debati në Kuvend për Programin qeverisës është i rëndësishëm për ta shpalosur bashkërisht vizionin dhe objektivat themelore, të cilat Qeveria i ka gjatë këtij mandati, por edhe për ndërtimin e një strategjie qeverisëse edhe për një mandat tjetër.

Qeveria ia ka përcjellë Kuvendit para 3 javësh Programin qeverisës për ta informuar lidhur me të. Qeveria e ka aprovuar Programin së bashku me planin për implementimin e tij.

Unë kam vërejtur në arsyetimin e mocionit përmbajtjesor të deputetit Glauk Konjufca, i përkrahur nga 6 deputetë tjerë, se në këtë arsyetim ka shumë të pavërteta dhe duhet të them: Është e pavërtetë se unë dhe ministrat e kemi përkrahur dhunën policore në demonstrata, por është e vërtetë se në protesta janë lënduar 126 policë, kryesisht me gurë, janë demoluar pronat private dhe pronat publike dhe janë lënduar 20 qytetarë. Raporti është 1:6.

E pavërtetë është pika 3 e mocionit se kam deklaruar se nuk kam shkuar në Stacionin e Autobusëve, meqë njerëzit po largohen me iPhone, por e vërteta është se në bisedat që i kam pasur jashtë vendit, njerëzit më kanë thënë se në radhën e atyre që po kërkojnë strehim, ka njerëz me iPhone. Aq ma e pavërtetë është se unë i kam quajtur familjarët e fëmijës që e humbi jetën në kampin e Hungarisë të papërgjegjshëm, por e vërteta është se familjarët kanë përgjegjësi për fëmijët dhe në qoftë se këtë nuk e dini, lexojeni Ligjin për familjen, i cili është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

E pavërtetë është se kam premtuar të shpallet “Trepça” kompani publike, përkatësisht ndërmarrje publike, ashtu siç shkruani në mocion, sepse unë jam i cili e kam tërhequr këtë ligj nga Kuvendi dhe se nuk kam planifikuar që t’ia paraqes Kuvendit Programin, por e vërteta është se programin ne e kemi paraqitur para 3 javësh dhe atë e kanë pasur të gjithë deputetët e Republikës së Kosovës.

Por, edhe shumë nga arsyetimet dalin të pavërteta, kjo assesi nuk e zvogëlon rëndësinë që të zhvillohet debati për një temë të rëndësishme, siç është Programi qeverisës dhe puna e madhe 100-ditëshe e Qeverisë të Republikës të Kosovës.

Unë dëshiroj po ashtu të tregoj mospajtimin tim lidhur edhe me cilësimin e deputetëve të LDK-së, sepse ne nuk kemi deputetë rebeles. Janë deputetët të cilët e kanë mendimin e vet, kanë të drejtë ta kenë qëndrimin e vet, dhe po ashtu edhe unë kam të drejtë ta kem qëndrimin tim, e ju nuk e keni licencën që të jepni vlerësime edhe t’i cilësoni deputetët këtu, dhe po ashtu dua të them se besimi i qytetarëve për të cilin ju flitni këtu është çështje e votës së tyre. Besimi shprehet përmes votës qytetare.

Prandaj, ju që keni më pak vota, nuk mund të flisni për besimin e qytetarëve ndaj atyre që kanë më shumë vota në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ju peshoni politikisht me besimin e qytetarëve për aq sa keni vota në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe, po ashtu, meqenëse po i akuzoni këto dy parti se kanë qenë në pushtet tërë kohën, e ju nuk keni qenë, atëherë është mirë të treguar se kujt prej neve ua keni dhënë votën në kohën që nuk keni qenë në pushtet. A ia keni dhënë PDK-së, a ia keni dhënë LDK-së, sepse edhe ju e keni përkrahur njërin prej këtyre subjekteve me votën tuaj.

Vlerësoj po ashtu se rekomandimet e propozuara, të cilat i lexove në emër të deputetëve që të kanë përkrahur, derivojnë nga shumë të pavërteta të këtij mocioni, prandaj mendoj se asnjë rekomandim i cili derivon nga e pavërteta nuk meriton të votohet nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë mendoj se deputetët duhet ta përkrahin Programin qeverisës, sepse ai jep përgjigje në të gjitha çështjet që ne kemi nevojë t’i zgjidhim sot.

Edhe pse 100-ditëshi ka përfunduar më 25 mars, sepse ne kemi filluar më 15 dhjetor të vitit të kaluar, ai nuk paraqet pjesë të veçantë të planit qeverisës. Megjithatë, Qeveria e Republikës së Kosovës dje e ka shqyrtuar dhe e ka miratuar raportin e punës 100-ditëshe dhe e kemi një raport të detajuar prej 81 faqeve, i cili flet për të gjitha punët që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore.

Sa i përket Programit të Qeverisë, unë këtu do të flas, zoti kryesues, pak më gjatë, sepse i kam dy fusha për të cilat duhet të flas, e ai përqendrohet në këto 5 shtylla kryesore: në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, në punësimin dhe mirëqenien, në sundimin e ligjit dhe të shtetit ligjor, me agjendën evropiane dhe në reformat thelbësore në arsim, si dhe në shëndetësinë bashkëkohore.

Në bazamentin e Programit të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe në filozofinë e saj vepruese të kësaj qeverie janë vlerat demokratike evropiane, është respekti për traditën, për lirinë, për tolerancën, është transparencia, liria e të shprehurit, liritë individuale dhe kolektive, që paraqesin fundamentin e një shoqërie moderne evropiane të Kosovës.

Në të gjitha politikat e saj, Qeveria do të promovojë dhe forcojë vizionin për Kosovën si shtet i pavarur demokratik dhe i integruar në strukturat euroatlantike dhe në marrëdhëniet të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e vlerëson arsyen që të gjithë ne ta kultivojmë një mentalitet tjetër ndaj ekonomisë së tregut. Sektori privat është bartës i zhvillimit ekonomik, prandaj ky sektor do të përkrahët me të gjitha instrumentet legale dhe do të luftohet mentaliteti që ndëshkon dhe e pengon sektorin privat dhe ndërmarrësit privatë.

Ideja themelore e Qeverisë është se vetëm një qeverisje e bazuar në ekonominë e tregut dhe në shtetin ligjor mund ta forcojë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë në vitalitetin e Kosovës si shtet i ri dhe shtet i pavarur. Një Kosovë demokratike ku sundon ligji dhe respektohen të drejtat e secilit pa asnjë dallim, që promovon zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien, që siguron lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe që promovon shoqërinë e dijes.

Prandaj, Programi është një rezultat i harmonizimit të politikave qeverisëse të partnerëve kryesorë të koalicionit, por edhe i punës së të gjitha ministrive, për të konkretizuar objektivat qeverisëse për periudhën 2015 – 2018.

Programi qeverisës nuk përmban projeksione numerike, sepse është bërë duke respektuar kriteret e ekonomisë së tregut, në të cilën Qeveria krijon kushte, ndërkaq bizneset private janë promotor i zhvillimit dhe punësimit. Por, unë mendoj se me kushtet që do të krijojë do t'i përmbushim premtimet tona në punësim të ri dhe në legalizimin e punësimit joformal.

Struktura bazë e programit qeverisës është si vijon:

- Programi elaboron dhe përpunon zhvillimin ekonomik, punësimin dhe mirëqenien, që përfshin përshtatësinë e TVSH-së, uljen e pragut të TVSH-së, pushimin nga tatimet dhe taksat, lirime doganore.

- Përfshinë politika tregtare konkurruese për përmirësimin e mjedisit biznesor, me qëllim themelor hapjen e tregut dhe tejkalimin e monopoleve, funksionalizimin e zonave të tregtisë të lirë, luftën e ekonomisë joformale, përkrahjen e prodhuesve vendorë, eliminimin e barrierave ligjore dhe zvogëlimin e burokracisë, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimin e investimeve përmes lehtësirave, krijimin e partneritetit strategjik, lehtësimin e investimeve nga diaspora dhe avancimin e partneritetit publik privat.

- Rëndësi të veçantë i është kushtuar formimit të Fondit për zhvillim, përkatësisht për punësim dhe investimeve në energji e në miniera, përfshirë edhe statusin, në të vërtetë, zgjidhjen e statusit të “Trepçës” përmes ligjit të veçantë.

Në program zë vend të veçantë bujqësia, rritja e fondeve për grante dhe subvencione, ndërtimi i sistemit të ujitjes dhe reformat ligjore për mbrojtjen e bujqësisë.

Zhvillimi i infrastrukturës orientohet në ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave, telekomunikacion dhe teknologjinë e informacionit, marrjen e Kodit telefonik shtetëror, privatizimin e “Valës” dhe liberalizimin e tregut të Telefonisë mobile.

Programi parasheh një qeverisje më të mirë korporatave të ndërmarrjeve publike dhe orientimet për sigurimin e ujit dhe planeve për menaxhimin e ujërave. Janë dhënë po ashtu, orientime të qarta dhe rreth zhvillimit të turizmit dhe të ofertës turistike. Një vend të veçantë në program zë sundimi i ligjit dhe ndërtimi i shtetit të së drejtës, luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit dhe rregullimi i infrastrukturës së mekanizmave të prokurimit publik dhe kalimi në prokurim të përqendruar dhe elektronik, integrimi i komunave veriore në sistemin e drejtësisë dhe reformat e administratës publike.

Agjenda evropiane dhe politikat e jashtme përfshijnë masat që qojnë Kosovën në Bashkimin Evropian, në NATO, në partneritet strategjik dhe bashkëpunim me vendet e rajonit.

Në fushën e arsimit parashihen të bëhen reforma strukturore në arsim dhe t’i jepet rëndësi e veçantë ngritjes së cilësisë së arsimit, si dhe promovimit të shkencës dhe hulumtimeve, kurse kultura, rinia dhe sporti përfshijnë segmente të gjëra masash në sigurimin e infrastrukturës së këtyre fushave në kultivimin e trashëgimisë kulturore, masivizimin dhe ndërkombëtarizimin e sportit dhe kulturës.

Shëndetësia është trajtuar si fushë me interes të veçantë, e cila duhet të reformohet për t’iu ngritur cilësia dhe të rregullohet çështja e financimit shëndetësor.

Në fushën e asistencës sociale promovohen masat për zvogëlimin e vartësisë sociale të popullsisë, prandaj ky program do të jetë udhërrëfyes për punën e Qeverisë gjatë mandatit të saj qeverisës.

Programi deri më tani është diskutuar me bizneset dhe asociacionet e tyre, me donatorët e jashtëm dhe të brendshëm, u është prezantuar përfaqësuesve të jashtëm diplomatik dhe institucioneve financiare ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të Bashkimit Evropian.

Kemi bërë përgatitje të duhura për hartimin e strategjisë kombëtare të zhvillimit të Kosovës, për periudhën 2015-2020, duke bërë që për herë të parë në historinë e Kosovës, Kosova të ketë një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillim ekonomik.

Kjo strategji do të përmbajë në vete prioritetet e prioritetëve të përzgjedhura me kujdes dhe në bazë të analizave të ndryshme të ndërmarra, që do të kenë fokus kryesor zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Si programi qeverisës, ashtu edhe strategjia kombëtare e zhvillimit do të shoqërohen me masa për përmirësimin e kapaciteteve institucionale të Kosovës, për menaxhimin e politikave zhvillimore. Kjo do të bëhet duke vendosur një mekanizëm të mirëfilltë të planifikimit të integruar, duke u bazuar në praktikën më të avancuar të vendeve në tranzicion për prioritetet dhe zbatimin e politikave zhvillimore.

Për të dy proceset edhe për programin qeveritar edhe për strategjinë, Kosova ka filluar përgatitjet me ndihmën e partnerëve zhvillimor, me theks të veçantë me fondet e IPA 2 të Komisionit Evropian. Kosovës i nevojitet një nivel i rritjes ekonomike, që në masë të konsiderueshme do ta bënte të mundur zvogëlimin e nivelit të papunësisë, që deri më tani vazhdon të jetë shumë e lartë.

Qeveria po ashtu, synon që sistemi i drejtësisë dhe i sigurisë të jetë funksional, të jetë profesional, i depolitizuar, i integruar dhe i shtrirë në tërë territorin e vendit në përputhje me standardet evropiane, në fushën e ligjit dhe të sigurisë. Është paraparë avancimi i legjislacionit me ndryshimin e një numri të madh të ligjeve ekzistuese dhe përgatitja e ligjeve të reja.

Në fushën e korrupsionit dhe të krimit të organizuar, Qeveria do të jetë e vendosur për luftimin e kësaj dukurie, me involvimin e të gjitha mekanizmave shtetërore, duke filluar nga niveli më i lartë dhe deri tek niveli më i ulët.

Ne synojmë të kemi një administratë publike tërësisht funksionale dhe në shërbim të qytetarëve dhe rrjedhimisht, kemi paraparë veprime konkrete për reformimin e kësaj administrate.

Natyrisht, se ne e shohim Kosovën pjesë të Bashkimit Evropian dhe të mekanizmave tjerë perëndimor dhe, rrjedhimisht programi ynë qeverisës i ka kushtuar një rëndësi të veçantë agjendës evropiane.

Së bashku me programin qeverisës kemi përgatitur edhe planin e implementimit, i cili përbëhet nga një amzë e detajuar e të gjitha aktiviteteve dhe veprimeve, që do të merren për të realizuar programin qeverisës. Ky plan do të më shërbejë mua si kryeministër dhe ministrave dhe ministrive përkatëse, për të monitoruar dhe për të përcjell realizimin e programit sipas afateve të caktuara kohore.

Të nderuar deputetë,

Para se t'i paraqes para jush arritjet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për periudhën e 100 ditëve, më lejoni të them që synimi parësor i Programit tonë ka qenë dhe mbetet ndërtimi i një qeverisjeje të mirë, efektive dhe të përgjegjshme. Që në fillim dua të them, se fillimi i punës së Qeverisë në këtë mandat nuk ishte aspak i lehtë, kjo për rrethanat tanimë që i

dimë të gjithë dhe për ngjarjet që i kemi jetuar të gjithë ne. Fillimi i punës së Qeverisë u pasua menjëherë nga grevat e sektorëve të ndryshëm të mësimdhënësve, të punëtorëve të shëndetësisë, gjyqtarëve dhe minatorëve, të protestave të organizuara nga opozita në disa qytete të Kosovës, të cilat eskaluan në dhunë ekstreme në Prishtinë.

U ballafaquam me një vendim të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, që e çonte “Trepçën” në likuidim dhe me nevojën për marrjen e masave emergjente për ta shpëtuar. Pastaj, fenomeni i migrimit masiv, fenomen ky ende i pashpjegueshëm, sado që fuqimisht i sponsorizuar dhe i përkrahur nga krimi i organizuar dhe nga profiterë të ndryshëm.

E kam thënë edhe dje, po e përsëris edhe sot, se nuk di a ka ndonjë shembull në rajon dhe në Evropën demokratike, kur një qeveri e zgjedhur në mënyrë demokratike nga vota e popullit, nga rezultatet e pranuar nga i gjithë spektri politik, që nuk i është dhënë asnjë ditë dispozicion, të fillojë punën në mënyrë normale. Por, mund të them se edhe përkundër kësaj, Qeveria ia ka arritur të përqendrohet në objektivat dhe prioritetet e saj, ta stabilizojë gjendjen dhe ta bëjë punën e vet me një kohezion të plotë dhe me një përgjegjësi shumë të lartë.

Siç edhe kam theksuar në ditën e inaugurimit të Qeverisë, ky koalicion është ndërtuar duke pasur parasysh dhe duke respektuar vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të shprehur me votën e lirë, si dhe detyrimin kushtetues për themelimin e institucioneve legjitime të vendit, funksionale dhe gjithëpërfshirëse. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë hapa konkretë në realizimin e synimeve dhe objektivave programor. Do t'i them disa prej tyre.

- Objektivi fillestar i Qeverisë është stabiliteti makroekonomik dhe stabiliteti buxhetor i vendit;
- Qeveria do të orientohet në investimet produktive, të cilat nxisin zhvillim ekonomik, në rend të parë në bujqësi, në arsim dhe në shëndetësi;
- Qeveria është përcaktuar për kursime të domosdoshme, ka hequr dorë nga shumë shpenzime, si ato të blerjes së automjeteve, pajisjeve për zyra, kompjuterëve, e tjerë, por, po ashtu ka marrë vendim për vlerësimin e Parkut të automjeteve dhe për shitjen e një numri të konsiderueshëm të tyre, që mendoj se fillimisht në ankand do të jepen për shitje rreth 25% të automjeteve, përkatësisht rreth 250 sosh;
- Qeveria ka vlerësuar se nuk ka kapacitete buxhetore për rritje të pagave dhe se çështja e pagave duhet të rregullohet nëpërmjet nivelimit, që siguron që njerëzit që bëjnë punë të njëjtë të pagohen njëjtë dhe që të evitohen shtesat mbi pagat, të cilat krijojnë pabarazi dhe pamundësojnë zbatimin e njëjtë të performansës. Rritja e ardhshme e pagave do të bëhet në harmoni me rritjen ekonomike;
- Qeveria ka përgatitur Ligjin për nivelimin e pagave dhe është në procesin përfundimtar të konsultimit për tabelarin e pagave, që do t'i përfshijë pagat e të gjithë atyre që pagohen me para publike. Ne, që në ditën e parë kemi premtuar se do të bëjmë ndryshime substanciale në sistemin tatimor, me synim që ky sistem të jetë përkrahës i rritjes dhe zhvillimit të sektorit privat në vend.

Vetëm një sektor i fuqishëm privat do të mund t'i arrijë synimet tona për rritje të punësimit dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve tanë. Në këtë kontekst ne kemi ndërmarrë veprime specifike, që besoj se disa prej tyre kanë filluar të japin rezultate e disa tjera do të prodhojnë rezultate në javët dhe në muajt e ardhshëm në vijim.

- Kemi bërë reformimin e sistemit tatimor, me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për mënyrën e të bërit biznes. Ligji mbi tatimin mbi vlerën e shtuar parasheh përshkallëzimin e TVSH-së duke ofruar një normë të zvogëluar prej 8% për një numër të konsiderueshëm të mallrave dhe shërbimeve, që konsiderohen si bazike për konsumin e qytetarëve. Ulja e kësaj norme në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në uljen e çmimit për këto produkte dhe, në kuptimin real, qytetarët do të mund të blejnë më shumë me të ardhurat e tyre.

Për të stimuluar sektorë të rëndësishëm, siç është prodhimtaria në përgjithësi, por edhe sektorët specifikë, siç është ai i teknologjisë informative dhe bujqësia, ne kemi përfshirë në këtë ligj lirimin nga TVSH-ja për të gjitha makineritë për përdorimin në procesin e prodhimit, pajisjet e teknologjisë informative, si dhe lëndët e para që shfrytëzohen në procesin e prodhimit.

Për më tepër, në fushën e politikave tatimore kemi bërë ndryshime në Ligjin dhe tatimin e të ardhurave personale dhe tatimin e të ardhurave të korporatave. Prania e ekonomisë joformale është një ndër pengesat kryesore të rritjes së mëtutjeshme të ekonomisë.

Në mungesë të konkurrencës së lirë penalizohen biznese e ndershme dhe konsumatori nuk është i mbrojtur. Gjithnjë duke pasur parasysh jetësimin e planit të Qeverisë, kemi aprovuar ndryshimet në Udhëzimin administrativ për pajisjet elektronike fiskale, udhëzim ky, i cili rregullon tregun e arkave fiskale, stimulon bizneset për pajisje me arka fiskale dhe po ashtu, stimulon konsumatorët, për arsye se u mundëson kthimin e një pjese të TVSH-së së paguar.

- Qeveria ka marrë vendim ta themelojë Fondin për zhvillim, ndërkaq modalitetet e këtij fondi do të përcaktohen me ligj, sipas konceptit të aprovuar. Është identifikuar fondi fillestar prej rreth 15 milionë eurove, që do të financohet nga Qeveria e Kosovës, së bashku me partnerët zhvillimor dhe agjencitë zhvillimore, si është USAID, Banka Gjermane për Zhvillim, ADA, SDC e tjerë.

Vendim tjetër, shumë i rëndësishëm, që ne kemi marrë është ai lidhur me faljen e borxheve të vjetra, që i takojnë periudhës deri më 31 dhjetor të vitit 2008, vendim ky i cili është marrë në mënyrë që t'u lehtësohet jeta qytetarëve dhe të përkrahet aktiviteti biznesor. Ne tani po e përgatitim ligjin për këtë, që do ta përmbajë një skemë që i motivon qytetarët dhe biznese t'i kryejnë obligimet me kohë.

Me të marrë mandatin qeveritar, vëmendje e veçantë i është kushtuar mbylljes së vitit fiskal 2014 dhe falë angazhimit të madh edhe të Ministrisë edhe të Qeverisë, si dhe të ministrive tjera, kemi arritur që ta përmbyllem me sukses këtë vit.

Qeveria ka arritur po ashtu, të aprovojë buxhetin brenda afateve ligjore, gjë që ka mundësuar që ky buxhet të ekzekutohet që nga fillimi i këtij viti. Me qëllim të menaxhimit efektiv dhe transparent të financave publike, janë ndërmarrë një serë veprimesh për rritjen e kontrollit të brendshëm dhe komunikimit mes organizatave buxhetore për t'u siguruar se paraja publike

harxhohet ashtu siç përcaktohet me ligj. Ndër veprimet konkrete është bartja e Divizionit të pagave nga Ministria e Administratës Publike, në Ministrinë e Financave dhe kjo mundëson një menaxhim dhe kontroll më të mirë të ekzekutimit të buxhetit për kategorinë e pagave dhe të mëditjeve.

Në fund të janarit 2015 kemi aprovuar dokumentin strategjik Programi kombëtar për reforma ekonomike, i cili përmbledh reformat prioritare, strukturore të Qeverisë duke u bazuar në kornizën e qëndrueshme makrofiskale.

Ky dokument i është dorëzuar me kohë Komisionit Evropian dhe së fundi janë mbajtur disa takime vlerësuese me disa nga institucionet ndërkombëtare, gjatë të cilave janë marrë vlerësime pozitive mbi përmbajtjen dhe cilësinë e këtij dokumenti.

Për të siguruar se niveli i borxhit publik mbetet në kuadër të limiteve të pranueshme dhe se kostoja e financimit të deficitit është më e ulët, ne kemi aprovuar programin e borxhit shtetëror për periudhën afatmesme.

Në të njëjtën kohë kemi filluar me rishikimin e tërësishëm të strategjisë së borxhit publik, për të parë mundësitë e huazimit nga jashtë me kushte më të mira për financimin e projekteve prioritare të Qeverisë, projekte zhvillimore, jo projekteve të pagave dhe mëditjeve.

Gjithnjë duke qenë konsistent me qëndrueshmërinë buxhetore dhe nivelin e pranueshëm të borxhit publik, janë nënshkruar dy marrëveshje për huamarrje me Bankën Botërore dhe këto marrëveshje dhe këto ligje kanë kaluar dhe janë aprovuar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe me eficiencën e energjisë.

Është aprovuar udhëzimi administrativ për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik. Ky lloj i prokurimit do ta rrisë transparencën, do të zvogëlojë burokracinë dhe do ta forcojë eficiencën për Qeveri.

Po i bëjmë përgatitjet po ashtu për përqendrimin e prokurimit publik në nivel të një agjencie dhe kalimin në prokurimin elektronik publik, në mënyrë që të eliminohet çdo burim i korrupsionit dhe të krimit.

Është inauguruar pika transite e shpejtë me Shqipërinë, në Vërmicë. Kemi vendosur kontroll më të mirë në dogana dhe kemi rritur efikasitetin e Administratës Tatimore dhe po punojmë po ashtu në modelin e integriteteve të këtyre dy organizatave në një organizatë buxhetore.

Kemi vendosur dialog të rregullt me bizneset, ku kemi organizuar debate, për ta diskutuar pakon ligjore dhe fiskale dhe po ashtu kemi marrë sugjerime shumë të dobishme të tyre.

Kemi mbajtur një tryezë me donatorët për të prezantuar para tyre programin tonë qeverisës, në mënyrë që t'i harmonizojmë aktivitetet e përbashkëta zhvillimore.

Kemi mbajtur mbledhje të dy qeverive, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe kemi nënshkruar 11 marrëveshje, përkatësisht memorandumë dhe protokolle, të cilat rregullojnë bashkëpunimin në shumë fusha dhe lehtësojnë këtë bashkëpunim.

Është përgatitur edhe takimi i përbashkët me Qeverinë e Maqedonisë, për të arritur po ashtu marrëveshje për lehtësimin e bashkëpunimit në disa fusha, sidomos ato të sigurisë, në kalimin e më të lehtë të kufirit dhe në tregti e në fushën fiskale.

Dy nga çështjet më emergjente me të cilat u përball Qeveria aktuale që në orët e para ishte miratimi i buxhetit në afat kohor ligjor dhe shpëtimi i “Trepçës” nga falimentimi.

Dua të theksoj se “Trepça” e Kosovës është shpëtuar me një veprim eficient dhe shumë të shpejtë të Qeverisë dhe deputetëve të këtij Kuvendi, të cilët qëndruan këtu dhe votuan për hyrje në rend dite të këtij ligji dhe e votuan këtë ligj.

Qeveria synon që të zhvillojë sektorin e industrisë përmes identifikimit të industrive në përparësi, duke krijuar plasterët industriale dhe për këtë është hartuar koncept- dokumenti i politikave industriale nga ne.

Integrimi i Kosovës në tregjet rajonale dhe globale është po ashtu një prioritet në të cilin është punuar në këtë periudhë, janë zhvilluar negociata të ndryshme në kuadër të CEFTA-s, janë zhvilluar koordinime dhe kontakte të ndryshme për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe po ashtu në lidhje me Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim.

Kemi bërë rishikimin e infrastrukturës ekzistuese për mbikëqyrjen e tregut të naftës dhe kontrollin e cilësisë së naftës. Në lidhje me këtë është bërë regjistrimi i të gjitha pikave shitëse të karburanteve në terren me GPS.

Jemi në proces të funksionalizimit të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Këshilli do ta ketë një format të ri, do të shërbejë si platformë adekuate për dialog të qëndrueshëm të Qeverisë dhe të sektorit privat.

Qeveria, do të vazhdojë investimet nëpërmjet koncesionimit me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe të zhvillimit ekonomik. Në këtë kuadër janë bërë përgatitjet e nevojshme për kompletimin e procesit të konsolidimit, në të vërtetë të koncesionimit të Qendrës së skijimit në Brezovicë.

Kemi marrë gatishmërinë e Bankës Evropiane për Zhvillim që të investojë në PTK në vitet në vijim, që do ta mundësojë të modernizohet kjo organizatë dhe t’i shtohet vlera e saj.

Në sektorin energjetik, kemi punuar për hartimin e legjislacionit të nevojshëm në fushën e energjisë, për harmonizimin e direktivave të Bashkimit Evropian, përkatësisht pakon e tretë të direktivave të BE-së për energji.

Gjithashtu është në përgatitje e sipër korniza strategjike për sektorin e energjisë. Në këtë kuadër strategjia e energjisë së Republikës së Kosovës dhe programi për zbatimin e saj, pritet të procedohet për miratim në Qeveri, së shpejti.

Qeveria po vazhdon angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, përkatësisht për ndërtimin e “Kosovës së re”. Komisioni drejtues ka marrë ofertë nga investitorët të parakualifikuar për ndërtimin e këtij termocentrali dhe janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për përshpejtimin e këtij procesi strategjik për Kosovën.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka hartuar dhe miratuar Programin për bujqësi dhe zhvillim rural dhe programe për pagesat direkte, gjë që do të mundësojë që të gjitha mjetet e garantuara me buxhet për grante dhe subvencione të realizohen në kohë të nevojshme dhe këto mjete t’u jepen prodhuesve bujqësorë.

Janë nënshkruar memorandume mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për punësimin e rreth 1.000 punëtorëve, përkatësisht 985 sish në Agjencinë e Pyjeve, si punësim sezonal.

Kemi vazhduar zbatimin e projekteve kapitale në sektorin e infrastrukturës rrugore, duke përfshirë rrugën 6 Prishtinë-Hani i Elezit, ku aktualisht punohet në hapjen e trasesë në dy drejtime, në drejtim të Gjilanit dhe në drejtim kryesor kah Hani i Elezit, në gjatësi prej 8.5 kilometrash, për projektin tjetër segmenti Besi - Merdar, të drejtimit të rrugës R-7, janë përgatitur termat e referencës, pas së cilave do të fillohet me studimin e fizibilitetit në bashkëpunim me BERZH dhe Bankën Evropiane për Investime, kurse për projektin strategjik të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, është duke u punuar projekti zbatues.

Edhe për projektin e zgjerimit të rrugës nacionale N-9 Prishtinë-Pejë, janë përgatitur termat e referencës dhe pritet që të fillohet me përgatitjen e plotësimit të studimit të fizibilitetit, ndërsa kanë filluar procedurat për fillimin e projektit të zgjerimit të rrugës nacionale N-2, Prishtinë-Mitrovicë.

(Ndërhyrje)

Ju keni kërkuar debat, unë s’kam kërkuar, prandaj dëgjoni!

Në fushën e transportit, së bashku me Shqipërinë është bërë aplikimi në kornizën financuese për Ballkanin Perëndimor. Është punuar në arritjen e marrëveshjes me vende të ndryshme në çështjet sociale, në fushën e punësimit, dhe janë nënshkruar një seri të marrëveshjeve të tilla.

Në fushën e sundimit të ligjit, është punuar në avancimin e kornizës ligjore dhe institucionale, në reformimin e sistemit gjyqësor, në këtë rast është finalizuar pakoja e ligjeve gjyqësore dhe një pjesë e pakos për të drejtat e njeriut.

Në forcimin e rendit dhe ligjit, është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Ligji për parandalimin e bashkimit të konflikteve të armatosura, dhe po punohet po ashtu në strategjinë e

parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizmit që shpie në terrorizëm, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Mund të them se kemi po ashtu çështje tjera të zbatimit të ligjit, të cilat duhet t'i adresojmë sa më shpejt pa asnjë prolongim, sidomos ato që kanë të bëjnë me praktikën që në ministri të caktuara dhe në agjenci vazhdojnë të punojnë njerëz ndaj të cilëve janë ngritur aktakuza për shkelje për punët që ata i bëjnë, si dhe ato që kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Dhe, mund të them se Qeveria do të marrë masa ndaj të gjithë atyre që nuk e zbatojnë ligjin dhe që nuk veprojnë sipas dispozitave ligjore.

Në adresimin e migrimit të parregullt, unë personalisht kam takuar shumë personalitete të vendeve të ndryshme. Gjithashtu, vlen të theksohen, takimet që i ka bërë zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Integriteteve Evropiane, me shtetas të Hungarisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë, Francës dhe zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian, si dhe vizitat të cilat i kanë bërë përfaqësuesit e lartë të Gjermanisë dhe vendeve tjera në Kosovë.

Janë marrë masa të profilizimit të kompanive transportuese, të taksive dhe të gjithë atyre që u shërbejnë pasagjerëve në mënyrë që e gjithë kjo të vihet nën kontroll të plotë.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka finalizuar strategjinë për vetëqeverisjen lokale dhe planin e veprimit.

Po ashtu i kemi bërë të gjitha përgatitjet për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe po i bëjmë përgatitjet për përmbushjen e të gjitha kriterëve teknike që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave, ndërkaq kemi premtimin e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, se në përmbushjen e kriterëve teknike do të kemi disponimin politik që të liberalizohen vizat.

Kosova ka pritur takimin e gjashtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si vazhdimësi e Konferencës së Berlinit. Në këtë Samit të gjashtë të ministrave të jashtëm dhe 6 ministrave të infrastrukturës të Ballkanit Perëndimor, i cili është mbajtur më 25 mars në Prishtinë, janë konkretizuar projektet ekonomike të karakterit rajonal, me theks të veçantë të investimeve në energjetikë dhe në infrastrukturën rajonale dhe atë hekurudhor.

Po ashtu është punuar shumë në sektorin e arsimit, në sektorin e shëndetësisë dhe të kulturës. Ne kemi arritur që të pranojmë në shumë organizata ndërkombëtare sportive gjatë tre muajve të parë të këtij viti dhe po ashtu mendoj se me këtë po arrijmë suksese të rëndësishme në përfaqësimin e vendit tonë.

Dhe, të theksoj se gjatë kësaj periudhe 100 ditore, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka mbajtur, në qoftë se flasim me numra, 20 seanca, 20 mbledhje, ka nxjerr 136 vendime, i ka trajtuar 28 projektligje dhe ia ka adresuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka miratuar 8 koncept-dokumente dhe po ashtu janë përgatitur edhe 10 koncept-dokumente të cilat do të trajtohen së shpejti.

Dhe, të nderuar deputetë,

Këto janë vetëm disa nga punët dhe aktivitetet kryesore të arritura nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë kësaj periudhe 100-ditëshe. Ne konsiderojmë se është punuar shumë, është siguruar një kohezion i madh, një sinergji e madhe e të gjithëve në realizimin e këtyre rezultateve dhe ne mburremi me këtë punë që e kemi bërë, por po ashtu konsiderojmë se duhet të kemi një bashkëpunim me të gjithë subjektet politike dhe me shoqërinë civile, që t'i adresojmë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, me hapjen e vendeve të reja të punës, me luftën kundër krimit e korrupsionit dhe me reforma të cilat ne do t'i bëjmë në periudhën e ardhshme. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Mirë, ke të drejtë në replikë! Fjalën, zotit Konjufca për replikë.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryesues!

Këtu, po më duket që kryeministri ka harruar që është në Kuvend, sepse e para e punës - kategoria parlamentare në të cilën jemi është debat parlamentar, e jo monolog qeveritar, siç bëri kryeministri deri më tash.

E dyta, kryeministri i drejtoi disa akuza shumë të rënda ndaj opozitës, të cilat nuk mund të mos i adresoj.

E para, për dhunën e qytetarëve në demonstrata, me ç'rast dhunën e kualifikoi në anën e qytetarëve dhe e mbrojti Policinë. Kjo është shumë serioze, sepse ne i themi kryeministrit mos e instrumentalizoni Policinë kundër popullit, siç ndodhi atë ditë në protesta dhe në demonstrata. Bile-bile, unë mendoj që kryeministri e ka nxitur dhunën e qytetarëve për arsye se nuk e shkarkonte ministrin Jablanoviq dhe tash pasi e shkarkoi atë në njëfarë mënyre, e ka pranua 'post festum' që qytetarët paskan pasur të drejtë, sepse më në fund është detyruar ta pranojë kërkesën e qytetarëve apo jo. E ka shkarkua ministrin e vet.

E dyta, sa i përket migrimit të qytetarëve është e pafalshme moskokëçarja e kryeministrit, kur thotë që faktikisht ai nuk paska thënë që qytetarët janë me iPhone, por dikush, një qytetar anonim, i paska thënë këtij që i ka parë me iPhone. Më falni, kjo është joserioze nga një kryeministër të thotë 'dikush më ka thënë', por unë nuk po them që ata janë me iPhone. Kjo është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më fal, regjia, të lutem edhe 30 sekonda!

GLAUK KONJUFCA: Edhe 30 sekonda po m'i jep kryetari, faleminderit shumë!

Kjo i bie të hidhet guri e të fshihet dora. Kështu i bie kjo deklarata e kryeministrit dhe ky është i tillë.

Tjetra është që po thotë 'a e kanë lexuar ato familje që i marrin fëmijët e tyre Ligjin për familjen dhe që duhet të kujdesen për fëmijët e tyre'. Ne i themi kryeministrit, a e ke lexuar ti Kushtetutën

që të obligon të merresh me këto familje dhe me mirëqenien e tyre, e të mos sillen njerëzit me shpirt në fyt dhe ta lëshojnë vendin. Ky nuk e bën atë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro zoti kryeministër, e ke fjalën për kundër-replikë.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Problem është i shtrembërimeve, që do të thotë kur shtrembërohen faktet para të gjithë deputetëve këtu, edhe për opinionin, atëherë unë e kam vështirë që të komunikoj, sepse të gjithë qytetarët e kanë dëgjuar fjalimin tim dhe e kanë dëgjuar se çfarë kam thënë unë. Unë s'kam thënë se qytetarët kanë reflektuar dhunë, por dhuna është reflektuar në protesta, dhe pasojë e dhunës në protesta janë 126 policë dhe 20 qytetarë të lënduar. Dhe, ky është fakti.

Nuk e kam akuzuar familjen që s'e ka lexuar Ligjin për familjen, por juve ju kam thënë që duhet ta lexoni, sepse atë ligj ju e keni votuar, ju e keni aprovuar dhe në të shkruan përgjegjësia dhe është e përcaktuar përgjegjësia e prindërve lidhur me fëmijët.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Është e pahijshme që kjo çështje të shtrohet. Prandaj, ne jemi këtu para publikut dhe nuk kemi arsye ta shtrembërojmë atë që e themi. Unë çdo fjale të cilën e kam thënë përpara i qëndroj prapa, për asnjë presje dhe asnjë pikë nuk lëviz prej tyre.

KRYETARI: Shefat e grupeve parlamentare - Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Të lutem, nuk po e thyejmë më shumë Rregulloren. Urdhëro, përfaqësues i Grupit Parlamentar, Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sigurisht që të diskutojmë për punën e Qeverisë për 100 ditë, një qeveri e cila ka filluar në mënyrë jo të natyrshme funksionimin e saj, sepse nuk iu dha mundësia që në mënyrë konkrete ta konsolidojë vetveten dhe t'i japë orientimet e veta programore, të cilat së bashku, nën udhëheqjen e Partisë Demokratike të Kosovës dhe së bashku me prioritetet e Lidhjes Demokratike të Kosovës është bërë Programi qeverisës i Qeverisë së Republikës së Kosovës, program i cili ne besojmë që duhet të jetësohet dhe kërkojmë që duhet të jetësohet në tërësi.

Sigurisht që ky Program qeverisës i ka prioritetet e veta në mirëqenien e qytetarëve, në zhvillim ekonomik, në krijim të vendeve të punës, në luftimin e ekonomisë informale, krijimin e fondit për punësim dhe zhvillim, në mirëqenien sociale, trajtimin e kategorive të dala nga lufta, shëndetësi, funksionim të rendit dhe ligjit, edukim, si dhe në agjendën evropiane.

Nga ajo që mund të shihet, edhe pse ishte fillim i vështirë, Qeveria së voni ka filluar të tregojë shenja të marrjes së vetes dhe të angazhimit serioz në drejtim të mirëqenies së qytetarëve dhe në zbatim të Programit qeverisës.

Partia Demokratike e Kosovës i ka mirëpritur vendimet të cilat janë marrë gjatë këtyre ditëve, vendime të cilat gjithsesi tregojnë një konsistencë të vazhdueshme me politikat qeveritare paraprake, sepse legjislacioni i cili është në procedim e sipër është legjislacion që është hartuar në Qeverinë paraprake, politikat dhe prioritetet të cilat janë bërë janë vazhdimësi të asaj dhe shumë aktivitete të cilat u përmendën nga zoti kryeministër, qoftë në reformën administrative, janë reforma të cilat kanë filluar dhe ne besojmë fuqishëm, si Parti Demokratike, që ato do të vazhdojnë, sepse e kanë vetëm një mision - për krijimin e jetës sa më të mirë për qytetarët.

Në fushën e zhvillimit ekonomik, Partia Demokratike mirëpret procedimin e paketës ligjore, e cila ka për synim zhvillimin, ka për synim përmirësimin e mirëqenies, edhe pse besojmë se një pjesë e mirë e këtyre vendimeve janë me karakter social, pra më shumë kanë dimension social se sa dimension zhvillimor. Prandaj, në këtë drejtim ne presim që procesi i zhvillimit ekonomik, vendimet të cilat janë marrë më herët dhe që duhet të procedohen për krijimin e vendeve të punës, për rritje të sektorit privat, për fuqizim të sektorit privat, të jenë prioritet i të gjitha prioritetëve, sepse besojmë që fuqizimi i mirëqenies së qytetarëve bëhet duke e përmirësuar ekonominë, e jo duke tentuar që të bëjmë veprime, të cilat kanë më shumë karakter social.

U përmend këtu besimi i qytetarëve, sepse kur flasim për besimin e qytetarëve duhet ta trajtojmë pak situatën më gjerësisht.

U fol për migrimin, një ngjarje e dhimbshme, një ngjarje e cila ka në vete komponentët ekonomikë, por një ngjarje e cila ka në vete edhe atë vakumin institucional dhe angazhimin e të gjitha institucioneve lokale në këtë drejtim.

Dua të them që më vjen mirë që ka nisur një debat i tillë dhe që po fokusohet mirëqenia e qytetarëve, por duhet të themi që nëse flasim tani për besimin e qytetarëve, një pjesë të mirë të përgjegjësisë e marrin edhe partitë opozitare, në këtë rast “Vetëvendosja”, sepse një pjesë e madhe e njerëzve që e kanë lëshuar territorin e Republikës së Kosovës janë nga komuna e Prishtinës, dhe e kemi një bllokadë totale të jetës ekonomike në kryeqendrën, e cila përbën mbi 70% të jetës ekonomike në vend.

Pra, ne duhet ta kemi parasysh se ky besim i qytetarëve nuk është besim i momentit, nuk është besim i 100 ditëve, por është besim i një konsistence të vazhdueshme qeveritare, dhe ajo çka Partia Demokratike e Kosovës kërkon nga Qeveria është që pavarësisht pengesave, të cilat mund të jenë edhe në nivelin lokal, t’i adresojë ato në mënyrën sa më të shpejtë të mundshme dhe ta kthejmë një besim të qytetarëve.

Është e vërtetë që largimi dhe migrimi është bërë për shkak të humbjes së besimit, jo vetëm me karakter ekonomike, por humbje e besimit në perspektivën e qytetarëve të vendit tonë.

Prandaj, duhet ta trajtojmë këtë me seriozitet dhe në mënyrën më të mirë të mundshme si të tillë.

Ne presim që të gjitha prioritetet, të cilat u thanë nga kryeministri, dhe u veçuan një nga një deri në nivelin e atyre udhëzimeve administrative, të cilat u thanë se janë bërë, të fokusohemi që të japim rezultate në fushën e ekonomisë, në fushën e edukimit, presim funksionalizimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore, sepse është kontribut i drejtpërdrejtë për mirëqenien e qytetarëve, presim luftimin e ekonomisë informale, zgjerimin e bazës për tatim në Republikën e Kosovës dhe presim në mënyrë të shpejtë të veprohet që t'i hapet rrugë zhvillimit ekonomik.

Ne i kemi marrë edhe disa vendime paraprakisht dhe ato kanë qenë të natyrës për pushim të taksave, të cilat do të mundësonin që ekonomia të zhvillohet dhe ky mundësim i zhvillimit të ekonomisë së Kosovës mundëson që pastaj të kemi edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gatishmërinë e qytetarëve për të qëndruar dhe për të kontribuar në ekonominë dhe në krijimin e një jete sa më të dinjitetshme në Republikën e Kosovës.

Pra, Partia Demokratike e Kosovës e përkrah fuqishëm punën e Qeverisë, duke kërkuar gjithsesi transparencë, duke kërkuar gjithsesi angazhim dhe do ta përcjellim me kujdes zbatimin e Programit qeverisës, të cilin e kemi të përbashkët dhe i cili konsiston, edhe një herë po them, në vazhdimësinë e të gjitha atyre politikave, të cilat ne si Parti Demokratike i kemi pasur në qeverisjen e kaluar dhe bashkërisht tani janë reflektuar në Programin qeverisës të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Në fillim dua të theksoj se Qeveria ia ka dorëzuar Kuvendit më 11 mars Programin qeverisës, kurse ne deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës na është shpërndarë më 13 mars. Ndërkaq kërkesa për debat është bërë më 19 mars.

Me këtë dua të them se është e qartë që Qeveria e ka realizuar atë që e ka thënë se do ta bëjë një Program të qeverisjes dhe se atë do ta dorëzojë në Kuvend.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerëson se Programi i hartuar është i tillë që në masën më të madhe është edhe i realizueshëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni t'i them disa fjali rreth raportit të paraqitur nga kryeministri Mustafa.

Qeveria Mustafa në 100 ditët e para të saj i ka aprovuar një mori dokumentesh të rëndësishme, që do të jenë udhërrëfyese i punës së saj në mandatin katërvjeçar. Përveç që e ka një program qeveritar të shkruar, është aprovuar edhe për vitet e ardhshme, përkatësisht për katër vjetët e ardhshme edhe plani i veprimit se si ky program të realizohet në praktikë.

Pra, Qeveria e ka përgatitur dhe e ka dorëzuar Programin kombëtar për reformat, veçmas për reformat ekonomike, edhe në Komisionin Evropian.

Ky program është bërë në suaza të nevojave të brendshme, por edhe të reformave të cilat shteti i Kosovës duhet t'i bëjë si reforma strukturore karshi kërkesave të Bashkimit Evropian.

Një dokument i tillë përmbledh reformat prioritare e strukturore të Qeverisë, duke u bazuar në kornizën e qëndrueshme makrofiskale. Ky dokument i është dorëzuar në kohë me kohë Komisionit Evropian dhe së fundi janë mbajtur takime të rëndësishme me këto institucione ndërkombëtare.

Krahas këtyre dokumenteve, shohim nga to që kemi si raport dhe informatë që Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet relevante të fushave të caktuara, përfshirë pra këtë Bashkimin Evropian, por edhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë, po ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit, po e përgatit po ashtu për herë të parë strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik, dokument ky që do ta trasojë rrugën e zhvillimit ekonomik, uljen e numrit të lartë të papunëve dhe bërjen e Kosovës vend të perspektivës për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë këtu.

Të nderuar kolegë deputetë,

E nisa këtë formë time të paraqitjes, për të theksuar se Qeveria, e drejtuar nga zoti Mustafa, me gjithë presionet dhe protestat, me të cilat u përball në fillim të mandatit, e që ne vlerësojmë se protesta është një e drejtë demokratike, por që këto protesta për mendimin dhe vlerësimin tonë ishin edhe me prapavijë të pastër politike dhe me momente të dhunshme, e të nxitura me dhunë të tillë.

Vlerësojmë që me nxjerrjen e disa nga dokumenteve, siç e thashë më lart, Qeveria e vendit ka nisur nga themeli, pra nga baza, sepse nxjerrja e dokumenteve të tilla janë bazë e mirë, që tregon se kjo përbërje e Qeverisë është e drejtuar nga zhvillimi ekonomik i vendit, e jo nga një turbo-folklorizëm i të mos bërit asgjë.

Qeveria e drejtuar nga zoti Mustafa që në ditën e parë ka premtuar se do t'i bëjë disa ndryshime substanciale në sistemin tatimor të vendit, me synimin që ky sistem të jetë përkrahës i rritjes dhe zhvillimit të sektorit privat në vend. Kjo tashmë veç ka ndodhur, të nderuar kolegë deputetë. E dimë të gjithë që është hartuar Ligji i ri për TVSH-në, ndërkohë që janë bërë plotësim-ndryshime në Ligjin për të ardhurat personale dhe në Ligjin për të ardhurat e korporatave.

Këto veprime janë ndërmarrë me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira për mënyrën të bërit biznes. Ligji i ri për TVSH-në që ka kaluar në Qeveri parasheh, ndërmjet tjerash, e besoj e keni pasur rastin të dëgjoni, përshkallëzimin e TVSH-së duke e ofruar një normë të zvogëluar prej 8% për një numër të konsiderueshëm të mallrave dhe shërbimeve, që konsiderohen si bazike për konsumin e qytetarëve. Ulja e kësaj norme në mënyrë direkte do të ndikojë në uljen e çmimit për këto produkte dhe në kuptim real qytetarët do të mund të blejnë më shumë me të ardhurat e tyre, të cilat asnjëherë nuk kemi thënë, e as nuk themi se janë të larta.

Për t'i stimuluar sektorët e rëndësishëm, siç është prodhimtaria, në përgjithësi, por edhe sektorët specifikë, siç është ai i teknologjisë informative dhe bujqësisë, në këto 100 ditë, kjo Qeveri ka marrë vendim për lejimin nga TVSH-ja për të gjitha makineritë për përdorim në procesin e

prodhimit, gjë që është shumë e rëndësishme, për pajisjet e teknologjisë informative, si për dhe lëndët e para që shfrytëzohen në procesin e prodhimit.

Për më tepër, në fushën e politikave tatimore, kjo Qeveri ka bërë ndryshimin në Ligjin për tatimin e të ardhurave personale dhe atë të korporatave.

Më duhet të theksoj se ne vetëm me një sektor të fuqishëm privat do të mund të arrijmë synimet e shtetit tonë për rritje të punësimit dhe përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarëve tanë.

Të nderuar deputetë,

Qeveria për këto 100 ditë, është një fakt i pamohueshëm, me votën e deputetëve të pozitës e ka shpëtuar “Trepçën” nga falimentimi dhe është hapur rruga që të krijohet një bazë ligjore për rregullimin e statusit ligjor të Kombinatit “Trepça”.

I ka bërë të gjitha përgatitjet e dokumenteve, përkatësisht marrëveshjeve që kanë të bëjnë me stabilizim-asociimin dhe ashtu, siç është thënë, pritet që kjo të nënshkruhet në mesin e këtij viti. Janë kryer edhe një mori e përgatitjeve lidhur me përmbushjen e kriterëve teknike për liberalizimin e vizave.

Të nderuar deputetë,

Jemi të vetëdijshëm që prania e ekonomisë joformale është një ndër pengesat kryesore të rritjes së mëtutjeshme të ekonomisë. Në mungesë të konkurrencës së lirë penalizohen bizneset e ndershme dhe konsumatori nuk është i mbrojtur. Në këtë drejtim janë ndërmarrë disa veprime nga dokumentet që i kemi parë dhe i kemi dëgjuar dhe tash do të kemi mundësi t’i kemi në dorë, përpos Programit, janë edhe disa veprime për ta luftuar ekonominë joformale, jo duke iu hedhur në qafë ose gjuajtur në qafë bizneseve, siç thuhet në popull, dhe afaristëve, por duke krijuar politika të atilla dhe iniciativa që do t’ua bënte bizneseve më të lehtë jetesën në ekonominë formale, se sa në informalitet.

Dhe, veprim konkret po ashtu është ndryshimi i udhëzimit administrativ për pajisjet elektronike fiskale, i cili tashmë e rregullon tregun e shitjes, i stimulon bizneset për pajisje me arka fiskale dhe po ashtu konsumatorëve u mundëson kthimin e një pjese të TVSH-së së paguar.

Vendim tjetër shumë i rëndësishëm për ne, që e vlerësojmë si grup parlamentar, si deputetë, është që Qeveria ka marrë vendim për faljen e borxheve të vjetra që i takojnë periudhës deri më 31 dhjetor 2008, i cili është marrë në mënyrë që qytetarëve t’u lehtësohet jeta dhe bizneseve aktiviteti i tyre i mëtejshëm.

Kjo Qeveri, me ta marrë mandatin, vëmendje të veçantë nga ajo që kemi parë i ka kushtuar mbylljes së vitit fiskal dhe falë angazhimit të të gjithë resorëve të saj, përmbyllja është bërë me sukses, duke përfshirë respektimin edhe të deficitit buxhetor.

Qeveria ka arritur ta aprovojë brenda afateve ligjore buxhetin e shtetit për vitin 2015.

Më lejoni të them se me qëllim të menaxhimit efektiv dhe transparent të financave janë ndërmarrë po ashtu një mori veprimesh.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këto 100 ditë të Qeverisë së zotit Mustafa, ajo e ka aprovuar programin e borxhit shtetëror për periudhën afatmesme. Kjo është bërë për t'u siguruar se niveli i borxhit publik mbetet në kuadër të limiteve të pranueshme dhe se kostoja e financimit të deficitit është më e ulët dhe kjo është diçka notore dhe që shihet.

Në të njëjtën kohë është filluar me rishikimin e tërësishëm të strategjisë së borxhit publik. Gjithnjë duke qenë konsistentë në qëndrueshmërinë buxhetore dhe nivelin e pranueshëm të borxhit publik, Qeveria në këto 100 ditë ka nënshkruar dy marrëveshje për huamarrje me Bankën Botërore për financimin e reformës shëndetësore dhe për financimin e projekteve që lidhen me eficiencën e energjisë.

Natyrisht janë bërë edhe shumë punë tjera, të cilat nuk i përmendëm, ose s'kemi mundësi t'i përmendim në këtë përmbledhje. Por, ajo që dua të them është se Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson se Qeveria Mustafa e ka bërë punën e vet në mënyrën më të mirë të mundshme për këtë periudhë të shkurtër kohore, ka filluar me përkushtim, me përgjegjësi të plotë dhe urojmë që me të njëjtin ritëm të vazhdojë deri në fund të mandatit qeverisës.

Ne si Grup Parlamentar e përkrahim raportin e paraqitur nga kryeministri Mustafa dhe unë, pa dashur të hyjë shumë në polemika, vetëm po e them këtë, nëse doni ta shihni se si nuk qeveriset mirë, keni për ta parë ose po shihet pas një viti e gjysmë në Prishtinë. Do ta shihni edhe pas dy vjetëve. Pyetini qytetarët e Prishtinës dhe duhet t'ia dinë për nder PDK-së ata që sot janë duke udhëhequr në Prishtinë, sepse do ta shihnin vetëm nga televizioni, ose duke shëtitur qytetit, sepse do të kishte mbetur vetë dëshirë e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Beqiri, shpresoj të mos ndiheni të provokuar,

Sot po diskutojmë për 100 ditët e para të Qeverisë së drejtuar nga zoti Mustafa dhe Programin qeverisës të saj. Sigurisht që secili prej nesh sot do të dëshironte të diskutonte për sukseset e kësaj qeverie, në realizimin e objektivave prioritare, që për synim do ta kishin uljen e varfërisë, rritjen e punësimit, zhvillimin ekonomik dhe, në fund të fundit, mirëqenien qytetare.

Do të na pëlqente që sot të konstatonim se si buxheti i shtetit është avancuar në një instrument serioz të mbështetjes së synimeve të Qeverisë për vizionin e saj për ndërmarrjet prodhuese të një rëndësie strategjike, apo edhe për uljen e tatimeve që, në fund të fundit, do të mundësonin që në xhepat e qytetarëve të mbeteshin më shumë para.

Mbi të gjitha do të dëshironim që ky program ta kthente optimizmin te qytetarët e Kosovës dhe besimin për një jetë më të mirë këtu. Për fat të keq, sot duhet të konstatojmë se kjo qeveri me lehtësi dhe shpejtësi e aprovoi një buxhet që mundëson gjithçka tjetër, përveç zhvillimit. Çuditërisht dhe asnjë pozicion i vetëm i buxhetit, po e përsëris, asnjë pozicion i vetëm i buxhetit nuk i reflekton prioritetet e deklaruara të zotit Mustafa.

Dhe, nëse ka dikush që mund ta demantojë bindshëm zoti Mustafa në realizimin e politikës që ka proklamuar, këtë nuk mund ta bëjë askush më mirë se buxheti që ai e ka prezantuar dhe që ky Kuvend e ka miratuar.

Më e dhimbshmeja në gjithë këtë histori është fakti që edhe vetë hartuesit e tij e kanë cilësuar si një buxhet joserioz. Në këtë frymë, nuk mund të mos përmendim qasjen e Qeverisë ndaj burimeve strategjike kombëtare. “Trepça” është shembulli më tipik i një qasjeje të tillë.

Një qeveri, e cila brenda ditës fut në presion deputetët për ta votuar shndërrimin e “Trepçës” në ndërmarrje publike, me pretekstin se kjo është mënyra e vetme për ta shpëtuar kompaninë nga likuidimi, nuk e ka fare problem që brenda orës të ndryshojë rrënjësisht qëndrimin duke na prezantuar mosvotimin e kalimit të “Trepçës” në ndërmarrje publike, si mënyra e vetme për shpëtimin e saj.

Sot do të doja të diskutonim për hapat e ndërmarrë të Qeverisë për uljen e tatimit dhe thjeshtimin e sistemit tatimor, në mënyrë që sektori publik të jetë barrë më e përballueshme për taksapaguesit.

Në vend të kësaj, përfaqësuesit qeveritarë proklamojnë në publik ulje të TVSH-së për një grup të vogël mallrash dhe shërbimesh, ndërsa në prapaskenë e rritin TVSH-në për më shumë se 1 000 artikuj të tjerë, e rritin akcizën për cigare dhe alkool, vendosin taksa të dyfishta në profitet e kompanive edhe atë prej 10%, dhe ulin pragun për regjistrim të kompanive të TVSH-së.

Ajo që shohim në praktik është rritja e normave tatimore dhe komplikimi i sistemit tatimor, pra e kundërta e asaj që proklamon Qeveria e zotit Mustafa.

Fatkeqësisht po shtohen informatat për rastet ku malli i importuar është taksuar në vlerë shumë më të lartë se vlera reale, vetëm e vetëm që të zvogëlohet sadopak diferenca ndërmjet të hyrave të realizuara dhe të planifikuara. Kjo, zonja dhe zotërinj, është plaçkitje. Do të doja të besoj se e gjithë kjo po bëhet pa dijeninë e Kabinetit të z. Mustafa.

Është fakt se 100 ditë nuk mjaftojnë për ta vlerësuar ndikimin e Qeverisë në rrjedhat ekonomike. Por, 100 ditë mjaftojnë për të parë kahet nëpër të cilat po ecën vendi. Sinjalet e para janë shumë trishtuese.

Nga mënyra se si kjo qeveri e ka trajtuar sektorin ekonomik lë për t’i konkluduar dy gjëra: mungesë serioziteti në trajtimin e një prioriteti të deklaruar si numër 1, pra prioritetin ekonomik, ose tregon paaftësi të Kabinetit qeveritar për ta vendosur relacionin e qëlluar ndërmjet objektivave të deklaruara, politikave dhe instrumenteve të zgjedhura për t’i realizuar objektivat e përcaktuar.

Pjesa tjetër e dëshpërimit vjen nga Programi qeverisës i këtij kabineti, një dokumenti që e them shumë siguri se është përpiluar shumë vite më parë dhe nuk disponon as me minimumin e lidhshmërisë, as me situatën aktuale politike, në të cilën ndodhet Kosova, e as me nevojat momentale të ekonomisë së vendit.

Nëse e shikojmë në tërësi, ky dokument në asnjë variant nuk del më i avancuar se plani i famshëm i Banjskos, i përpiluar brenda një vikendi në vendskijimet e Bullgarisë.

Nëse shikohet me kujdes pjesa dedikuar politikave fiskale, do të kuptojmë menjëherë se dokumenti është përpiluar nga individë me njohuri vetëm bazike të fushës, por shumë të aftë për të kopjuar paragrafë nga dokumentet tjera, kryesisht nga tekstet shkollore.

Ajo që vërehet në Programin qeverisës është një kaos i vërtetë në përcaktimin e prioriteteve, me ç'rast del që Qeveria përveç më tepër se 50 prioritete ka edhe rreth 15 objektiva, e besa edhe disa synime.

Por, ajo që mungon tërësisht është përcaktimi i indikatorëve për matjen e suksesit, si dhe prezantimi i instrumenteve që kjo Qeveri mendon t'i përdorë për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.

Në këtë kuptim, Programi qeverisës përngjan shumë më shumë në një program elektorale se sa në një instrument për realizimin e politikave.

Në vend të indikatorëve dhe instrumenteve, Qeveria na ofron zotime për angazhim, në shumicën e rasteve madje premtim angazhim serioz.

Më lejoni që me këtë rast të përmend vetëm disa shembuj që e ilustronin këtë joseriozitet të Qeverisë në përpilimin e politikave fiskale në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Qeveria e sheh përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit tatimor si prioritet themelor të saj dhe konstaton se ky përmirësim, krahas ndihmesës në zhvillimin ekonomik, ndihmon edhe agjendën e kohezionit social dhe ruajtjen e përparësisë krahasuese të mjedisit biznesor. Kjo është skandaloze.

Jam i bindur që po ta pyesim kryeministrin se çfarë do të thonë këta rreshta në Programin e tij nuk do të dijë t'i shpjegojë. Dikush që sadopak i kupton termet e përmendur më lart, me siguri se nuk do të lejonte formulime të tilla të pakuptimta. Pra, po flasim për një Program qeverisës, i cili jo vetëm që nuk është premtim, jo vetëm që nuk bazohet në buxhet, por ka edhe mungesë të logjikës në përpilimin e pikave të tij.

Po ashtu, Qeveria zotohet se duke i mbajtur të ulëta normat tatimore do të mundësojë rritjen e të hyrave buxhetore, një logjikë kjo e nxjerrë nga hipoteza e lakores së Lafferit, e cila, në fakt, u referohet vendeve me norma shumë më të larta tatimore.

Shikuar nga ky prizëm, del që Qeveria ose nuk u beson një formulimi të tillë, ose nuk është e vetëdijshme se çka ka futur në Programin qeverisës. Sjellja në praktike, rritja e përditshme e normave tatimore, çon në një përfundim të tillë.

Njësoj e pakuptimtë është edhe pjesa që e trajton vullnetin e Qeverisë për fiskalizimin e bizneseve, ku gjejmë formulime të palogjikshme.

E pakuptimtë është edhe dëshira e Qeverisë për ta ulur pragun tatimor për regjistrimin e bizneseve për TVSH, pa i forcuar paraprakisht kapacitetet absorbuese të Administratës Tatimore.

Hiç më mirë nuk e gjen as shpjegimin për prapavijën e shfrytëzimit të lehtësirave fiskale, meqë argumentet e përdorura në fakt shfrytëzohen për barriera tregtare, por jo për lehtësira fiskale.

Në fund, më lejoni edhe një herë t'i drejtohem Qeverisë me kërkesë që, si zhvillimit ekonomik, ashtu edhe politikave fiskale, që mendon t'i aplikojë, t'i kushtojë më shumë vëmendje e të fillojë t'i trajtojë më seriozisht. Veprimet e deritanishme nuk lënë shumë hapësirë për optimizëm në këtë drejtim.

Dhe, krejt në fund, meqë këtu u përmend Prishtina, ndoshta z. Beqaj nuk e di, por qytetarët e dinë që Prishtina që 15 vjet është kriminalizuar. Në Prishtinë për 15 vjet me radhë, përveç anëtarëve të PDK-së dhe atyre që kanë qenë afër PDK-së, nuk është punësuar askush tjetër në nivelin nacional. Dhe, e njëjta gjë ka ndodhur edhe në nivelin lokal, ku janë punësuar vetëm të afërmit, vetëm dajat e kushërinjtë e përfaqësuesve të LDK-së. E di që kryeministri e tha këtë për ndërtimet në Prishtinë, ku ka filluar të bëhet një rregull i mirëfilltë. Kryeministri tha se jashtë vendit janë duke dalë qytetarët me iPhone, pra nuk tha se janë duke dalë qytetarët me çekiç...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe 10 sekonda i kanë mbetur!

FATON TOPALLI: ...Është hera e parë që po e shoh këtu afër ministrin e Punëve të Brendshme. Kemi kërkuar disa herë prej tij ta thotë numrin e saktë të qytetarëve që janë larguar nga Kosova, meqë kryeministri nuk po e di. Çdo hyrje dhe dalje jashtë Kosovës regjistrohet në kufi. Të gjithë qytetarët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetë i kërkoje 10 sekonda, ata të kanë dëgjuar, unë nuk u thashë. Pas 15 sekondave e kanë ndalë. Jo, nuk po e mbrojë askënd, secili e mbron veten.

KRYETARI: Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Programi i Qeverisë është një program ambicioz, konciz dhe real për realitetin politik dhe qytetar të Republikës së Kosovës. Në thelb të angazhimit të Qeverisë së dalë nga marrëveshja për bashkëqeverisje ndërmjet PDK-së dhe LDK-së është zhvillimi ekonomik dhe përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova i ka realizuar etapat kryesore në konsolidimin e shtetit brenda dhe jashtë. Zgjidhjet e qershorit të vitit të kaluar janë një konfirmim i konsolidimit të brendshëm dhe shtrirjes së sovranitetit të Kosovës në tërë territorin e saj. Dëshmia më e mirë është organizimi i zgjedhjeve nacionale në gjithë territorin e vendit. Kosova është konsoliduar edhe jashtë dhe po e fuqizon subjektivitetin e vet ndërkombëtar. Konfirmim për këtë janë ftesa për ta nënshkruar me MSA-në dhe Bashkimin Evropian në pjesën e parë të këtij viti, si dhe Konferenca Rajonale “Ballkan 6”, ku është rikonfirmuar edhe një herë se Kosova është shtet shembull për bashkëpunim në rajon.

Ky konsolidim i brendshëm dhe i jashtëm ka qenë parakusht që Kosova të funksionojë si shtet. Që nga zgjedhjet e kaluara, partitë politike është mirë që janë përqendruar edhe më tepër në aspiratat dhe synimet e qytetarëve të saj. Kjo është ekonomia, zhvillimi i vendit dhe hapja e vendeve të reja të punës, që janë edhe prioritet i Qeverisë të Kosovës.

Pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit të vitit të kaluar, Kosova u vu në kërkim të formulës më të mirë qeverisëse. Rezultat i kërkimeve për Qeverinë e re ishte marrëveshja politike ndërmjet PDK-së dhe LDK-së. Kjo marrëveshje është e arsyeshme pasi dy partitë e kanë të përqendruar vëmendjen në zhvillimin ekonomik të vendit, çka është proklamuar në programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si krijimi i kushteve për investimin në Kosovë dhe hapja e vendeve të reja të punës. Kjo do të thotë infrastrukturë adekuate teknike dhe ligjore, sundim i ligjit, stimulim i prodhuesve vendorë, identifikimi i fushatave strategjike në të cilat Kosova ka mundësi zhvillimi dhe ku mund të ketë rezultate të mira. Bujqësia, energjetika dhe xehetaria janë identifikuar si fusha në të cilat Kosova mund të zhvillohet, siç e përmendi edhe kryeministri Mustafa.

Por, nuk janë lënë anash as arsimi dhe përgatitja e kuadrove për shërbimet e teknologjisë informative dhe banka. Më konkretisht, jemi duke e ndërtuar infrastrukturën, si autostradat, pastaj jemi duke zhvilluar negociata për kredi për modernizimin e hekurudhave, për ndërtimin e termocentralit të ri “Kosova e Re”, si dhe projekte për hidrocentralet e vogla gjithandej Kosovës. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe përkrahja për Gjyqësorin, rritja e buxhetit për bujqësinë dhe subvencionet për bujqësi.

Ndërsa, edhe në arenën ndërkombëtare, por edhe politika e jashtme është vënë në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit. Diplomacia ekonomike është kryefjala e politikës së jashtme. Kosova po promovohet si destinacion i ri dhe atraktiv për investime. Investimi në Qendrën e Skijimit në Brezovicë është një argument i fuqishëm për t’i tërhequr investitorët e rinj seriozë ndërkombëtarë.

Janë duke u përgatitur projekte konkrete me analiza dhe biznes-planet e elaboruara, që do t’u prezantohen investitorëve në Evropë dhe më gjerë. Prioritetet tjera të politikës së jashtme janë forcimi i shtetësisë.

Do të vazhdojmë të kërkojmë njohjen e Kosovës, por në fokus do të jetë edhe anëtarësimi i Kosovës në forume e organizata ndërkombëtare, nga ku qytetarët e Kosovës do të përfitojnë sa më shumë. Në të njëjtën kohë, i kemi vizituar vendet fqinje dhe jemi duke e vizituar rajonin, nga ku kemi promovuar fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim për të ardhmen e përbashkët euroatlantike.

Kemi mbajtur, siç e përmendi edhe kryeministri Mustafa, mbledhjen e përbashkët të të dy qeverive, me Shqipërinë. Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Maqedoninë dhe presim shumë shpejt edhe mbajtjen e përbashkët të mbledhjes së dy qeverive, të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë. Po e përmbysim demarkacionin me Mal të Zi. E kemi vazhduar dialogun për normalizimin e marrëdhënieve të plota me Serbinë.

Gjithashtu kemi zhvilluar kontakte dhe vizita edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani dhe vende tjera për ta konfirmuar partneritetin tonë, synimet dhe vizionin tonë që të jemi pjesë e NATO-s dhe e Bashkimit Evropian, ndërsa në takimet “B 6” kemi dëshmuar se jemi partnerë i barabartë në rajon dhe lider në promovimin bashkëpunimit për të ardhmen rajonale.

Synimet afatshkurtra për këtë vit do të vazhdojnë të jenë nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, aplikimi për anëtarësimin në Këshillin e Evropës, si dhe ta bindim Komisionin Evropian që brenda të këtij viti të rekomandojë liberalizimin e regjimit të vizave për Kosovën.

Synime afatgjata mbeten fuqizimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës me theks të veçantë në sigurimin e njohjes nga 5-shja e Bashkimit Evropian, që ende nuk e ka njohur Kosovën, si dhe puna për t’u bërë anëtar i Kombeve të Bashkuara.

Kosova sot e ka stabilitetin dhe fuqinë politike për t’i shtyrë përpara interesat e qytetarëve të vet, prandaj Qeveria e saj e gëzon besimin dhe mbështetjen e shumicës së qytetarëve. Po, autostradat janë duke vazhduar edhe për Shkup, edhe për Pejë, edhe për Mitrovicë, edhe kjo tjetra Prishtinë-Nish do të vazhdojë dhe siç e përmendi edhe kryeministri tani jemi në fazën mjaft të rëndësishme të fillimit të projektit të autostradës Prishtinë-Gjilan, Donikë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Punëve të Brendshme, Skënder Hyseni, e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Programi që para jush sot e deklamoi kryeministri Mustafa është i sajuar me kujdes dhe mbulon fushat prioritare, duke i përcaktuar objektivat të qartë dhe instrumente dhe kornizë të qartë për arritjen e objektivave.

Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë këtyre muajve të qeverisjes ka bërë punë të madhe dhe ka qenë e angazhuar intensivisht në aktivitetet e ngjeshura ndërkombëtare për ta rritur përkrahjen ndërkombëtare, në rend të parë përkrahjen evropiane për disa objektiva madhore në fushën e rendit dhe të ligjit.

Pra, unë do të përqendrohem në fushën e rendit dhe të ligjit, përkatësisht në prioritetet që i ka vendosur Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë sektor.

Gjatë muajve të kaluar ka pasur një aktivitet të ngjeshur ndërkombëtar për ta rritur përkrahjen, e cila është evidente dhe shumë shpejt do t'i japë rezultatet e saj për anëtarësimin e mëtejshëm të Republikës së Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë të bashkëpunimit policor, për arritjen e marrëveshjeve të shumta bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në rend të parë, për bashkëpunim policor dhe në fushën e rendit dhe të ligjit.

Gjatë muajve të kaluar është zhvilluar dhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë dhe përmbajtësor substancial ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve anëtare të BE-së, veç e veç, dhe si tërësi në adresimin e çështjeve jetike dhe urgjente, siç ishte migrimi i parregullt ose ilegal, quajeni si të doni.

Republika e Kosovës ka bërë gjithçka që është e mundur që qytetarëve të Kosovës t'u shpjegojë, t'u përcjellë mesazhin e qartë se migrimi ilegal nuk është zgjidhje, duke pasur parasysh që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian e kanë thënë qartë dhe pa ekuivoke se të gjithë do të kthehen. Si do që të jetë, falë bashkëpunimit të shkëlqyeshëm të Policisë të Kosovës dhe të organeve të rendit dhe ligjit në Kosovë, me "Europol"-in dhe vendet anëtare të BE-së, veç e veç, është arritur sukses i pakontestueshëm dhe i madh në zbulimin dhe arrestimin e një rrjeti të madh trafikantësh me njerëz - 77 në vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian dhe në Kosovë. Ky sukses ka ardhur ekskluzivisht falë bashkëpunimit të ngushtë të institucioneve të rendit dhe ligjit të Republikës së Kosovës me "Europol"-in dhe me policitë individuale të vendeve anëtare individualisht.

Liberalizimi i vizave ka qenë dhe mbetet prioritet i Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe, edhe këtu, unë ju siguroj, në emër të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe në emër të gjithë asaj që bie në këtë dikaster, se janë bërë përpertime të ndjeshme, jo vetëm në këtë sektor, por në të gjithë sektorët e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe jemi shumë afër përmbylljes definitive të kriterëve teknike dhe krejt natyreshëm dhe me të drejtë presim që Bashkimi Evropian të marrë vendim që të mos e mbajë Kosovën të izoluar si të vetme në Ballkanin Perëndimor nga regjimi i lëvizjes pa viza në zonën Shengen.

Unë po e përmbyllë këtu, duke konstatuar dhe duke theksuar para qytetarëve të Republikës së Kosovës se të gjitha shqetësimet e tyre janë duke u adresuar në mënyrë sektoriale dhe sërish flas për sektorin tim. Dhe, rezultatet do të vijnë, pashmangshëm. Kushdo që pret se do të ndodhin mrekullitë brenda tre muajsh, ose është në lajthitje, ose nuk e ka idenë elementare të qeverisjes. Faleminderit!

KRYETARI: Ramush Haradinaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër,

I nderuar kryesues,

Shikoni, një fjalë të gjatë, prej një katër-pesë faqesh po e reduktoj në dy-tri momente kyçe, se ndoshta edhe jeni mërzitur duke dëgjuar.

E para, për t'u ndryshuar gjendja në Kosovë besoni s'mund të ikim pa e trajtuar edhe një temë, që njihet si shtet i kapur, kapja e shtetit. Në rast se nuk e trajtojmë këtë temë, e në çfarë mase mund ta shkapim nuk e di, ose mundeni, por në rast se i ikni krejt kësaj teme, nuk shoh që drejtimi është i mirë.

E dyta, që po ashtu e ka peshën e madhe, a mund ta ndalim korrupsionin, ose për ta zvogëluar, ose për të punuar institucionet, në njëfarë mënyre që korrupsioni s'e shkatërron Kosovën.

E treta, është kjo që bëtë ju sot, për t' i kryer punët e shtëpisë, detyrat qeverisëse, sa mbërrini, sa mundeni, në aftësinë e dijen e juaj. Një aspekt tjetër është i rëndësishëm, a mund të jemi partnerë të qëndrueshëm të tjerëve. Pra, në fushën e sigurisë, se në atë politike besoj ka përparime, e dimë, që ka, por a mundemi edhe të jemi partnerë ekonomikë, pra të sjellim investime në vend, që të mund pastaj ne edhe ju të kalkulojmë e kush e ka interesimin, sa do të rritet bruto-produkti në 2018-ën, sa vende të punës i hapim deri atëherë, sa e zvogëlojmë papunësinë, si dhe a do të ndryshohet struktura e shkëmbimeve tregtare në mes Kosovës dhe të tjerëve, pra eksport-import dhe a do të ndryshohet standardi i njerëzve tanë. Këto janë parametrat me të cilat ne duhet të përballemi sot, por jo vetëm sot, me siguri se edhe në të ardhmen.

Sipas bindjes sime, në rast se nuk e trajtoni në këtë mënyrë gjendjen në vend, besoni, sado që mendoni se ua kam inati, s'ka dert, ju do ta fundosni edhe Kosovën edhe vetveten, edhe këtë Qeveri. Pra, në rast se s'e kuptoni se shkapja e shtetit është parametër i parë, ndalja e korrupsionit është shumë e rëndësishme, punët e shtëpisë, detyrat qeverisëse, s'ka dilemë që e kanë peshën e vet, partneriteti i qëndrueshëm, sidomos në sferën ekonomike e do të shkojmë gabim, do të shkojmë keq, kur të takohemi tjetër herë për ballafaqim me gjendjen do të jemi më keq se sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Nisma", Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Se jemi në një situatë paradoksale, tregon edhe ky moment i diskutimit. Qytetarët që e shikojnë këtë debat, nuk e kanë të qartë se çka është duke u debatuar, a po bisedohet për programin qeveritar, apo për 100-ditëshin.

Në vend se sot të bisedojmë tamam për 100-ditëshin nga programi që është bërë me fillimin e qeverisjes, ne sot do të bisedonim për atë çka ka mundur të bëjë ky program për 100 ditë e çka s'ka mundur. Mungesa e programit, duhet folur për zhvillimet që kanë dalë për 100 ditë në vendin tonë, në qeverisjen e koalicionit qeverisës.

Së pari, prej ditës së parë ka qenë e qartë që ne kemi një vazhdimësi të qeverisjes në planin e investimeve ekonomike, po flas. Këtë e dëshmon miratimi i buxhetit i hartuar e i përgatitur nga Qeveria e kaluar. Natyrisht, nuk besoj që dikush pret që ndryshime cilësore në zhvillimin ekonomik mund të ndodhin për 100 ditë. Këto janë të pamundura.

Për 100 ditë jepet një uverturë se kah do të shkojë, në aspektin e planit dhe zhvillimit ekonomik të vendit tonë dhe, nuk besoj që ne këtu do të duhej të merremi me atë se çka ka bërë Qeveria në planin ekonomik për 100 ditë, sepse do të ishte e padrejtë dhe e pamundur për 100 ditë të shihet.

Ajo çka po them unë, është se ne kemi vazhdimësi të qeverisjes dhe pak a shumë e dimë se si do të shkojë buxheti këtë vit, i hartuar nga qeverisja e kaluar.

Po mirë, çka ka mundur të ndodhë për 100 ditë? Natyrisht, ka pasur mundësi për këto 100 ditë të ndodhin shumë gjëra, për të dhënë një shembull, se qeverisja e re do të bëjë hapa ndryshe nga qeverisja e kaluar, do të ketë një shkëputje, një mentalitet tjetër qeverisës dhe një dëshirë për t'i ndryshuar gjërat, një demonstrim për t'i ndryshuar gjërat në kuptimin pozitiv.

Në këto 100 ditë, kemi parë edhe aty, për të treguar se klima e Qeverisë është goxha e vështirë dhe e rëndë për të treguar hapat se do të ketë një qeverisje ndryshe, tregon më së miri se edhe ndonjë përpjekje e ndonjë ministri, për t'i kapur gjërat dhe për ta futur një frymë ndryshe në qeverisje, nganjëherë keni parë edhe në medie dhe jashtë medieve, se ka një prapavijë, një disponim për ta sulmuar çdo përpjekje të një ministri për të ndryshuar gjendjen, aty-këtu ndonjë ministër që po përpiqet për të pasur një frymë ose një ndryshim në logjikën, mentalitetin dhe mënyrën e qeverisjes, nga ajo që ne po e shohim.

Domethënë, klima është të vazhdohet status quo-ja, të mos priset balanca dhe në këtë mënyrë çka mund të bëjmë rrugës. Kjo është ajo që ka ndodhur këto 100 ditë, nga ajo që ne e kemi parë, të paktën.

E thashë edhe më herët, çka ka mundur të ndodhë për 100 ditë të kaluara? Unë mendoj, se kanë mundur të ndodhin disa gjëra, disa hapa të rëndësishëm për të demonstruar se do të kemi një qeverisje ndryshe. Ka shkëndija, që ne nuk mund të mos i pranojmë. Për shembull, ka shkëndija, që ka tendenca me qenë më transparente se sa në të kaluarën. Për shembull, thuhet "S'ka mundësi të rriten pagat!" Është një gjë që duhet përsëritur, sepse gjendja është kështu.

Ka tendenca, sikurse u tha "FAK-u nuk mund të shkojë në veri". S'është thënë sot, kryeministri e ka bërë publike, por kjo është më 2011 e 2012, është kjo marrëveshje e hershme, që FAK-u nuk mund të shkojë në veri, por ne të paktën po e dëgjojmë nga Qeveria sot. E tani, a është e drejtë a s'është e drejtë, besoj se do të vijë koha kur do të debatojmë për këtë.

Por, unë inkurajoj që edhe gjendjen e rëndë edhe të mirë, çfarëdo që të jetë, është mirë sa më shumë transparente ta bëjmë transparente, sepse ka nevojë njerëzit ta dinë se në cilën gjendje jemi, sepse pastaj edhe përgjegjësia është më e vogël, ose të paktën e dimë pse s'po mund të bëhen gjërat, për të cilat presin njerëzit që të bëhen.

Çka ka ndodhur për 100 ditë? Çka ka mundur të ndodhë e çka ne kemi pritur? Për shembull, kemi pritur që do të kemi, siç ka qenë e premtuar vazhdimisht dhe është kritikuar se do të kemi një qeveri më të vogël, ka ndodhur e kundërta. Kemi një qeveri më të madhe. Kemi shtim të ministrive dhe kemi emërim të zëvendësministrave, në mënyrën që po e shohim si po emërohen. Kjo ka mundur të ndodhë, kjo ka qenë një shenjë e demonstrimit, se do ta bëjmë një qeveri më të vogël, sepse të gjithë e kemi kritikuar Qeverinë e madhe në qeverisjen e kaluar. Tash, është e

vërtetë që s'kemi 5 zëvendësministra, por i kemi dy apo tri ministri më tepër, pak a shumë, po rritet Qeveria dhe, kjo ka qenë dashur të ndodhë e kundërta.

Është e vërtetë, që për 100 ditë Qeveria aktuale është ballafaquar menjëherë me pakënaqësi dhe greva, pakënaqësi në rritje për gjendjen ekonomike-sociale të qytetarëve dhe pastaj edhe në greva të sektorëve të caktuar. Po, s'është faji i opozitës pse është rritur pakënaqësia dhe pse kemi greva, faji është i premtimeve, i mashttimeve, i premtimeve që ua kanë bërë arsimtarëve, që ua kanë bërë sektorëve të ndryshëm, se do të ketë rritje të pagave. Dhe, kur këta sektorë, këta njerëz e kanë parë që në buxhetin e miratuar në Parlamentin e Kosovës, nuk do të ketë rritje të pagave, siç u është premtuar në fushatën elektorale, natyrisht, ata kanë shprehur pakënaqësinë e tyre, duke demonstruar edhe me greva.

Kjo pastaj, ju ka hequr atyre çdo shpresë, sepse janë mësuar të gënjenen nga ministri i Financave, pastaj edhe nga kryeministri duke thënë që s'ka para. Kjo është gjendja!

Dhe, kjo ka ndodhur, ky tension, ky presion i Qeverisë ka ndodhur për shkak të premtimeve të rrejshme apo mashttimeve.

E dyta, u fol për protesta. Si erdhi deri te shkak i protestave? Dikush tha, ka pasur prapavijë politike këtu. Edhe unë besoj, se s'ka protestë tjetër, përveç politike. Çdo protestë është politike. Por, shkaqet? Si ka ardhur deri te protesta? Kush e provokoi protestën, si erdhi deri te protesta? Përsëri nga Kabineti qeveritar.

Një anëtar i Kabinetit qeveritar ka ofenduar qytetarët e këtij vendi dhe, hezitimi i Qeverisë për ta marrë në përgjegjësi atë anëtar të Kabinetit, në një mënyrë apo tjetër, ka krijuar shkaqet për të ardhur deri te ajo protestë që erdhi e në fund edhe u përmbyll ajo siç u përmbyll.

U fol për... ne nuk kemi asnjë indicie, ne kemi pritur që në 100 ditë të paktën të kemi demonstrim të indiceve, se në sektorë të caktuar po fillohet një erë e re, një ndryshim i gjendjes. Gati pothuaj, nuk ka sektor në Republikën e Kosovës, që nuk është në një gjendje kaotike, që ballafaqohen me probleme të natyrave të ndryshme, të gjitha sektorët. Ama, unë do të ndalem në dy a tri, të cilat janë tepër të rëndësishme, e cila do të krijonte shpresën dhe mundësinë që këtu edhe të ndryshohet gjendja dhe të hapet mundësia e perspektivës së zhvillimit ekonomiko-social të këtij vendi.

U fol për shkapjen e shtetit. Jo që s'ka asnjë sinjal në drejtim, që çon se këtu po demonstrohet dhe do të punohet në shkapjen e institucioneve të pavarura të këtij vendi, por e kemi një situatë goxha të rëndë. Sistemi i drejtësisë në vendin tonë është para kolapsit. Mund të mos na bëjë përshtypje, natyrisht, secili i ka bindjet e veta, realitetin e kemi.

Imagjinoni, në një Këshill Prokurorial dalin prokurorët dhe e akuzojnë njëri -tjetrin. Prokurorët thotë, një grup thotë, është i kapur nga bandat kriminele, ky tjetri thotë është i shantazhuar, kështu ndodh edhe në Gjykatën Supreme. Kemi grevën edhe të gjyqtarëve, domethënë, sistemi ynë i drejtësisë, fatkeqësisht, është para një kolapsi.

Që të jem i qartë, detyrë, obligim për ta ruajtur funksionimin e sistemit të drejtësisë në këtë vend, është përgjegjësi e Qeverisë. Është diçka tjetër të ndërhyhet në drejtësi, diçka tjetër është të ruhet funksionimi i sistemit të drejtësisë, që fatkeqësisht, nuk po ndodh. E dimë në çfarë situatë është sot dhe, çfarë do të prodhojë, sidomos greva dhe ajo që po ndodh.

Ne po futemi në një proces të komprometuar të një Gjykate Supreme dhe ajo që ka ndodhur, qoftë në Këshillin Gjyqësor, qoftë në Këshillin Prokurorial dhe kjo do të ketë pasoja për shtetin ligjor. Dhe, kjo është një sinjal negativ, jo që s'kemi shkapje, por fatkeqësisht, krejt ajo çka ka ndodhur për vite të tëra po shpërfaqet, po shpërfaqet gjendja dhe kemi me qenë para një krize dhe, unë pres që Qeveria shumë seriozisht të fillojë të mendojë e të merret me këtë çështje.

Në ndërmarrje publike e kemi situatën kaotike. Shikoni çfarë është duke ndodhur në Radio-Televizionin e Kosovës, kemi një menaxhment, i cili sillet sikur të ishte pronë e tij private. Kemi një instalim të censurës, kemi një seleksionim të lajmeve, kemi seleksionim të ngjarjeve, gazetarët janë të frikësuar dhe të orientuar politikisht, ku duhet të shkojë e të paraqesë ngjarje e ku s'duhet të paraqesë ngjarjet. Kemi një televizion, jo më shtetëror, se po të ishte shtetëror do të ishte mirë, por kemi televizion në shërbim të individëve, të individëve të kufizuar, se ky është televizion dhe, as i Qeverisë nuk është ky televizion krejt, se të ishte i Qeverisë, bile kishim thënë diçka, po as i Qeverisë nuk është krejt.

Dhe, ne heshtim dhe, ne shkojmë themi- shkojmë të votojmë edhe shkojmë me votë. E bëjmë edhe me votë, por dëmet nuk mund të ndalen, pasojat do t'i kemi, do t'i shohim në të ardhmen.

Çka është duke ndodhur në sektorë tjerë të veçantë? Mua më vjen keq për shumë ministra këtu mbrapa, të cilët e kanë vullnetin dhe unë besoj se e kanë vullnetin për të punuar, po këta mirë e dinë se në çfarë gjendje i kanë sektorët e vet dhe me çfarë ballafaqohen. Është momenti, të nderuar miq, në qoftë se doni të realizoni ato pritje për të cilat, po flasim në emër të qytetarëve, filloni seriozisht t'i zgjidhni problemet e grumbulluara me vite dhe t'ua ktheni shpresën këtyre njerëzve.

Më së lehti është me u gjuajt pozitivë dhe opozitivë. Edhe nëse gjuhemi pozitivë-opozitivë, ju gjithmonë do të fitoni, sepse jeni shumicë. Mos e ndalni, po që se doni kështu. Por, ju siguroj se me këtë mentalitet, nëse shkojmë në atë mënyrë, në fund do të dëmtohet më së shumti vendi e përmes vendit do të dëmtoheni ju si shumicë, në qoftë se nuk reflektoni drejt me ato që keni.

Këto 100 ditë... çka do të bëhet në të ardhmen, do të shohim. Por, ne presim nga kryeministri e Qeveria, që tash e tutje më mos të na lexojë programe, se çka ka për të bërë, por të na tregojë çka ka bërë.

Dhe në fund, po e mbyll. A e vërejtët një gjë? Situata është e rëndë në këtë qeverisje. Gjithkund në botë del kryeministri e raporton për punën e vet, kryeministri për Kabinetin qeveritar. Ne sot i patëm dy raporte, Qeveria Mustafa dhe Qeveria Thaçi. Skenderit iu duk që po mbetet prapa, u çua edhe Skenda, edhe ky ta bëjë një raport.

Dhe, ky mentalitet po s'e ndërruam këtë klimë, po s'e dimë kush është adresa, një zot shtëpie edhe me u bë ekip për të punua, do ta shihni, siç... unë s'e kam fort gajle, pse ju nuk pajtoheni

njëri me tjetrin, por dëmi është tek vendi. Pres që edhe në këtë drejtim të punoni shumë, që të paktën, bile këtu në Parlament, ne e dimë qysh jeni në mes vete, po të paktën në Parlament, mos dilni dy qeveri, këtu.

Ne sot dëgjuam raportin e dy qeverive. Kjo s'ka ndodhur kurrkund e s'bën të ndodhë as te ne! Ishalla, herën tjetër, raporti tjetër nuk bëhen më shumë se një! Po, siç ka filluar Skenda, ku me e ditë tash këtu mbas Skendës kujt i ka mbetur merak... Faleminderit!

KRYETARI: Qerim Bajrami, ju lutem, “6+”-i.

ČERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Poštovani poslanici,

Parlamentarna grupa “6+” podržava izveštaj premijera o 100 dana rada Vlade Republike Kosova. Smatramo da je minuli period veoma kratak da bi se donosile kritike ili ocjene o preduzetim mjerama, međutim mnogi od preduzetih poteza, koje ovde izložio premijer najavljuju kretanje u pozitivnom pravcu u svim sferama u Republici Kosovo.

Podržavamo i konstruktivna izlaganja naših koalicionih partnera iz parlamentarnih grupa PDK i LDK u vezi konkretnih planova i koraka, koje je vladajuća većina preduzela u minulom periodu.

Što se tiče naših specifičnih očekivanja od ove Vlade, mi predstavnici Bošnjaka, Turaka, Aškalija i Roma iz Parlamentarne Grupe “6+” očekujemo da Vlada i njena ministarstva što prije popuni svoj kabinet sa zamjenicima ministara iz nevećinskih zajednica, odnosno iz naše parlamentarne grupe.

Očekujemo također da se sva ministarstva pozabave zasebnim problemima pripadnika nevećinskih zajednica u Republici Kosovo zasebno sa našim zahtjevima za decentralizacijom, sa zahtjevima za poboljšavanje stanja u obrazovanju na bosanskom i turskom jeziku, i tako dalje.

Posebno očekujemo od Vlade, da se ozbiljno pozabavi i problemom malog broja zaposlenih pripadnika naših zajednica, odnosno službenika u institucijama, zasebno u institucijama na centralnom nivou.

Također očekujemo i nastavak investicija u infrastrukturne projekte u sredinama gde žive pripadnici nevećinskih zajednica. Posebno očekujemo od ministarstva poljoprivrede podršku poljoprivrednim proizvođačima u brdsko planinskim područjima, što nije vezano samo za naše sredine, nego za sve sredine na Kosovu. Smatramo da su ova područja zanemarena u programu i planovima tog ministarstva.

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Uzimajući u obzir da smo mi koalicioni partneri, nastavićemo da podržavamo i da pružamo podršku Vladi u svim dobrim potezima za dobrobit svih građana u Republici Kosovo. Zahvaljujemo!

KRYETARI: Zoti Hyseni ka kërkuar replikë, po zoti Limaj nuk është këtu, zoti Hyseni. Atëherë, ministri Hyseni, replikë.

MINISTRI SKENDER HYSENI: S'ka lidhje që s'është Famiri, këtu, se i ka kolegët që ia përcjellin. Merrni shënime!

Fatmir Limaj, si duket, edhe pse ka qenë gjatë në Qeveri, ka harruar që kur bëhet fjalë për 100-ditëshin e Qeverisë, të gjithë ministrat kanë të drejtë dhe duhet të flasin për punën e vet dhe, jo vetëm kryeministri apo zëvendëskryeministri.

Do të ishte fyerje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, nëse secili ministër, Fatmir, kudo që je po ta them tash, nuk do ta merrte fjalën dhe t'u përgjigjej observimeve veç e veç të deputetëve. Prandaj, përpjekja për ta luajtur këtu njëfarë interpretuesi të Kanunit, siç di Fatmiri të jetë nganjëherë, është totalisht e dështuar.

Ai kanune mund të interpretojë diku tjetër, por jo në Kuvend të Kosovës. Kuvendi i Kosovës sot po debaton për 100 ditë të Qeverisë Mustafa dhe secili anëtar i Kabinetit Mustafa, është i obliguar të flasë para jush dhe të tregojë çka ka bërë gjatë 100 ditëve të kaluara. Faleminderit !

KRYETARI: Zafir Berisha, kundër-replikë nga "Nisma", pasi ministri iu drejtua Grupit Parlamentar, pastaj.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Është një e vërtetë, zoti ministër, që kur të dalësh të flasësh është mirë të thuash diçka, por ju në fakt nuk thatë asgjë dhe, natyrisht, se u morët nëpër gojë, përndryshe nuk prezantuan. Do të ishte mirë të prezantoni, se çfarë masash keni ndërmarrë për miliona euro, që kanë humbur para disa ditësh në Ministrinë tuaj, për vrasjet që ndodhin për çdo ditë në Kosovë dhe, ky është roli juaj dhe duhet t'u tregoni deputetëve, jo të tregoni "muhalife" në Parlament, sa për t'ua marrë kohën deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, kalojmë në pjesën e diskutimeve në bazë të paraqitjes së deputetëve. I kemi aktualisht 34 deputetë të paraqitur për diskutim. Do të fillojmë me Shaip Mujën, pa Grup, u japim privilegj, pasi që janë pa grup.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më zure kështu të befasuar, sepse prita të akumuloj se çka po thonë këtu, mirëpo, unë dua t'i them vetëm dy fjali.

Unë jam dakord, që programi qeveritar nuk është diskutuar nga deputetët këtu dhe, si rrjedhojë ne nuk do të nxjerrim asgjë si rezultat për 100-ditëshin, i cili ka ndodhur, sepse kanë qenë vërtet disa veprime të cilat edhe nuk mund të nxjerrin ndonjë cilësi, sepse ka punuar Qeveria pa një program dhe pa një orientim.

Mirëpo, duke e marrë këtë programin që e kemi aktualisht dhe, nëse e zhveshim gjuhësisht nga pjesa dëshirore, që paraqitet në këtë program, ky program shndërrohet vetëm në dy faqe

përmbajtjesore, nga 90 faqe. Dhe, mënyra dëshirore e paraqitjes së propozimeve dhe kërkesave janë shumë interesante.

Në Komisionin ku unë veproj në bujqësi, ka një romantizëm dhe ka një paraqitje të dëshirave, të cilat nga kultivimi i kivit, që do të bëhet në Republikën e Kosovës e deri tek strukturimi i organizimit bujqësor dhe, thuhet në një fragment, thuhet për të arritur standardet evropiane, ne do ta futim Agjencinë e Ushqimit dhe Kontrollit të Ushqimeve nën Ministrinë e Bujqësisë. Kjo, jo që s'është standard, por është anti-standard evropian. Kjo, jo që s'është politikë, siç bëhet edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por është në kundërshtim me politikat e pavarësisë së institucioneve të tilla. Në aspektin e politikave shëndetësore të cilat janë edhe nga grupet parlamentare, këtu që i dëgjova, janë dëshirore dhe jo përmbajtjesore e kohore, problemet janë evidente, politikat sektoriale të cilat janë duke dështuar në sektorin publik, janë evidente, struktura e sigurimit shëndetësor është spekulative, sepse vetë nga buxheti i Kosovës paraqitet i shpërndarë Ligji për sigurimet shëndetësore nuk do ta krijojë përmbajtjen deri në vitin 2018 dhe publikut i krijohet përshtypja se do bëhet këtë vit dhe çdo vit sa herë çdo ministër ka pasur krizë, ka deklaruar se pas gjashtë muajsh do të bëhen këto.

Janë duke dështuar në strukturat e sektorëve të veçantë, siç janë për shembull në Kardiokirurgji, sot nuk është duke funksionuar për shkak të keqmenaxhimit, keqplanifikimit, keqorgnizimit të politikave kuadrore për të gjetur strukturën kuadrore që do punojë në atë institucion. Kush është fajtor këtu? Janë fajtorë të gjithë ministrat, përshtirë tash e dhe ky që ka ardhur i riu, ndoshta nga kjo mjegull mund të orientohet pak, por siç po e shoh është duke u mjegulluar edhe më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë do të vazhdojmë me radhën e diskutuesve, në bazë të grupeve parlamentare. Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Diskutimin tim do ta filloj me atë që u tha edhe në fillim se duhet të jemi të vetëdijshëm se pas një ngërçi gjashtëmuor ka vështirësi në ecje normale, sepse pas çdo ngërçi mbesin pasojat dhe ecja vështirësohet. Dhe, gjithsesi kur kjo ecje vështirësohet nga hedhjet me gurë, atëherë normalisht se zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale do të jetë një vështirësi e radhës, por kështu mendojmë se do të arrijmë pastaj me ecje normale për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien më të mirë sociale.

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimin sot do ta fokusoj në dy sektorë, në shëndetësi dhe në zhvillimin ekonomik, në programin qeverisës është planifikuar reforma në shëndetësi dhe në zhvillimin ekonomik, por për këto 100 ditë qytetarët kanë pritur hapat e parë në reformën shëndetësore duke shprehur mirëkuptimin për ministrin Rrahmani që ka marrë ta udhëheqë njërin nga resurset më problematike dhe më të ndjeshëm, por është edhe një fakt më se evident se nuk ka pasur asnjë shenjë pozitive në zhvillimin apo përparimin e shëndetësisë.

Kjo gjendje në shëndetësi është jo se nuk kemi mjekë të zot e të aftë, jo se nuk kemi hapësirën e nevojshme dhe aparaturë të nevojshme shëndetësore, por shëndetësia po dështon në menaxhim,

në funksionim të sistemit shëndetësor, në furnizim me barna, në menaxhimin human në kuadër të këtij sistemi.

Reforma shëndetësore duhet t'i përmbahet udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetit, që ajo të jetë e suksesshme, sipas udhëzimeve të Organizatës së Organizatës Botërore të Shëndetit, 80 deri 85% e shërbimeve shëndetësore duhet të kryhet në sektorin primar dhe sekondar, ndërsa vetëm 15% në sektorin terciar, ndërsa ne kemi një sistem shëndetësor që nuk punon në këtë princip, sepse regjioni i Prishtinës e përbën: Prishtinën, Besianën, Obiliqin, Fushë Kosovën, Drenasin apo thënë më shkurt 1/3 e popullsisë, nuk ka fare të organizuar sistemin sekondar, ndërsa regjioni si Prizreni, Gjiçani, Ferizaj, Gjakova, Peja dhe Mitrovica e kanë gjysmë të organizuar sistemin shëndetësor sekondar dhe edhe këta i referojnë pacientët në Qendrën Klinike Universitare dhe kështu bëhet një ngufatje e patolerueshme në Qendrën Klinike Universitare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithsesi kur jemi te sektori terciar duhet të theksojmë edhe dy probleme kyçe që janë në organizimin e saj. Shuarja e Qendrës Klinike Universitare si sistem terciar edhe pse funksionimi i saj parashihet me ligj dhe me Statutin e SHQKUK-së, menaxhimi human jo i mirë sot në Qendrën Klinike Universitare në shumë klinika ka vështirësi për arsye se shumë mjek sot apo shumë reparte e klinika ka më shumë mjekë se sa që ka shtretër për pacientë. Anomalia në organizimin e sistemit shëndetësor sot është kur shihet se Prishtina nuk ka fare spital regjional, ndërsa Mitrovica i ka tri gjysmë spitale regjionale në 11 kilometra vi ajrore, Spitali regjional në Vushtrri, ai i Mitrovicës dhe i Mitrovicës veriore dhe që të tri këto spitale lënë shumë për të dëshiruar për punën e cila bëhet.

Miratimi i një pakoje të ligjeve nga legjislatura e kaluar si Ligji për shëndetësi dhe Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë, dhe Ligji për sigurime shëndetësore, ka qenë një bazë e mjaftueshme për fillimin e reformës shëndetësore dhe unë personalisht kam pritur një lehtësi tani për ministrin Rrahmani që ta fillojë këtë reformë shëndetësore bazuar në këto pako të ligjeve të cilin e kemi filin e kemi filluar. Kjo pako e ligjeve ka qenë e mjaftueshme për fillimin e reformën shëndetësore dhe ne nuk mund të presim një përmirësim të sistemit shëndetësor dhe një reformë shëndetësore dhe një shëndetësi bashkëkohore pa pasur të organizuar mirë sistemin e informimit shëndetësor dhe pa implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja e dytë që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik. Zhvillimi ekonomik parashihet edhe me programin qeverisës dhe është një nga objektivat kryesore dhe edhe unë si deputet e mirëpres një gjë të tillë dhe sigurisht se ky zhvillim ekonomik do të jetë përmes promovimit të biznesit privat dhe stimulimit të biznesit privat, por gjithsesi edhe një nga fokuset tona sigurisht që është edhe në zhvillimin makro ekonomik apo në zhvillimin e ndërmarrjeve të mëdha siç është "Trepça".

"Trepça" kohëve të fundit ka qenë temë e debateve të shpeshta dhe të nxehta në Kuvendin e Kosovës, në media dhe në opinionin publik për shkak të rëndësisë strategjike që ka në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ishim dëshmitarë se "Trepça" shkonte drejt likuidimit dhe të gjithë bëmë përpjekje dhe u angazhuam që "Trepçën" ta shpëtojmë nga një likuidim për t'ia dhënë rrugën e zhvillimit.

Sot nuk do të lavdëroj askënd për veprimet që kemi ndërmarrë për ta shpëtuar a ringjallur dhe organizuar “Trepçën”, sepse atë e kemi detyrim kushtetues dhe pres një qasje edhe më aktive në realizimin e objektivave për “Trepçën” nëpërmjet Programit qeverisës.

Kështu do të duhej të ishte edhe për ata të cilët sot janë vënë në krye të “Trepçës”, që në fakt ata janë duke bërë të kundërtën. Ata po dëshmojnë se aty nuk janë për interesa të “Trepçës”. Këtë e dëshmuuan edhe me një njoftim të datës 9 mars dhe ditën e djeshme ku menaxhmenti njoftoi opinionin e gjerë se “Trepçën” e kanë sjellë në gjendje të rëndë financiare dhe sipas tyre në këtë situatë ata kanë ardhur për arsye të mungesës së licencës për shfrytëzim që u ka skaduar më datë 24 janar.

Ky njoftim i menaxhmentit të “Trepçës” ishte një tentativë e paskrupullt të manipulimit të opinionit publik, sepse sipas Ligjit për miniera dhe minerale neni 36, pika 4, në rrethana të veçanta në ushtrimin e funksionit të tij të arsyeshëm KPM-ja mund të vazhdojë periudhën në fjalë për një periudhë shtesë për 3 muajve, domethënë në rastet kur nuk refuzohet licenca aplikuesit i lejohet vazhdimi i saj edhe për 3 muaj shtesë e në rastin e “Trepçës” i bie se licenca e “Trepçës” është e lejueshme deri me 24 prill dhe të gjithë ata që edhe këtu edhe në media kanë tentuar ta paraqesin “Trepçën” buzë falimentimit në mungesë të licencës, është e pavërtetë.

Menaxhmenti i “Trepçës” duke e parë gjendjen buzë falimentimit në të cilën e ka sjell këtë gjigant industrial, provoi që fajin t’ia hedhë institucioneve qendrore, për borxhet ndaj operatorëve ekonomikë, borxhet për shërbime publike, blerja e makinerisë së vjetër për të re dhe realizimi i projekteve jo fitimprurëse për “Trepçën”, dështimin në shitjen e koncentratit dhe krijimi i ekstra përfitimit të menaxhmentit, për veten e tyre në kundërshtim me Ligjin siç është rasti me ... e shpëtimit dhe shumë të tjera dëshmojnë se fajtor për “Trepçën” janë menaxhmenti i saj dhe jo Qeveria e Kosovës dhe nuk mund t’ia hedhim fajin për këtë Qeverisë.

Gjithsesi në programin qeverisës, në strategjinë dhe në Ligjin për “Trepçën” duhet të jetë një nga objektivat kryesor, pasi që dështoi likuidimi dhe falimentimi juridik i “Trepçës” sot si duket dikush ka provuar ta bëjë një falimentim operacional dhe Qeveria duhet të jetë e vëmendshme, për këtë sepse ne presim një zhvillim ekonomik nëpërmjet zhvillimit të “Trepçës” dhe zhvillimit të sektorit privat. Faleminderit!

KRYETARI: Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, Kabinet qeveritar, Sot vërtet duhet të falënderojmë kryeministrin për një raportim përmes të cilit u jep shpresë qytetarëve të Kosovës së Qeverisë Mustafa, me të cilin raportim do ta nxjerr vendin, pra po i njofton qytetarët e këtij vendi që do ta nxjerrë vendin nga kriza ekonomike dhe sociale.

Ne, sot po diskutojmë për 100 ditë qeverisje me rezultate konkrete dhe po debatojmë për programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Çka duhet të jetë qëllimi i këtij debati për qytetarët e Kosovës? Qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të kuptojnë se çfarë ka ndodhur për këto 100 ditë dhe çka planifikohet për të ardhmen e këtij vendi, dhe ne si deputetë duhet të jemi korrektë, duhet të jemi profesionalistë.

Unë pajtohem që këtu jemi pozitivë- opozitivë, por natyrisht gjithçka duhet thënë me argumente, sepse tek fundi i fundit, secili prej nesh që jemi ulur këtu në këto ulëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kemi një qëllim që Kosovën ta bëjmë më të mirë dhe qytetarët e Republikës së Kosovës të jenë të kënaqur me vendin dhe me zhvillimin e vendit të tyre.

Kjo Qeveri është e vetme pas lufte që nuk iu dhanë as 5 minuta afat për të filluar punën. Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar punën me protesta, një herë dhe në radhë të parë me një vonesë e cila kishte një krizë të thellë dhe të gjatë institucionale, me greva në arsim, shëndetësi, në drejtësi, me problemin e aprovimit të buxhetit, me protesta nga opozita e eskaluar në dhunë, ballafaqim me problemin e “Trepçës” pra, grevën e minatorëve dhe fluksin e migrimit në dy muajt e parë të këtij viti, i nxitur nga krimi i organizuar, që vërtet tashmë edhe jemi dëshmitarë që janë arrestuar deri 80 persona për këtë çështje.

Unë shkurtimisht do të flas, sepse u fol shumë edhe për 100-ditëshin, edhe për programin e Qeverisë. Pra, shkurt po ndalem, Qeveria e Kosovës për këto 100 ditë ka hartuar 4 dokumente shumë të rëndësishme, siç janë: Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me dokument përcjellës, pra Planin e punës së Qeverisë, nën 3 raporti për 100 ditë punë të Qeverisë Mustafa dhe 4 është Strategjia kombëtare e zhvillimit të Republikës së Kosovës.

Kolegë deputetë, 80 faqe të raportit për 100 ditë pune, unë po përmend vetëm këto gjëra. Ne jemi të gjithë dëshmitarë që me rastin e aprovimit të buxhetit të këtij viti janë marrë masa për kursime deri në 14 milionë euro dhe ato po vazhdojnë.

Kjo Qeveri për 100 ditë i ka sjellë dhe aprovuar 28 ligje, janë proceduar në Kuvend, pra për vetëm 100 ditë. Është bërë falja e borxheve, është në përgatitje legjislacioni për ndryshimet e politikave tatimore dhe fiskale dhe po thuaj se është një ndryshim në thellësi të politika fiskale dhe natyrisht se këto të gjitha po i përcjell një transparencë krejt tjetër fare.

Për të mos marrë kohë shumë, unë dua të ndalem në pika të shkurtra, vetëm në aspektin ekonomik, pra sa i përket programit. Unë dua t’ju siguroj qytetarëve të Republikës së Kosovës se vërtet gjithçka ka filluar për të ndryshuar dhe kjo na garanton edhe vetë programi i cili ndalet pra në 5 ose është i hartuar në 5 fusha, në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, punësim dhe mirëqenie, sundimin e ligjit dhe shtetit ligjor, agjendën evropiane dhe politikat e jashtme, arsimi, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor dhe shëndetësia moderne.

Unë po ndalem vetëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe atë në mënyrë telegrafike dua t’i përmend disa gjëra.

Qeveria, nëpërmjet këtij programi synon në reformimin e politikave tatimore që përmes kësaj reforme të bëhet rritja e të hyrave të përgjithshme në buxhet krahas mbajtjes së niveleve të ulëta tatimore, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme të investimeve të huaja, ruajtje të një mjedisi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm tatimor, kushte këto të cilat janë me rëndësi për rritjen e biznesit vendor dhe tërheqjen e investitorëve të huaj, zgjerimin e bazës tatimore përmes reformës fiskale dhe përmirësimit në inkasim nëpërmjet luftimit më zbrazëtirave ligjore dhe evazionit fiskal.

Qeveria, pra nëpërmjet këtij programi na thotë se do të aplikojë një politikë tatimore të thjeshtë, me procedura të thjeshta të deklarimit të tatimeve, nëpërmjet avancimit të sistemit elektronik të raportimit dhe të kontrollit.

Qeveria do të punojë në përmbylljen e procesit të fiskalizimit të të gjitha bizneseve. Paralelisht me ngritjen e të hyrave nga tatimi i brendshëm do të ulët pragu i pagesës së TVSH-së në mënyrë progresive. Përshkallëzimi i TVSH-së do të nënkuptonte uljen e normës së TVSH për produktet bazike si buka, qumështi, vaji, uji i pijshëm e tjera dhe në të njëjtën kohë mbajtja e TVSH-së në zero për produktet primare bujqësore, do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e prodhimit dhe në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, duke bërë zëvendësimin e produkteve të importuara pra me ato vendore.

Ulja e pragut të TVSH-së - Qeveria do të angazhohet për t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të uljes së pragut të TVSH-së dhe siç e kemi dëgjuar këto ditë ministrin e Financave, pra TVSH-ja do të ndryshojë prej 50 mijë deri në 20 mijë euro, ulja e pragut do ta rriste bazën tatimore, pra për rreth diku 1 500 biznese dhe të krijonte të hyra shtesë.

Pushimet nga taksat - Edhe kjo është në kuadër të politikave tatimore, të aplikohen pushimet tatimore për bizneset që investojnë një shumë të konsiderueshme dhe gjenerojnë vende të reja të punës. Është parim i përgjithshëm i pushimeve tatimore që ato funksionojnë më së miri kur e kanë afatin e skadencës së përcaktuar.

Do të përgatitet një pako për investitorë që do t'i lirojë ata nga tatimi në korporata dhe nga pagesa e TVSH-së për investimet kapitale në varësi të nivelit të investimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë. Ilir Deda e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit! Deputetë të nderuar, 100-ditëshi i një qeverie zakonisht tregon drejtimin si do të qeverisë dhe dinamikën e reformave dhe veprimeve të cilat kjo qeveri i merr. Ne, fatkeqësisht, në ditën e sodit nuk kemi parë dhe nuk mund të diskutojmë as për ndonjë drejtim e as për dinamikë të qeverisjes.

Ne, në këtë kohë kemi dëgjuar fjalë që tingëllojnë bukur, veprime të cilat nuk përcillen me veprime dhe shohim që në këtë 100-ditësh ka më shumë inercion, mungesë të iniciativës dhe me të vërtetë injorim të problemeve të qytetarëve të Kosovës.

Dhe, çka dëgjuam ne dje dhe sot? Ne po dëgjojmë një ankesë të përgjithshme për protestat e janarit, për shkarkimin e Jablanoviqit dhe këto protesta kanë mund të evitohen në qoftë se do ta kishte shkarkuar kryeministri menjëherë, Aleksandar Jablanoviqin dhe mos të kishte pritur një muaj ditë, dhe dy një lëvdatë të jashtëzakonshme me punën e vetëm një ministri - ministri të Ekonomisë, zotit Hoti.

Në rregull, por qeveria mbas 100 ditëve duhet të tregojë suksesin në çdo dikaster, jo një ankesë me disa protesta dhe jo të ketë lëvdatë me punë vetëm të një ministri.

Dhe, saktësisht para 112 ditëve është votuar Qeveria në këtë Kuvend. Në ditën e 21-të Qeveria e ka aprovuar buxhetin e qeverisë paraprake. Në ditën e 63-të Qeveria e sjell një marrëveshje antikushtetuese nga Brukseli, Marrëveshja për drejtësi, në ditën e 91-të e sjell para qytetarëve të Kosovës apo para deputetëve në Kuvend, programin qeverisës dhe kjo është dita e 112-të prej që ne e kemi Qeverinë dhe diskutojmë për punën apo mos punën e saj.

Dhe, duke marrë parasysh inercionin dhe mungesën e shkathhtësisë, ne kemi problem të diskutojmë për rezultate. Për këtë arsye diskutohet për programin i cili na është paraqitur dhe fatkeqësisht nuk përcillet me programin për zbatim të këtij programi qeverisës.

Dhe, në 112 ditë prej që ekziston kjo Qeveri, ne dëgjojmë se si prioritet shtetëror për Kosovën dhe të zhvillimit dhe transformimit shoqëror ekonomik dhe politik të Republikës së Kosovës, është integrimi në Bashkimin Evropian.

Mua më ka interesuar shumë për ta parë si e sheh Qeveria këtë proces dhe mund t'ju them se me 2 faqe të cilat kanë 9 paragrafë dhe e përshkruajnë vizionin e Qeverisë, kam dalë jashtëzakonisht i zhgënjyer.

Pse? Sepse Qeveria e sheh boshtin e integritit evropian në dy sfera, në MSA-në dhe në liberalizimin e vizave. Dhe, po që se është kështu, atëherë injorohet apo nuk ndahet me deputetët e Kuvendit që MSA realisht e subordonon integritimin e Kosovës në BE drejt me dialogun me Serbinë. Pse? Sepse Marrëveshja për Stabilizim-Asociim të cilën e ka aprovuar Qeveria e Kosovës, kushtëzohet vetëm me një instrument, apo kushtëzohet vetëm me zbatimin e rezultateve dhe marrëveshjeve të cilat arrihen në dialog me Serbinë, në Bruksel.

Kjo është problematike. Asnjë shtet tjetër në rajon nuk ka pasur kësi lloj kushti në rrugëtimin e vet për BE-në.

Dy, në vend se të ketë një definim të marrëdhënieve bilaterale të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, me atë me MSA, ne këto marrëdhënie i definojmë Prishtinë-Beograd-Bruksel, prapë është problematike.

Dhe, në vend se të ndërlihet MSA dhe kushtet për Kosovë të jenë lufta kundër korrupsionit, sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik i jonë, forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar, ai ndërlihet vetëm me marrëveshjet me Republikën e Serbisë.

Dhe, në këtë MSA e cila në program qeverisës thuhet se do ta forcojë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, nuk parashihet njohja e Kosovës si shtet. Në atë MSA e cila është shtylla e vizionit qeverisës të Qeverisë për Bashkimin Evropian, Kosova realisht definohet si entitet, domethënë një MSA të tillë kanë mund ta nënshkruajnë entitetet si Palestina apo Tajvani, jo si shtetet e tjera.

Dhe, pastaj thuhet se me MSA-në Kosova do të fillojë të ketë zhvillim të gjithmbarshëm ekonomik e shoqëror që njëjtë nuk është e vërtetë. Sepse vetë dy dokumente të Qeverisë, një i cili e ka emrin analiza e ndjeshmërisë dhe e dyta i cili është studimi i vlerësimit të impaktit të MSA-së, tregon që Kosova absolutisht nuk do të përfitojë ekonomikisht asnjë gjë nga MSA-ja,

përkundrazi, do të rritet numri i importit nga BE për 7%, ndërsa eksport për BE nuk do të ketë, rrjedhimisht nuk do të ketë as rritje të prodhimit në Kosovë dhe as zhvillim ekonomik.

Dhe, pjesa politike e MSA-s asgjë nuk ndryshon, sepse BE-a nuk merr përsipër obligim që Kosovën ta shohë si pjesë të bashkësisë ndërkombëtare, ashtu si e ka marrë për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe përkundrazi, MSA e tillë, e që në program qeverisës është forcim i subjektivitetit të Republikës së Kosovës, kjo MSA e ngurtëson trajtimin e Kosovës si jo shtet. Dhe, kjo është problem.

Dhe, është një pjesë tjetër që është liberalizimi i vizave, i cili realisht nuk e ka vendin aspak në fushën e integritit evropian, sepse liberalizimi i vizave s'ka të bëjë asgjë me integritim evropian. Liberalizim të vizave ka Tajvani, liberalizim të vizave ka Kolumbia, liberalizim të vizave ka Moldavia. Domethënë, nuk ka të bëjë kjo me integritim evropian dhe për të ta sqaroj, ekziston edhe liberalizimi i vizave me shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Britaninë e Madhe. A do të thotë që nëse një ditë do të vijmë deri te ai liberalizim i vizave, ne do të themi me këtë logjikë të cilën e kemi lexuar, se Kosova po shkon në drejtim të integritimeve amerikane apo angleze. Mos, të lutem, udhëtimi i lirë është diçka tjetër, që nuk ndërlidhet me procesin e integritit ekonomik e politik të Kosovës, e veprimet në këto 100 ditë të gjithë Qeverisë në fushën prioritare të integritit evropian janë zero. Domethënë nëse e shihni punën e 21 dikastereve qeverisëse nuk ka avancim në këtë fushë. Fatkeqësisht, kjo tregon se ne nuk e kuptojmë, Qeveria nuk e kupton rëndësinë e këtij procesi. Por, ekziston diçka tjetër.

Dy prioritetet tjera të Qeverisë, të cilat nuk po thuhën, janë krijimi i bashkësisë së komunave me shumicë serbe dhe krijimi i Gjykatës Speciale. E asnjëra nga këto të dyja nuk na çojnë në Bashkim Evropian. Dhe, fatkeqësisht, pa luftim të korrupsionit e të krimit të organizuar, pa hetim të zyrtarëve të lartë publikë për korrupsion dhe krim të organizuar, dhe me zero veprime në 112 ditë në luftën kundër korrupsionit dhe të krimit të organizuar nuk kemi për ta parë as integritimin evropian, e as Evropën.

Dhe, në fund, nuk na keni dhënë përgjigje qysh do ta forconi subjektivitetin ndërkombëtar karshi Bashkimit Evropian? Nuk na keni treguar çfarë ndodh në qoftë se akomodohet edhe më tej fusnota në vend të Republikës së Kosovës? Tek e fundit, ne jemi deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e ju jeni Qeveri e Republikës së Kosovës. Dhe, këto çështje duhet t'i diskutoni me shumë seriozitet në Kuvendin e Republikës. Faleminderit!

KRYETARI: Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministri si duket u lodh dhe shkoi, por unë megjithatë do ta filloj diskutimin mbi bazën e asaj se çka diskutoi dhe prezantoi këtu para deputetëve, e që në fakt nuk lidhet me ndonjë pjesë programore ose punë, por më shumë me atë se çka po e ndien me ndjenja kryeministri.

Dhe, filloi duke thënë që “ne mburremi me vetveten”. Tash do të duhej që qytetarët të mburren me Qeverinë, e jo anasjelltas - kryeministri dhe Qeveria të mburren me vetveten, sepse mburra

në këtë mënyrë, në këtë koncept dhe kuptim, siç e ka kuptuar kryeministri, nuk është ndonjë virtut i cili ndihmon zhvillimin e vendit, ose qytetarët.

Pastaj tha që “ne nuk po i rritim pagat”, por foli në emër të një farë kohezioni social, të cilin e kemi dëgjuar ka një kohë të gjatë, kur thotë që “do të bëjmë një harmonizim të të ardhurave dhe do të hapim vende të reja pune, sepse ka të varfër që kanë nevojë të punësohen”, dhe ne të gjithë jetojmë në Kosovë dhe e dimë që është ashtu. Mirëpo, ndoshta kryeministri duhet të fillojë nga vetvetja, të mos i mbajë pesë vende pune, për shembull, por të lejojë që katër të rinj të punësohen, ndërkohë që ai ta kryejë orarin e vet të plotë edhe ta ketë një performansë pak më të lartë, ta ketë një dinamikë pak më ndryshe.

Pastaj tha që LDK-ja i ka marrë votat mirë demokratike dhe “ju s’keni të drejtë në njëfarë forme as të kërkon llogari dhe s’na keni lënë të punojmë”. Edhe nëse është kështu, këto vota në mënyrë demokratike janë barrë mbi bazën e premtimeve që 40% do t’i rritin pagat. Madje kur PDK-ja thoshte 25%, ministri Hoti dilte dhe kundërshtonte, thoshte “jo, ne LDK-ja do t’i rritim 40%, se e kemi planin për zhvillimin ekonomik”. Tash po del që nuk po rriten as 25%, as 40%.

Dhe, e ka shkruar në program që bujqësia deri sot nuk është marrë seriozisht aspak. Sa mua më kujtohet, në të kaluarën Sektori i bujqësisë është udhëhequr prej PDK-së, e edhe tash po vazhdon të udhëhiqet prej saj. Prandaj, nuk po e shoh që ka avancuar diçka në atë kuptim, ose që do të merret më seriozisht tash se kryeministër është Isa Mustafa, se nuk e ka asnjë veprim konkret, ose nuk e ka rritur buxhetin, ose nuk e ka shtuar asnjë mekanizëm matës mbi bazën e të cilit do të shohim që bujqësia do të jetë prioritet, s’ka qenë prioritet, s’është marrë seriozisht, e tash merret seriozisht.

Dhe, disa nga karakteristikat të cilat i kemi parë në këto 100 ditë, unë fillimisht do t’i ndaja në tri segmente kryesore të funksionimit të mirëfilltë të një shteti modern.

1. Nëse shohin në planin e brendshëm për 100 ditë - 50 mijë, 70 mijë, 100 mijë, ende nuk e dimë se asnjë ministër nuk doli me shifra konkrete, por një numër shumë i madh i qytetarëve të Kosovës u shpërngulën dhe u shpërngulën nga humbja e shpresës. Dhe, asnjë veprim më i vogël nuk u ndërmor, asnjë veprim paralajmërues për zhvillim ekonomik, për punësim dhe rrjedhimisht për përmirësim të mirëqenie. Ndodhi e kundërta.

2. Në planin e sigurisë dhe mbrojtës ishte një dështim i plotë në formimin e ushtrisë dhe një dështim i plotë në krijimin e një ambienti të sigurt për qytetarët. Në këta 100 ditë kemi pasur rritje të dhunës dhe të pasigurisë.

3. Në planin e jashtëm, për 100 ditë s’e kemi pasur asnjë njohje. E kemi pasur një turne të ministrit të Jashtëm, por si duket sa më shumë që ka shëtitur, që ka lëvizur më pak kemi pasur vullnet prej shteteve të tjera për të na njohur. Dhe 100 ditët e para, edhe pse në një Qeveri të re do të duhej të kishte shumë më shumë energji dhe shumë më shumë veprim, në fakt këto 100 ditët e para nuk kanë dalluar aspak nga 100 ditët e fundit të Qeverisë Thaçi. Ka qenë një vazhdimësi, meqë është zbatuar, për shembull, në përpikëri edhe buxheti i përgatitur nga PDK-ja.

Për të mos marrë shumë kohë, do t'i lexoj disa nga dështimet e evidentuara në 100-ditëshin e Qeverisë Mustafa. I kam të shënuara 100, por besoj që brenda kohës së paraparë për ne nuk do të mund t'i prezantoj të gjitha, edhe pse qytetarët i dinë.

1. Qeveria Mustafa-Thaçi konfirmoi se premtimi për 120 mijë, rrjedhimisht 200 mijë vende të punës, ishte mashtrim parazgjedhor.
2. Qeveria Mustafa-Thaçi konfirmoi se premtimi për rritje pagash 40% dhe 25% ishte mashtrim parazgjedhor.
3. Qeveria Mustafa-Thaçi konfirmoi se Kontrata Kolektive ishte një mashtrim parazgjedhor.
4. Qeveria Mustafa-Thaçi konfirmoi se Fondi i Punësimit ishte në fakt fondi i mashtrimit parazgjedhor.
5. Qeveria Mustafa-Thaçi konfirmoi se Fondi për shërimin e sëmundjeve të rënda ishte mashtrim po ashtu parazgjedhor.
6. Edhe kryeministri Mustafa, edhe kryeministri Thaçi, konfirmuan se programet e partive të tyre, LDK dhe PDK, ishin programe të bazuara në mashtrim elektorale.
7. Madje, kryeministri Mustafa tha “po këto i kemi premtuar gjatë zgjedhjeve”, disi kështu, domethënë edhe e konfirmoi që jemi të vetëdijshëm për mashtrim, por vazhdojmë.
8. Kryeministri Mustafa e mashtroi Kosovën edhe në mënyrë deklarative, por edhe me veprimet e tij më shumë se një herë gjatë kësaj periudhe dhe sidomos pas zgjedhjeve.
9. Kryeministri Mustafa premtoi zvogëlimin e resorëve ministrorë, por pasi u bë kryeministër e rriti Qeverinë edhe për dy ministri.
10. Kryeministri Mustafa premtoi rishikim të të gjitha vendimeve të Qeverisë Thaçi pas zgjedhjeve të 8 qershorit, por asnjë rishikim nuk e bërë, përkundrazi vazhdoi në plotëni zbatimin e këtyre politikave.
11. Kryeministri Mustafa buxhetin e përgatitur nga Qeveria Thaçi, e të cilin e kishte kritikuar ashpër, bashkë me ministrin e vet të Financave, e solli në Kuvend dhe e aprovoi pa asnjë ndryshim.
12. Kryeministri Mustafa as 100 ditë pas marrjes së përgjegjësisë nuk ka guxim që ta përmbyllë procesin e konstituimit të Qeverisë.
13. Paramendojeni një Qeveri e cila as për 100 nuk është konstituuar.
14. Ai dhe kryeministri Thaçi çdo javë kontrabandojnë në heshtje nga dy-tre zëvendësministra të frikësuar se zgjedhja e menjëhershme shkakton reaksion përkatës të militantët dhe në partitë e tyre.

15. Kryeministri Mustafa kishte premtuar me shumë konsideratë për barazinë gjinore në Qeveri, ndërkohë që ka vetëm dy femra të cilat morën përgjegjësi ministrore. Ndërkohë që e prapaktheu Kosovën sa u përket çështjeve gjinore. Dhe, nëse ju kujtohet dhe besoj grave të Kosovës ju kujtohet, e sidomos votuesve të tij u kujtohet që në ato tubime pompoze elektorale thoshte “në Kabinetin Mustafa do të jenë 50% gra dhe 50% burra” dhe, kryeministër, nga 22 ministri dy gra nuk janë 50%. Besoj që e dini matematikën.

16. S’po e përmend edhe një herë që rreth 100 mijë qytetarë e braktisën Kosovën gjatë këtij 100-ditëshi. Dhe, ju përpjesëtojeni se sa veta e kanë lëshuar Kosovën brenda një dite.

17. Qeveria Mustafa ishte indiferente në procesin e ikjes masive të qytetarëve nga Kosova. Nuk është në rregull që ju nuk keni shkuar në Stacionin e Autobusëve dhe nuk është në rregull që ju në vazhdimësi e keni shndërruar gjithë reagimin tuaj në një slogan që “ne nuk jemi fajtorë”. Ju jeni fajtor dhe jeni përgjegjës dhe keni marrë përgjegjësi, prandaj këto përgjegjësi duhet t’i zbatoni.

18. Mosrespektimi i rezolutës së Kuvendit të Kosovës për ndaljen e migrimit masiv - na tregona për 100 ditë a keni mbërri ta zbatoni një pikë, sepse shumë nga këta të ikur dhe të shpërngulur tani po kthehen dhe do të kthehen dhe do të jenë një barrë e rëndë sociale, sepse kanë shitur krejt çfarë kanë pasur kur kanë ikur, e sigurisht i-Phone-t nuk janë zgjedhje që ata të vazhdojnë të jetojnë këtu me një të tillë.

19. Kryeministri Mustafa, në vend të keqardhjes për vdekjen e një fëmije shqiptar me sindromin “Dawn” në Suboticë, e drejtoi gishtin e fajtorit te prindërit e tij dhe mendoj se kjo çfarë e tha sot në fakt është e tepërt për t’u komentuar.

20. Kryeministri Mustafa premtoi se liberalizimi i vizave do të ndodhë në fillim të vitit 2015, kurse vartësi i tij, ministri Çollaku, thotë ndoshta në vitin 2016. A bën t’i harmonizojnë qëndrimet edhe të dalin sot para Kuvendit e të na tregojnë se ku kemi mbërri sa i përket liberalizimit të vizave. Edhe pse asnjë ministër i Punëve të Brendshme, thënë të drejtën para qytetarëve të Kosovës, me këtë shkallë të korrupsionit, e cila në asnjë moment nuk po luftohet, nuk do të nënshkruajë për liberalizim të vizave për kosovarët.

21. Të rinjtë dhe të rejat tona me këtë qasje dhe mungesë të dinamikave për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën, se edhe deputetët po kanë dëshirë.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kam mbërri te pika 23, e sigurisht se do të duhen edhe shumë minuta për t’i prezantuar 100 dështimet, por realisht do t’ia lëmë kohës dhe qytetarëve, sepse ajo çka është parë në fillimet e para, nëse dita e mirë shihet me mëngjes, është parë që kjo Qeveri në përfundim të 200-ditëshit do të jetë aq e lodhur dhe e dërmuar e pa energji dhe dinamika, sa Kosova do të udhëhiqet dhe qeveriset edhe më keq se në të kaluarën.

E kam thënë shumë herë në këtë foltore se s'ka më keq, e po më duket që e keqja s'paska fund - paska edhe më keq! Faleminderit!

KRYETARI: Ministri Arsim Bajrami, le të përgatitet Valdete Bajrami.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Besoj që tema që unë do ta ngre do të jetë një temë që do të na bashkojë dhe do të na përkushtojë më tepër. Është sektori i katërt i Programit qeveritar, sektori i arsimit.

Më lejoni që pas një prezantimi të shtyllave të Programit në sektorin e arsimit, të prezantoj edhe të arriturat e 100-ditëshit të parë me parametra shumë konkretë.

Deri më tani kam raportuar dy herë para komisionit parlamentar dhe është kënaqësi që për herë të parë mund të prezantoj të arriturat e pas 100-ditëshit të parë.

Pas investimeve të mëdha që ka bërë Qeveria e kaluar në infrastrukturë, sidomos në përmirësimin e pozitës materiale, shtyllë e Programit të ri qeveritar në sektorin e arsimit është ngritja e standardeve të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit, kur them standarde të cilësisë mendoj në tri dimensionet e standardeve të cilësisë.

E para, standardet e politikave publike në sektorin e arsimit, duke rishikuar legjislacionin dhe strategjitë për t'i avancuar ato me trendët moderne.

Momentumi i dytë, standardet e mësimdhënies, duke promovuar një mësimdhënie moderne me mësimdhënës të përgatitur, me mësimdhënës të kualifikuar që e ndërtojnë karrierën e vet gjatë gjithë jetës.

Momentumi i tretë i standardit të cilësisë është ndërrimi i metodologjisë së mësimdhënies, duke promovuar në të gjitha shkollat dhe në universitet tona një mësimdhënie moderne të shekullit XXI, që është një kombinim i mësimdhënies digjitale dhe mësimdhënies manuale.

Shtylla e dytë e Programit qeveritar është përshtatja e sektorit të arsimit programeve arsimore, nga arsimi parauniversitar, arsimi profesional dhe universitar nevojave të tregut të punës, sepse definitivisht arsimi duhet të lidhet me ekonominë dhe me zhvillimin ekonomik dhe ne jemi në procesin e përshtatjes së programeve tona arsimore nevojave të tregut të punës.

Kemi lansuar projektin e madh me Bashkimin Evropian, që nënkupton që çdo program shkollor duhet ta marrë parasysh tregun e punës.

Dhe, sektori i tretë ku ne po fokusohemi është reforma e arsimit të lartë, stabilizimi i zonës kombëtare të arsimit të lartë dhe më vonë do t'i prezantoj edhe hapat e 100-ditëshit të parë.

Më lejoni tani të jem shumë konkret me të gjithë sektorët e arsimit, sepse ne po kalojmë nga sistemi i arsimit me dy nivele te sistemi i arsimit me katër nivele dhe ky është trendi më i ri evropian, që ne e kemi parë dhe jemi duke e implementuar në Kosovë me shumë përkushtim dhe me shumë përgjegjësi.

Po filloj me nivelin e parë, arsimi para universitar, apo arsimi ‘zero’, që përfshin reformimin e sektorit të kopshteve të tona.

Këto ditë me Qeverinë zvicerane, përkatësisht me “Karitasin” zviceran kemi nënshkruar kontratën për furnizimin e 150 çerdheve tona me pajisje moderne për mësimdhënie moderne për fëmijët tanë të moshës së hershme dhe për trajnimin e mësimdhënësve, edukatorëve për mësimdhënie argëtuese me fëmijët tanë dhe jemi duke zhvilluar projektin e gjithëpërfshirjes që asnjë fëmijë i asnjë komuniteti të mos jetë jashtë sistemit të arsimit parauniversitar.

Tani më lejoni të prezantoj çfarë kemi bërë në 100 ditët e para tek arsimi parauniversitar.

E para, jemi kah e rishikojmë kurrikulën. Kurrikula e Kosovës është një kurrikulë moderne, por jemi duke e rishikuar për ta balancuar mësimdhënien praktike me atë teorike.

E kemi pilotuar në 92 shkolla dhe jemi duke i parë rezultatet. Më 14 prill fillon projekti “...”, që është projekt global evropian, që do të na tregojë se çfarë inteligjence kanë fëmijët tanë dhe pa dyshim se ky tregues duhet të merret shumë realisht dhe ne duhet t’i nxjerrim konsekuencat.

Momentum i dytë tek arsimi parauniversitar është reformimi i maturës shtetërore. Për shumë pak kohë do të vijë në Kuvend Ligji për maturën shtetërore, i cili ka kalua në Parlament. Është një reformim në interes të qytetarëve, në interes të nxënësve, sepse ne e kemi mënjeluar parimin e kalueshmërisë, duke e zëvendësuar me parimin e arritshmërisë, sepse dëshirojmë që ta ruajmë standardin e cilësisë dhe t’i stimulojmë mësuesit tanë që jo vetëm në maturë, por gjatë gjithë arsimit parauniversitar ta ruajnë standardin e cilësisë. Kjo është një gjë shumë e mirë, e cila do t’i mundësojë secilit fëmijë që të ketë të drejtë të konkurrojë për universitet, kur ne po krijojmë mekanizma të kontrollit të cilësisë gjatë gjithë kohës së tyre.

Pastaj, siç e thashë edhe më herët, jemi duke zhvilluar bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian për ta studiuar tregun e punës dhe dëshira jonë është që sa më shumë nxënësit tanë të orientohen drejtë arsimit profesional, një trend evropian, një trend kryesisht i modelit gjerman dhe zviceran, ku shumica e fëmijëve orientohen kah një punësim i shpejtë, kah një treg i shpejtë i punës, kah një arsim profesional dhe jemi duke e promovuar edhe projektin e ndërtimit të karrierës gjatë gjithë jetës.

Çka do të thotë? Do të ndërtojmë dy karriera: karrierën e mësimdhënësve gjithë jetën, në mënyrë që çdo mësimdhënës, i cili tani e ka kontratën e përhershme në dorë, sepse kemi dhënë kontratën e përhershme, gjatë gjithë jetës ta ngrejë performansën e vet, ta ngrejë karrierën e vetë dhe t’i përsosë metodat e veta, ta kapë trendin modern të digjitalizimit të shkollës.

Dhe, ndërtimi i karrierës tërë jetën për fëmijët tanë, sepse fëmijët tanë do të kërkojnë gjithmonë një punë të shpejtë, por gjithmonë edhe kohë për ta ndërtuar karrierën nga arsimi parauniversitar deri te arsimi elitar akademik.

Jemi duke e reformuar mekanizmin e Inspektoratit të Arsimit, një mekanizëm shumë i rëndësishëm për matjen e performansës së kualitetit të mësimdhënies, dhe jemi duke e zhvilluar një plan strategjik me inspektoratin, në mënyrë që ta kemi një inspektorat të modelit evropian. Nuk e fsheh që e kemi marrë modelin slloven, ku inspektorati është mekanizmi më i rëndësishëm i ruajtjes së kualitetit dhe cilësisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni ta prezantoj tani planin tonë, apo rezultatet tona për sektorin e arsimit të lartë, apo sektorin e arsimit universitar.

Kemi filluar ndryshime strukturore dhe shumë shpejt në Kuvend do të vijë dy ligje sistemore, dy ligje bazike: Ligji për arsimin e lartë dhe Ligji për profesione të rregulluara. Do të thotë, Kosova do t'i praktikojë praktikatat evropiane të profesioneve të rregulluara.

Ju e dini se para pak muajsh kemi pasur shumë debate edhe në këtë Parlament për gjendjen e arsimit të lartë. Dhe, ju e dini se edhe legjislatura e kaluar ka diskutuar. Këta katër muaj kemi arritur ta qetësojmë situatën. Këta katër muaj është folur shumë për autonominë e Universitetit, e nuk është folur për politizimin e tij. Nuk keni dëgjuar këta katër muaj akuza për politizim të Universitetit. Keni dëgjuar vetëm përpjekje të singërta për qetësimin e situatës, për autonominë e Universitetit dhe ne kemi qenë shumë të kujdesshëm në menaxhimin e situatave çfarë i kemi.

Ligji për arsimin e lartë do të ndërtojë një konsensus akademik ndërmjet profesorëve, studentëve, shoqërisë civile, partive politike për rolin e universiteteve në shekullin XXI.

Dhe, unë dëshiroj qysh tani t'i falënderoj partitë opozitare të cilat i kanë deleguar ekspertët në Komisionin e Ministrisë së Arsimit dhe ata po punojnë bashkë në proceset e draftimit të këtyre ligjeve dhe kjo është një praktikë e mirë, meqë sektori i arsimit të lartë merret si sektor i depolitizuar dhe për mua ka qenë një kënaqësi e veçantë që t'i kyç këta ekspertë të cilët po punojnë. Janë ekspertë më të mirë që ka Kosova dhe jam i sigurt se me Ligjin për arsimin e lartë ne do ta stabilizojmë trendin, do të krijojmë konkurrencë ndërmjet universiteteve dhe secili universitet do ta ketë performansën e vet. Qeveria asnjëherë nuk do të ndërhyjë në autonominë e Universitetit, por do t'i rrisë kërkesat për llogaridhënie, sidomos për llogaridhënie për sa i përket cilësisë, sepse ne dëshirojmë universitet cilësorë.

Të nderuar deputetë,

Siç e keni përcjellë punën e Ministrisë, ne jemi duke e rishikuar sektorin privat të ministrisë, dhe ju keni parë shumë vendime me të cilat ne edhe e kemi mbyllur institucione private jolegjitime, të cilat nuk e pranojnë kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, që është një kornizë evropiane.

Momentum i dytë për të cilin ne do të debatojmë shumë me ju në Parlament do të jetë momenti kur do të vijë këtu Ligji për profesionet e rregulluara dhe atëherë do të ketë nevojë për sqarime shtesë, por debate televizive, sepse kjo është një praktikë e munguar evropiane.

Ky ligj do të vendosë rend dhe cilësi sa i përket kualitetit të diplomave universitare. Universitetet do të japin diploma master, bachelor, por edhe doktorata, por Qeveria ka të drejtë t'i kontrollojë standardet e profesionit. Dhe, ne sipas një udhëzimit të Bashkimit Evropian do t'i caktojmë standardet e profesionit, do të fillojmë me shtatë sosh. Kjo do të thotë që secili inxhinier, secili mjek, agronom, para se të plasohet në tregun e punës duhet ta japë tekstin shtetëror të profesionit. Është diçka që e ka ndërtuar Republika e Shqipërisë, Republika e Sllovenisë, dhe ne jemi të vendosur kushtuar drejtë kësaj rruge evropiane.

Gjithashtu, tek arsimi i lartë po punojmë në stabilizimin e universiteteve të reja publike, sepse ju e dini se tani i kemi gjashtë universitete dhe ne i kemi shpallur zgjedhjet për tri universitete, të cilat brenda tre muajve do të bëhen me menaxhment të konsoliduar dhe me menaxhment të përhershëm.

Ministria e Arsimit këto 100 ditët e para e ka zhvilluar edhe një aktivitet të fuqishëm ndërkombëtar. Jemi duke bërë çmos, duke lobuar që Kosova këtë vit të pranohet si anëtare fuqplotë e procesit të Bolonjës. Të bëhemi anëtar i barabartë i hapësirës evropiane dhe mund të ju them se jemi në rrugë të mirë për ta korrur këtë sukses dhe besoj se këtë vit do të kemi lajme dhe kjo nuk do të jetë një çështje e meritave, por do të jetë një obligim për Kosovën që t'i arrijë standardet e Bolonjës dhe në këtë drejtim ne po punojmë me shumë përkushtim për ta korrur këtë sukses.

Siç e dini, kemi bërë shumë edhe në proceset e integriteteve në sferën e arsimit të lartë. Ne kemi nënshkruar tri marrëveshje me Republikën e Shqipërisë në mbledhjen tonë të përbashkët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem vazhdoja!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Marrëveshja e parë është shumë e rëndësishme dhe ajo unifikon sistemin parauniversitar. Ju e dini se Shqipëria e ka pranuar kurrikulën e Kosovës dhe po e punojmë edhe një të njëjtë për mësimdhënës.

Marrëveshja e dytë, në të cilën ka kontribuar edhe Ministria e Diasporës, është për ofrimin e një mësimi unik për Diasporën, ofrimin e librave, ofrimin e standardeve dhe mësuesve, ku nxënësit, pa marrë parasysh prej nga vijnë, Shqipëria, Kosova, Maqedonia apo Lugina e Preshevës, do ta marrin një arsim të unifikuar në Diasporë.

Dhe, marrëveshja e tretë shumë e rëndësishme është për arsimin e lartë, që ta krijojmë një treg të liberalizuar të bartjes së kredive, të diplomave, të nostrifikimit të diplomave dhe të koordinojmë bashkë me Shqipërinë përpjekjet në aderimin të Marrëveshja e Bolonjës.

Muajin e ardhshëm do të nënshkruajmë edhe tri marrëveshje që janë të koordinuara, marrëveshja që do të bëhet në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, me Republikën e Maqedonisë. Kjo do të përfshijë të gjitha universitetet shqipfolëse brenda këtij tregu të liberalizuar të arsimit të lartë.

Marrëveshja me Republikën e Sllovenisë, me të cilën ajo do të ndihmojë modernizimin e sektorin në arsimin e lartë.

Dhe, marrëveshja e tretë që do të nënshkruhet në muajin qershor do të jetë me Ministrinë e Kroacisë, ku ajo do të na bartë përvojat që ka bërë në digjitalizimin e shkollave tona.

Mendoj se reformat në arsim, të nderuar kolegë, janë të ngadalshme, por janë një proces nga i cili do të përfitojë i tërë populli i Kosovës. Dhe, e shfrytëzoj rastin edhe në këtë paraqitje të parë të detajuar të ju ftoj të gjithëve që të mos e shohim me syza partiake progresin në arsim. T'i bashkojmë të gjithë forcat, sepse përparimet në arsim do t'i ndiej çdo familje, do t'i ndiej çdo deputet, sepse progresi në arsim siguron familje të forta, mirëqenie, një shoqëri demokratike, një shtet demokratik, rrit mirëqenien e qytetarëve, sepse nëpërmjet shkollave cilësore e universiteteve cilësore, ne e bëjmë Kosovën një vend të shpresës, çfarë e meritojmë, sepse e kemi një rini inteligjente, e cila meriton një arsim cilësor dhe jam i sigurt se në bashkëpunim edhe me komisionin parlamentar, me të gjitha partitë politike, ne do të mund ta stabilizojmë trendin për ta filluar një trend pozitiv në arsim, në mënyrë që ky sektor, që është sektori më i rëndësishëm, vërtet të jetë një sektor i suksesit.

Edhe një herë ju ftoj që të gjithë t'i bashkojmë fuqitë për ta arritur këtë mision tonin të përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Valdete Bajrami, le të bëhet gati Xhevahire Izmaaku. E kisha lutur regjinë, se edhe kështu kemi edhe 31 diskutues, të mos na vonojë.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Është për të të ardhur mirë kur sheh numër kaq të madh të ministrave sot këtu të pranishëm, por do të kishte qenë mirë që edhe kur t'i kemi pyetjet parlamentare të jeni po ashtu numër të madh këtu dhe të na përgjigjeni. Por, është për t'u përshëndetur kjo prania juaj sot.

Edhe unë detyrimisht sot duhet të ndalem patjetër në ngjarje, të cilat e kanë karakterizuar 100-ditëshin e Qeverisë Mustafa.

Ndër to është shpërngulja e qytetarëve nga Kosova drejt vendeve të BE-së, e cila po ashtu u theksua edhe nga shumë parafolës këtu; marrëveshja e arritur me Serbinë për drejtësinë në komunën e veriut; protestat si shkak i fyerjes të bërë me deklaratat fyese nga vartësi i kryeministrit Jablanoviq dhe duke vazhduar pastaj me atë të Stavilecit; mosrealizimi i premtimeve nga të dyja palët gjatë fushatës, mosrritja e pagave, protesta të ndryshme, kolapsi dhe skandalet në sistemin e drejtësisë, pasiguria në vend dhe vazhdimi i krimit të organizuar, korrupsioni, skandalet nëpër fakultete me diploma falëse, skandalet në shëndetësi.

Këto janë disa nga dështimet e kësaj Qeverie, të cilat do t'i elaboroj pak më gjerësisht.

Të nderuar qytetarë,

Jeni dëshmitarë që menjëherë pas lidhjes së koalicionit dhe dëshpërimit të cilin e solli koalicion LDK-PDK te ju, po ashtu edhe ne jemi dëshmitarë të eksodit të popullatës sonë drejt Perëndimit.

Me mijëra qytetarë u detyruan të largohen nga Kosova, nga vendi ynë 16 vjet pas luftës, vetëm e vetëm për një jetë më të dinjitetshme, për një jetë më të mirë ekonomike, për një shkollim më të mirëfilltë, në kërkim të të gjitha këtyre dhe shumë e shumë kushteve të tjera, të cilat kjo Qeveri nuk mori mundin t'ua sigurojë këtu, por as që të deklarohej për popullatën tonë, e cila i mbushte për çdo natë autobusët drejt Serbisë.

Marrëveshja e drejtësisë, marrëveshje totalisht e papranuar dhe si e tillë bën diskriminimin e të gjitha minoriteteve të cilat jetojnë në veri. Marrëveshja e cila edhe një herë e dëshmon ndikimin dhe ushtrimin e Beogradit mbi autoritetin e vendit tonë dhe këtë miratim e ka marrë edhe në bazë të kryeministrit të vendit tonë.

Protestat të cilat u bënë për arsye të fyerjes që iu bënë nënave të Gjakovës nga ish-ministri serb dhe të cilin ju qytetarë e larguat nga po ky Kabinet qeveritar, e jo kryeministri, se po të mos ishin ato protesta ai do të ishte sot ulur së bashku me kolegët e tij këtu, ashtu siç është ende në detyrë ministri tjetër, që hiç më pak nuk la dhe ky pa i fyer nëntat e motrat tona, duke u bërë thirrje të mos lindin fëmijë, e deklarata e tilla, të nderuar, janë dëgjuar vetëm në regjimin e Milosheviqit, dhe që bien në kundërshtim me deklaratimet e shefit të tij, i cili u kishte premtuar kur ishte kryeministër që secila nën që do ta ketë një lindje do t'i takojnë 300 euro, pra premtim i cili kurrë nuk është realizuar.

Të nderuar qytetarë,

Ju jeni dëshmitarë të këtij Kabineti gjigant, e që vetëm në shërbim të qytetarëve nuk është. Po e them këtë pasi jeni duke i parë veprimet e tyre që asnjëherë nuk shkojnë në drejtim së paku të disa realizimeve të premtimeve, të cilat janë bërë gjatë fushatës.

Ata, jo që nuk po i realizojnë ato premtime, ata vetëm e vetëm që janë duke rënduar jetën tuaj me politika kinse të planifikuara mirë, e të cilat as që janë përmendur në fushatë. Këtu vlen të përmendet mosrritja e pagave, e cila po ashtu u theksua nga shumë parafolës. Kolapsi, skandali në sistemin e drejtësisë në të gjitha nivelet.

Ju lutem, ju e keni parë këtë situatë dhe e dini që e kam shtruar shumë herë. Skandalet, gjendja e rëndë në Këshillin Prokurorial, në Prokurorinë e Shtetit, në Gjykatën Supreme, në Gjykatën e Apelit. Definitivisht është tmerruese dhe alarmante kjo gjendje e sistemit të drejtësisë këtu te ne.

Skandalet në misionin ndërkombëtar, i cili është thirrur për zbatimin e rendit dhe ligjit këtu, ai i EULEX-it, ku raportohet se si ndërkombëtarët janë të kapur nga vendorët dhe kur marrin vendime për linçime të qytetarëve, vetëm e vetëm se u kanë dalë në rrugë dhe po ua zënë rrugën. Dhe, normalisht kjo Qeveri hesht!

Jeni dëshmitarë të vrasjeve të përditshme dhe askush nga Policia, apo edhe nga Ministria, konkretisht zoti Hyseni është dashur sot ta japë një deklaratë për këto ngjarje, nuk dalin ta japin një shpejtim se si është ardhur koha që për një shumë të vogël vriten qytetarët dhe ju po flisni për një Program qeveritar këtu. Ju lutem!

Pastaj pasojnë skandalet në Universitet, ku nuk kanë të ndalura punësimet jo të rregullta, skandalet me falsifikime të diplomave, e shumë e shumë të tjera.

Po ashtu vlen të përmendet edhe sektori i shëndetësisë, skandalet në këtë sektor. Ku duhet patjetër prapë t'i përmendim keqpërdorimet me stenda, keqpërdorime nga mjekët me mashtrimet dhe regjistrimin e kujdestarive, mungesa e barnave esenciale, mosrealizimi i sigurimit shëndetësor, e nga ministri së fundi është thënë që nuk do të ketë sigurim shëndetësor.

Partneri juaj i koalicionit gjatë gjithë fushatës ka propaganduar dhe mashtruar gjithnjë në emër të votës zgjedhësin e tij se nga prilli do të bëhet implementimi i sigurimeve shëndetësore.

Ju në programin e përbashkët qeverisës e keni miratuar këtë premtim duke e pranuar si të implementueshëm. Po e them këtë kushtimisht, në qoftë se fare keni debatuar për këtë premtim gjatë fushatës.

Tani sipas deklarimeve tuaja të fundit, ju e demantoni këtë dhe thoni se kjo do të mund të bëhet mbase në vitin e ardhshëm. Edhe në këtë nuk e keni ndonjë optimizëm të bindshëm se do të realizohet. Logjikisht si partner i koalicionit e keni pranuar logjikën e kontinuitetit të reformës në shëndetësi dhe implementimin e ligjeve të aprovuara, 2010-2014.

Deklaratat e fundit dëshmojnë një mosvazhdimësi të këtij kontinuiteti dhe premtimin tuaj, të partisë tuaj, të LDK-së, për shtim të buxhetit për shëndetësi gjithashtu. Ku mbeti ai buxhet?

Pse po e mashtroni popullatën se keni numër të mjaftueshëm kuadrosh, sidomos menaxherësh, që kanë përvojë në përpilimin e strategjive, implementimin e sistemeve shëndetësore, kuadro që kanë shijuar e jetuar funksionimin e shtetit të mirëfilltë, shkurt e shqip që e njohin mirë funksionimin e sistemit bashkëkohor shëndetësor.

Prapë po ju pyes: A do të duhej dikush të japë përgjegjësi për këtë mashtrim të radhës dhe deri kur do të vazhdoni me këtë avaz të mashtrimit të mëtutjeshëm të popullatës, edhe ashtu të lodhur nga shërbimet gjysmake dhe të papërbalueshme për pjesën dërmuese të tyre?

Me çka do të duhej të ishit krenarë për këtë 100-ditësh? Ju lutem, këto janë vetëm disa çështje që unë i ngreha sot këtu, por do ishte mirë të merrej edhe mendimi i të gjithë atyre qytetarëve që direkt preken nga këto dështime tuaja.

Prandaj, dhëntë Zoti që të vazhdoni siç ju ka ecur deri më tani, por besoj që kjo bashkëjetesë juaja nuk do të shkojë deri në fund të vitit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Shëndetësisë e ka kërkuar fjalën. Po Xhevahire Izmaqi bëhu gati, po u japim përparësi ministrave, pasi i kemi të gjithë sot këtu.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Jo që desha të dal, por thjesht u detyrova, sepse prononcimet e fundit të zonjës deputete nuk qëndrojnë.

Nuk jemi duke e mashtruar opinionin, por jemi duke e thënë të vërtetën. Sigurime shëndetësore nuk do të ketë në vitin 2015. Pse s'do të ketë? Sepse, ende nuk është përgatitur e gjithë baza ligjore, e cila duhet të jetë e përfunduar dhe që garanton një sigurim shëndetësor efikas. Çka është bërë deri më tash në këtë drejtim?

Prioritet i është dhënë hartimit të bazës juridike për themelimin dhe funksionalizimin e agjencisë së financimit shëndetësor, që është paraardhëse e Fondit të sigurimeve shëndetësore.

Tek tash është finalizuar Rregullorja për organizimin e brendshëm të agjencisë së financimit shëndetësor, e cila mundëson rekrutimin e personelit profesional që do ta përgatiste bazën juridike për funksionalizimin e Fondit të sigurimeve shëndetësore.

Duhet të nxirren dhe janë në vazhdim e sipër udhëzimet administrative, si vijon:

Për pagesa dhe bashkëpagesa, për grupet që përjashtohen nga bashkëpagesa, udhëzimi administrativ për shërbimet profesionale, udhëzimi administrativ për grumbullimin e premieeve, udhëzimi administrativ - kujdesi themelor shëndetësorë dhe çmimorja, lista e shërbimeve shëndetësore jashtëspitalore dhe çmimorja, çmimet e barnave dhe kategoritë e qytetarëve me të drejtë rimbursimi të barnave dhe materialit harxhues medicinal, si dhe udhëzimi administrativ - qytetarët dhe banorët e liruar nga bashkëfinancimi i shërbimeve shëndetësore. Kur këtu ia shtojmë edhe nevojën që ta kemi një sistem të informimit shëndetësor të Fondit të sigurimeve shëndetësore, atëherë me sinjeralitetin më të madh i jam drejtuar opinionit se në vitin 2015 nuk do të ketë sigurime shëndetësore dhe ky nuk është mashtrim i radhës, mirëpo kjo është e vërteta, e cila ashtu edhe do të dalë.

Meqenëse e mora fjalën, e meqë u tha se ka mungesë nga lista esenciale, ju them që sot në institucionet e kujdesit primar sekondar dhe terciar kemi 75 deri 80% të barnave nga lista esenciale. Pritet që nga prilli kjo të rritet. Edhe në citostatikë është e njëjta.

Ju them që sot është marrë vendimi që të formohet trupa udhëheqëse për kardiokirurgji dhe shumë shpejt kardiokirurgjia dhe kardiologjia invazive do të jenë storie të suksesit të kësaj qeverisjeje. Sot, mu sot e kemi marrë vendimin, e jo 100 ditë, por 101 janë bërë. S'di a ka problematikë këtu?

U tha që nuk ka afatizime ose planifikime të afatizuara. Ju them që për herë të parë Ministria e Shëndetësisë ka bërë koston e strategjisë sektoriale, e cila tash është në Zyrën për Zhvillim Strategjik të Qeverisë dhe deri në vitin 2020 ne e dimë saktë se në bazë të muajve, në bazë të periudhave, çfarë kemi bërë dhe çfarë do të bëjmë. Faleminderit!

KRYETARI: Ka kundër-replikë deputetja Valdete Bajrami, shefja e grupit parlamentar.

VALDETE BAJRAMI: Zoti ministër!

Është ndoshta korrekte nga ju që e pranoni që nuk do të ketë për 2015 sigurime shëndetësore dhe njëkohësisht nëse është ashtu, i keni informuar qytetarët me kohë. Po çfarë ngel nga ai premtimi tjetër që më 1 prill të këtij viti sigurimet shëndetësore është dashur të jenë në shërbim të qytetarëve? Kjo është brenga. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot unë do ta përshëndes fillimisht iniciativën për këtë debat parlamentar, por po ashtu edhe gatishmërinë e kryeministrit që të jetë i pranishëm me gjithë Kabinetin qeveritar.

Me të vërtetë është inkurajuese që gjithë raportimet që i dëgjuam deri më tani nga ministrat, e unë jam njëra nga ato deputete dhe deputetë që e kanë votuar këtë mandat qeverisës dhe s'jam aspak pishman për këtë. Shpresoj që krejt plani qeverisës brenda mandatit do të realizohet dhe besoj që është shumë herët që tani të flasim për të mirat apo për mburrjet. Mirëpo, kjo që unë kam shpresa dhe jam optimiste më shumë se kolegët e mi opozitarë nuk ma ndalon që të flas për ato gjëra të cilat i shoh në fillim se nuk kanë nisur mbarë dhe sigurisht që këto detektive të hershme kanë për të bërë të mundur që ju t'i përmirësoni bashkë me Kabinetin.

I nderuar kryeministër,

Secili nga ne deputetët fokusohet në çështje të cilat e ndien veten më shumë kompetent. Unë sot do të fokusohem në dy çështje, që do të jenë të lehta, mirëpo sigurisht që kërkesat do të jenë pak më të vështira.

Ne e kemi promovuar si vend qeverisjen e mirë dhe qeverisja e mirë detyrimisht kërkon një komunikim të mirë dhe një etikë publike. Këtë do ta kërkoj nga dy ministrat që ju i keni në Kabinet dhe që shihet që nuk e nisen mbarë me këtë veprim. Pra, është fjala për ministrin e Kulturës, zotin Shala, dhe besoj që kemi nevojë pak më shumë edhe për transparencë.

Pra, nuk mund ta lavdërohem që e kemi pasur transparencën edhe gjatë mandatit të kaluar, sepse kemi pasur vërejtje nga komuniteti i gazetarëve. Mirëpo, besoj që kjo është e mundur të përmirësohet më shpejt, ndërsa te çështja e ministrit të Kulturës, i nderuar kryeministër, ju e keni marrë një kërkesë nga një komunitet i madh i artistëve dhe, po ashtu, edhe unë si deputete, por edhe një pjesë e kolegëve të mi.

Është kohë shumë e shpejtë që një ministër i një dikasteri, i cili shumë më pak është dashur të ketë politizime, të bëjë shumë politikë në fillim të mandatit të tij.

Pra, fillimisht zoti Shala i shkarkoi të gjitha bordet kulturore, pa ndonjë detektim ose performansë që do të kishte pasur mundësi ta bëjë më vonë.

E dyta, ministri Shala e humbi komunikimin e mirë dhe lidhjen që është dashur ta ketë me komunitetin kulturor. E kundërta ndodhi pra me ish-ministrin e Kulturës, i cili së shpejti e mori veten në Dikasterin e Bujqësisë dhe vendosi kontakte me gjithë këtë komunitet, gjë që nuk ishte e lehtë, pra prej Dikasterit të Kulturës. Unë e përgëzoj për punën e mirë, por nuk dyshoj që ministri i Kulturës mund ta rikthejë këtë performansë.

Unë e di që kolegët e mi nga Lidhja Demokratike dhe krejt Lidhja Demokratike kemi miq dhe i njohim njerëzit që kanë afinitet të kulturës. Mendoj që ndoshta mund të rishikohet një pozicion ose një profil i ri për këtë dikaster. Pasi ministri i Kulturës e ka edhe pozitën si zëvendëskryeministër, mendoj që kjo nuk po i ndihmon ta kryejë një punë të mirë. Sinqerisht, kryeministër, është e pamundur për një kohë kaq të shkurtër ta krijojë një aversion kaq të madh ndaj një komuniteti të tërë të Kulturës.

Pra, vërejtjet janë në shkurtime buxhetore, vërejtjet janë në vendosjen e njerëzve të ri nëpër bordet udhëheqëse e kulturore, njerëz të cilët kanë një CV të zbehtë, ose kanë aktivitete jo të mëdha, nuk janë të njohur në komunitetin kulturor. Thjesht si deputete e këtij Kuvendi kërkoj që ta shikoni edhe një herë fillimin e punës të ministrit të Kulturës, ndërsa përsëri mbetem në shpresën dhe në optimizmin që ju do ta kryeni punën siç duhet, sepse posaçërisht në fushën e zhvillimit ekonomik, unë personalisht kam besim që ju do ta bëni një punë shumë të mirë, bashkë me kolegët tjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuara Qeveri,

Kryeministër,

Të respektuar deputetë,

Mendoj që është një rast shumë i mirë dhe duhet të përshëndetet kjo iniciativë për këtë debat, pasi patëm mundësi që të shohim dhe të dëgjojmë nga Qeveria për Programin qeveritar dhe për sukseset të cilat janë arritur për vetëm 100 ditët e para. Do ta përdori atë fjalën “dita e mirë shihet në mëngjes”, sepse mendoj që ky mëngjes po e tregon një ditë edhe një mandat të suksesshëm dhe të mirë për Kosovën.

Në anën tjetër, në qoftë se analizohen, jo vetëm kërkesa, por edhe rekomandimet të cilat kanë dalë nga kërkesa për këtë debat, mendoj që rekomandimet në fakt, kam pritur të jenë disa rekomandime shumë më serioze, kam pritur që rekomandimet vërtet do të jenë në vijë të programit edhe të analizës së 100-ditëshit, por në fakt ajo çka mund të dalë prej këtyre rekomandimeve është fjalia, që më së shumti përmendet: “të publikohet kontrata që qeveritarët të marrin pjesë në seancë”. Rekomandim për 100-ditëshin dhe për Programin qeveritar është që ministrat të marrin pjesë në seancë. Ju lutem! Kam pritur diçka pak më serioze, apo që në 100-ditëshin, apo në programin që ministri i Drejtësisë t’i raportojë Kuvendit për Këshillin Prokurorial.

Unë mendoj se ministrin e Drejtësisë mund ta thirrni në komision dhe ta kërkonin këtë prej tij. Mendoj që kjo nuk është analizë për 100-ditëshin, e aq më pak një analizë, apo një rekomandim për Programin qeveritar. Në anën tjetër, vazhdojnë me rekomandimet përsëri “të bëhen publike”. “Të bëhet publike” është fjalia e cila më së shumti përmendet. “Të bëhet publik tenderi për ‘Kosovën e Re’”, të bëhet publike për atë, të bëhet publike vendimi me shkrim për shkarkimin e ish-ministrit për Komunitete, si një vendim shumë i rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës, të bëhet konkrete strategjia për punësim, që mendoj se në Programin qeveritar edhe është paraparë në mënyrë detaje.

Në anën tjetër, ishte interesant kur u dëgjua në fillim që në 5 minutat e para të Qeverisë u fol për deputetët rebeluar, kurse sot kur i shohim portalet, tërë kohën flitet për deputetët apo këshilltarët e përjashtuar dhe njerëzit të cilët me komisione disiplinore, nuk e di sa është kjo demokratike, por janë përjashtuar prej partisë. Te ne nuk e di që ka ndodhur ajo.

Tjetër, në Programin qeveritar edhe në 100-ditëshin e parë shihen menjëherë veprimet të cilat flasin për një program me të vërtetë serioz, për një program për të cilin është punuar bukur gjatë dhe si pikë themelore e tij është pikërisht çështja e cila më së shumti i nevojitet Kosovës, e ajo është zhvillimi ekonomik, ku shihet si prioritet kryesor dhe për këtë kisha dashur t'i përmend pak disa pika, në pjesën më të madhe të të cilave pritet dhe flitet për fuqizimin e sektorit privat, por në të njëjtën kohë është edhe ekonomia sociale e tregut, e cila e tregon kujdesin për të gjitha shtresat e popullit të Kosovës.

Në reformimin e sistemit tatimor shihet me të vërtetë që janë përpjekjet për të bërë ndryshime radikale dhe thjeshtimi i sistemit tatimor, apo ulja e TVSH-së, për një numër të konsiderueshëm të mallrave që konsiderohen bazike për konsumin e qytetarëve, mendoj që është një pikë me të cilën vërtet ndihmohen qytetarët. Ndërsa vajtimi për atë që është rritur akciza për duhan dhe për alkool, mendoj se nuk ka aspak vend. Shumë mirë që është rritur, bile sa herë të mundni rriteni sa më tepër në duhan.

Pastaj lirimi i TVSH-së për përdorim dhe për procesim të prodhimit të makinerive dhe pajisjeve të teknologjisë informative, si dhe për lëndët e para që shfrytëzohen në procesin e prodhimit, në fakt drejtpërdrejt do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, drejtpërdrejt do të ndikojë në ambientin për një biznes sa më të suksesshëm dhe në krijimin e vendeve të punës. Pastaj e ulja e pragut, nuk e kuptova çfarë do të thotë ajo që qenka keq që ulja e pragut prej 50 000 mijë në 30 000 do të ndikojë negativisht. Në fakt, kjo ulje do të rrisë bazën dhe do t'i ndihmojë bizneset në punën e tyre. Ata që kanë punuar ndonjëherë, e dinë se çka do të thotë kjo.

Pastaj, pjesa tjetër, ku ndihmohen kategoritë me nevoja, si pagat që lirohen prej tatimeve në të ardhurat personale, pagat e personave me aftësi të kufizuara, mendoj që është një pikë shumë e rëndësishme dhe pres që të ketë ndikim. Që kontributet shëndetësore të të punësuarve të hiqen nga tatimi në të ardhura. Pastaj që kontributet për qëllime bamirësie të lejohen si shpenzime deri në 10%, mendoj që ky është një potez jashtëzakonisht i mirë. Që të ulet norma e interesit në vonesat e pagesave të tatimeve nga 15 në 11%, mendoj që kjo do t'u ndihmojë bizneseve që të frymojnë më lirshëm, sepse secili biznes mund të ketë telashe në kohët e ndryshme dhe ulja e tatimeve në fakt do t'u ndihmojë atyre.

Në anën tjetër, Ligji për shlyerjen e borxheve që do të bëhet duke u bazuar në numër të kriterëve që lidhen me shlyerjen e obligimeve pas periudhës 2008, mendoj që edhe kjo do t'i ndihmojë ato biznese dhe ata persona që në fakt sa më shpejt të kyçen në sistemet, në rrugën e duhur të sistemit, pra të hyjnë në sistem. Pastaj për marrëveshjen ndërkombëtare për huazim flitet për dy ligje, të cilat ne veç i kaluam, financimin për reformën shëndetësore për të cilën është folur shumë dhe për projektet që lidhen me ofiçencën e energjisë, janë çështjet të cilat përsëri do të ndikojnë në zhvillim ekonomik dhe në fuqizim. Tregu i letrave me vlerë dhe rehabilitimi i linjave hekurudhore përsëri janë në dobi të zhvillimit ekonomik dhe në dobi të fuqizimit të sektorit privat.

Integrimi i Administratës Tatimore dhe Doganave, pastaj me kohë heqja e vjeljes së TVSH-së prej Doganës dhe futja në sistem, pasi të kryhet faturimi, mendoj që gjithashtu është edhe një pikë shumë e rëndësishme, e cila do të ndikojë dhe e cila tregon që ekziston gatishmëria. Në anën tjetër, të gjithë ne e dimë se nuk jetojmë në një vend ideal. E di se vendi ideal nuk ekziston askund. E di që në Kosovë ka mjaft probleme dhe mjaft punë, e cila duhet të bëhet, dhe unë besoj që me këtë program dhe me vullnetin, jo vetëm të Qeverisë, por edhe me vullnetin e opozitës dhe të gjithëve, e besoj se ai vullnet është i përbashkët për një zhvillim më të mirë, për një mirëqenie më të mirë të Kosovës, mendoj që me këtë program mund të shohim se ekziston mundësia për ta bërë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri, replikë! Jo! Glauku, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Desha të bëj replikë, sepse zonja Sahatqija e ka përmendur ndër të tjera Lëvizjen “Vetëvendosje” dhe shkarkimet e fundit që kanë ndodhur në subjektin tonë politik dhe për ç’gjë unë kërkoj një adresim, sepse mendoj që ajo nuk ka faj pse çuditet, për shkak se në të vërtetë këtu po flasim secili për oborrin e vet, dhe kjo çfarë ndodh në të vërtetë në Lëvizjen “Vetëvendosje” është ndryshe nga ajo çfarë ndodh në Qeveri.

Në Lëvizjen “Vetëvendosje” shkarkohen njerëzit që zihen me keqpërdorime financiare, përkundër Qeverisë, dhe kjo mund t’i çudisë ata të Qeverisë, e nuk është fare e rastësishme pse mendojnë kështu.

E dyta, desha t’i mbroj rekomandimet tona dhe seriozitetin e rekomandimeve tona, për arsye se aty janë lexuar rekomandimet, por ajo i sulmoi, dhe ma jepni rastin t’i mbroj edhe një herë.

Mendoj që niveli i rekomandimeve tona është nivel që i përshtatet përgjegjësisë së Qeverisë. Ne nga Qeveria nuk mund të kërkojmë tash ‘krijoni 200 000 vende të punës’, sa i kanë premtuar, sepse e dimë që kanë mashtruar dhe kanë rrejtur. Ne nuk ua kërkojmë atë për të cilën ata kanë gënjyer. Ne kërkojmë aq sa Qeveria i ka kapacitetet e saj. Kemi filluar fillimisht me transparencën. Qeveria duhet të jetë transparente, sepse kaq janë mundësitë fillestare të saj. Bile, ato dokumentet, ato veprimet, vendimet që i merr, të mos i fsheh, por t’i bëjë publike. Pastaj këtu ka edhe tema tjera shumë të rëndësishme, nuk është vetëm publikimi i këtyre gjërave, por është për shembull që të rritet kontrolli në dogana. Po e shohim se çfarë evazioni fiskal janë në gjendje të bëjnë korporatat e mëdha, të cilat e kanë kapur pushtetin.

Pastaj të fillojë së zbatuari taksat doganore,...

KRYETARI: Edhe 30 sekonda Glauk, të lutem!

GLAUK KONJUFCA:.. pastaj sa u përket minatorëve të “Trepçës”, ua ka dhënë një premtim, e ai premtim duhet të realizohet. Pastaj sa i përket strategjisë për punësim, që e ka dhënë Qeveria e Kosovës, ne kërkojmë specifikim që të dihet se si konkretisht do të punësohen të gjithë ata njerëz, meqë po i pjesëtuat ato premtime të Qeverisë për çdo ditë sa njerëz duhet t’i punësojë, aty është një masë marramendëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Atëherë zëvendëskryeministri e ka kërkuar fjalën. Ok! Kundër-replikë, deputete të lutem!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

“Qeveria të fillojë ta zbatojë taksën doganore”. Kurrfarë kuptimi nuk ka kjo! Qeveria të fillojë të zbatojë taksën doganore në Doganë! E di që ndoshta shkollimi është ndryshe dhe nuk e kupton, por kjo fjali nuk ka kurrfarë lidhje - Qeveria të zbatojë taksat doganore - nuk ka lidhje. Kapacitetet e Qeverisë, mendoj që rekomandimet nuk i kanë treguar kapacitetet e Qeverisë, por kanë treguar kapacitetet e hartuesit të rekomandimeve, dhe sa u përket keqpërdorimeve, ju përgëzoj që i hiqni keqpërdoruesit prej mesit tuaj, por, në anën tjetër, kemi dëgjuar që ka qenë më tepër diktatura e ushtruar ndaj atyre se sa keqpërdorimi, por është punë për ju. I rregulloni ju vetë çështjet që i keni brenda, nuk ka problem.

KRYETARI: Atëherë, zëvendëskryeministër! Edhe më mire për opozitën gjithmonë kur fletë pozita. Ti je menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë to të bëj një paraqitje të shkurtër të njave kryesore të Programit të Qeverisë për kulturën, rininë dhe sportin dhe meqë paraqitësi i debatit, kërkuesi i debatit e ka lidhur edhe me 100-ditëshin dhe me disa shenja themelore për punën në këto 100 ditë, por së pari më duhet t’i bëj dy komente.

E para, këshillat e institucioneve nacionale janë në diskrecionin e ministrit, do të thotë ai i shkarkon dhe emëron këshillat, sepse kjo i lejohet dhe i kërkohet me ligj.

E dyta, sa i takon përbërjes të këshillave, ato janë grupe profesionistësh. Ata vërtet nuk kanë përvojë, por nuk kanë përvojë në një fushë tjetër, që është politika, sepse nuk janë përfaqësues politikë. Edhe përfaqësuesit e ministrit në këta këshilla janë profesionistë. Ndërsa sa i takon buxhetit, nuk ka asnjë shkurtime buxheti për titullarët jopublikë. Deri më tani, e jemi në muajin e katërt, ne i kemi dhënë nëpërmjet thirrjes publike dhe nëpërmjet subvencionimeve direkte, siç e përcakton Rregullorja për subvencionime, mbi 600 000 euro, ndërsa gjatë gjithë vitit 2014 janë dhënë 800 000 euro. Do të thotë, deri në fund të vitit ne do ta kalojmë dukshëm atë shifër.

Çështja e debateve publike për subvencionimin e thirrjes publike që ka bërë Ministria e Kulturës është diçka tjetër, meqë subvencionimet kanë qenë të orientuara në grupe interesi, në grupe të lidhura, pra nuk ka të bëjë me lartësinë, por ka të bëjë me shpërndarjen. Ne kemi përcaktuar kritere, të cilat janë të rregulluara, të nënshkruara, e kemi respektuar konkursin dhe e kemi shpërndarë këtë shumë. Jo vetëm në këtë rast, por në asnjë rast ne nuk do të lejojmë që subvencionimet të lidhen me një grup njerëzish, me një grup titullarësh, apo me një grup interesi.

Tani më lejoni t’i jap shumë shkurt disa nga çështjet kryesore të Programit dhe të punës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ta rrisë në vijimësi buxhetin për institucionet publike të kulturës, si për Teatrin Kombëtar, për Bibliotekën Kombëtare, për Qendrën Kinematografike të Kosovës, për Filarmoninë, për Baletin, për Ansamblin etj., meqë ne do të ndjekim politika të

tilla publike dhe kemi detyrim kushtetues dhe ligjor që të sigurojmë funksionimin dhe menaxhimin normal të institucioneve kryesore nacionale.

Për të mundësuar pavarësimin financiar të institucioneve, Ministria e Kulturës, bashkë me Ministrinë e Financave, i ka krijuar kodet buxhetore të veçanta për institucionet nacionale të kulturës dhe synojmë që kodet të tilla të krijojmë edhe për institucionet e trashëgimisë kulturore për Komitetin Olimpik dhe të gjitha federatat.

Ministria do të ndërtojë politika, raporte të sakta dhe të qarta, si dhe mbështetje financiare për artistët e pavarur, duke filluar nga ata që tashmë e kanë arritur të ndërtojnë profilin e tyre, por duke synuar që të mundësojmë konkurrencë sa më të gjerë në këtë fushë.

Kinematografia është një fushë e rëndësishme për promovimin e kulturës të vendit tonë, prandaj Ministria do t'i kushtojë asaj vëmendje të veçantë, duke rritur sistematikisht buxhetin për prodhimin e filmave dhe për lidhjen e bashkëpunimit me qendrat simotra të vendeve të tjera, me të cilat Qendra Kinematografike e Kosovës mund të nënshkruajë marrëveshje për projekte të bashkëpunimit dhe të bashkëprodhimit të filmit.

Ministria do t'u kushtojë një rëndësi të veçantë politikave dhe qarkullimit të librit, po ashtu do t'i mbështesë botuesit e shoqatat e tjera nga fondi për subvencionimin e kulturës, për prezantim nëpër panaiere ndërkombëtare të librit, organizimin e panaiereve të librit në Kosovë dhe në takime letrare.

Qeveria do të japë fonde të veçanta për të teatrot e qyteteve dhe do t'i rrisë ato, sikur edhe këtë vit, në mënyrë që në gjithë Kosovën të zhvillohet jeta teatrale. Gjithashtu bibliotekat publike do të kenë fonde të veçanta për pasurimin e librit dhe buxheti që në këtë vit është katërfishuar. Ministria do ta plotësojë infrastrukturën ligjore në fushën e kulturës dhe do të punojë në reformimin e saj duke e përafruar atë me praktikatat më të mira ndërkombëtare të vendeve të rajonit, si dhe të Bashkimit Evropian.

Prioritet janë hartimi dhe miratimi i strategjisë së kulturës, strategjisë për trashëgiminë kulturore, strategjisë për rininë dhe strategjisë për zhvillimin e sportit, ekipet për të cilat janë themeluar dhe po punojnë, Ligji për sponsorizime në kulturë dhe në sport, Ligji për trashëgiminë si dokumente të rëndësishme për zhvillimin e jetës kulturore në vend dhe për prezantimin ndërkombëtar të saj.

Kosova tash e disa vite prezantohet në ngjarjet e rëndësishme të kulturës në botë, siç janë: Bialja e Venedikut; Festivali i Filmit në Kanë, Festivali i Filmit në Berlin; Panairi i Librit në Frankfurt dhe shumë ngjarje të rëndësishme. Ne do të vijojmë ta rritim mbështetjen për prezantimin e Kosovës si edhe këtë vit në këto ngjarje, por edhe në ngjarje të tjera shumë të rëndësishme të kulturës në botë, duke shikuar këtë angazhim edhe nga prizmi i përafrimit të kulturës sonë me atë evropiane.

Kultivimi i raporteve të veçanta kulturore dhe të tjera me Shqipërinë dhe me trevat e tjera shqiptare do të thellohet. Tashmë, Kosova dhe Shqipëria e kanë kalendarin e përbashkët kulturor.

Ministria do të vazhdojë të angazhohet për zbatimin e këtij kalendar duke e pasuruar atë çdo vit dhe duke e rritur buxhetin për aktivitetet e përbashkëta, siç kemi bërë edhe në këtë vit.

Bazuar edhe në legjislacionin në fuqi, por edhe në prioritetet e Qeverisë për katër vjetët e ardhshme, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet Diasporës, me theks në fushën e kulturës. Përveç mbështetjeje të aktivitetëve të ndryshme kulturore në Diasporë, Qeveria do të themelojë së paku 5 qendra të kulturës së Kosovës në vendet e ndryshme të botës, me fokus të veçantë në vendet ku jeton numri më i madh i qytetarëve nga Kosova. Bashkë me Ministrinë e Diasporës kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë për aktivitete të përbashkëta kulturore të shqiptarëve në Diasporë.

Pas problemeve të theksuara në projektin e mëhershëm të Teatrit, Operës dhe Baletit “Ibrahim Rugova”, Qeveria e Republikës së Kosovës do të shpallë konkurs të ri ndërkombëtar për projekte, e më pas ndërtimin e ri. Ne tashmë i kemi iniciuar procedurat bashkë me Komunën e Prishtinës për ta përcaktuar një lokalitet të ri për ndërtimin e tij në Qendrën e Prishtinës. Ndërsa Teatri Kombëtar i Kosovës do të rinovohet në tërësi në vitin e ardhshëm, për të siguruar kushte moderne për punë për të gjithë artistët. Renovimi do të bëhet edhe për qëllim të modernizimit të hapësirës ekzistuese dhe të funksionalizimit më të mirë të saj. Po ashtu, do të rinovohet në tërësi Biblioteka Kombëtare, që ka filluar sivjet, dhe do të rinovohet në tërësi edhe Muzeu i Kosovës. Ne e kemi propozuar listën me emrat e mundshëm të anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimisë Kulturore, sepse është e domosdoshme që Kosova duhet ta ketë listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përhershme të plotë dhe të saktë. Pasi Kuvendi t'i ketë emëruar anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi kulturore, do të fillojë menjëherë puna për hartimin dhe miratimin e kësaj liste.

Me Ligjin e ri për trashëgiminë kulturore parashihet edhe themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të jetë një organ mbikëqyrës për të gjitha restaurimet, konservimet dhe gërmimet arkeologjike. Roli dhe përgjegjësia i këtij mekanizmi janë përcaktuar qartë dhe mundësojnë punë efikase.

Miratimi i Ligjit për muzetë, i cili kërkohet për ta plotësuar legjislacionin në fushën e trashëgimisë kulturore, që të jetë në përputhje me ‘acquis communautaire’ e Bashkimit Evropian do të hapë rrugë për një menaxhim shumë efikas të muzeve, si dhe do ta krijojë bazën legale për themelimin e muzeve të rinj.

Qeveria po ashtu do t'i rrisë fondet për subvencionimin e organizatave të të rinjve dhe për aktivitetet e tyre, si promovimin e edukimit joformal; promovimi i shëndetit, të artit, të sportit e tjera. Ministria do ta mbështesë çdo vit me buxhet Këshillin qendror për veprim dhe këshillat lokalë të veprimit rinor. Bashkëpunimi me organizatat e ndryshme ndërkombëtare, që janë aktive në fushën e rinisë, do të rritet, por fokus i veçantë i bashkëpunimit do të jetë ndërmarrësia e edukimit profesional dhe promovimi i vlerave sociale.

Ministria do të vazhdojë të punojë shumë për masivizimin e sportit nëpërmjet investimeve në infrastrukturën sportive dhe ne vetëm brenda këtij viti do të investojmë rreth 9 milionë euro në këtë fushë. Pastaj, promovimi i sportit shkollor dhe universitar dhe masivizimi i sportit në

përputhje me kartën evropiane të sportit dhe kodit të etikës në sport. Do të mbrohet dhe promovohet autonomia e federatave sportive.

Pas anëtarësimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar dhe të nëntë federatave që nga janari, përfshirë anëtarësimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës në FIBA-Evropë dhe FIBA-Botë, po punojmë intensivisht edhe në disa procese të rëndësishme të ndërkombëtarizimit të sportit, siç është anëtarësimi i Federatës të Futbollit të Kosovës në UEFA dhe në FIFA.

KRYETARI: Regjia, të lutem!

MINISTRI KUJTIM SHALA: ...Hartimi dhe miratimi i Ligjit kundër dhunës në sport, i Ligjit për sponsorizimin e Ligjit menaxhimin e objekteve sportive, si dhe hartimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare për zhvillimin e sportit janë prioritet të Ministrisë në sektorin e sportit për këtë vit. Po ashtu, Qeveria e Kosovës do të punojë që të funksionalizohet mjekësia sportive, si një kusht shumë i rëndësishëm për zhvillimin e garave.

Ministria i ka miratuar rregulloret për shpërblimet shtetërore, për sportistët kulminantë, ndërsa ne po vazhdojmë të plotësojmë legjislacionin sekondar në këtë fushë. Ministria po angazhohet maksimalisht për fillimin e ndërtimit të stadiumit nacional të futbollit, i cili do të ndërtohet në Prishtinë. Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, po i përmbysim procedurat e ndarjes së lokacionit që pastaj të vazhdohet në procedura tjera të shpalljes të konkursit për projektim dhe më pas të atij për ndërtim. Ministria këtë vit e ka dyfishuar buxhetin për ndërtimin e palestrave sportive nëpër komuna me qëllim të krijimit të kushteve moderne për gara sportive në shumë sporte kolektive. Tani është në proces ndërtimi i palestrave në Kamenicë, Istog, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Klinë e Kaçanik, ndërkaq palestra sportive do të ndërtohen gjatë këtij viti edhe në Viti dhe në Dragash.

Promovimi i sportit në gjithë Kosovën është një prioritet i Qeverisë të Kosovës. Për ta bërë këtë është i nevojshëm ndërtimi i poligoneve sportive për futboll, basketboll dhe volejbol, që duhet të jetë politikë dhe strategji afatmesme e Qeverisë.

Me anëtarësimin e Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar janë zgjeruar mundësitë për sportistët tanë. Një nga sportet ku ka interesim dhe talent është noti dhe disiplinat e ndryshme të sportit në ujë. Në këtë rrafsh, Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare për ndërtimin e pishinës olimpike, e cila po ashtu do të jetë në Prishtinë dhe do të bashkëfinancohet me Komunën e Prishtinës. Faleminderit!

KRYTARI: Visar Ymeri, të lutem, pastaj të përgatitet Time Kadrijaj.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Deputetë të Kuvendit të Republikës të Kosovës,

Më integroi një fjali që e dëgjova pak më herët, kur deputetja i referohej Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe tha që te ne, duke iu referuar LDK-së, në këtë rast, nuk ndodhin këto. Jo, nuk ndodhin, është e qartë. Ju rriheni me karrige dhe shumë mirë që rriheni. Bile ju kisha sugjeruar edhe në këtë Kuvendin që e keni në maj të rriheni me karrige, sepse kështu i ndihmohet

edhe prodhimit vendor, pra duke supozuar se këto karrige i blini pastaj nga prodhimi vendor dhe i ndihmoni ekonomisë për të cilën po flasim. Por, nëse jeni dakord i ishim kthyer temës.

Më herët, siç u dëgjua këtu nga deputetët, por qe besa edhe kryeministri, edhe zëvendësi i tij, apo siç u tha këtu ky kryeministri tjetër, thanë që ky është program i cili e ka për synim dhe në thelb të tij zhvillimin ekonomik. Pak a shumë kështu. Pastaj nga disa deputetë, kryesisht të Partisë Demokratike të Kosovës, u tha që programi nuk është edhe aq në aspektin e zhvillimit ekonomik, por në aspektin social është më i theksuar. Kjo tregon në njëfarë mënyre që këto ky grupe ose nuk po pajtohen se çfarë kanë shkruar në këtë program, ose, çka është shumë afër mendsh, nuk e kanë lexuar fare programin. Pra, nuk e dinë çfarë ka në të dhe tash secili flet qysh i merr mendja për të. Edhe qe besa, kur ta lexosh programin, në disa fjali të tij e shoh se as këta që e kanë dorëzuar nuk e kanë lexuar, ose edhe këta e kanë një mospajtim të thellë ndërmjet vete.

Për shembull, aty në program thuhet që Qeveria në secilën politikë të vet, për pjesën hyrëse po flas, do ta promovojë dhe forcojë vizionin për Kosovën e pavarur. Pra, Kosova e pavarur është ende vizion në mendjen e Qeverisë, e nuk është realitet i cili duhet të ndërtohet.

Në anën tjetër, më vonë, te luftimi i ekonomisë joformale, te masat që janë propozuar për ta luftuar ekonominë joformale, thuhet, ndër të tjera, te pika e fundit “do të punojë në zbatimin Marrëveshjes së Brukselit për ta shtrirë kontrollin e plotë në pikat doganore në Jarinë dhe Bërnjak”, e zëvendëskryeministri Hashim Thaçi thotë “po, ashtu, do të punojmë për këtë punë”, paçka që prej vitit 2011 për çdo ditë kanë thënë që tashmë kjo punë është kryer, atje i kemi doganierët tanë, i kemi policët tanë dhe, rrjedhimisht, Kosova është një dhe me territor të pandarë dhe me secilën pikë të kufirit të vet të kontrolluar nga institucionet tona. Pra, shihet se nuk e kanë lexuar fare programin. Nuk dinë se çfarë kanë shkruar në të dhe rrjedhimisht kanë përvjedhur këso fjalish, të cilat i kanë vënë aty në program edhe të cilat po na i shesin neve këtu si analizë. Po, në fakt, nëse ky program lexohet me vëmendje, kushdo që e ka lexuar me vëmendje, besoj që ka deputetë, që e kanë lexuar me vëmendje, mbase edhe ndonjë ministër, shihet që nuk ka kurrfarë analize as të efektit të masave të propozuara, pra çfarë ndikimi do ta kenë ato në çështjet, për të cilat flasin e as të mundësisë së arritjes së këtyre qëllimeve. Janë vendosur aty disa qëllime, diku të përgjithësuara, diku me numra më konkret, po fare nuk flitet për mundësinë se si do të arrihen ato.

Po ashtu, programi është i përgjithësuar dhe, mendoj që kjo është bërë me qëllim, në mënyrë që pastaj për shkak të mungesës së konkretësisë së saj, puna e Qeverisë të jetë e pamonitorueshme, sepse kur nuk ka asgjë konkrete, atëherë çka do që të bësh, ajo nënkupton që je duke vepruar në atë drejtim.

Pra, thuhet që do ta bëjmë këtë, do të punohet më mirë në këtë, do të punohet më mirë në atë, dhe secili ministër çdo mëngjes që zgjohet dhe shkon në zyrë, thotë, ja pra po punoj më mirë për këtë që e kam thënë, sepse vetë shkruarja në zyrë do të nënkuptohet si punë e këtij ministri për çështjen për të cilën është zotuar në program.

Çështje tjetër pastaj, po ndalem te disa pika, të cilat kjo Qeveri disa herë i ka quajtur edhe në program, po edhe në ligjërimin e tyre publik, si çështje prioritare. U dëgjua këtu disa herë, u tha që natyrisht, “Trepça” dhe është diskutuar gjatë disa seancave të Kuvendit të Republikës së

Kosovës, rëndësia që “Trepça” ka për ekonominë e vendit dhe rëndësia që “Trepça” të funksionalizohet dhe të futet në prodhim e në anën tjetër, të futet në sistemin ekonomik të vendit.

Dhe, për “Trepçën” në faqen 19 janë vetëm dy paragrafë, në të cilët thuhet se do ta bëjmë një strategji, ashtu siç është thënë edhe kur është diskutuar ligji dhe, kjo strategji pastaj do të na tregoj se çfarë do të bëhet me “Trepçën”.

Pra, në njëfarë mënyre për asetin më të rëndësishëm të vendit, të cilin të gjithë janë pajtuar, të paktën, që është aseti më i rëndësishëm i vendit, Qeveria e Republikës së Kosovës ia ka ndarë 2 paragrafë në 80 faqe program, në të cilin tregon që në fakt nuk e ka të qartë se çfarë duhet bërë me “Trepçën”, por këtë do ta marrin vesh më vonë.

Për të qenë korrektë, për krejt ekonominë thuhet kështu, sepse thonë që për sa u përket sektorëve strategjikë, në të cilët do të zhvillohet Kosova, ata do të përpilohen në një strategji të zhvillimit ekonomik, e cila do të jetë gjithëpërfshirëse pra, dhe e cila do të na tregojë në fakt, se cilat janë potencialet ekonomike të vendit dhe kah do të duhej të shkojë Kosova në rrafshin ekonomik dhe në zhvillimin e prodhimit.

Pra, Qeveria me program ka treguar, që pak a shumë nuk është se e din se çka duhet bërë me ekonominë e vendit dhe si do të duhej të zhvillohej ajo, mirëpo, i kanë paraparë disa masa për ta arritur këtë që nuk e dinë.

Pastaj energjia, është thënë po ashtu, disa herë, që është një prej sektorëve më strategjikë dhe më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe, natyrisht, secilit njeri, qoftë ekonomist apo jo, që jeton në Kosovë, e din që mungesa e furnizimit të rregullt me energji elektrike ta pamundëson zhvillimin ekonomik. Pra, këtë nuk ka nevojë të na e thotë as Qeveria, e aq më keq, ta shkruajë në program, sepse kjo dihet. Mirëpo, për energjinë Qeveria duket se nuk ka kurrfarë plani të qartë, përveçse e kanë bërë aty një paragraf, ku e kanë mbushur me numra. Pra, thuhet që 2 herë nga 300 megavat do të parashihet të hyjnë në operim deri në vitin 2021 dhe, këtu po supozoj që i janë referuar një tenderi, i cili tashmë është hapur e të cilin është kërkuar që ta shpallin publikisht, në mënyrë që ta kuptojmë edhe ne si deputetë, se çfarë do të ndodhë me këtë projekt kaq të rëndësishëm, që është propozuar të ndërtohet në Kosovë.

Mirëpo këtu, Qeveria thotë edhe një gjë, thotë që edhe 600 megavat tjerë do të shtohen deri në vitin 2023. Pra, nuk qenka projekti 2 herë 300 megavat, gjithsej 600 megavat, siç është thënë dhe për të cilin është tenderuar, por qenka një projekt 1.200 megavat, sipas programit të Qeverisë gjithnjë.

Po kjo është ajo një e re këtu, të cilën po e mësojmë prej programit dhe, për të cilën kishim kërkuar nga Qeveria të na tregojë qartë, a do të ndërtohen dy nga 300 megavat, dy blloqe nga treqind apo katër blloqe nga 300 megavat dhe, kush do t’i ndërtojë këto 600 megavat shtesë, të cilat po shihen këtu në programin qeverisës, sepse është folur njëherë për 2.100, pastaj për 1.000, po pastaj është hequr dorë dhe ka rënë në 600 megavat, të jetë termocentrali i ri, ndërkohë që tash Qeveria po planifikua 1.200. Kush do t’i ndërtojë këto 600 të tjerë?

Po ashtu, për ta kuptuar se sa joserioze është kjo Qeveri dhe sa pak ka menduar për këto zhvillime, ose më mirë thënë, se si ka shpenzuar kohë që t'i mbledhë të gjitha frazat e dëgjua deri më tash për sektorët e caktuara dhe i ka futur ato si propozim për program, tregon edhe Hidrocentrali i Zhurit. Thuhet që do të funksionalizohet deri në vitin 2017, pra që i bie edhe mbase dy vjet, po një vit e gjysmë, pak a shumë, Hidrocentrali i Zhurit me kapacitet instalues prej 305 megavatësh. Po, unë do ta kisha pyetur Qeverinë, a jeni serioz në këtë, a jeni të sigurt që do ta ndërtoni Hidrocentralin e Zhurit deri në vitin 2017? A jeni të sigurt që ky projekt është i mundshëm dhe, a jeni të sigurt që ky projekt do të jetë përfitues, jo vetëm për energjinë, por edhe për ekonominë e Kosovës?

Ndërkohë që thuhet se Qeveria e ka për qëllim që të vazhdojë mbështetjen për investimet në energjinë e ripërtëritshme dhe të zhvillojë resurset në vijim: - qiellore, thuhet, 8 megavat; era 130 megavat; hidroja, tash na bëhet 180 megavat dhe biomasa 10 megavat.

Në bazë të çfarë studimesh? Pra, a keni studime të qarta, që tregojnë se ky vërtetë është potenciali i Kosovës në energji të ripërtëritshme, që është vetëm ky, që nuk është as më i vogël as më i madh dhe, pastaj cilat janë masat që do ta arrijnë këtë? Ose, nëse e bartim tash diskutimin për energjinë, po në nivel më të përgjithësuar. Janë katër synime që i ka paraqitur Qeveria këtu, të cilat janë synime të programit qeverisës, për sa i përket sektorit të energjisë.

Pra një, thuhet të ketë energji të mjaftueshme për nevojat e Kosovës dhe, nuk tregojnë pastaj a ka kalkulime, se cilat do të jenë nevojat e mjaftueshme, ose energjia e mjaftueshme për nevojat e Kosovës? Në bazë të çka? Në bazë të cilës rritje? Në bazë të çfarë strukture të rritjes ekonomike? Pra, do të orientohet ekonomia e Kosovës në industri apo më shumë në shërbime dhe çfarë energjie do të konsumojë kjo?

Pra, vetëm thuhet energji të mjaftueshme për nevojat e Kosovës, pa e pasur fare të qartë, se cilat janë nevojat e Kosovës.

E dyta, pastaj është që çmimet e energjisë të jenë të përballueshme për qytetarët dhe bizneset. Si do të arrihet kjo? Çfarë mekanizmi do të përdorë Qeveria, për ta ndikuar çmimin? Sepse, Qeveria formalisht nuk ka kurrfarë mundësie, që të ndikojë në çmimin e energjisë elektrike. Mundësinë tash për tash e ka ZRE-ja, siç e dimë, e cila do të duhej të jetë organ i pavarur, pra që i merr politikat në bazë të profesionalizmit dhe rrjedhave në treg e jo në bazë të direktivave të Qeverisë dhe, e dyta edhe kjo e ZRE-së, siç e dini të gjithë, me ligj, pas liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, nuk do ta ketë më këtë mundësi, sepse supozohet që liberalizimi, konkurrenca në treg do t'i përcaktojë çmimet dhe si e tillë, edhe ZRE-ja do ta humbë atë.

Pra, pse po zotoheni për diçka, të cilën nuk e keni mundësinë ta zbatoni dhe, nëse e keni mundësinë pse nuk po tregoni si do ta zbatoni këtë, se do të kishte qenë shumë e rëndësishme. Dhe, jam plotësisht dakord që ta krijojmë një sistem, i cili do të ofronte çmime të përballueshme, por cili do të jetë ai.

Çështja tjetër pastaj, u fol këtu edhe për tregtinë e lirë dhe, njëri prej rekomandimeve të propozuara, të cilin prapë po them, deputetë, kishte deputetë që s'e kishin kuptuar fare, ose që

donin qëllimisht që ta keqkuptonin, ishte rekomandimi 5. Ju kisha ftuar ta lexoni deri në fund. Pra, mos i lexoni vetëm tri fjalët e para...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem, vazhdoja!

VISAR YMERI: Faleminderit!

Pesëshi thotë, të fillojmë menjëherë së zbatuari taksat doganore ndaj produkteve bujqësore ushqimore të subvencionuara në vendin e tyre të origjinës. Me çfarë qëllimi është kjo?

Ky është me qëllim, që produktet vendore të jenë më të konkurrueshme në treg, pra t'u krijohet hapësirë produkteve vendore të bujqësisë dhe të industrisë përpunuese të ushqimit, në mënyrë që prodhimi vendor të ketë rritje dhe, në mënyrë që kështu t'i zëvendësojmë importet për ta përmirësuar bilancin tonë tregtar, një prej problemeve të vazhdueshme që e kemi në ekonomi. Pra, ky është ai rekomandim të cilin deputetët, ose nuk e kuptuan, ose nuk donin ta kuptojnë.

Dhe për fund, propozohet këtu dhe e kam një pyetje të fundit për Qeverinë, për kryeministrin, se thuhet që tek ajo pjesa ku flitet për përmirësimin e performansës së ndërmarrjeve publike, thuhet që privatizimi i ndërmarrjeve publike duhet të ndodhë, dhe pastaj vazhdon fjalia. Kjo “duhet të ndodhë” është vendim i Qeverisë tashmë, apo jo? Pra, “duhet të ndodhë”, nuk ka mundësi tjetër, nuk ka alternativë, përveç privatizimit të ndërmarrjeve publike në kohë të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme, këtu jam dakord që e kanë bërë një ndryshim kjo Qeveri. Mirëpo, kur thoshim ne - ta bëjmë “Trepçën” ndërmarrje publike, na thoshit, jo, na duhet një studim së pari i fizibilitetit dhe i dobive që do të na sillte kjo e pastaj ta marrim vendimin, ndërkohë që për privatizim nuk paska nevojë për kështu studim. Pra, që tash ju po e dini që privatizimi është më i mirë, se sa ndërmarrja publike.

Pra, kjo a është tash në bazë të analizave, apo është në bazë të doktrinëve ideologjike, të cilave ju takoni? Se, këtu po tingëllon si doktrinë ideologjike, pra një vendim i paravendosur, pa pikë analize dhe pa kurrfarë nevoje. Dhe, e tëra kjo pastaj në funksion të tregut të lirë.

Së pari, duhet ta kemi parasysh se tregu i lirë ka të bëjë me liberalizim, nuk është çështje pronësie. Ndërmarrjet publike mund të jenë agjentë në tregun e lirë, konkurruese me kompanitë tjera. PTK-ja në pronësi publike ka garuar, “Vala” në këtë rast ka garuar me një kompani tjetër, e cila është në Kosovë, në pronësi private, po llogaritet si kompani private, që është IPKO-ja. Çka ka pasur këtu të keqe? Prapë, PTK-ja ka fituar.

Sikur mos të kishin qenë dallaveret e Qeverisë, e besoj që ndoshta ju nuk jeni Qeveri e njëjtë me të kaluarën, atëherë PTK-ja prapë kishte dalë kompani shumë më përfituese se sa IPKO-ja, pra po bëka me pas pronësi publike, në kushte të një tregu të liberalizuar.

Dhe e dyta, tregu i lirë për të cilin ju po flisni, a mund të na tregoni, për fund tash e kam, kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ju të tjerët, cili treg i lirë ua mundësoi vëllezërve dhe djemve tuaj të bëhen milionerë? Pra, në bazë të cilit treg të lirë, ju i bëtë këto para, ose të afërmit

e juaj? Pra, na e shpjegoni edhe këtë, që ta kuptojmë më mirë këtë tregun e lirë, që po doni ta ndërtoni këtu në Kosovë? Faleminderit!

KRYETARI: Teuta ka kërkuar fjalën për replikë.

TEUTA SAHATQIJA: Po, vetëm shkurt. Sa i përket demokracisë, mendoj që LDK-ja vetëm mundet ta mësojë çka është demokracia e çka është fjala e lirë dhe, çka është respektimi i fjalës së lirë. Ndërsa, ato sigurt çka nuk ka, nuk ka biseda informative, nuk ka marrje në pyetje, nuk ka komisione disiplinore, po ka demokraci dhe pikë.

KRYETARI: Atëherë, Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Për herë të parë, për aq sa mban mend dikush, Qeverinë e Kosovës e gjen tremujori i parë pa një program qeverisës, të miratuar në Kuvend, aq më tepër një program që është sjell në kutitë e deputetëve si njoftim për programin e qeverisjes, e as që mori mundin që këtë program ta prezantojë në Kuvendin e Kosovës.

Po bëhen 100 ditë dhe Qeveria Mustafa ende nuk është konstituuar në tërësi. Kabinetit qeveritar i mungojnë edhe shumë zëvendësministra si dhe staf këshilltarësh e personel tjetër. Dhe, kjo nuk i ka ngjarë deri më tani asnjëherë kryeministrave të vendit. Kjo qeveri e ka mbytur shpresën e popullit të Kosovës, ka nxitur grevat, protestat, pakënaqësitë dhe braktisjen e vendit, shkak i politikave mashtruese dhe premtimeve të rrejshme dhe dështimeve të njëpasnjëshme.

Dy gjëra mund të kuptohen nga programi qeverisës për shëndetësi. Qeveria Mustafa lëre që nuk ka zgjidhjet e veta për problemet në shëndetësi, por as nuk i kupton as ligjet që rregullojnë këtë fushë. Ndryshe nuk ka si të shpjegohet fakti se i përshkruajnë detyra dhe obligime vetes, që janë fushëveprime të Fondit të sigurimeve, Odës së Mjekëve, ose Shërbimit spitalor dhe klinik të Kosovës.

Ndërkaq, që këtyre institucioneve, që me ligj janë të pavarura nga Ministria e Shëndetësisë, u japin detyra që nuk u takojnë. Madje, harrojnë se për shumicën e aktiviteteve që planifikojnë, paratë nuk janë në xhirollogarinë e Ministrisë, por në xhirollogaritë tjera.

Ndryshimi i mënyrës së financimit në shëndetësi nga financimi i vetëm prej buxhetit në financim të buxhetit dhe nga fondet e sigurimeve publik dhe privat, nuk është asgjë e re. Ajo që është e re dhe fatkeqësisht, befasuese, është mungesa totale e kuptimit për funksionim dhe detyrat e Fondit të sigurimeve.

Ndryshe nuk ka si të kuptohet fakti, se disa prej pritjeve prej Fondit, si rritja e buxhetit të Shërbimit spitalor klinik dhe universitar të Kosovës, rritja e granteve specifike për komuna ose funksionalizimi i shërbimit të informimit në shëndetësi nuk janë fare detyra të fondit, ashtu sikurse nuk janë as furnizimi 100% i listës esenciale, përmirësimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve dhe resurseve, fuqizimi i kapaciteteve diagnostike duke blerë pajisje dhe duke i servisuar më mirë, këto të fundit, detyra të Shërbimit spitalor klinik universitar dhe mjekësisë primare.

Duke i dhënë vetes detyra për ta riorganizuar Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Qeveria ka harruar se organizimi i saj është i rregulluar me ligj dhe me statut, sipas modelit që ka marrë përkrahje më të madhe prej LDK-së dhe PDK-së në qeverisjen Thaçi-2.

Pastaj, konstatimi se prioritet i Qeverisë Mustafa do të jetë shqyrtimi i mundësisë që të themelohet Spitali i Prishtinës, jo të themelohet, por të shqyrtohet mundësia e themelimit, një qeveri serioze do të dinte, se a i duhet një spital Prishtinës? Ku do ta ketë këtë spital, ku do të marrë kuadro për këtë spital dhe me çka do ta ndërtonte? Dhe, nuk do të merrej me shqyrtimin e mundësisë.

E dyta është tendenca për të vazhduar me mikromenaxhim, funksionalizimin e Kardiologjisë Invazive dhe Kardiokirurgjisë dhe funksionalizimin e shërbimeve profesionale për Onkologji, për nëna dhe fëmijë, që janë kompetenca të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Vazhdimi përkrahës për trajtimin e fëmijëve me sëmundje malinje jashtë vendit, kjo tendencë e cila nuk përfshinë vetëm fëmijët, tregon mungesën e përkushtimit për ngritjen e këtyre kapaciteteve brenda vendit.

Licencimi i institucioneve shëndetësore, i deklaruar prioritet i Qeverisë, nuk sqaron çështjen kryesore, se a do të licencohen edhe institucionet shëndetësore publike, çështje shumë me rëndësi, sepse në mungesë të përballjes së këtyre institucioneve me minimumin e kriterëve për të marrë leje për punë, ne ende nuk e dimë në çfarë institucioneve shëndetësore mjekohemi.

Duke vënë theksin mbi mjekësinë primare familjare, programi nuk adreson çështje shumë brengosëse të kujdesit shëndetësor në institucionet parashkollore dhe shkollat e Kosovës, si dhe mungesën e përkujdesjes specialistike në shërbimin primar.

Qeveria, fatkeqësisht është për keqardhje, sepse Qeveria komunitetin ndërkombëtar e sheh vetëm si komunitet të donatorëve, nuk e thotë ama as një fjalë për kontributin e këtij komuniteti për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore në Kosovë, përmes mentorimit, binjakëzimit apo formave të tjera të ngjashme.

Në mes të gjërave të tjera, që janë për keqardhje, është edhe mungesa ndër prioritetet e aktiviteteve për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, siç janë rishikimi i formimit të punëtorëve shëndetësor, programeve të specializimeve dhe të subspecializimeve, edukimit të vazhdueshëm profesional dhe licencimit të punëtorëve shëndetësor, si dhe standardizim të shërbimeve shëndetësore, që duhet të zhvillohen në bashkëpunim me Odën e profesionistëve shëndetësorë.

Pra, nëse bëjmë analizë punën e Qeverisë Mustafa dhe Ministrisë së saj të Shëndetësisë, në 100 ditët e kaluara, konstatojmë se Ministria nuk ka bërë punë fare. Në këto rrethana kemi mundur vetëm të konkludojmë se Kosovës kur është shëndetësia në pyetje, nuk po i vijnë ditë të mira.

Programi i Qeverisë për shëndetësi i bërë publik këto ditë, nuk na ka luhatur në këtë konkluzion, përkundrazi dy gjëra mund të kuptohen nga programi qeverisës për shëndetësi, Qeveria Mustafa lëre që nuk i ka zgjidhjet e veta për problemet në shëndetësi, por as që i ka kuptuar ato të nisura

nga qeveria e mëparshme. Rrjedhimisht, programi është përplot zgjidhje të këqija, ndërkohë që nuk adreson shumë probleme me rëndësi, ndërsa për ato pak veprime që mund të bëjnë ndryshime në shëndetësi, nuk cakton as kush, as kurë dhe as si do të realizojë, duke bërë jo program i aksioneve po, listë të dëshirave.

Për Aleancën, paralajmërimi se nuk do të ketë fond publik të sigurimeve shëndetësore, të paktën deri në vitin 2016, është për keqardhje, ndërsa arsyetimi se kjo për arsye se Qeveria nuk do që ky fond të dalë i keq, është i papranueshëm, për shkak se Kosova ka pasur nevojë që të ketë fond të sigurimeve shëndetësore publike jo sivjet, por qe 15 vjet. Qeveria është dashur të mobilizojë mjetet nga të gjitha vijat buxhetore, ku mund të marrë edhe mjete borxh, që fondin ta bëjë funksional menjëherë.

Dhe, çka të them lidhur me një vendim të fundit të Qeverisë, për importin e veturave më të vjetra se 13 vjet. Bash në ditën e luftimit të tuberkulozit, Qeveria merr vendimin për import të veturave më të vjetra se 13 vjet, duke ditur ndotjen momentale të ajrit, e cila është më e paktë nga industria, meqenëse nuk e kemi e më shumë nga mjetet motorike me ndezje të pakontrolluar, nuk mund ta quajmë ndryshe këtë vendim, pos një veprim skajshmërisht të papërgjegjshëm.

Në një anë, kinse kujdesemi për shëndetin e popullatës me manifestime të ndryshme, si Dita e luftës kundër tuberkulozit e në anën tjetër me importin e veturave më të vjetra se 13 vjet, i dënon gjeneratat në vijim me shtim të numrit të sëmurëve nga organet e frymëmarrjes e posaçërisht sëmundje si astma bronkiale dhe kanceri i mushkërive.

Në një anë e mashtrojnë popullatën, kinse me lehtësimin e ofrimit të mundësisë që shumë familje të posedojnë veturë, nga ana tjetër e ngarkon me plaçkitjen institucionale të quajtur taksa ekologjike, të cilën nuk e kemi, nuk kemi informata se ku përdoret e më së paku për çështje ekologjike.

Rritja eventuale e buxhetit nga importi i këtyre veturave, në anën tjetër, do t'i shumëfishojë shpenzimet për shëndetësi, të cilën gjithsesi do ta paguajë qytetari nga xhepi i vet. Me këtë veprim, Qeveria edhe njëherë tregon se nuk e ka prioritet shëndetin e qytetarit, por vetëm rritjen e masës monetare, që dot ë keqpërdoret në vazhdimësi, në kurriz të qytetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar Nisma, ka vetëvendosur ta bëjë një kombinim. Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Unë për shkak të replikës, u ndërrua renditja, përndryshe shoku Enver e ka pasur parasysh se jam përpara.

Faleminderit! Unë dëgjova me vëmendje, veçanërisht fjalimin e kryeministrit dhe që në fillim dua të them se është një fjalim, që tregon se kjo Qeveri ka vendnumërim, ose ecje në “orbitrek”, që i bie se janë duke vendnumëruar dhe nuk janë duke bërë asgjë. Dhe, më e keqja është se as edhe fjalimi dhe programi nuk është shpresëdhënës, siç nuk ka qenë shpresëdhënës edhe vetë koalicioni i arritur midis PDK-së dhe LDK-së, koalicioni i cili thjesht, në momentin e bërjes publike i ka venitur ekstremisht shpresat për një jetë më të mirë të qytetarëve.

Thënë të drejtën, pesë objektivat kryesore, që i theksoi kryeministri, mendoj se janë vazhdimësi e deklaratave politike programore elektorale, por jo edhe çështje të cilat mund të realizohen edhe për faktin se mungon njëra nga objektivat kryesore dhe, ajo është çështja e sigurisë. Dhe nuk mund të ketë zhvillim ekonomik, investime të huaja në rast se kemi një siguri të brishtë, siç është në Kosovë dhe, aq më keq, ministri i Punëve të Brendshme, përpos ndonjë fjalë kështu për t'i hyrë në hatër, se ka zgjedhje të brendshme partiake, nuk tha asgjë konkrete, në përjashtim me ministrat tjerë.

Me thënë të drejtën, çështja e sigurisë llogaris se nuk është njëjtë t'i biesh harmonikës dhe të menaxhosh sigurinë e një vendi, veçanërisht një vendi siç është Kosova, në një rajon jo shumë të qetë dhe në një rajon të trazuar.

100-ditëshin e Qeverisë e karakterizojnë shumë gjëra, të cilat kanë ndikuar bukur shumë në vazhdimin e dëmtimit të imazhit të vendit, domethënë nga keqqeverisja e kaluar, sepse kjo qeverisje është përballur si rezultat i këtij kombinimi qeverisës, ka pasur shpërthime të arsyeshme në formë reagimi të qytetarëve, fillimisht për shkak se në kuadër të Kabinetit të kësaj Qeverie, kemi pasur fjalor fyes dhe ofendues në raport me qytetarët, që kanë ngritur protesta dhe demonstrata të arsyeshme të qytetarëve, demonstrata të cilat e kanë vetëdijesuar kryeministrin për ta bërë një reagim në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën.

Kjo qeverisje, natyrisht, do të mbahet në mend për 100-ditëshin e parë, për shkak se mbi 100 mijë qytetarë e kanë lëshuar vendin, thjesht sepse kjo qeverisje me këtë kombinim dhe me qëndrimet e veta publike, që në fillim nuk ka premtuar zhvillim të qëndrueshëm të vendit dhe realizim të objektivave qytetare të Kosovës për integritet në strukturat evropiane.

Realisht, ne jemi dëshmitarë dhe me thënë të drejtën, rastësisht qëlloma në njërin nga shumë protestat, që ndodhin në sheshin e Prishtinës dhe i dëgjova disa të rinj, kur pyesnin njëri-tjetrin, se çka po ndodh. Dikush që ishte më në rrjedha, tha se ka protesta si çdo ditë. Dhe, thjesht me këtë qeveri kanë shpërthyer protestat në të gjitha sektorët e shtetit, duke filluar në arsim, në shëndetësi, në gjyqësi e kështu me radhë dhe, ky program i prezantuar, nuk po besoj se do t'i realizojë dëshirat e arsyeshme të qytetarëve, të cilët presin nga kjo Qeveri.

Prandaj, mendoj se disa veprime të Qeverisë më shumë janë dekorative, se që prekin realisht atë që duhet prekur. Veçanërisht do të ndalem pasi nga disa kolegë deputetë u lavdërua Qeveria për faljen e borxheve... dhe të jua them të drejtën nga praktika dhe nga ajo, për shkak se jemi të deputetëve të paktë që jetojmë në mesin e qytetarëve, sepse të gjithë të tjerët jetojnë në Prishtinë dhe veç kur vijnë votat dalin në terren, unë vi nga terreni dhe me ju thënë të drejtën, një e vërtetë është, se borxhi i para 2008-ës në rast se falet, nuk falet për qytetarët e Kosovës, si tërësi, por për një pjesë të qytetarëve të Kosovës, pa dashur për të politizuar me këtë, ne e dimë se një komunitet, ose veçanërisht komuniteti serb në veri nuk i janë përgjigjur asnjëherë shtetit të Kosovës, ndërsa qytetarët dhe bizneset rrezikohen dhe kanë mbetur borxh kryesisht mbas vitit 2010 – 2011.

Prandaj, nuk keni arsye për t'u lavdëruar se keni bërë ndonjë falje, në rast se në mënyrë esenciale, ministri i Ekonomisë e shpjegon këtë çështje në bazë të dhënave, në rast se i ka mbledhur, e sheh se kjo falje nuk ka atë impakt të ndikimit, siç pretendohet të paraqitet.

U përmend edhe nga kolegu Visar Ymeri, unë dua vetëm t'ia përkujtoj kryeministrit, sepse sipas gjasave, nuk është shumë në rrjedhë, rreth Hidrocentralit të Zhurit. Para dy ditësh, Asambleja e qytetit të Dragashit ka miratuar në parim një licencë, e cila një institucion i Qeverisë së Kosovës i ka licencuar firmat private për hidrocentrale të vogla, për ato ujëra rrjedha të cilat janë planifikuar të shfrytëzohen për Hidrocentralin e Zhurit. Me këtë po dua të dal tek ajo, se pjesë të këtij programit janë “copy paste” nga programet e kaluara dhe të fushatave elektorale, siç është edhe diçka që nuk u përmend, as nga ministri i Kulturës dhe Sportit, se vartësi i Isa Mustafës, aktualisht për politikë të jashtme ka pas premtuar një stadium evropian në Prizren. Me thënë të drejtën, ajo ka mbetur një fushë e futbollit dhe është në shkatërrim e sipër, dhe unë prita që ministri së paku, edhe në këtë drejtim ta përmend edhe Prizrenin, që nuk ka bërë asgjë.

I përmenda dy raste që lidhen me rajonin prej nga vi, përndryshe në përfundim unë dua të shpreh keqardhje publike, se kjo garniturë politike, ky kombinim qeverisës dhe ky program i prezantuar, nuk premtojnë perspektivë evropiane të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi e ka fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër dhe deputetë e ministra kolegë,

Bujqësia është nga sektorët kyç për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe shpreh pak befasinë time, që realisht, pothuajse askush nuk diskutoi për bujqësinë, as për mirë, as për keq. Më vjen keq nëse në sytë e deputetëve nuk e ka rëndësinë, të cilën bujqësia e ka në sytë e Qeverisë.

Duke u bazuar në raportin e gjelbër të Ministrisë së Bujqësisë, ky sektor kontribuon me mbi 12% në bruto- prodhimin vendor, si dhe llogaritet se punëson deri në 20% të forcës totale punëtore, përfshirë normalisht dhe ata në tregun joformal.

Në vitet e fundit ka pasur investime të shtuara nga shteti në këtë sektor dhe falë këtyre investimeve prodhimi vendor në këto dy vjet të fundit është rritur për rreth 26%. Duke e parë bujqësinë si potencial të rëndësishëm dhe kryesor në planin afatshkurtër dhe afatmesëm për zhvillimin ekonomik, Qeveria e Kosovës e ka bërë prioritet nacional zhvillimin e bujqësisë dhe për këtë buxheti është dyfishuar e po ndërmerren hapa për një zhvillim cilësor në këtë sektor.

Një ndihmesë të madhe në hartimin e politikave do të japë edhe regjistrimi i bujqësisë, i cili ka përfunduar vitin e kaluar pas mbi 50 vjetësh, me ç'rast janë dhënë rezultatet preliminare në muajin shkurt dhe planifikohet që rezultatet përfundimtare të bëhen publike në shtator të këtij viti.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në 100-ditëshin e parë të Qeverisë ka hartuar dhe ka miratuar Programin për bujqësi dhe zhvillim rural dhe Programin për pagesat direkte për vitin 2015.

Programi për bujqësi dhe zhvillim rural, që përfshin grandet investive në fushën e bujqësisë për vitin 2015, ka një buxhet prej 20 milionë eurosh dhe përfshin investimet në modernizimin e makinerisë për prodhim, për përpunim, në investimet në asetet fizike të prodhimit primar, në sektorin e përpunimit, në ujitje të tokave bujqësore, si dhe në diversifikimin e aktiviteteve në fermë dhe jashtë saj.

Është me rëndësi të theksohet, se këtë vit buxheti është dyfishuar për secilën masë të mbështetjes, si dhe janë përfshirë një serë kriteresh lehtësuese për fermerët aplikues.

Baza e aplikimit për masat e këtij programi për fermerët është hapur më 25 shkurt, do të vijojë të jetë e hapur deri më 10 prill dhe duhet thënë, se Ministria në disa masa tek skema e grandeve për t'ua lehtësuar fermerëve ka zgjatur afatin e implementimit të projekteve që përfitohen nga Ministria.

Sipas indikatorëve të Ministrisë, vetëm përmes mjeteve që do të shpërndahen përmes programit për bujqësi dhe zhvillim rural gjatë vitit 2015 do të hapen rreth 2.600 vende të reja të punës të qëndrueshme, ndërsa një numër shumë më i madh do të vazhdojë të mbështetet përmes skemës së pagesave direkte.

Programi për pagesa direkte, që nënkupton subvencionimin e fermerëve, këtë vit kap një buxhet rekord prej 23 milionë eurosh dhe përfshin subvencionimin në tri kategori kryesore: në blegtori, në hortikulturë dhe në drithëra.

Këtë vit në programin e pagesave direkte paraqiten edhe risi, siç është subvencionimi i pemishteve ekzistuese dhe subvencionimi i therjeve të raportuara të gjedhit, që ndërlihet drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore.

Subvencionimi për drithëra dhe blegtori në disa kategori është rritur nga 25% deri në masën 50% më shumë, se sa vitin e kaluar. Shembull konkret është subvencionimi i misrit, subvencionimi i luledielli.

Faza e aplikimit për fermerët për shumicën e kulturave bujqësore është hapur, ndërsa faza e dytë e aplikimit do të fillojë pas mbylljes së kësaj faze, besojmë nga fundi i muajit prill. Në dy programet ka skema të reja të mbështetjes dhe rritje të dyfishtë të buxhetit, krahasuar me vitin e kaluar.

Me qëllim të realizimit sa më efikas dhe transparent të këtyre dy programeve, Ministria tashmë ka organizuar një fushatë të gjerë informuese mediale, ka mbajtur dhjetëra takime informuese me fermerë anekënd Kosovës, ka shpërndarë në kopje fizike programet, udhëzuesit, si dhe të gjitha dokumentet përcjellëse nëpër të gjitha komunat e Kosovës dhe po ashtu, ka publikuar gjithë materialin e nevojshëm edhe në ueb-faqet e ministrisë dhe të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Përveç programeve që përmenda, më lejoni t'i listoj vetëm një pjesë të disa nga veprimeve, që kemi realizuar në 100-ditëshin e parë.

Për të implementuar në mënyrë më efikase programin për bujqësi dhe zhvillim rural dhe atë të pagesave direkte, me mbështetje të donatorëve ndërkombëtar do të rrisim kapacitetet e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për procesin e vlerësimit dhe veçanërisht për atë të kontrollit dhe monitorimit, shpërndarjes së granteve dhe subvencioneve.

Po ashtu, Ministria ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën gjermane për zhvillim ndërkombëtar GIZ, për bashkëpunim në zhvillimin e strategjisë për sektorin e verës, për konceptin e marketingut dhe aktivitetet promovuese, dedikuar tregjeve lokale, rajonale dhe të Bashkimit Evropian, si dhe për adaptimin e kornizës ligjore, sipas AKI-së. Janë publikuar rezultatet preliminare të regjistrimit të bujqësisë në Kosovë, në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, më 28 shkurt dhe siç thashë , pritet që sipas ligjit në fund të muajit shtator, të publikohen rezultatet finale të këtij regjistrimi.

Janë nënshkruar katër memorandume mirëkuptimi në mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për punësimin sezonal të 985 punëtorëve nga ana e Agjencisë Pyjore të Kosovës, që konsistojnë me 650 të punësuar për projektin e sanimit të zjarrit në pyje, 195 për projektin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, 120 për projektin për shuarjen e zjarreve në pyjet e Kosovës dhe 20 punëtorë për projektin e prodhimit të fidanëve.

Është finalizuar edhe strategjia dhe plani i veprimit për krijimin e mundësive të reja në zhvillimin e sektorëve të hortikulturës dhe blegtorisë në ekonomitë familjare për vitet 2015-2017, që si cak dhe target kryesor ka në mënyrë të veçantë familjet, që janë në skemën sociale. Në sektorin e pylltarisë është aprovuar plani vjetor për menaxhimin me pyje. Kemi publikuar raportin e gjelbër për vitin 2014, që paraqet të dhëna të detajuara për një serë statistikash tepër të rëndësishme nga sektori i bujqësisë.

Nga projekti zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore janë angazhuar këshilltarë komunalë në 34 komuna të Kosovës. Është bërë organizimi i 102 këshillimeve me tema të ndryshme, prej të cilave kanë përfituar 1 673 fermerë. Janë themeluar 11 qendra informative këshilluese komunale në territorin e Republikës së Kosovës dhe nga ky projekt kanë fituar drejtpërdrejt 1 062 fermerë.

Normalisht, është vazhduar me regjistrimin elektronik të fermerëve, ku tashmë në regjistrin e fermave janë shtuar në këtë periudhë edhe rreth 2.100 fermerë të rinj.

Për sa i përket infrastrukturës ligjore, me qëllim të krijimit të kornizës ligjore për implementim të suksesshëm të politikave zhvillimore dhe për përafrimin e tyre me Bashkimin Evropian, gjatë periudhës raportuese pra, 100-ditëshit të parë ne kemi finalizuar 3 ligje tepër të rëndësishme, të cilat shumë shpejt do të procedohen në Kuvend e që janë Projektligji për pyjet, Projektligji për ushqimin, si dhe Projektligji për pijet e forta alkoolike.

Normalisht, janë hartuar dhe janë në përfundim edhe dhjetëra akte nënligjore, që cilat lidhen me legjislacionin primar në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.

Po e cek në fund edhe faktin, që në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive, kemi nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural me Ministrinë e Bujqësisë të Republikës së Shqipërisë, për të mundësuar një bazë legale, që në të ardhmen të harmonizojmë legjislacionin dhe veçanërisht të fokusohemi tek unifikimi i standardeve, që ndërlidhen me cilësinë ushqimore, si dhe për tejkalimin e problemeve që kemi pasur në të kaluar, në lidhje me importin apo eksportin e produkteve bujqësore.

Gjithsesi, sot do t'ju kursejmë për planet që i kemi, ato janë të publikuara jo vetëm në programin e Qeverisë, por edhe në dokumentet tjera që i përmenda, por, shpresoj, po e përsëris në fund edhe njëherë, se do të kemi pak më shumë debat për bujqësinë, për zhvillimin rural, sepse ndonjëherë edhe idetë e opozitës mund të na shërbejnë për të mirë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhje e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Kam analizuar programin e Qeverisë për vitin 2015 – 2018, por me kujdes të veçantë e kam analizuar pjesën e programit për shëndetësi.

Të nderuar, infrastruktura ligjore për shëndetësi tashmë gati është kompletuar, si Ligji për shëndetësi, Ligji i sigurimeve shëndetësore, Ligji i odave të profesionistëve shëndetësorë dhe ligjeve të tjera në lëmin e shëndetësisë, por, mbetet përgjegjësi e institucioneve dhe të gjithë neve zbatueshmëria e këtyre ligjeve në praktikë.

Njëherësh, pjesë e programit të Qeverisë është edhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në interes të qytetarëve, duke pasur parasysh edhe projekte tjera që janë të parapara në këtë program.

Unë konkretisht, dëshiroj të ndalem në pjesën e programit, ku theksohet se zonat e thella rurale janë të privuara nga shërbimi mjekësor, gjë për të cilën Qeveria zotohet të kanalizojë më shumë fonde dhe të mundësojë subvencione për personel të kualifikuar, që do të shërbejnë në zonat e thella periferike.

Kjo çështje në fakt është e rregulluar me nenin 71, paragrafi 5, të Ligjit për shëndetësi, sipas të cilit të gjithë profesionistët shëndetësorë të sapodiplomuar, që përcaktohen të punojnë në viset rurale, do të punësohen menjëherë në kuadër të Mjekësisë familjare. Edhe pse, shëndetësia primare është kompetencë e komunave, ky ligj rregullon që mjetet financiare për këta profesionistë shëndetësorë të sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë, kështu që qytetarëve në viset rurale u ofrohen shërbime shëndetësore dhe mjekëve të rinj u jepet mundësia të punojnë dhe, në këtë mënyrë ata nuk do të jenë të obliguar që krahas provimeve në Fakultetin e Mjekësisë, të ndjekin kurse të gjuhës gjermane, siç po ndodh në vitet e fundit.

Disa nga prioritetet tjera të Qeverisë, të parapara me këtë program janë edhe sigurimi dhe furnizimi 100% me barna dhe material shpenzues mjekësor nga lista esenciale e barnave, që do të përpiqet me vlerësim real të nevojave.

Funksionalizimi i sistemit informativ shëndetësor, përmirësimi i qeverisjes dhe menaxhimi i institucioneve shëndetësore dhe resurseve profesionale, fuqizimi i kapaciteteve diagnostifikuese në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, përmirësimi i kushteve të punës, stimulimi financiar i profesionistëve shëndetësor në bazë të performancës dhe prioritetet tjera, të cilat janë shumë të nevojshme.

Sipas informatave që kam, projekte të rëndësishme do të fillojnë të realizohen ditët në vijim, si ndërtimi i Qendrës Emergjente të Qendrës Klinike Universitare dhe funksionalizimi i plotë i Kardio-kirurgjisë. Në programin e Qeverisë për shëndetësi është e domosdoshme t'i jepet shumë më shumë rëndësi shëndetit oral. Sa i përket mbrojtjes së shëndetit oral tek pacientët, në veçanti tek shkollarët, Kosova ka kapacitete profesionale për të punuar edhe më mirë se deri tash. Përveç fushatave sensibilizuese, edukative për mbrojtjen e shëndetit oral, duhet që të obligohen të gjitha institucionet shëndetësore të nivelit primar, që për çdo vit të organizohen kontrollimet sistematike me standarde unike në tërë Republikën e Kosovës dhe këto standarde të miratohen nga grupi i ekspertëve, nga Fakulteti i Stomatologjisë dhe, po ashtu të monitorohet ky proces nga ta dhe pastaj të dilet me rekomandime konkrete.

Punëtorët shëndetësorë në Kosovë janë shumë profesionalë dhe shumica prej tyre janë të përgjegjshëm, andaj me përmirësimin e kushteve të punës dhe përmirësimin e menaxhimit, padyshim se programi i Qeverisë për sektorin e shëndetësisë do të realizohet.

Duke ditur që ministri është ai i cili deri dje është ballafaquar me këto probleme dhe kolegët e tij ballafaqohen edhe sot, si me mungesë të mjeteve të punës, mungesë të barnave nga lista esenciale dhe, në pamundësi për ta ndihmuar pacientin edhe në orët e vona të kujdestarisë, prandaj unë besoj se nuk do të mungojë përkushtimi i tij maksimal në realizimin e këtij programi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministrja Bajrami.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë dola sa për të raportuar pak, se u fol shumë për zhvillimin ekonomik. Më vjen keq që nuk më ndërlihet fjala ime me fjalën e parafolësës, po e kemi këtu ministrin e Shëndetësisë dhe besoj se ai do t'i japë përgjigjet.

Pra, u fol shumë për programin për zhvillim ekonomik dhe desha të dalë me qëllim që të tregoj se masat të cilat po i marrim, në bashkërendim edhe me ministrinë tjera, të cilat kanë në mandat zhvillimin ekonomik, sigurisht se do të ndikojnë shumë shpejt në hapjen e vendeve të reja të punës.

Gjatë periudhës kohore 12 dhjetor 2014, deri më 8 mars 2015, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka punuar me përkushtim në fuqizimin e sektorit privat.

Po i përmend vetëm disa prej aktiviteteve. Është bërë ndarja e granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nga fondi i përbashkët i Bashkësisë Evropiane, rreth 4 milionë dhe nga ky fond janë ndarë grantet prej 25 000 euro për 25 ndërmarrje mikro dhe deri në 200 000 për 15 ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Është në përfundim e sipër procesi i themelimit të mekanizimit të skemës për garantim të kredive, i cili është një fond i donatorëve rreth 14 milionë ku Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, kontribuon këtu fillimisht me 1 milion euro, fond ky i cili do të bëjë 50% të mbulimit të hipotekës e cila mendojmë që merr me 50% të mbulimit të hipotekës merr 50% të rrezikut e cila drejtpërdrejt do të ndikojë edhe në uljen e kamatave, po gjithashtu edhe do të ketë qasje më të lehtë sa i përket bizneseve në institucionet tona financiare.

Së bashku me Administratën Tatimore dhe Doganat, jemi duke bërë projektin, kemi iniciuar për integrimin e sistemit të regjistrimit dhe unifikimin e numrit të biznesit me numrin e TVSH-së, numrin fiskal dhe numrin për certifikatën për eksport dhe import. Besojmë se kjo do ta rrisë transparencën dhe në masë të madhe do të ulë burokracinë.

Ministria jonë së bashku me Ministrinë e Diasporës, kemi mbajtur disa konferenca për promovim të investimeve në Gjermani, Zvicër dhe Austri, ku kemi shpalosur programin qeveritar dhe në fakt kemi ftuar diasporën tonë që të vijnë e investojnë në Kosovë, kemi parë se e kanë një vullnet jashtëzakonisht të madh dhe jemi në përgatitje të projekteve konkrete për fushat ku ata kanë interes.

Me qëllim të përmirësimit të sektorit privat, MTI gjatë kësaj kohe e ka hartuar edhe konceptin, dokumentin për politikat industriale. Gjithashtu e kemi finalizuar edhe planin zhvillimor për sektorin e turizmit dhe planin e veprimit 2015-2017.

Sa i përket integritetit të ekonomisë sonë në tregjet rajonale dhe globale, gjatë kësaj kohe janë bërë përgatitje intensive brenda Ministrisë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit sapo ajo të jetë e nënshkruar. Jemi në negociata shumë intensive në kuadër të CEFTA-s për shërbimet. Po bëjmë ligjin për shërbimet, e kemi po thuhet se gati, ku po bëhet edhe transfuzimi i Direktivës evropiane për shërbimet.

Gjatë kësaj kohe, në fakt në kuadër të CEFTA-s është arritur edhe Marrëveshja e Qeverisë sonë me Qeverinë e Bosnje e Hercegovinës për njohjen reciproke të certifikatave veterinarë. Bisedat janë udhëhequr nga MTI dhe si rezultat nga 1 shkurt ky problem është zgjidhur.

Ne kemi filluar gjithashtu aktivitete shumë intensive për përgatitjen e aplikacionit tonë në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe për këtë qëllim deri tani kemi mbajtur 6 takime me Organizatën Botërore të Tregtisë dhe me vendet anëtare të kësaj organizate.

Sa i përket përmirësimit të lëvizjes së lirë të mallrave dhe rregullimit të tregut të brendshëm, unë dua të them që Ministria jonë, në bashkëpunim me Doganat e Kosovës, ka filluar një projekt për

kompletimin e një laborator kimik për kontrollin e cilësisë së naftës. Për këtë qëllim parashihet edhe pajisja e Inspektoratit të Tregut në kuadër të Ministrisë me një laborator mobil që do të mundësojë fleksibilitet dhe mundësi për kryerjen e të gjitha inspektimeve të paralajmëruara.

Të nderuar deputetë,

Për herë të parë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka bërë evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha pikave të shitjes së karburantit në Kosovë, me pajisje GPS duke përfshirë këtu edhe komunat e veriut dhe janë evidentuar komplet 865 pika të karburanteve me pakicë, prej të cilave 733 janë në funksion, ndërsa 133 nuk janë aktive.

Më lejoni t'ju tregoj se me 31 dhjetor 2014 rreth 10,4% të pikave të karburanteve nuk kanë pasur licenca. Kanë qenë duke operuar në treg pa licenca. MTI ka filluar aksionin e mbylljes së të gjitha pikave të cilat nuk kanë pasur licenca dhe ky aksion nuk ka pasur për qëllim që të mbyllë vende pune apo të mbyll biznese, por qëllimi i vetëm ka qenë që faktikisht të respektohet ligji. Dhe, tani kemi një numër shumë të madh të aplikacioneve, ku në fakt të gjitha pikat pa licenca gradualisht, në kuadër të kapaciteteve që ka MTI, po licencohen. Besojmë se kjo është një arritje e madhe.

Paralel me këtë, Departamenti i Metrologjisë po bën kalibrimin apo siç është e njohur në gjuhën e sektorit, “bazhdarimin” e të gjitha pajisjeve të qitjes për të vërtetuar nëse litri është litër, edhe kjo konform kapacitetit është një projekt i cili do të marrë një kohë më të gjatë, mirëpo është diçka të cilën e kemi ndërmarrë dhe e kemi me shumë prioritet.

Ne, gjithashtu, në kuadër të rishikimit të tregut dhe rregullimit të naftës në kuadër të këtij Departamenti, po bëjmë rishikimin e Ligjit të naftës dhe shumë shpejt do e sjellim për plotësim-ndryshim dhe të gjitha udhëzimet administrative të cilat autorizojnë trupa inspektuese që janë operatorë privatë dhe laboratorë për kontrollin e cilësisë të cilët janë prapë kompani private, por operojnë në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ne nuk jemi të kënaqur me performancën e tyre, po i ndërrojmë udhëzimet administrative dhe shumë shpejt do të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale për t'i ndarë mirë fusha të përgjegjësisë së tyre.

Ne, siç e dini në kuadër tonë edhe Agjencinë e Standardizimit dhe gjatë kësaj kohe Agjencia e standardizimit, nëpërmjet komiteteve teknike ka miratuar 166 standarde.

Ne kemi hapur, siç e dini, me iniciativën e kryeministrit dialogun me sektorin privat. Janë mbajtur disa takime me komunitetin e biznesit dhe ne po takohemi çdo ditë me ta, shumë shpejt do të bëhet edhe funksionalizimi i Këshillit Kombëtar për zhvillim ekonomik, i cili do të udhëhiqet nga vetë kryeministri, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të jetë koordinatore dhe brenda Ministrisë ne do të kemi sekretariatit dhe aty mendojmë që t'i adresojmë të gjitha barrierat të cilat sot i kanë kompanitë private.

Mendoj se të gjitha këto aktivitete të cilat kanë ndodhur për 100 ditë, pa dyshim që do të përmirësojnë ambientin e biznesit dhe do të kenë ndikim në krijimin e vendeve të reja të punës, por mos të harrojmë se mandati nuk është 100 ditë, është shumë më gjatë, kështu që pritet se premtimet që i kemi dhënë dhe gjërat të cilat i kemi premtuar në program të realizohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër, akademik Isa Mustafa,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Dhe ju kolegë deputetë, këta që jeni këtu, një pakicë!

Po ashtu, qytetarë të Republikës së Kosovës,

Siç e patëm rastin të dëgjojmë edhe ekspozenë e kryeministrit e po ashtu edhe të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, unë nuk do t'i përsëris, sepse ishin të qartë e po ashtu ishte edhe kryeministri konkret në realizmin e objektivave të Programit qeverisës.

Mendoj se edhe ju e dini që ndoshta nuk ka qenë edhe shumë korrekte që menjëherë të fillojmë me skenarë të ndryshëm të protestave apo të grevistëve dhe nuk i kemi lënë shumë hapësirë Qeverisë. Këtu nuk i them vetëm kryeministrit, por edhe anëtarët e Kabinetit qeveritar që ta bëjnë punën qysh i takon Kabinetit qeveritar.

Po ashtu, edhe ne si deputetë, e kemi një obligim kushtetues si legjislativ që të jemi korrektë edhe ne, t'i ofrojmë rekomandime Kabinetit qeveritar, të mos jemi vetëm kritikë, por të shohim se çka mundemi së bashku të bëjmë e të rrugëtojmë së bashku, sepse konsideroj që nuk do të duhej të jemi të kënaqur në dështimin e Qeverisë, sepse konsideroj që ne së pari jemi qytetarë të Republikës së Kosovës e pastaj kemi edhe detyrat tona obligative si ligjvënës.

Kemi shumë sfida para vetes dhe unë personalisht jam shumë e kënaqur me ministrat tanë që i kemi këtu prezent dhe me punën që po e bëjnë, por mendoj se ne duhet të fokusohemi edhe te agjenda evropiane më shumë si deputetët që edhe kur t'i kemi takimet tona mos të jemi kritikues por të ndihmojmë dhe të llojmë sa i përket agjendës evropiane, sepse kjo krejt neve na bie hise, në atë kuptimin se edhe na duhet të jemi ata të cilët duhet të kontribuojmë dhe jo vetëm kritika. Unë e kuptoj, sepse edhe unë kam qenë ndoshta në rolin e opozitës para se të kalojë në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe është shumë normale për ta luajtur rolin opozitar, por mendoj se me të drejtë e kanë paraqitur edhe kërkesën Lëvizja "Vetëvendosje" që është shumë normal, sepse kjo po na kontribuon edhe neve që të fillojmë të mendojmë se çka mundemi së bashku t'i ndihmojmë Qeverinë.

Unë e kuptoj se për 100 ditë s'kanë mund këta të bëjnë mrekulli, e as ju s'kishit mund të bëni mrekulli, sepse kemi pasur rast që edhe AAK-n ta kemi në Qeveri, por...

(Ndërhyrje)

Zonja Teuta, unë dëgjova me vëmendje kështu që ta përfundoj, kërko replikë.

E dyta, kërkoj po ashtu që sa i përket imazhit të Qeverisë këta asnjëherë, zoti Grabovci... këta e kanë krijuar një kulturë tash të re të punës. Domethënë janë disa punë që edhe Qeveria paraprake i ka filluar, por kjo tash duhet t' i mbarojë.

Prandaj, unë duke mos e zgjatur më shumë, përveç sukseseve që këta veç i paraqitën këtu, ministrat e po ashtu edhe kryeministri, unë vetëm një mesazh e kam për ju kolegë deputetë dhe

për Kabinetin qeveritar, që të punoni, që i keni marrë këto detyra dhe ta mbrojmë vendin ashtu si e meritojnë edhe qytetarët e po ashtu të dalim aq më mirë edhe para bashkësisë ndërkombëtare, para qytetarëve tanë dhe t'ia kthejmë besimin e jo vetëm t'i themi dështimet që janë bërë, por t'i themi edhe sukseset që i kemi dhe i kanë edhe ministrat tanë dhe me aq sa po munden për 100 ditë dhe mendoj se janë bërë shumë hapa të rëndësishëm.

E shpëtuam edhe “Trepçën” nga falimentimi dhe normalisht edhe me votën e deputetëve dhe mendoj se janë bërë edhe do masa tjera që ju i dini. Po ashtu ministri i Bujqësisë Memli Krasniqi e tha se askush nga ju nuk e përmendi bujqësinë, që kjo është njëra prej sektorëve dhe njëra prej kushteve të liberalizimit të vizave, sepse edhe në Raportin e Progresit janë thënë shumë gjëra të qarta se ne duhet të punojmë sa më shumë edhe për bujqësinë.

Megjithatë, kolegë deputetë, hajde të punojmë së bashku dhe t'ia kthejmë qytetarëve, kështu që të mos jemi shumë demagogë, por të punojmë më shumë dhe mandej të kthejmë pak besimin e qytetarëve, sepse mjaft janë lodhur edhe me gjendjen e rëndë ekonomike që e kanë, por të punojmë aq sa mundemi. Faleminderit edhe një herë për vëmendjen dhe unë ministra ju përgëzoj dhe do ta keni mbështetjen time si deputete me aq sa mundem dhe suksese. Pra, edhe një herë faleminderit për vëmendje nga ju kolegë deputetë që ishit këtu!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salihu, e keni fjalën.

SALIH SALIHU: I nderuar kryesues,

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Përkundër kushteve të favorshme klimatike dhe tokës pjellore që ka Kosova, gjendja e tanishme e bujqësisë është ende e rëndë dhe kjo si pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve jo adekuate dhe të papërgjegjshme të njerëzve të Qeverisë së kaluar e që po vazhdojnë të qeverisin edhe me këtë Qeveri.

Unë dëgjova me vëmendje ministrin e Bujqësisë dhe disi mu krijua përshtypja se a jemi duke folur për të njëjtin program qeverisës apo i kanë vërtet dy programe qeverisëse për bujqësi. Në një program qeverisës që unë e kam lexuar që ju e keni publikuar, ku shihet se nuk janë më tepër se tri faqe për bujqësi, u kisha lutur të gjithë deputetëve kolegë që ta lexoni këtë program dhe të shihni se çfarë përmbajtje ka ai program për bujqësi.

Për mua është e papranueshme të thuhet se ky sektor është prioritet nacional për zhvillimin ekonomik të vendit dhe në anën tjetër t'i shkruash vetëm 3 faqe program për këtë sektor. Madje këto 3 faqe janë të shkruara me retorikë dhe terma të përgjithshëm pa përcaktime kohore dhe hapësinore se kur dhe ku do të ndërmerren hapa të caktuar dhe në gjithë programin për bujqësi nuk mund të gjesh qoftë edhe një shifër apo një përqindje që është planifikuar për sektorin e caktuar në bujqësi.

Pra, në gjithë programin përdoren fjalët: “do të përmirësohet, do të rritet, do të shumëfishohet, do të përkujdeset”. Madje shpesh e gjen edhe fjalën “Qeveria në katër vjetët e ardhshme”, çka lë të kuptohet se ky program është vetëm kopjim i programit elektorale, por se këtu kanë harruar të përmendin dhe të shpjegojnë hapjen e 120 000 vendeve të punës.

Kosova ka një program kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 i cili duhet të jetë në harmoni të plotë me programin qeverisës, por ky program nuk është përmendur fare në kuadër të programit qeverisës dhe nuk është harmonizuar fare me objektivat e tij.

Ne kemi veçuar disa nga paqartësitë që e bëjnë këtë program problematik, pa objektiva të qarta dhe pa një plan për realizmin e tyre.

Në program thuhet se buxheti do të rritet vazhdimisht, por nuk precizohet se sa do të jetë buxheti për bujqësi së paku në dy vitet e ardhshme, dhe në cilët sektorë, do të thotë, do të investohet në dy vitet e ardhshme në bujqësi. Buxheti i tanishëm, ne konsiderojmë se është ende i vogël dhe konform kërkesave që ka bujqësia e Kosovës, por edhe në raport me buxhetin që e kanë shtetet fqinjë, sidomos shteti i Maqedonisë, i cili është konkurruesi kryesor me produkte bujqësore në Kosovë.

Fillimisht në kuadër të rritjes së Fondit për subvencione dhe grande, thuhet se do të mbështetet blerja e plehrave kimike, të pesticideve, të farës dhe fidanëve dhe pastaj më poshtë shkruajnë krejt të kundërtën, se do ta ndryshojnë politikën e subvencioneve – mbështetjeve, ku thonë se nuk do të mbështesin më imputet, do të thotë rrjedhimisht nuk do të mbështesin farën, plehun dhe fidanët, por do të mbështesin thjeshtë prodhimin. Domethënë brenda një fjalie, një paragrafi hasin në kundërshtim do të thotë qëllimet, objektivat e tyre. Madje nuk kanë shpjeguar se si do të bëjnë këtë, pasi që subvencionimi i prodhimit, ne mendojmë, është i vështirë për t'u realizuar duke pasur parasysh mundësinë e keqpërdorimit kur kemi parasysh importin e madh të produkteve bujqësore, sidomos të drithërave të cilat mund të prezantohen rrejtshëm si prodhim vendor.

Nuk janë të trajtuara kriteret për subvencionim. Deri më tani kriter për subvencionim të prodhuesve të grurit është sipërfaqja mbi 2 hektarë, ndërkaq, në Kosovë janë diku 10 deri 15% të ekonomive familjare që kanë sipërfaqe mbi 2 hektarë dhe përfitojnë vetëm kjo kategori, ndërkaq 80% e ekonomive tjera familjare nuk përfitojnë nga subvencionimi i grurit. Ne konsiderojmë se edhe ajo ekonomi familjare që mbjell edhe gjysmë hektari tokë me grurë duhet të subvencionohet. Mandej ka vonesa në subvencionim. Ministri tha se jemi në kohën e aplikimit për subvencionime dhe për grande. Paramendoni, tash muaji prill - 2 prilli, tash jemi në kohën e aplikimit. Ne mendojmë se koha e aplikimit për subvencione dhe grande duhet të jetë në muajin janar, në shkurt duhet të bëhet përzgjedhja, në mars duhet t'u bëhen publik emrat e fermerëve që kanë përfituar dhe në prill fermeri duhet të jetë në ara, e jo tash fermeri të vrapojë pas dokumentacionit dhe të dalë për të aplikuar dhe humb një vit.

Nuk janë të shpjeguara se cilat masa do të ndërmerren kundër importit damping dhe se a do të subvencionohet edhe te ne eksporti i produkteve bujqësore.

Është përmendur ndërtimi i sistemeve të ujitjeve në mënyrë shumë të përgjithshme. Në të gjithë lumenjtë që i kemi ne, do të ndërtojmë sisteme të ujitjes. Kjo diqysh është e pakuptueshme. Madje thuhet se do ta ndërtojmë sistemin e ujitjes Ibër-Lepenc, sistemin e Radoniqit, ku do t'i përfshijmë të gjitha sipërfaqet bujqësore në rrafshin e Kosovës dhe në rrafshin e Dukagjinit, por nuk është saktësuar se kur do të fillojë ky projekt kapital normalisht për ne dhe me çfarë buxheti do të mbështetet. Domethënë, nuk dihet prejardhja e buxhetit.

Është përmendur se do të mbështesim masat... kullimin e tokave, por nuk tregojnë se cilat regjione dhe ku është planifikuar të bëhet kjo. Për ne është nevojë urgjente që sot të intervenohet në komunën e Vitisë, që të bëhet rregullimi i shtratit të lumit, sepse atje janë vërshtuar rreth 1000 hektarë tokë pjellore dhe gjithashtu janë bërë dëme të mëdha në ekonomitë familjare dhe nëpër shtëpitë e tyre.

Përmenden se do të bëjnë inventarizimin e stoqeve të bagëtive, vreshtave, pemishteve, serrave dhe pikave të grumbullimit të qumështit, tregjeve të gjelbra, por nuk e përmendin regjistrimin bujqësor që është kryer në vitin e kaluar dhe nuk tregojnë për rezultatet e atij regjistrimi.

Shumë pak i kushtohet rëndësi blegtorisë, perimtarisë, pemëtarisë dhe vreshtarisë, fusha këto që Kosova ka një traditë të kultivimit, ndërsa më tepër në program janë fokusuar në planifikimin e prodhimeve të produkteve të reja, si kivi, shpargulli, pastaj kultivimi i kërmijve, strusave dhe drerëve për të cilat natyrisht se Kosova nuk ka ndonjë traditë.

Gjithashtu është për keqardhje që me vetëm 5 rreshta përshkruhet plani i mbrojtjes së pyjeve dhe zhvillimit të tyre. Për ne resurset pyjore janë me interes nacional që kanë efekte ekonomike dhe ekologjike, prandaj konsiderojmë se në program do të duhej të saktësohet se sa hektarë në vit do të ripyllëzohen, në cilat zona dhe me çfarë drurësh do të bëhet ai ripyllëzim.

Pra, vetëm shprehjet që i dedikohen bujqësisë në këtë program, nuk garantojnë zhvillim të bujqësisë, por duhet program dhe politika adekuate për secilin sektor të detajuar që orientojnë bujqësinë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Natyrisht se Kosova ka nevojë për politika të mirëfillta që e mbrojnë prodhimin vendor, ka nevojë për hartimin dhe zbatimin e masave në sigurimin e cilësisë së prodhimeve vendore dhe për promovimin e tyre.

Gjithashtu është me interes për bujqësinë e Kosovës të bëhet orientimi i prodhimit sipas predispozitave që kanë në regjione të caktuara, dhe të bëhet planifikimi i prodhimit sipas trendit të zhvillimit të tregut për të mënjeluar mundësinë e paraqitjes së hiperprodhimit të një produkti të caktuar në treg dhe deficitin e një produkti tjetër.

Për të gjitha këto natyrisht se duhet dhe kërkohet një angazhim e koordinim ndërministror, ndërinstitutional në mes të Kryeministrit, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Tregtisë e Industrisë si dhe të Doganave e gjyqësorit. Mirëpo, a mund të shpresohet se kjo qeveri me njerëz të njëjtë që qeverisën deri më tani dhe me jo kompetencën dhe papërgjegjësinë e tyre i shkatërruan tokat bujqësore duke bërë ndërtime të egra në to, i shkatërruan pyjet duke i prerë e më pastaj duke i nderur, i shkatërruan lumenjtë duke e shfrytëzuar zhavorrin dhe rërën për ndërtim, kanë vullnet të ndryshojnë gjendjen e rëndë të bujqësisë së Kosovës.

Ne mund të krijojmë ligje, mund të krijojmë memorandume bashkëpunimi, mund të kemi programe, por në Kosovë problem është implementimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve.

Dhe si përfundim, themi se bujqësia do të vazhdojë të ketë gjendje të rëndë, prodhimi vendor dhe fermeri i Kosovës, do të jetë i pambrojtur dhe i pa barabartë në treg, si dhe fermerëve nuk do t'u

afrohet mbështetja as në cilësi e as në sasi dhe as në kohën kur ata kanë më së shumti nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Krasniqi do të sqarojë disa gjëra.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Më shumë për sqarime, të nderuar deputetë, faleminderit i nderuar kryesues, se sa për replikë.

Të nderuar deputetë,

Realisht ju thatë, keni përdorur fjalët “do të”. Po në program duhet përdorur “do të”, sepse ai flet për të ardhmen dhe tregon se cilat janë zotimet dhe përkushtimet. S’mund të thuhet - është bërë, sepse ajo është kohë e kaluar, është bërë diçka në të kaluarën e ne po flasim për 4 vjet. Kjo është e para.

E dyta, po thoni është i shkurtër. Unë mendoj se nuk është shumë e rëndësishme sasia, sa është e rëndësishme cilësia. Dhe në këtë kuadër këtu tregojmë ne për vizionin e Qeverisë, për sa i përket bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë.

Detajet pa dyshim se do t’i gjeni, veçanërisht te ai që ju e quajtet me të drejtë - programi për bujqësi dhe zhvillim rural për vitet 2014-2020, sepse aty pastaj të gjitha detajet për çdo sektor, për të gjitha punët dhe planet tona normalisht se janë të detajuara, por është pak kjo reale të pritët që në programin e Qeverisë ne t’i shkruajmë 200 faqe për bujqësinë, sepse ne duhet ta bëjmë si me thënë pak më të kondensuar atë program, që të mund ta lexojnë të gjithë.

Rritja. Disa pyetje i patët, unë po mundohem të jap përgjigje. Rritja e buxhetit për këtë vit është 121% krahasuar me vitin e kaluar. 60 milionë euro i ka Ministria e Bujqësisë. Dhe po ashtu, nëse i shtohen edhe 8 milionë e gjysmë që është buxheti i dedikuar për bujqësi në nivel të komunave, ne kemi rreth 69 milionë euro vetëm nga buxheti nacional, që për Kosovën është absolutisht deri tash një rekord, sepse kemi arritur që të kemi rreth 4.4% të buxhetit të përgjithshëm nacional të dedikuar për bujqësinë.

Mendoj se para se gjithash kjo është një e dhënë faktike dhe s’mund të kontestohet prej askujt.

Vetë fakti që ne kemi arritur që ta programojmë një program për bujqësi dhe zhvillim rural dhe për pagesa direkte prej 43 milionë eurosh për vitin 2015, tregon që kemi një rritje substanciale dhe është e palogjikshme të thuhet prej kujt do qoftë që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Mund t’ia shtoni pak minuta!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Plani për rritje, thatë, unë po ju tregoj, plani ynë shpresoj më se do të kemi mundësi financiare, është që buxheti për grande dhe subvencione të rritet për 5% në vit, për periudhën e ardhshme.

Ndryshimi i mbështetjes, nuk është e saktë që është thënë në program, në fakt është thënë për atë sa është e mundshme rishikimi i mënyrës, do të thotë ne s’kemi bërë zotim 100% se do të

ndërrojë subvencionimi prej imputeve në produktivitet. Ne kemi subvencionim edhe të produktivitetit, ta zëmë kemi filluar me skemën e mbështetjes për cilësinë e qumështit. Ajo e mbështet produktivitetin, jo inputin. Pastaj ne do të shpresojmë që në të ardhmen, por jo menjëherë, por shpresojmë nga fundi i mandatit të kemi mundësi që prodhimtarinë ta subvencionojmë në kategori të caktuara, absolutisht jo në të gjitha.

Sipërfaqja 2 hektarë. Është debat i gjatë, nuk është e saktë që janë vetëm 15%, j anë shumë më shumë. Ne besoj se këtu duhet koordinuar me komuna dhe këtu ka qenë gjithmonë qëllimi që komunat t'i subvencionojnë ata që janë me më pak se 2 hektarë, sepse rentabiliteti ekonomik i atyre që mbjellin më pak se 2 hektarë grurë realisht është inekzistent, sepse nuk mund ndoshta ta sigurojnë grurin - miellin as për familjen e vet.

Për afatet e aplikimit, të cilat ju i përmendët, pajtohem se mund t'i bëjmë në të ardhmen edhe më herët dhe qëllimi ynë është që në të ardhmen t'i bëjmë në janar, por asnjë rast në këtë vit nuk do të rrezikohet programi, sepse ju e dini që fazat vegetative, veçanërisht te hortikultura, te pemëtaria para se gjithash, janë të tilla që edhe ta kishim shpallur më herët njerëzit nuk mund t'i mbjellin mollët para nëntorit ose në fund të tetorit, kështu që është problematike. Ne vetëm kishim bërë problem, kishim thënë i keni 4 muaj dhe ata s'kishin mund ta bëjnë në shtator, ishte dashur për t'ua shtyrë prapë, kështu që nuk e cenon asnjë fermer, fakti që është hapur në shkurt kjo çështje.

Regjistrimin e kemi përmendur, unë e përmenda edhe sot. Inventarizimi është i nevojshëm. Regjistrimi do të na ndihmojë për ta bërë inventarizimin, padyshim për të gjitha ato që i përmendët dhe është absolutisht e pasaktë nëse thuhet që pemëtaria, vreshtaria, perimtaria ose hortikultura në përgjithësi nuk është në fokus. 11 milionë euro është e planifikuar për masën 101 të programit për zhvillim rural, ku shumica e këtyre mjeteve janë të dedikuara pikërisht për pemëtari, sikur për pemët frutore, normalisht edhe për pemët e imta që kanë treguar një sukses të jashtëzakonshëm në vitet e fundit, për serat, për pjesën e perimtarisë, por këtë vit shumë më shumë se çdo vit tjetër, edhe për vreshtarinë.

Për këto kulturat e reja që i kemi përmendur, ato janë një treg i vogël, që është interesant. Kanë pasur njëfarë suksesi, veçanërisht shafрани, për shembull, që ka filluar të eksportohet edhe jashtë Kosovës, nuk mund ta ketë një impakt shumë të madh në ekonominë e vendit, por është me rëndësi tek diversifikimi i aktivitetit në fermë t'u jepet mundësi bujqve për të krijuar të hyra shtesë edhe prej aktiviteteve jo tradicionale që s'janë marrë në të kaluarën.

Për pyllëzimet, plani i menaxhimit me pyje është publik dhe sot bile më duket ka pasur kryeshefi i Agjencisë edhe një intervistë që ka treguar saktë edhe numrin, si me thënë, për sipërfaqet sa do të pyllëzohen. Unë i tregova që kemi marrë edhe 985 punëtorë sezonalë gjatë këtij viti në sektorin e pylltarisë, që përshin edhe prodhimin e fidanëve në Institutin në Pejë, por edhe pyllëzimet në rajonet që do të bëhen.

Por, mbi të gjitha më lejoni t'u them në fund, që për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë, unë edhe një herë ju ftoj që të kemi komunikim të rregullt, por mbi parimet dhe faktet. Faktet janë këto që janë, ndërsa të gjitha çështjet për të cilat keni edhe ju personalisht si njeri që jeni

marrë me këtë fushë dhe merreni edhe në Komision, por edhe për deputetët tjerë, ne jemi në dispozicionin e juaj për t' u dhënë informata shtesë 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, urdhëro, zoti Salihu, 2 minuta.

SALIH SALIHU: Fjala - do të, përdoret dhe normalisht se është për të ardhmen, por ju keni qenë që keni qenë domethënë duke qeverisur më herët dhe keni pasur këtë dikaster dhe janë parë sukseset, numër një.

Tri faze, të lutem ministër, nëse vërtet nuk e keni lexuar, ose vërtet i ke lexuar dhe nuk keni intervenuar, më dëshpron edhe më shumë fakti se ka këso gabime në këtë program qeverisës.

Aty thuhet plotësisht do ta ndryshojmë mënyrën e mbështetjes, do të thotë për subvencione. Domethënë, plotësisht nënkuptohen 100%.

Regjistrimi bujqësor. Lexoje aty qysh shkruan plotësisht - regjistrimi bujqësor është bërë... Nuk përmendet në program, nën një.

Dhe asnjë nga eksperimentet me kulturat eksperimentale, kulturat e reja që pajtoj të bëhen hulumtime, por jo për t' u futur në program qeverisës. Për shkak se hulumtimin e bëjnë institutet që janë shkencore hulumtuese, por jo Qeveria.

Prandaj, me këto hulumtime që janë bërë, domethënë kanë dështuar të gjitha këto projekte, si me shafran, si me shpargull, si me kërmij, si me kërpudha, e tjera. Prandaj nuk ka nevojë ndoshta për të filluar sepse ne kemi nevojë për kulturat që janë esenciale të cilat po na i marrin paratë dhe po rrjedh paraja jashtë vendit dhe ato janë kulturat esenciale për jetë dhe jo për të bërë eksperimente, do të thotë, në këtë program që veç ju qysh e keni paraparë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Më lejoni që para jush t' i pasqyroj disa prej aktiviteteve, respektivisht të arriturave të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, në këtë tremujorin e parë të punës së Qeverisë Mustafa.

Fillimisht duhet thënë se Ministria e FSK-së aktivitetet e veta në këtë periudhë kohore i ka bazuar dhe ndërlidhur me planin e veprimit për zbatimin e programit të Qeverisë 2015-2018, pastaj me dokumentin Politikën e sigurisë dhe përafrimi me mekanizmat e NATO-s, pastaj në përputhje me rekomandimet e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë dhe me planin afatgjatë zhvillimor.

Në përgjithësi të gjitha aktivitetet e Ministrisë së FSK-së të zhvilluara në këtë periudhë 100 ditore mund të kategorizohen në disa sfera, dhe atë:

Aktivitetet që kanë të bëjnë me hartimin e dispozitave ligjore dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore, si dhe me draftimin dhe aprovimin e dokumenteve doktrinale strategjike konform rekomandimeve të dala nga rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë.

Kështu Ministria e FSK-së ia ka proceduar Qeverisë draftligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës.

Pastaj, ka hartuar draft-doktrinën e përgjithshme ushtarake;

Ka iniciuar hartimin e strategjisë së mbrojtjes dhe librit të bardhë.

Sfera tjetër e aktiviteteve është planifikimi dhe përgatitja për ngritjen dhe ndërtimin e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura mbi bazën e prioriteteve dhe fazave të zhvillimit të paraqitura në bazë të rekomandimeve të rishikimit të strategjisë së sektorit të sigurimit.

Ministria e FSK-së me Komisionin e saj profesional dhe këshilltarët e ekipit këshillues të NATO-s, ka punuar dhe është në prag të finalizimit në parim të Deklaratës së misioneve të Forcave të Armatosura të Kosovës dhe njërive të saj, pastaj strukturës organizative, pajisjeve si dhe planit afatgjatë buxhetor të mbrojtjes së vendit.

Sfera tjetër e aktiviteteve ka të bëjë me thellimin e bashkëpunimit bilateral me Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të rajonit, NATO-s dhe BE-së. Në këtë rrafsh janë nënshkruar planet bilaterale të veprimit për vitin 2015 me Gjermaninë, Shqipërinë, Kroacinë dhe Turqinë.

Janë finalizuar draftet e memorandumeve të bashkëpunimit me Ministrinë e Mbrojtjes së Italisë, Ministrinë e Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Ministrinë e Mbrojtjes së Hungarisë.

Në koordinim me ENLAT-in është bërë planifikimi për pjesëmarrjen e oficerëve të FSK-së në trajnimet që zhvillohen në NATO gjatë vitit 2015.

Janë bërë përgatitjet për organizimin e Konferencës ndërkombëtare me titull: FSK dhe partnerët, që do të mbahet në fund të prillit.

Është nënshkruar protokolli për shkëmbimin e personelit ushtarak dhe civil për qëllime sociale me Ministrinë e Turqisë.

Zyrtarët e lartë të ministrisë gjatë kësaj periudhe kanë pasur takime pune me sekretarin e NATO-s, zotin Jens Stoltenberg, kanë realizuar vizitë pune në selinë e NATO-s me ftesën e misionit të SHBA-ve në NATO, si dhe takime të tjera me atashetë, ushtarakët, ambasadorët, zyrtarët, oficerët e delegacioneve të larta të shteteve mike si të SHBA-ve, të Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Italisë, Suedisë, Turqisë, Shqipërisë, Norvegjisë, Zvicrës, Kroacisë, Maqedonisë, Hungarisë, Greqisë dhe Sllovakisë.

Sfera tjetër e aktiviteteve të Ministrisë së FSK-së përbëhet nga pjesëmarrja e pjesëtarëve të FSK-së dhe njësive të saj në ushtrime fushore, trajnime, seminare, operacione humanitare dhe aktivitete, qoftë të karakterit rajonal apo më gjerë me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për anëtarësim në iniciativat rajonale.

Në këtë rrafsh duhet veçuar Misionin e kontingjentit të specializuar të kërkim - shpëtimit në operacionin humanitar për të ndihmuar tejkalimin e situatës së krijuar nga vërshimet e ujërave në disa zona të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut.

Sfera tjetër e aktiviteteve të Ministrisë së FSK-së ka të bëjë me ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve operacionale, logjistike dhe infrastrukturore të njësive të FSK-së si dhe pjesëmarrja e tyre e vazhdueshme në aktivitetet për forcimin e besimit të qytetarët dhe mbështetja për autoritetet civile vendore, si për shembull: kërkimi dyjavor i kufomës së fëmijës në ujërat e lumit Sitnica, në kushte dhe rrethana tejet të rënda nga ana e Task-Forcës për Kërkim-Shpëtim, pastaj organizimi dhe mbajtja e ligjëratave në shkollat fillore dhe të mesme për vetëdijësimin e nxënësve për rrezikun nga minat dhe nga përdorimi i mjeteve piroteknike. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka kërkuar fjalën,

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryesues!

Ne, në bashkëpunim edhe me subjektet tjera opozitare e kemi formuluar kërkesën që ky debat të vazhdojë nesër, për arsye se siç po duket këtu më pak se 1/3 e deputetëve të Kuvendit ndodhen, për shkak se shumica kanë ikur dhe e tjetra është se ka rënë koncentrimi i deputetëve pak dhe janë lodhur dhe nëse kemi edhe, të themi, mirëkuptimin e grupeve tjera parlamentare të mazhorancës, atëherë do të ishte mirë që ky debat të vazhdojë nesër në orën 10.

KRYESUESI: Faleminderit! Pra, e kisha ndërmend edhe një deputeti t'ia jap fjalën, por e lëmë këtë për nesër dhe nesër në orën 11 të vazhdojë mbledhja, për shkak se edhe Qeveria e ka një mbledhje në orën 10, kështu kam informatën, pra , të paktën të shkojë një gjysmë ore dhe të vazhdojmë ne. Si duket Ademi u lajmërua për fjalë. Urdhëro, Adem!

ADEM GRABOVCI: Zoti nënkryetar,

Ne kemi mirëkuptim për opozitën. Vërtet po shihet se ne po tregojmë respekt, e respektojmë, kanë kërkuar debat dhe ne jemi të gatshëm të vazhdojmë, mirëpo nëse janë lodh këta, ne prapë... sepse kemi çka të themi.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Për zotin Grabovci, sepse ka mbetur i vetëm në sallë, prandaj këtë s'po e shoh të arsyeshme çka po thotë.

KRYESUESI: Pra, shihemi nesër në orën 11:00.

* * *

*E premte, më 3 prill
Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 2 prill
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,
Po vazhdojmë punimet e seancës së djeshme, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Siç e dini, dje ka mbetur një numër i madh i deputetëve pa diskutuar. Po vazhdojmë me listën e përafërt, ashtu siç ka qenë, përveç nëse ndonjë ndërhyrje e grupeve parlamentare propozon që të ndryshojë renditja, ose t'i jepet fjala dikujt pa radhë në interes të mbarëvajtjes ose të debatit që e kemi planifikuar.

Sipas radhës së diskutuesve, kam përshtypje që ka ngelur radha tek Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Fjalën e ka zoti Bali Muharremaj. Besoj që kryeministri do të vijë edhe pak.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Në shtetet me sistem parlamentar demokratik, puna e parë pas zgjedhjes së Qeverisë do të ishte sjellja në Kuvend e planit dhe programit të saj qeverisës.

Por, si duket është bërë traditë e keqe jetës sonë politike papërgjegjësia institucionale dhe respekti ndërmjet pushteteve.

Afër katër muaj kjo qeveri ka punuar mbi baza të improvizimeve dhe me plan 'ad hoc' për shkak se i ka munguar plani dhe programi i qartë qeverisës.

Nuk e di nëse kjo ka ardhur si rezultat i koncepteve të ndryshme politike ndërmjet partnerëve të koalicionit apo energjia e tyre u koncentrua në ndarjen e posteve ministrore dhe zëvendësministrore, apo ndoshta dikur vonë dikujt iu kujtua që Qeveria duhet ta ketë një program qeverisës bile së paku në letër.

Ende i kemi të freskëta planet famoze të Qeverisë së kaluar, sikur ajo e Banjskos, apo edhe premtimet e partnerëve të koalicionit për hapjen e 120 mijë apo 150 mijë vendeve të reja të punës, ndërsa një parti tjetër politike ka premtuar 200 mijë vende të reja të punës, deri te premtimet cinike si ajo për luginën e silikonit.

Pavarësisht kësaj, tani jemi ku jemi, dhe para nesh është prezantuar një program qeverisës, e kryeministri na e prezanton si një program i zhvillimit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Sipas vlerësimit tim, ky program që na është ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës është një përmbledhje e fjalëve të mira, por që nuk garanton zhvillim ekonomik, nuk ofron mirëqenie dhe zbutje të papunësisë, nuk e kthen dinjitetin e humbur të qytetarëve të vendit, por thjesht është një program që do të vazhdojë 'status quo'-ja, ku jeta e qytetarëve do të rëndohet edhe më tutje dhe perspektiva për jetë më të mirë në këtë vend do të zbehet edhe më tutje.

Nëse e marrim si pikë referente mënyrën se si kjo Qeveri e kishte shpërndarë buxhetin e vitit 2015 vërehet fare qartë se një pjesë e madhe të parave tona edhe më tutje vazhdon ta marrë asfalti, kurse pjesën më të vogël arsimit, bujqësia, shëndetësia, edhe pse këto segmente kanë zënë shumë vend në programin, të cilin e kemi para nesh.

I nderuar zoti kryeministër,

Kohës së fjalëve të mira dhe e premtimeve boshe duhet t'i vijë fundi, Kosova dhe qytetarët e saj kanë nevojë për veprime konkrete, për projekte të detajuara dhe mirë të planifikuara, për arsim cilësor dhe shëndetësi funksionale, për siguri individuale dhe kolektive, për barazi dhe mirëqenie sociale. Kohën e fundit, sistemi i sigurisë ka rënë shumë. Në qoftë se marrim disa shembuj në komunën e Suharekës, besoni që qytetarët e Kosovës janë duke vendosur roja natën për arsye se ndodh që në një fshat të thyhen 15 shtëpi.

Për fat të keq të qytetarëve të Kosovës, as ky program dhe as ky koalicion qeverisës nuk jep shpresë që ka energji dhe vullnet politik që interesi publik i qytetarëve në këtë vend ta vendosin para interesave të ngushta partiake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po bisedojmë për 100-ditëshin e Qeverisë së Kosovës dhe për programin të cilin nuk e kemi pasur hiç ne si deputetë.

Kjo Qeveri, e dalë nga një marrëveshje muzgu, do të mbahet në mend për këto 100 ditët e para për vrasjen e shpresës së qytetarëve në këtë vend, se do të ketë ndryshime të pritura, se do të ketë perspektivë, se do të ketë zhvillim ekonomik, sundim të ligjit, arsim cilësor, shëndetësi të dinjitetshme dhe punësim.

Vrasja e shpresës së kombit që në shumë sondazhe ishin ndër më optimistët në botë nuk ka guxuar të ndodhë në një vend me demokraci parlamentare të proklamuar në dokumentin bazik të shtetit.

Për shpërnguljen masive, apo për ikjen e qytetarëve nga Republika e lirë e Kosovës, nga shteti sovran e demokratik, pa dyshim që kjo ishte edhe është ana më e dhimbshme, e cila është konfirmuar, jo vetëm gjatë këtyre 100 ditëve, por edhe më herët.

Vazhdimin e kapjes së institucioneve të shtetit nga grupe e klane të subjekteve më të mëdha politike e klienteliste në vend, të cilat gjatë këtyre viteve kanë dominuar në të dy nivelet e qeverisjes në Republikën e Kosovës dhe kanë krijuar kaos në të gjitha sferat e jetës.

Rrënimin i sistemit të drejtësisë në tërë sistemin e Kosovës, në Këshillin Prokurorial të Kosovës, skandale të cilat patën rastin t'i shohin e t'i dëgjojnë qytetarët e Kosovës. Ajo që pamë e tregon nivelin në mjerim të drejtësisë në Kosovë, të Gjyqësorit, të Prokurorisë, Gjykatës Kushtetuese, për të cilat ditëve të fundit e patëm edhe reagimin e Avokatit të Popullit. Ky degradim ka prodhuar edhe kërkesën për një Gjykatë Speciale, e cila në një formë a tjetër e suspendon sistemin e drejtësisë në Kosovë. Sigurisht që kjo e fundit nuk është rezultat vetëm e këtij 100-ditëshi, por ky 100-ditësh veç sa e ka përkeqësuar gjendjen.

Të nderuar qytetar të Republikës së Kosovës,
Moskonsolidimi i Kabinetit qeveritar, pasi kryeministri i Qeverisë ende nuk e di sa zëvendësministra do t'i ketë dhe sa ata do t'i kushtojnë buxhetit të shtetit, pse ai nuk e thotë asnjë fjalë për këtë? Ai apo edhe varësit e tij po tentojnë ta vazhdojnë mashtrimin e madh të filluar gjatë fushatës zgjedhore. Madje, Qeveria as me projektligje nuk e ka furnizuar në masën e duhur Kuvendin e Kosovës.

Mosdërgimi në Kuvendin e Kosovës dhe njoftimet e opinionit për Programin qeverisës as pas 100 ditëve të qeverisjes, duke mos deklaruar me asnjë shifër konkrete për veprat që do të kryhen në shërbim të publikut, por një program i mbushur me terrorizma të thatë në stilin “do të bëjmë këtë” ose “do ta bëjmë atë”.

Prioritetet e programit të ri janë prioritetet e të gjitha qeverive të mëhershme.

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Tani jemi dëshmitarë se sistemi i arsimit në Kosovë është në gjendje të keqe, e këtë e pranoi edhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ministri foli edhe për parregullsitë në regjistrimin e studentëve në Universitetin e Pejës. Ai e di se regjistrimi nuk është problemi, por problemi është cilësia e dijeve të marra në universitetet tona publike. Problemi është te falsifikimi i diplomave. Si u morën ato diploma dhe kryerja e shkollimit pa dije e deformon edhe më tepër nivelin e arsimit në Kosovë.

Ky sistem tanimë është degraduar dhe degradimi ka ardhur nga politika dhe keqqeverisja. Nuk është te mungesa e kuadrove të shkolluara dhe të përgjegjshme me të cilat Kosova po i furnizon edhe shtetet e BE-së, të cilët po të menaxhoheshin mirë do ta kryenin punën e tyre me ndërgjegje, përkushtim e profesionalizëm të lartë.

Këto 100 ditë kanë dëshmuar për paaftësinë e Qeverisë për t'i përmbyllur listat e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat me të drejtë kanë ngjallur reagime të shumta të luftëtarëve të vërtetë, sepse po t'i mohohet një pjesëmarrësi e drejta për të qenë veteran është padrejtësi. Është padrejtësi edhe futja në ato lista edhe një mashtruesi, e të tillë ka shumë në listat e komisionit qeveritar.

Pyetja që duhet të shtrohet: Kush i fuqi aty mashtruesit edhe pse? Kush janë mashtruesit e mëdhenj? Ata janë në Kabinetin qeveritar.

Vazhdimi i keqpërdorimit të parasë publike në luksin e Kabinetit qeveritar të më shumë se 21 ministrave e zëvendësministrave, të cilët ende nuk e di as kryeministri sa janë, po vazhdojnë t'i terrorizojnë edhe më tej qytetarët e Kosovës. Këto gjëra jo vetëm që janë duke e rrënuar qeverisjen dhe politikën para qytetarëve tanë, por janë duke e rrënuar mbi të gjitha autoritetin e kombit tonë para botës demokratike.

Jemi dëshmitarë se ne këtë 100-ditësh nuk patëm asnjë njohje, përkundrazi vetëm patëm gjëra jo të mira në opinionin publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demi nuk është këtu. Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Unë dua të flas vetëm çështjet për të cilat jemi i ngarkuar si komision, për kulturën dhe për arsimin. Janë dy fusha që kanë pasur defekte bukur shumë të mëdha, po ashtu edhe ngarkesa politike, por edhe partiake, për të cilat mendoj që në komision janë shqyrtuar dhe janë debatuar shumë defekte, të cilat janë bërë publike brenda këtij 100-ditëshi të Qeverisë.

Aspektet të cilat janë theksuar apo theksohen janë të natyrave të ndryshme dhe kemi kërkuar nga ministri i Arsimit të na përgjigjet në shumë pyetje, kemi kërkuar po ashtu edhe nga Agjencia e Akreditimit, edhe vizitat nëpër fakultete dhe universitete, apo kolegje private, kanë dëshmuar që arsimi në nivel të Kosovës është në nivel shumë të keq.

Në projektet që i ka Qeveria me ligjet që i ka prezantuar dhe i prezanton, që do të vijnë në Kuvend të Kosovës, sidomos Ligji i maturës, Ligji për arsimin e lartë, ne shohim që ka mundësi të përmirësohen nëse ka një vullnet politik. Por, ky vullnet politikë, sa shihet nëpër ato forma, mungon, e mungojnë edhe sanksionet për të cilat duhet të merren.

Ne e kemi edhe një inspektorat, i cili ka qenë pasiv, e i njëjti është prapë pasiv - Inspektorati i Arsimit, dhe kur e kemi parash inspektoratin i cili duhet t'i ketë detyrat e veta, ai nuk i ka krye dhe nuk i kryen.

E kemi po ashtu mungesën, meqë ne kërkojmë vazhdimisht përmirësimin e kushteve të nxënësve nëpër shkolla, kërkojmë vazhdimisht të kemi pedagogë dhe psikologë, sepse janë rritur rastet e dhunës, rastet e keqpërdorimeve, rastet e rrahjeve, apo bartja e armëve të ftohta nëpër shkolla të mesme, të cilat janë një rrezik i vazhdueshëm për nxënësit.

Për ta arritur mbrojtjen e tyre në ligjet, sidomos në ligjet e arsimit, duhet të jetë pjesë edhe kjo mbrojtje, e duhet të hyjnë nëpër shkolla edhe pedagogët dhe psikologët, ndërsa Inspektorati duhet të jetë pjesë më e angazhuar, që të jetë kontroll dhe kontrollues i drejtpërdrejtë pikërisht për ngritjen e cilësisë në arsim.

Ministri ka deklaruar që do ta ketë prioritet cilësinë e arsimit, ndërsa e shohim që me një Ligj të maturës që na ka afruar dhe ai ligji na ofron një mundësi po ashtu jo të cilësisë, por një formë të arritshmërisë. Jo forma e arritshmërisë mendoj që është një anë pozitive, por e ka negativitetin e vet, sepse të gjithë i krijojmë si pozitive me diploma, ndërsa anën tjetër negative është sepse secilit i jep mundësinë të jetë pjesë e universitetit, edhe atyre që e kanë rezultatin zero.

Ne kemi pasur defekte në arsim nëpër universitete apo kolegjet tjera, të cilat ministri është munduar t'i prezantojë, por këto defekte, edhe të diplomave, të cilat kanë qenë false, për 100 ditë janë dalë diku rreth 505 diploma false të studentëve që kanë kryer universitete, apo fakultete.

Mendoj që kjo është një fushë që na duhet ta përmirësojmë, ta kemi një vullnet politik dhe një masë e cila duhet të jetë e arritshme.

Te Ministria e Kulturës, ministri ka prezantuar dhe prezanton vazhdimisht, ne shpresojmë që me ligjet edhe me angazhimin edhe aty ta përmirësojmë pjesën e sportit, sepse e kemi pjesën e fushave të pamobiluara, të cilën do të jemi pjesë e federatave të futbollit e të tjera.

Prandaj, kërkojmë që ministrat të jenë më efektivë dhe më të angazhuar pikërisht për arritjen e qëllimeve, ose të prioritetëve që i kanë përcaktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati, nuk është. Atëherë Blerim Grainca e ka fjalën.

BLERIM GRAINCA: Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Është një rregull parlamentar që qeveritë ta sjellin në Parlament programin qeveritar dhe kështu të kemi mundësi ta analizojmë edhe vizionin, edhe strategjinë, por edhe të arriturat për 100-ditëshin.

Nga leximi i programit shohim se kemi të bëjmë me një program, i cili është objektiv dhe i bazuar në mundësitë reale që ka vendi ynë dhe në kapacitetet, qofshin ato njerëzore, apo mundësinë financiare në dispozicion.

Nëse i qasemi me kujdes leximit, shohim se ky program si qëllim parësor dhe synim primar e ka zhvillimin ekonomik si një parakusht i cili mundëson edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë.

Zhvillimi ekonomik, i bazuar në iniciativën private dhe krijimi i mundësive për investime të reja, është qëllim primar i këtij programi.

Në rast se do ta bënim një analizë, apo nëse do ta krahasonim programin dhe të arriturat e 100-ditëshit, shohim se është bërë progres dhe hapa të rëndësishëm sidomos në fushat që lidhen me kontrollin qeveritar, me uljen e shpenzimeve, me rritjen e kulturës qeverisëse, me menaxhimin e resurseve financiare dhe me paranë publike.

Po ashtu, janë bërë hapa edhe në drejtim të luftimit ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal.

Është me rëndësi të themi se gjatë këtij 100-ditëshi janë bërë ndryshime edhe në politikat fiskale dhe ekonomike, siç janë heqja e barrierave të caktuara për bizneset, shkallëzimi i TVSH-së, heqja e ngarkesave fiskale për makinerinë që shkon për prodhim dhe të gjitha bashkë këto aktivitete kanë ndikim direkt në përmirësimin e kushteve dhe standardit të jetesës për qytetarët dhe në rritjen e mundësive për investime të reja direkte.

Problemi i energjisë dhe stabilizimi i furnizimit të tregut duket se zë vend me rëndësi në Programin qeveritar, e të gjithë e dimë se energjia mbetet, jo vetëm problem për qytetarët, por problem edhe për ata që dëshirojnë të investojnë në Kosovë dhe t'i rritin kapacitetet prodhuese.

Bujqësia dhe agrobiznesi duket se janë sektor, për të cilin ky program ka paraparë një varg masash jo vetëm në rritjen e granteve dhe subvencioneve, por edhe në menaxhimin profesional që do të rezultonte me rritjen e kapaciteteve prodhuese vendore dhe kështu të kemi ulje të shkallës së importit dhe përmirësim të bilancit negativ tregtar, që është deri më tani.

Qasja serioze ndaj investimeve kapitale dhe trajtimi që u jepet projekteve strategjike, bashkë me rritjen e shkallës së investimeve direkte, ndikojnë në rritjen e kërkesës vendore, e me këtë edhe në rritjen e nevojës për prodhime vendore.

Në ditët në vazhdim, ashtu sikur edhe më tani, e inkurajojmë Qeverinë të vazhdojë me hapa të guximshëm dhe me reformat, sidomos në fushat që lidhen me sundimin e ligjit, luftimin e monopoleve të caktuara në biznes, në rritjen e performansës së agjencive dhe kompanive publike, me theks të veçantë Administratës Tatimore, Doganës, KEK-ut, PTK-së, si dhe luftimin e dukurive negative dhe dyshimeve që ekzistojnë për performansën e këtyre kompanive dhe agjencive publike.

Të nderuar kolegë,

Të presës që problemet e grumbulluara me decenie dhe vite të zgjidhen brenda 100-ditëshit, mendoj se është një dëshirë jo mirë e analizuar. Andaj, mbetemi me shpresë se bashkërisht, Qeveria bashkë me Kuvendin, do të punojnë për zgjedhjen e këtyre problemeve duke sjellë ndryshime pozitive edhe substanciale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Demaku.

PUHIE DEMAKU; Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Që nga vitit 2008, kur është themeluar Ministria e Punëve të Jashtme, së cilës në atë kohë, vetëm falë disa ekspertëve ndërkombëtarë, i ishin mveshur disa objektiva e qëllime, që nuk u përditësuan më kurrë, kjo ministri nuk ka qenë kurrë në gjendje më të rëndë. Për pasojë, njëjtë, në gjendje shumë të rëndë është edhe vetë politika e jashtme e Kosovës.

100-ditëshi i kësaj ministrie nuk u shënua me asnjë të arritur, apo sukses. Ngjarjet që e karakterizuan mospunën e Ministrisë së Jashtme ishin disa vizita kot të ministrit të Punëve të Jashtme, disa takime ditore që nuk janë as ngjarje mediatike, një konferencë për t'ia mundësuar Daçiqit vizitën e radhës në Kosovë me shpenzimet e Qeverisë së Kosovës. Pra, shkurt e shqip,

përveç shpenzimeve të parave, nuk u bë edhe shpenzimi i nevojshëm i energjisë përkitazi me seriozitetin që e kërkon fusha e politikës së jashtme.

Ministri i Punëve të Jashtme, me gjithë ftesat e përsëritura nga Komisioni për Punë të Jashtme, ka refuzuar të paraqitet para këtij komisioni, duke mos dhënë qasje as në raporte, e as në informata, të cilat i kanë kërkuar deputetë dhe anëtarët e komisionit. Injorimi dhe neglizhimi që i bën ministri komisionit flet për mënyrën se si ai e sheh punën e komisionit parlamentar, duke e rikonfirmuar atë që e kishte etabluar sa ishte kryeministër dikur, pra republikën qeveritare, e jo republikën parlamentare.

Në fakt, kur ishte kryeministër mbase edhe mund të arsyetohej se kishte shumë angazhime, por tash si ministër i Isa Mustafës ai do të duhej ta kishte kohën e duhur që ta kalonte edhe në raportim para komisionit.

Kanë kaluar 100 ditë që ky Parlament ende nuk ka marrë përgjigje në pyetjen se sa njohje i ka Kosova. Mbeti po aq e patrajtuar çështja e migrimit të qytetarëve të Kosovës, që në disa raste përfundoi edhe me tragjedi. As edhe një lëvizje e vetme nuk u bë në drejtim të njohjeve të reja. Ngecëm po aq të izoluar, në mos edhe më keq.

E për fatin tonë të keq, ky 100-ditësh nuk duket se ka përmirësim. Bazuar në Programin qeveritar të shpërndarë në këtë Kuvend, politika e jashtme do të vazhdojë të mbetet e cunguar, e munguar dhe e rrënuar. Programi qeveritar e dëshmon një vazhdimësi të një politike të jashtme pa vizion, pa ambicie, pa qëllime, pa strategji dhe me shumë shpenzime.

Më lejoni të zbërthej para juve disa pika nga kombinimi i fjalëve dhe fjalive, në një tekst, që pa të drejtë është quajtur program qeveritar. Pikë së pari, nga ky dokument bëhet e qartë se kjo qeveri e ka një problem shumë të madh me fjalën ‘prioritet’. Gjithçka për ta është prioritet. Prioritet janë njohjet, prioritet NATO-ja, prioritet BE-ja, prioritet marrëdhëniet bilaterale, prioritet rajoni, pra gjithçka në politikën e jashtme është prioritet dhe s’i duket nuk kanë qenë aq ekspeditiv sa të gjen edhe pak parashtresa, si super-prioritet apo nën-prioritet.

Megjithatë, ndonëse njohjet janë një prioritet, Qeveria ka qenë modeste duke thënë se brenda këtij mandati synon që ta arrijë njohjen e 2/3 të shteteve anëtare të OKB-së. 2/3 e vendeve anëtare të OKB janë saktësisht 128 shtete, e nëse Kosova vërtet i ka 108 njohje, siç pretendohet, atëherë kjo qeveri i ka vënë vetes synim që për 4 vjet të sjellë 20 njohje, apo 5 njohje për secilin vit të mandatit. Kjo i bie që, ose nuk e dinë matematikën, ose e dinë fare mirë se sa kanë kapacitet, bile e kanë mbiçmuar veten!

Në raport me 5 vendet mosnjohëse të BE-së në Programin e qeverisë thuhet se kjo qeveria do të vazhdojë me diplomacinë e vjetër proaktive dhe dinamike të Kosovës. Dhe, të gjithë e dimë se kur bëhen përpjekjet e njëjta, edhe rezultati është i njëjtë. Pra, në këtë rast rezultati mungon në tërësi.

OKB-ja konsiderohet objektiv suprem në politikën multilaterale, ndërkohë që në tërësi anashkalohet fakti se aplikimi për anëtarësim duhet të kalojë nëpër Këshillin e Sigurimit dhe nuk përmendet aspak sfida e vetos nga Rusia dhe Kina.

Prioritet është edhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës, por ky prioritet daton që nga viti 2013, e aplikimi nuk ndodhi kurrë.

Ky dokument flet edhe për partneritete strategjike, duke përmendur këtu SHBA-në, Britaninë, Gjermaninë, Italinë, Francën dhe vendet e tjera evropiane, por në asnjë moment nuk shpjegohet se për cilat fusha dhe si do të avancohet partneriteti.

Dhe, pas partneriteteve strategjike flitet për rëndësinë e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit, natyrisht duke u thirrur gjithnjë në ndihmën e Bashkimit Evropian, se ndryshe nuk dinë. Papritmas te rajoni shfaqet Shqipëria si partneritet strategjik. Por, edhe partneriteti strategjik me Shqipërinë shikohet vetëm për nga aspekti i përsheptimit të integritetit të Kosovës në BE dhe NATO. Asnjëherë nuk përmendet bashkëpunimi me shqiptarët të cilët jetojnë në vendet e rajonit.

Politika e jashtme e Kosovës do të duhej të përpilohej duke marrë parasysh pikërisht interesat dhe nevojat e shqiptarëve jashtë kufijve të Kosovës dhe Shqipërisë. Pra, kjo pjesë e këtij programi është konkretisht ndesh me atë që është arritur në mbledhjet e dy qeverive.

Një pjesë e konsiderueshme i dedikohet dialogut me Serbinë, madje caktohen edhe temat që do të diskutohen në dialogun me Serbinë në Bruksel, por as këtu nuk ka afate kohore e as strategji, e cila paraprakisht i dorëzohet Kuvendit. Temat që janë caktuar nga kjo qeveri për të qenë tema diskutimi në Bruksel nënkuptojnë kërkim-faljen e Serbisë dhe derivojnë nga kjo kërkim-falje, ndërkohë që realiteti, e dini shumë mirë, është ndryshe. Temat e dialogut në Bruksel deri tash i ka caktuar Serbia, e jo Kosova.

Ky dokument na flet për diplomacinë ekonomike si shtyllë e rëndësishme e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Sa qesharake duket kjo, kur e kemi parasysh se ministrinë e udhëheq njeriu që e rrënoi ekonominë dhe e rrënjosi korrupsionin!

Flitet për shërbimin e jashtëm, përderisa e dimë mirë se është i degraduar ky shërbim dhe se ky shërbim ka qenë shërbim i punësimit të militantëve dhe, përveç disa përjashtimeve individuale, nuk ka qenë kurrë në shërbim të objektivave të Kosovës, përkundrazi në mandatin e kaluar ky shërbim u karakterizua nga një mori skandalesh, e protagonistët e tyre vetëm u transferuan brenda shërbimit, e nuk u ndëshkuan kurrë.

Pra, programi i gabuar në duart e njeriut të gabuar nuk ka asses të jetë storie suksesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Edhe pse unë e pata qëllim të ndalem më shumë te komisioni, të cilin e kryesoj, ai për Siguri dhe Punë të Brendshme e Mbrojtja, por ministrat nuk janë këtu, pak është e paarsyeshme të diskutojmë shumë.

Por, fillimisht, më lejoni të jua them veç një fakt, ministri i Mbrojtjes ose i FSK-së, dje veç sa nuk na tha që edhe te tezet ku kanë shkuar pjesëtarët e FSK-së, por asnjëherë nuk tregoi se ku është procesi i Projektligjit për ndryshim-plotësimin e ligjeve për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Ndërsa kryeministri, po ashtu, katër ditë më herët deklaroi se FSK ose FAK nuk do të kalojë në veriun e Kosovës pa lejen e NATO-s. E unë po ia lexoj vetëm dy nene - Misioni dhe detyrat e Forcave të Armatosura të Kosovës: “Forcat e Armatosura të Kosovës janë forcë kombëtare ushtarake të Republikës së Kosovës dhe mund t’i dërgojnë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj”. Pyetja tash është se deri ku është sovraniteti i Kosovës, sipas kryeministrit? A është deri te Ura e Ibrit, apo deri në pikën 1 dhe 31.

Në pikën 2 të nenit 10 shkruan: “Forcat e Armatosura të Kosovës e mbrojnë sovranitetin, integritetin territorial të qytetarëve, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë”. Pra, edhe një herë e njëjta pyetje mund të jetë për kryeministrin. A je ti për t’i implementuar ligjet në Kosovë, apo duhet marrë leje diku tjetër? Natyrisht se Forcat e Armatosura të Kosovës janë të qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, por si detyrë primare e kanë ruajtjen dhe garantimin e sovranitetit të Kosovës, që nënkuptojnë Kosova një dhe të pandarë.

Për Policinë e Kosovës është e vërtetë që pjesëtarët e saj kanë kryer detyra të shumta dhe duhet përgëzuar, por është edhe fakt i vërtetë që disa ditë më herët një oficer i Policisë së Kosovës është vrarë në qendër të qytetit, në pikë të ditës, dhe Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk e ka dhënë një shpjegim të saktë se çfarë ka ndodhur, pse është vrarë ky pjesëtar. Për rastet e shumta kriminale që po ndodhin në Kosovë, sigurisht që Ministria e Punëve të Brendshme do t’u japë përgjigje qytetarëve të Kosovës, por e vërteta është që Qeveria gjermane u detyrua të krijojë njësi të veçanta për ta ruajtur kufirin Kosovë-Serbi për shkak të migrimit ilegal.

Kosova ka kapacitet ta ruajë kufirin me pjesëtarë të saj, pasi jemi të sigurt që policët tanë janë skajshëm të përgatitur profesionalisht për ta garantuar kontrollin kufitar.

E kemi po ashtu një gjendje jo të lehtë të zjarrefikësve të Kosovës, të cilët i janë drejtua edhe Kuvendit të Kosovës, kryetarit, kryeministrit, ministrit të Punëve të Brendshme dhe komisionit, që alarmojnë për gjendjen e tyre jo të lehtë, aq më tepër kur në 11 komuna koeficienti i këtyre pjesëtarëve është 3,5, ose thanë më thjesht është më pak sesa një pastrues.

Uniformat e tyre prej vitit 2004 nuk janë ndërruar, gjendja e tyre është e mjerueshme, komunat nuk ndajnë buxhet për këto njësi dhe ne si qytetarë të Kosovës e dimë fare mirë, sidomos në sezonin e verës, sidomos në rajonin perëndimorë të Kosovës, kur digjen pyjet këta njerëz nuk janë të gatshëm ta kryejnë detyrën. Prandaj, është gjendje e rëndë dhe natyrisht kërkoj edhe nga institucionet përgjegjëse që urgjentisht t’i marrin masat për ta.

Për të mos hyrë tek obligimet që i kanë premtuar edhe gjatë fushatës elektorale të dy partitë në Qeveri, siç është implementimi i Kontratës Kolektive, marrëveshjet me sindikata të shumta për rritjen e pagave, të gjitha këto shpresoj që Qeveria do t’i ketë parasysh dhe do t’i përmbushë obligimet e veta karshi qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Haradinaj! Fjalën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të vendit,

Sot po debatojmë me 100-ditëshin e Qeverisë dhe për Programin të cilin e ka prezantuar kryeministri dhe Kabineti qeveritar në Parlament.

Unë fillimisht do të ndalem te 100-ditëshi, të cilin e ka manifestuar kjo qeveri në këtë 100-ditësh të qeverisjes.

Në prezantimin e qeveritarëve pamë edhe disa ankesa lidhur me fillimin e punës së Qeverisë, duke u ankuar e vajtuar për protestat, për grevat, për demonstratat dhe për shumë dukuri tjera, të cilave ata iu referuan si pengesa gjatë këtij 100-ditëshi.

Por, duhet të konstatojmë saktë se këto protesta, këto greva, këto situata të rënda për vendin, natyrisht edhe për Qeverinë, e kanë një burim, dhe burimi është në Kabinetin qeveritar. Askund tjetër. Burimi është te pavendosmëria politike e kësaj Qeverie për të marrë vendime të duhura në kohën e duhur.

Nuk mund ndryshe të shihet protesta kundër Jablanoviqit, protesta për “Trepçën”. Nuk mund të shihet ndryshe edhe situata për migracionin. Si rezultat i kësaj pavendosmërie dhe i këtyre politikave ka ndodhur të gjitha këto ngjarje në vendin tonë. Prandaj, Qeveria duhet të marrë qëndrim për t’i zgjidhur, për t’u dhënë kahje, për t’u dhënë drejtim, e jo për t’u ankuar dhe vajtuar dhe për ta parë opozitën dhe ata të cilët guxojnë ta ngrenë zërin që të shihen si fajtorë të vetëm.

Po ashtu, për këto 100 ditë ne nuk pamë asnjë fakt se si Qeveria e ka konstatuar gjendjen gjatë këtyre 100 ditëve. Cila është gjendja nëpër sektorë të caktuar, nëpër ministri, nëpër ndërmarrje publike, nëpër agjenci të pavarura, çka po ndodh në sistemin e prokurimit, çka po ndodh me raportet të cilat i sjell Auditori për shumë organizata buxhetore? Prandaj, të gjitha këto janë dukuri dhe fakte për të cilat Qeveria nuk e ka as gatishmërinë, e as vullnetin politik, dhe është shumë e thjeshtë që të mos e ketë.

Ne, të nderuar qytetarë, e pamë edhe dje se nuk kemi partner në koalicion. Nuk kemi partner në Qeveri, por kemi palë në Qeveri, dhe këto si palë që janë, si të tilla nuk kanë besueshmëri ndërmjet vete. Prandaj, e meta më e madhe e kësaj Qeverie është mu në Kabinetin qeveritar dhe në mosbesimin e kësaj Qeverie ndërmjet palëve të cilat janë në Qeveri.

Prandaj, me një mosbesim të tillë, me një mosbashkëpunim të tillë, nuk mund t’u besoj as qytetari, e as ne si opozitë, prandaj kërkojmë që kjo të reflektojë dhe t’i marrë obligimet dhe të ecë përpara, nëse ka mundësi të ecën.

Në Programin qeverisës do të isha ndalur vetëm në dy sfera - te sistemi i drejtësisë, të cilin e ka parashikua dhe vendosja e shtetit ligjor. Nëse e shikojmë me vëmendje vetëm atë çka po ndodh

në Këshillin Prokurorial të Kosovës, ne nuk mund të flasim fare për shtet ligjor dhe për sistem të drejtësisë, i cili do të mund të avancohet.

Nuk mund të avancohet sistemi i drejtësisë me një ministër i cili është tani e tetë vjet në krye të këtij dikasteri, e nuk i ka marrë reformat dhe nevojat që është dashur t'i marrë konform ligjshmërisë dhe Kushtetutës së vendit.

Po ashtu, sektori publik i sigurisë vazhdimisht po cenohet si pasojë e disa rezultateve të ekonomisë joformale.

Kryeministri foli për angazhim në bizneset e mesme dhe të vogla. Me këtë monopol, me këtë konkurrencë, me këto aktivitete të cilat ekzistojnë në vend, nuk mund të zhvillohen këta dy sektorë. Prandaj, është si konkludim i përgjithshëm se më i fortë është sistemi i korrupsionit, sesa sistemi i drejtësisë.

Unë do ta përfundoja këtë, duke e marrë si shumë seriozisht gjendjen, e me këtë Qeveri, me këtë klimë politike, me këtë mosbesim ndërmjet palëve në Qeveri nuk mund të presim asnjë zhvillim dhe asnjë ndryshim të mëtutjeshëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të vendit në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po e diskutojmë me kërkesën e një grupit të iniciuar nga opozita 100-ditëshin e Qeverisë dhe njëkohësisht Programin qeveritar, të cilin e ka prezantuar dje kryeministri i Kosovës bashkë me ministrat dhe, për mendimin tim, edhe dje ka pasur diskutues të shumtë, pse ndoshta të njëjtën ditë të diskutohet edhe Programi qeveritar edhe 100-ditëshi, gjë që ndoshta do të kishte qenë mirë që Qeveria e Kosovës, përkatësisht kryeministri i Kosovës me Kabinetin e tij ta prezantojë 100-ditëshin, i cili ka shumë të arritura, dhe pastaj do të kishte qenë mirë që edhe Programi qeveritar, i cili është një program voluminoz, i përgatitur dhe i hartuar nga shumë ekspertë të prezantohet një ditë tjetër. Por, kështu ka qenë kërkesa e opozitës dhe kjo ka qenë përgjigjja, të cilën e ka dhënë Qeveria, që e ka prezantuar dje kryeministri i Kosovës.

Unë konsideroj se në kuadër të këtij 100-ditëshi ka shumë të arritura dhe shumë rezultate, të cilat janë prezantuar edhe nga kryeministri, por njëkohësisht janë prezantuar edhe nga dikasterët e ndryshëm, përkatësisht nga ministrat e ndryshëm të Qeverisë së Kosovës.

Unë e di që kryeministri i Kosovës dje është treguar shumë modest, por krahasuar nga 100-ditëshit e të gjitha qeverive tjera të cilat kanë prezantuar deri më tani, le të kuptohet se nga shumë barrierat dhe nga shumë pengesa që ka pasur kjo Qeveri gjatë këtij 100-ditëshi, nga protesta të shumta të mbështetura edhe nga disa grupe opozitare, e ka bërë një punë të madhe dhe jo vetëm që e ka prezantuar në raportin e saj retorik, por njëkohësisht ka prezantuar argumente të fuqishme, të cilat kanë nxjerrë vendime të rëndësishme dhe të fuqishme, sidomos në fushën e ekonomisë dhe po ashtu në dikasteret dhe fushat tjera.

Programi i mbështetur nga pesë shtylla kryesore, që është zhvillimi ekonomik, punësimi dhe mirëqenia, pastaj sundimi i ligjit dhe shteti ligjor, agjenda evropiane dhe politika e jashtme, arsimi, shkenca, kultura dhe shëndetësia moderne, në kuadër të katërvjeçarit të cilin do ta udhëheqë kryeministri Mustafa, do të jetë njëri prej programeve që do të dëshmojë, e njëkohësisht do të ndryshojë dhe do të garantojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Unë do të konsideroj që atë që e ka bërë në 100-ditëshin në hapat e parë Qeveria e Kosovës, kryeministri Mustafa, vlen të theksohen masat e kursimit nga Qeveria dhe në kursimet të cilat po bëjnë ministrinë dhe ministrat përkatës, në këtë rast. Pra, janë shkurtuar në një masë jashtëzakonisht të madhe blerja e veturave, pastaj shpenzimet e luksit, të cilat deri më tani, në krahasim me qeveritë tjera, kanë qenë shumë alarmante dhe njëkohësisht janë bërë thirrje të shumta edhe nga partitë politike që shpenzimet e luksit të reduktohen. Në këtë 100-ditësh ka ndodhur që Qeveria e Kosovës i ka reduktuar shpenzimet e luksit në një masë jashtëzakonisht të madhe.

Prandaj, ne e inkurajojmë edhe kryeministrin, edhe Kabinetin qeveritar që të vazhdohet akoma më tutje me ndryshimin që po ndodh në të gjitha dikasterët, me përmirësimin e gjendjes dhe reformat ekonomike që i ka ndërmarrë edhe kryeministri, edhe Qeveria e Kosovës, që të vazhdohet akoma më tutje dhe më shumë i bindur që edhe grupet parlamentare që janë në Parlamentin e Kosovës, por edhe qytetarët e Kosovës, brenda një viti do ta shohin këtë ndryshim dhe brenda katër vjetëve Qeveria e Kosovës do të jetë njëra prej qeverive më të mira deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti kryesues, ne dje e shtymë mbledhjen për një orë që ta kemi Qeverinë këtu. Por, prapë s'e kemi këtu. Si duket, qeveritarët, përveç punës së Qeverisë, i kanë edhe nga pesë-gjashtë angazhime tjera. Prandaj, herët tjera është mirë fare të mos i presim, ose t'i obligojmë të vijnë këtu, se vërtet nuk ka kuptim. Po e shoh, Ademi që po reagon, por nuk e ka mirë.

Qytetarë të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Gjendja në arsim dhe kulturë para 100 ditësh ka qenë e rënd. Gjatë këtyre 100 ditëve, në këta dy sektorë kanë ndodhur ndryshime që gjatë do të mbahen në mend. Bazuar në informatat e Ministrisë së Arsimit, rreth 5 300 nxënës i kanë lëshuar shkollat, e kjo i bie që tani, pas 100 ditësh, realisht t'i kemi 10 shkolla më pak.

Në kulturë, gjatë këtij 100-ditëshi po ndodh një dramë, por jo në skenë. Për shkak të gjendjes së papërballueshme, aktorët e teatrove të disa qyteteve janë detyruar ta zgjedhin rrugën. Pra, ata janë në grevë. Kurse zhgënjimi i rinisë, i shtresuar me vite, për shkak të mungesës së perspektivës, po i afrohet pikës së vlimit.

Sa i përket Programit të Qeverisë, karakteristikë e këtij programi t që ka ardhur në Kuvend tani kur ka kaluar 1/5 e këtij mandati janë frazat, si: "Qeveria synon...", "Qeveria do të

angazhohet...”, “Qeveria zotohet...”, “Qeveria ju siguron dhe garanton...”, e kështu me radhë, pa i përcaktuar afatet kohore, bartësit konkret dhe mënyrën se si do t’i bëjë synimet e saj realitet, dhe pa ndarë fonde për pjesën më të madhe të synimeve, angazhimeve dhe garancive të saj.

Në programin për arsim, përveç tjerash, në këtë dokument thuhet se, “Qeveria do të angazhohet për ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës”. Kjo ta krijon përshtypjen se Qeveria ka harruar se sistemi i arsimit në Kosovë është gjithëpërfshirës. Pran, ne nuk kemi sistem seleksionues. Pastaj thuhet: “Qeveria angazhohet ta trajtojë arsimin si një prioritet themelor...”. Shtrohet pyetja, nëse nuk ka qenë arsimit prioritet, së paku në programet e qeveritarëve.

Kur flitet për reformat në arsim, nuk përmendet fare shkolla fillore (nga klasa e parë deri në klasën e pestë), kurse shkolla e mesme e ulët (nga kasa VI - IX) përmendet vetëm me këtë fjali: “...Arsimi i mesëm i ulët do të jetë bazë për orientim në arsimin e mëtejshëm të nxënësve”. Kjo që thuhet në kuadër të reformave, nuk ka të bëjë fare me reforma, ky është vetëm një konstatim. Sipas kësaj që po e shohim del se në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët nuk do të ketë reformë, edhe pse janë konstatuar shumë defekte në këtë nivel të arsimit.

Njëri ndër planet konkrete të Qeverisë është ndërtimi i Universitetit të Shkencave Bujqësore në Rahovec, pa e dhënë asnjë arsytim për këtë zhvendosje. Rritja e përqindjes së përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe hapja e paraleleve parafillore është synim që duhet të përshëndetet, sidomos atëherë kur të na thuhet për sa do të rritet kjo përfshirje, pasi aktualisht në këtë aspekt jemi më keq se Zimbabveja.

Qeveria e përmend ndarjen e fondeve për stimulim përherë të parë në këtë dokument kur bën fjalë për nivelin universitar, për studentët që studiojnë degë të rëndësishme për zhvillimin e vendit, siç janë shkencat ekzakte, inxhinieria, mjekësia etj. Në të njëjtën kohë, pjesa më e madhe e mjekëve të diplomuar ikin në Gjermani, pasi këtu nuk gjejnë punë. As profilet tjera nuk mund të gjejnë punë lehtë. E të papunët vështirë se mund të kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

Kjo Qeveri, që synon t’i stimulojë doktoratat, shpesh nuk i kryen obligimet e saj ligjore ndaj filloristëve. Shpesh Qeveria nuk i paguan shpenzimet për udhëtimin e nxënësve të shkollës fillore, që jetojnë mbi 4 kilometra larg shkollës.

Qeveria po na garanton se do ta rrisë cilësinë në arsim duke e përshpejtuar procesin e licencimit të arsimtarëve, furnizimin e shkollave me internet, e kështu me radhë. Por, përshpejtimi dhe cilësia janë larg njëra-tjetrës. Në këtë kontest, nuk përmenden laboratorët, puna praktike, mbikëqyrja e punës, e kështu me radhë, që ndikojnë në ngritjen e cilësisë.

Për sigurimin e rezultateve reale, Qeveria planifikon vlerësim të jashtëm. Qeveria e di se vlerësimi i jashtëm ka ndodhur edhe në të kaluarën, por nuk ka siguruar vlerësim real. Qeveria synon t’i shndërrojë universitetet në gjenerator të zhvillimit ekonomik, por nuk na tregon si do ta arrijë këtë qëllim.

Ajo që nuk u përmend në Programin qeverisës është mësimi në gjuhën serbe, me plan-programe të Serbisë, që financohet nga Buxheti i Kosovës, por për Kosovën mësohet nga këndvështrimi i

politikës hegjemoniste të Serbisë. Sipas këtij dokumenti, Qeveria as nuk synon, as nuk angazhohet që ta ndryshojë këtë gjendje të pa pranueshme për çdo qeveri normale.

Dukuritë e shumta negative në fushën e arsimit, si falsifikimi i diplomave, analfabetizmi funksional, mungesa e sigurisë në shkolla, bastoret e kafeteritë afër shkollave, përdorimi i alkoolit, i drogës e dukuri të tjera negative brenda shkollave, si duket nuk po i bëjnë përshtypje Qeverisë.

Qeveria në programin e saj nuk i ka përmendur fare institucionet private të arsimit, sikur ato të vepronin në një kontinent tjetër, edhe pse në këtë segment ka probleme të shumta që kërkojnë zgjidhje të shpejtë, siç është cilësimi i falsifikuar si universitete të kolegjeve private, cilësia e ulët, regjistrimi i studentëve me vonesë etj. Pjesa më e madhe e këtyre problemeve janë të shkaktuara kryesisht me fajin e qeveritarëve, e ku shumë prej tyre edhe vetë po përfitojnë mirë nga këto institucione, në të cilat janë të angazhuar, prandaj edhe po heshtet.

Duke e pasur parasysh angazhimin e gjysmës së Qeverisë në procesin mësimor në shumë institucione arsimore, mosmbajtja e mësimi me rregull nuk kemi pritur të trajtohet në këtë dokument qeveritar.

Qeveria në këtë dokument nuk është marrë fare me problemet e personave me nevoja të veçanta, kurse bashkatdhetarët tanë në Diasporë që kanë nevojë për organizimin e mësimi të gjuhës amtare, të historisë, të gjeografisë dhe të kulturës kombëtare i përmend shkarazi pa ofruar zgjidhje konkrete.

Programi për kulturë fillon me premtimin se Qeveria do të vazhdojë ta rrisë buxhetin për institucionet publike të kulturës. Nëse vazhdohet si gjer më tani, për ata që e kanë përcjellë gjendjen në kulturë, mesazhi është i qartë. Pra, nuk do të ketë përmirësime në këtë fushë të rëndësishme të jetës. Për shkak të mungesës së investimeve, jeta kulturore është shumë e varfër, e artistët janë në gjendje të mjerë. Aktualisht, aktorët e teatrove të disa qyteteve janë në grevë, shumë qyteteve u mungojnë galeritë e artit, shumica e sallave të kinemave tanimë janë privatizuar, ansamblet amatore e zhvillojnë aktivitetet e tyre kryekëput në baza vullnetare, trashëgimia kulturore ka mbetur në duart e fatit. Botimi i veprave letrare kryesisht bëhet me donacione.

Kalendari i përbashkët kulturor me Republikën e Shqipërisë është iniciativë e mirë, që, nëse zbatohet, duhet të përshëndetet.

Është mirë që për të rinjtë që po planifikohet ndërtimi i shtëpive të rinisë nëpër komuna, por kjo nuk mjafton. Të rinjtë kanë nevojë për ndërtimin e perspektivës në këtë vend, për çka i Qeveria duhet të angazhohet shumë seriozisht.

Ky Program i Qeverisë, që është sjellë në Kuvend për të na njoftuar me të, e jo për të debatuar në lidhje me të, është dëshmi e fortë se kjo Qeveri nuk ka program. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Programi i Qeverisë së Kosovës në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor synon që të shënojë një ndryshim strategjik përkitazi me këtë çështje jetike për qytetarët e vendit.

Fakti se mjedisi dhe planifikimi hapësinor u përmend shumë pak, në mos fare edhe gjatë debatit të deritanishëm nuk është shumë inkurajues, sepse pa një vetëdijesim optimal të qytetarëve e të institucioneve të vendit për rëndësinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, çështjeve të ndërtimit për kualitetin e jetës së qytetarëve do të ketë vështirësi të mëdha edhe në mobilizimin e resurseve të nevojshme financiare në vend dhe jashtë tij nga komuniteti i donatorëve.

Ajo që Qeveria do të bëjë në periudhën më të afërt kohore dhe ku ministria do të jetë bartëse e aktiviteteve është që qysh me rishikim sivjet të rritet buxheti në kategorinë ekonomike të subvencioneve për projekte mjedisore nga burimet financiare, të cilat gjenerohen nga grumbullimi i taksës ekologjike, një gjë që deri më tani nuk ka ndodhur në periudhën e kaluar. Këto mjete do të shfrytëzohen qysh sivjet për themelimin, ndërtimin dhe stabilizimin e sistemeve të mbikëqyrjes së cilësisë së ajrit, ujit dhe të tokës, si dhe biodiversitetit, rregullimit emergjent të shtretërve të disa lumenjve, të cilët sivjet kanë shkaktuar vërshime, sikur dhe në vitet e kaluara, e po ashtu edhe në mobilizimin e resurseve të rëndësishme në komunitet, në shoqërinë civile, sepse e kemi një organizim jashtëzakonisht të mirë të shoqërisë civile në fushën e mjedisit. Të interesuar për të qenë partner në zbatimin e projekteve të ndryshëm mjedisore, por në mungesë të mjeteve financiare, deri më tani kjo ka qenë e pamundur.

Në vazhdim, Programi qeveritar në fushën e mjedisit e inkorporon si koncept themelor në kornizën e tij të veprimit edhe çështjen e ndryshimeve klimatike, një çështje globale, e cila po bëhet çdo herë e më tepër e rëndësishme, si në nivelin rajonal, ashtu edhe global.

Ministria e ka miratuar strategjinë për ndryshime klimatike para dy javësh dhe në bazë të kësaj strategjie do të jemi në gjendje që në mënyrë shumë më adekuate t'i adresojmë problemet e fatkeqësive elementare, të cilat janë rezultat i ndryshimeve klimatike, siç janë vërshimet, zjarret, thatësira e të tjera.

Natyrisht, kjo do ta imponojë edhe nevojën që në nivel të Qeverisë të themelohen politika ndërsektorale dhe këtë do ta bëjmë nëpërmjet bashkëveprimit me ministrinë e linjës.

Një prej prioriteteve të ministrisë në fushën e mjedisit do të jetë mbrojtja e ajrit nga ndotja. Në këtë aspekt është konstatuar se ka mangësi evidente në zbatimin e legjislacionit në fuqi, konkretisht të udhëzimit administrativ 03/2011, i cili i ka përcaktuar nivelet e gazrave që emetohen nga burimet e lëvizshme dhe në dritën e analizës së Ligjit për ajrin, i cili është miratuar në vitin 2010, sot është iniciuar dhe është miratuar koncept-dokumenti për fillimin e elaborimit të ligjit të ri për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe besoj që ky ligj do të mundësojë që situata në këtë aspekt të jetë shumë më e kontrolluar dhe natyrisht të rezultojë me një cilësi shumë më të mirë të ajrit, të cilin e kemi në vend.

Natyrisht, edhe një herë po e theksoj se një vëmendje e veçantë sa i përket kësaj do t'i kushtohet monitorimit të rregullt të cilësisë së ajrit në sistemet e qëndrueshme të kontrollimit, që nuk varen më nga donacionet e ndryshme dhe projektet donatore, por nga burimet buxhetore.

Fushë e veçantë e politikave mjedisore është menaxhimi i mbeturinave solide dhe i mbeturinave të rrezikshme.

Ministria e ka miratuar strategjinë dhe master-planin, i cili do të promovohet javën që vjen për menaxhimin e mbeturinave solide dhe politikat e ardhshme në këtë fushë do të shkojnë në drejtim të asaj që ta kemi një Kosovë pa deponi të mbeturinave, por një Kosovë në të cilën mbeturinat do të riciklohen në pajtim me politikat më bashkëkohore dhe praktikat e Bashkimit Evropian.

Sa u përket mbeturinave të rrezikshme, është miratuar projekti i financuar nga Komisioni Evropian, i cili pritet të zbatohet në vitet në vijim, projekt detaj dhe i elaboruar.

Natyrisht se i përmenda kapacitetet ricikluese dhe për këtë ka interesim edhe nga komuniteti i donatorëve, edhe nga komuniteti i investitorëve privatë, por natyrisht ka interesim edhe nga institucionet shtetërore. Do të punojmë në këtë drejtim që t'i gjejmë modalitetet më të përshtatshme.

Sivjet do të iniciohet edhe Ligji për trajtimin e mbetjeve minerare, një ligj tejet i nevojshëm për vendin, i cili deri më tani nuk ka qenë fare në rend të ditës, ndërsa kjo çështje është e natyrës emergjente, e cila në njërën anë e ka dimensionin e saj ekologjik, si depozitë, të cilat e ndotin dukshëm mjedisin kudo që janë të vendosura, në anën tjetër janë edhe si burim i rëndësishëm i mjeteve financiare për ndërmarrjet publike, të cilat i menaxhojnë ato.

Sfera e ujërave është një sferë e veçantë, e cila po ashtu do ta ketë vëmendjen tonë të plotë dhe të zhvillojmë aktivitete në bazë të strategjisë për ujërat 2014-2033, e cila është përfunduar në ministri dhe do të miratohet shpejt në Qeveri.

Do të punojmë në Ligjin për autoritetet e pellgjeve ujore, që është një domosdoshmëri e kohës. Do të punojmë në ngritjen e kapaciteteve ujore, me theks të veçantë në zhvillimin e krahut jugor të sistemit Ibër-Lepenc, dhe natyrisht edhe një herë po e cek rregullimin e shtretërve të lumenjve.

Kur janë në pyetje ujërat e zeza, prapë një problem tejet i rëndësishëm mjedisor, në të cilin është punuar mjaft, do të vazhdoen projektet në ndërtimin e impianteve të mëdha në Prizren e Gjakovë dhe shpejt do të gjendet edhe burimi i financimit për Pejë, e me këtë do ta zgjidhim problemin në pjesën perëndimore të vendit. Burimet financiare janë të siguruar, e pritet vetëm implementimi i tyre.

Në të njëjtën mënyrë do të punojmë edhe për gjetjen e zgjidhjeve për Prishtinën, Mitrovicën, Ferizajn dhe Gjilanin, me theks në ofertën e Bankës Gjermane për Zhvillim me grant prej 60 milionë euro, në qoftë se edhe Qeveria e Kosovës e gjen burimin financiar prej 20 milionë euro të tjera, në mënyrë që të hyhet në një partneritet në ndërtimin e impiantit për kryeqytetin Prishtinë, që mendoj se do të ishte zgjidhje optimale për momentin.

Natyrisht, një vëmendje e veçantë, edhe në Programin qeveritar është e theksuar, do t'u kushtohet liqeneve, ose akumulacioneve të Batllavës dhe të Badocit, ku kemi probleme me ujërat e zeza të cilat derdhen në liqe, e kjo do të jetë një pikë e vëmendjes së veçantë të ministrisë.

Po ashtu, vëmendje e rëndësishme do t'u kushtohet parqeve nacionale, të cilat në këtë moment nuk janë duke u menaxhuar si duhet. Ekziston një mungesë e madhe në menaxhimin adekuat të tyre, sepse këto parqe janë nën autorizimin e drejtpërdrejtë të drejtorive të parqeve nacionale, të cilat janë nën Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit, por kërkohet një riorganizim dhe do të punojmë dhe jemi duke punuar qysh tash në themelimin e ndërmarrjes publike, e cila do t'i menaxhojë parqet nacionale të Bjeshkëve të Nemuna, të Sharrit, Shpellën e Gadimes dhe Ujëvarën e Mirushës dhe resurset e ndryshme natyrore që janë nën mbrojtjen shtetërore, në bazë të ligjeve në fuqi.

Natyrisht, vëmendja e duhur do t'i kushtohet edhe biodiversitetit dhe cilësisë së tokës, duke themeluar sisteme të qëndrueshme të kontrollit dhe të monitorimit.

Në fushën e planifikimit hapësinor, vëmendja kryesore do të shkojë në drejtim të rregullimit të saj në aspektin shumësektorial. Fillimisht, duke e zbatuar në mënyrë të përpiktë Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, e në këtë drejtim i kemi rezultatet e para.

Më pastaj, sivjet do ta iniciojmë Ligjin e ri për kadastër, i cili do të themelojë sistemin e ri të monitorimit dhe integritetit të shërbimeve në aspektin vertikal. Më pastaj do të vazhdohet avancimi i sistemit të integruar softuerik të planifikimit hapësinor, do të punohet në licencimin e arkitektëve dhe inxhinierëve të ndërtimtarisë, një proces i cili ka munguar tani e 15 vjet dhe ky proces do të themelohet në bazë të ligjit, të cilin do ta paraqesim para jush për miratimin - Ligjin për odat e arkitektëve dhe të inxhinierëve të ndërtimit.

Po ashtu, kodi i ri i ndërtimit, i cili është përfunduar nga ministria dhe është për miratimin në Qeveri do të jetë një instrument themelor me të cilin këto oda do të merren.

Natyrisht, ministria do të vazhdojë edhe me aktivitetet brenda Këshillit për Monitorim dhe Zbatim, që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore në zonat e mbrojtura në bashkëkryesim me Komisionin Evropian, si dhe një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe riorganizimit të ministrisë, e cila e ka një vëllim dhe kompleksitet specifik dhe kërkohet një riorganizim i saj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Si është puna, Teuta? Çfarë po ndodh?! Në të gjitha parlamentet, ata që e keqpërdorin kamerën dhe me qëllim të keq e i nxjerrin në media deputetët, u ndalohet filmimi ose pjesëmarrja në mbledhje tjera. Sidoqoftë, ne nuk e kemi këtë rregull dhe i kemi lejuar, mund të filmojnë çfarëdo... Në qoftë se doni të kemi rregulla të tilla t'ua ndalojmë, mund t'i nxjerrim në votim në Parlament. Kjo është e mundshme.

Fjalën e ka zoti Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Ndonëse Programi i Qeverisë Isa-Hashim ka fjalë të mira teorike të një përmbledhjeje të gjithanshme për një zhvillim të mirë ekonomik dhe problematik social-ekonomik dhe politik në vend, nuk arrin të përkthehet në parametra matës që duhet të ketë një program i mirëfilltë ekonomik. Kjo mungesë e numrave dhe indikatorëve matës të jep të kuptosh që kjo Qeveri ka pasiguri të skajshme dhe nuk i beson as vetë këtij programi në realizim.

Në rastet më të thjeshta, një plan biznesi i një kompanie ka parametra matës dhe afate për realizimin që e bën të mundur monitorimin...

KRYESUESI: Haxhi, afroje mikrofonin pak se nuk po dëgjohesh.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

...monitorimin e suksesshëm të një kompanie, ndërsa një program qeveritar i lë vetes komoditet në varësi të situatave për të treguar suksese, apo mossuksese.

Çdo reformë për zhvillimin ekonomik dhe çdo fond punësimi ka qenë e domosdoshme që të ketë shifra dhe afate, në mënyrë që të synohet realizimi dhe të matet ky realizim.

Mungesa e indikatorëve, rrjedhimisht e bën këtë plan vështirë të matshëm, vështirë monitorues dhe shumë skeptik të realizueshëm. Andaj, më poshtë shihen dështimet e para të këtij programi.

Krijimi i infrastrukturës për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik sipas Programit të Qeverisë do të bazohet në qëndrueshmërinë buxhetore dhe në stabilitet makrofiskal. Kjo që në fillim ka rezultuar si e paqëndrueshme për këtë Qeveri. Ky konstatim del nga ajo çfarë u tha këtyre ditëve nga FMN-ja dhe nga vetë Qeveria.

Nëse në Programin qeverisës planifikohet një reformë e mirëfilltë fiskale, duke krijuar favore në politika tatimore, investime të jashtme, punësime dhe tërheqje të kapitalit, kjo në praktikë rezultoi me ndryshime të shpejta në projektligje, sa për t'i quajtur reforma fiskale, pa ndonjë analizë të mirë për nevojat e ndryshimeve dhe një periudhë më të papërshtatshme që për grupet e interesit janë të mbingarkuara me raportime vjetore dhe nuk mund të kontribuojnë në këto ndryshime. Lind pyetja pse u bë me kaq nxitim dhe pse në këtë kohë të papërshtatshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demi-Murtezi e ka fjalën.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Nga dita e djeshme po vazhdon një debat i gjatë nga i cili shpresojmë që do të arrijë një korrespondencë e mirë e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë dhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për t'i vazhduar punët dhe planet optimale që kjo Qeveri ka paraqitur para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Punët e bëra dhe iniciativat e ndërmarra deri më tani të cilat i shpalosi dje kryeministri Mustafa, e për shumicën prej të cilave na duhet kohë që të arrijmë rezultate dhe të shohim reflektime, për mendimin tim, janë optimalja e mundshme për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe ajo çka qytetarët e Republikës sonë presin nga puna e Qeverisë, e mbështetur edhe nga puna e Kuvendit.

Nga shumë parafolës të ditës së djeshme dhe të ditës së sotme u evidentuan shumë probleme dhe punë të pabëra, ose të bëra jo siç duhet nëpër agjenci e gjëra të tjera, por këto nuk korrespondojnë me planin e punës që ka hartuar Qeveria. Këto janë punë që duhet të mbikëqyren në ndërkohë, e për të cilat do të mbështeten për punë më të mirë edhe nga deputetët e pozitës, jo vetëm nga ata të opozitës.

Duke qenë bashkëpartiake me ministrin Agani dhe duke bashkëpunuar ngushtë me ministrin e Financave, zoti Hoti, domethënë duke qenë pjesëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, them se kam dy arsye më shumë për t'i besuar punës së ardhshme të kësaj Qeverie. Në anën tjetër, nga shpalosja e mirëfilltë e planit të punës së ministrit Bajrami në Ministrinë e Arsimit dhe një shifre të admirueshme që nuk e ka pasur asnjëherë Qeveri deri më tani në sektorin e Bujqësisë dhe planet e shpalosura nga ministri Krasniqi, janë shkëndijat e para për shpresë, për punë më të mirë dhe evidente, seç kanë pasur ndonjëherë qeveritë e vendit deri më tani.

Andaj, lus gjithë deputetët që bashkërisht që bashkërisht të performojmë në mënyrën e duhur ashtu siç na ka hije si deputetë dhe ta mbështetim punën e Qeverisë dhe të japim kritika aty ku këto punë çalojnë nga ajo që është paralajmëruar deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Kryesues i Kuvendit!

I respektuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Programi qeverisës të cilin sot e kemi para nesh është një program ambicioz dhe gjithëpërfshirës, i përgatitur dhe i shtjelluar nëpërmjet shtyllave kryesore të cilat sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Shtyllat kryesore në të cilat mbështetet Programi qeverisës janë të zbërthyer mjaftueshëm rreth punëve dhe veprimeve që do të ndërmerren për t'i arritur objektivat e parashtruara për një zhvillim, duke filluar nga politikat fiskale, përmirësimi i mjedisit biznesor, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e deri te një arsim dhe shëndetësi moderne.

Gjatë analizës të këtij Programi qeveritar është e vërtetë që mund të vijmë deri te përfundimet se i mungon aspekti numerik i të dhënave, mirëpo pavarësisht kësaj pune dhe detyrat jenë mirë të shtjelluara, të cilat mbështeten me aktivitete kryesore që Qeveria do të ndërmarrë me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të saj në të gjitha segmentet.

Plani i implementimit është një segment tjetër me rëndësi brenda Programit qeverisës nëpërmjet të cilit jepen sqarime rreth periudhave kohore brenda të cilave do të kryhen këto aktivitete.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për të qenë sa më racionalë në fjalimin tim, unë do të ndalesha vetëm në disa objektiva të qeverisjes, siç është: çështja e përcaktimit të TVSH-së, e cila do të jetë e ndryshme për mallra të ndryshme. Ky veprim nga Qeveria do të jetë me rëndësi për qytetarët tanë, sepse do ta krijojë mundësinë e lirimit nga TVSH-ja për mallrat bazike, të cilat drejtpërdrejt do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies të qytetarit tanë, si dhe në zbutjen e nivelit të varfërisë. Pushimi nga taksat për ndërmarrjet të cilat do të krijojnë vende të reja pune për një periudhë kohore do të jetë e mirëseardhur për këto veprimtari të këtyre ndërmarrjeve. Lehtësirat për investimet nga bashkatdhetarët tanë nga Diaspora do të jetë një tjetër veprim i rëndësishëm i kësaj Qeverie, në mënyrë që këtyre t'u krijojnë lehtësira dhe siguri për investimet e tyre këtu, të cilat do të krijojnë vende tjera të reja pune dhe një pjesë të këtyre bashkatdhetarëve do t'u krijojnë edhe mundësi kthimi në vendlindje.

Rritja e fondit për subvencione në bujqësi është një tjetër element i rëndësishëm i këtij Programi qeverisës kur kihet parasysh fakti se Kosova ka kushte të volitshme klimatike dhe pedologjike për zhvillimin e kësaj dege ekonomike si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Kosovës, si dhe si degë e cila më së shpejti gjeneron vende pune për të rinjtë tanë.

Një element tjetër me rëndësi në këtë program është edhe formimi i një universiteti bujqësor që do të jetë një shtysë e mëtejme e zhvillimit të kësaj dege duke nxjerrë kuadro të nevojshme për një bujqësi bashkëkohore, e cila do të mundësojë sigurinë e një baze ushqimore të qëndrueshme për popullatën tanë.

Në sferën e arsimit brenda këtij Programi qeverisës inkurajohen hapa të rëndësishëm që do të ndërmerren në drejtim të rishikimit të kornizës së kurrikulës së Kosovës, me qëllim të arritjes së pretendimeve për një arsim më cilësor. Kurrikula që është duke u pilotuar jemi të vetëdijshëm se ka shumë të meta, prandaj kërkohet që në të ardhmen ajo të rishikohet me sy kritik, në mënyrë që sistemi arsimor në Kosovë të dalë nga eksperimentet e njëpasnjëshme që janë bërë që nga paslufta.

Të respektuar kolegë deputetë,

Një tjetër element i rëndësishëm i Programit qeverisës është hapja e paraleleve parashkollore, niveli 5-6 vjeçar në të gjitha shkollat në Kosovë, që do të jetë një ndihmesë e madhe drejtë parapërgatitjeve të fëmijëve për fillimin e arsimit fillor. Funksionalizimi i shërbimeve profesionale nëpër shkollë, siç është mjeku, pedagogu, psikologu, punëtori social, e kështu me radhë, do të ishin të mirëseardhura nëpër shkollat tona, në mënyrë që nxënësve tanë t'u lehtësohet kontrolli i shëndetit dhe problemet tjera me të cilat ballafaqohen në shkollat tona.

Sigurisht që këto tri të parat janë elemente shumë të rëndësishme, ndërsa për punëtorë socialë është mirë që mendohet, por besoj se në qoftë se do të arrijmë t'i realizojmë këto tri të parat, besoj që do të jenë të mjaftueshme për këtë fazë të kësaj periudhe qeverisëse. Ndërkaq kur flasim për 100-ditëshin e qeverisjes Mustafa, mund të konkludojmë që nëse themi që dita e mirë shihet në mëngjes mund të vijë përfundimet që brenda kësaj periudhe kjo qeverisje ka bërë disa hapa dhe punë inkurajuese pozitive, me gjithë vështirësitë të cilat e kanë përcjellë që nga fillimi i marrjes së detyrës.

Vlen të cekim ndryshimin dhe përshkallëzimin e vlerës së TVSH-së për mallrat e ndryshme, Ligji mbi ndërmarrjen publike dhe “Trepçën”, nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet e ndryshme dhe Kosovës, falja e borxheve të vjetra dhe inkurajimi i bizneseve për t’i paguar pagesat e mbetura të borxheve, marrëveshjet për huamarrje me kushte të volitshme e kështu me radhë. Dhe, për fund themi se ky Program qeverisës, që sot u është dhënë në duar deputetëve të zgjedhje, e kanë për obligim ta studiojnë mirë dhe ta analizojnë, në mënyrë që në të ardhmen e kësaj qeverisjeje ta përcjellin realizimin e tij në periudha periodike me qëllim që Qeveria ta implementojë në praktikë në të mirë të qytetarëve të saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

100-ditëshi i Qeverisë shënohet, përveç shumë parregullsive tjera, edhe me shkelje kushtetuese që kanë të bëjë me sovranitetin e vendit.

Qeveria ka vazhduar edhe më tutje ta shkelë Kushtetutën e Kosovës në fushën e sigurisë, me moszbatimin e saj, përkatësisht të nenit 126, paragrafët 1 dhe 2.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 26, paragrafi 1 thotë: “Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës dhe mund t’i dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare”.

Paragrafi 2 thotë: “Forca e Sigurisë së Kosovës mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj”.

Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka hequr dorë nga territori i komunave veriore të Kosovës edhe në fushën e sigurisë. Atje nuk ka asnjë repart të FSK-së, asnjë kazermë të kësaj force. Asnjë stërvitje nuk organizohet atje. Madje, atje nuk ka asnjë pjesëtar të vetëm të FSK-së. E, në ndërkohë, ky nuk është lëshim por angazhim i Qeverisë që të mos ketë ushtarë të Kosovës në komunat veriore.

Por, nëse Qeveria e kaluar nuk i dërgoi ushtarët e FSK-së në veri, kryeministri i sotëm shkon edhe më tej, jo vetëm FSK-së, por edhe Forcave të Armatosura të Kosovës ua pamundëson praninë në veri ende pa u themeluar ato.

Deklarimi i kryeministrit me 1 prill: “Forcat e Armatosura nuk do të mund të shkojnë në veri”, qoftë edhe duke deklaruar se kjo mund të ndodhë vetëm në marrëveshje me NATO-n, është një deklaratë e rëndë dhe mbytje e shpresës që Kosova ta ketë ushtrinë e saj në përputhje me Kushtetutën dhe me aspiratat e qytetarëve të saj.

Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që dëgjojmë se ushtarët e Kosovës nuk do të mund të shkojnë në një pjesë të territorit të saj, pra në veri, por është hera e parë që këtë e dëgjojmë nga ai i cili e ka për detyrë zbatimin e Kushtetutës dhe garantimin e sovranitetit të vendit. Pra, këtë e dëgjojmë nga kryeministri i Kosovës, pasi të njëjtën gjë e kemi dëgjuar disa herë më parë si deklaratë edhe nga kryeministri i Serbisë.

Është e vërtetë që në marrëveshje me NATO-n, Kosova mund dhe duhet të dërgojë trupa jashtë vendit, por kjo nuk do të duhej të ndodhte kështu kur bëhet fjalë për praninë e trupave brenda territorit të Republikës. Duke e praktikuar këtë normë, Qeveria e Kosovës po e konsideron veriun e Republikës si territor jashtë vendit, që i referohet nenit 126, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

E kur kryeministri deklarohet se, jo vetëm FSK-ja sot, por edhe Forcat e Armatosura të Kosovës nesër nuk mund të jenë të pranishme në veri, atëherë kryeministri po e shkelë Kushtetutën në avancë, pra paraprakisht. Kështu, kryeministri po e paralajmëron mosrespektimin edhe të propozim-amendamenteve për ndryshime kushtetuese që pritet të na vijnë në Kuvend për miratim e që kanë të bëjnë me ndryshime kushtetuese për Forcën e Armatosur të Kosovës, neni 126 - Forcat e Armatosura të Kosovës. Paragrafi 1 thotë: “Forcat e Armatosura të Kosovës janë forca kombëtare ushtarake të Republikës dhe mund t’i dërgojnë pjesëtarët e tyre jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e tyre ndërkombëtare”. Dhe, paragrafi 2 si propozim thotë: “Forcat e Armatosura të Kosovës mbrojnë sovranitetin, integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global”.

Por, kur i shohim këto propozim-amandamente për ndryshime kushtetuese, shtrohet pyetja se si do të mund që Forcat e Armatosura të Kosovës, siç thuhet në amendament, ta mbrojnë sovranitetin dhe integritetin territorial, kur njëherësh këtyre forcave u pamundësohet që të jenë aty ku mbrohet sovraniteti dhe integriteti? Si mund të mbrohen qytetarët, prona e tyre dhe e Republikës së Kosovës, kur Forcat e Armatosura, si garantuese për mbrojtjen e tyre, nuk mund të jenë pranë tyre që i kanë detyrë t’i mbrojnë? Si do të mund që Forcat e Armatosura të Kosovës të kontribuojnë, siç thuhet në amendament, për ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal e global, kur një gjë të tillë nuk mund ta bëjnë as brenda territorit të vet? Si mund ta kuptojmë se pse po na i sjellin pra propozim-amendamentet për ndryshime kushtetuese, kur të njëjtat po na paralajmërojnë që do t’i shkelin?

Shkelja pra paraprakisht e nenit 126 të Kushtetutës paraqet vërtet rast unik. Këtë po e bën vetëm Qeveria jonë. Kryeministri ka deklaruar po ashtu se “mosprania e FAK-ut në komunat veriore është një marrëveshje e mëhershme”. Për çfarë marrëveshje bëhet fjalë? Ne nuk e dimë që ka marrëveshje me dikë apo ndonjë ditë për Forcat e Armatosura të Kosovës. Nëse ka marrëveshje, atëherë kryeministri duhet të na thotë, e jo të na e fshehë një marrëveshje të tillë. Në të kundërtën, kryeministrin e bëjmë përgjegjës edhe për fshehjen e marrëveshjeve të dëmshme, por edhe për zbatimin e tyre në dëm të sovranitetit dhe të integritetit të territorial të Republikës.

Ne, pra, nuk mund të jemi më pak fajtor nëse e zbatoni një marrëveshje të dëmshme për vendin se sa fajtor ai që e ka bërë këtë marrëveshje, sikur ata zbatojnë marrëveshje të dëmshme, përgjegjësia dhe faji janë të barabartë.

Prandaj, për kaq sa kryeministri po angazhohet, shndërrimi i Forcës të Sigurisë të Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës është vetëm një premtim për ndryshim nominal, si qëndrim maksimal i Qeverisë, duke qenë njëkohësisht si amortizim i angazhimeve të dëmshme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit tash e në të ardhmen.

Shndërrimi i FSK-së në Forca të Armatosura për më tepër duke që rrezikon të mbetet vetëm si premtim dhe retorikë politike për t'i ushqyer me shpresë dhe për t'u thënë diçka qytetarëve. Duke e ditur që Qeveria nuk i mban premtimet, krejt lehtë dhe vetëm ndryshimi i emrit mund të mbetet vetëm një premtim i perealizuar i saj. Pra, Qeveria ka marrë dy angazhime antagoniste. Nëse të dyja quhen premtime dhe angazhime të kryeministrit të Qeverisë, atëherë nuk është e vështirë të kuptohet se nga cili angazhim do të heqë dorë dhe nga cili nuk guxon të heqë dorë kryeministri i Kosovës.

Dua të ndajë para jush edhe një episod tjetër që karakterizon 100-ditëshin e Qeverisë Mustafa. Pra, dhuna policore në protesta dhe instrumentalizimi i Policisë së Kosovës.

Në ditët e para të qeverisjes, kryeministri u përball me protestat e qytetarëve dhe të opozitës, si pasojë e qëndrimeve fashiste të njërit nga ministrat e tij. Protestat ishin të arsyeshme dhe të nevojshme përballë një ministri lidhur me deklaratat e tij fashiste.

Edhe pasi ky ministër e quante Kosovën me emër jokushtetues, edhe pasi ky ministër i Qeverisë Mustafa ushtronte lojalitet ndaj Qeverisë së Serbisë, edhe pse ky ministër i Qeverisë Mustafa i fyente nënat e viktimave të luftës, shefit të tij kryeministër as që i shkante ndërmend ta shkarkonte. Jo vetëm që nuk e shkarkoi, por ai edhe nuk u bind as nga debatet, as nga opinioni publik, për shkarkimin e këtij ministri.

Përballë gjithë kësaj situate, përballë gjithë këtyre kërkesave dhe protestave, kryeministri dhe Qeveria LDK-PDK u vunë në mbrojtje të këtij ministri fashist. Madje, aq shumë u mbrojt ministri, sa u rezistua deri në momentet e fundit, edhe kur u mbushën sheshet me qytetarë protestues, edhe ku u përgjakën këto sheshe nga dhuna policore kundër qytetarëve të vendit. Vetëm pak orë para protestës së radhës, kryeministri u dha të drejtë qytetarëve dhe protestuesve.

A do të thotë kjo se vetëm me protesta kryeministri rreshtohet në anën e interesave të qytetarëve? Sidoqoftë, kjo që unë e ndava me ju janë vetëm dy episode të qeverisjes 100-ditëshe të Qeverisë LDK-PDK.

Edhe këtë 100-ditësh, kryeministri e quan të suksesshëm të Qeverisë të tij. Kur ka episode të tilla në 100 ditët e para të qeverisjes, edhe po ashtu dëgjojmë nga kryeministri se ky 100 ditësh ka qenë qeverisje e suksesshme, atëherë sipas kësaj logjike u dashka t'ia rritim suksesin kësaj Qeverie, duke ia rritur dozën e protestave edhe më të mëdha, përderisa 100-ditëshi i ardhshëm të jetë edhe më i suksesshëm. Por, me sa pamë në 100-ditëshin e parë të qeverisjes LDK-PDK, kjo është një Qeveri është e keqe.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Ftoj deputeten Ganimete Musliu ta merr fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit e nderuar kryesuese!

Kur të pashë ulur atje, mendova mos është 8 Marsi, se tek ne zakonisht u jepet hapësirë femrave të ulen atje vetëm në këtë datë, kështu po ndihem jashtëzakonisht mirë që e mora fjalën prej juve.

Nuk dua të përsëris shumë, të nderuar kolegë dhe ju kolege, për të gjitha ato që u thanë për 100-ditëshin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, qeverisjes së Isa Mustafës, por megjithatë nuk mund të mos ndalem pak në Programin qeverisës për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe me këtë rast shpreh shqetësimin tim që kjo ministri në publikimin e listave të përfituese të projekteve kulturore, e harron plotësisht Komunën e Skenderajt, e anashkalon, e diskriminon, ose edhe e ofendon, duke mos i dhënë asnjë projekt, ose thjesht duke mos e mbështetur asnjë projekt. Ministria e Kulturës nuk e ka parë të arsyeshme që t'i përkrahë dy projekte të rëndësishme në fushën e kulturës në Skenderaj, që janë jetike për atë pjesë, siç është festivali rapsodik “Rapsodia shqiptare”, dhe Takimet e Teatrove Shkollore, për çfarë Komuna e Skenderajt ka dorëzuar projekte detale për këto dy aktivitete.

Për informimin e ministrit, por edhe të qytetarëve, dua që të jap disa sqarime rreth festivalit rapsodik. Festivali rapsodik “Rapsodia shqiptare” ka karakter gjithëkombëtar, që tradicionalisht mbahet më 26, 27 dhe 28 nëntor të çdo viti. Ky festival mbledh rapsodë nga të gjitha trevat shqiptare dhe nga Diaspora, të cilët performojnë dhe konkurrojnë me krijimet e tyre karakteristike të këtij zhanri të muzikës sonë tradicionale. Festivali është unik në tërë Kosovën, pasi ruan dhe kultivon një krijimtari që konsiderohet si më e vjetra e kulturës sonë, pra muzika rapsodike. Ai i shërben ruajtjes dhe kultivimit të kësaj vlere të trashëgimisë sonë kulturore. Rapsodia shqiptare mbahet në kuadër të shënimit të festës së 28 Nëntorit dhe për simbol të tij e ka heroin kombëtar Hamëz Jasharin, vëllai i Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe kultivues i kësaj muzike.

Në vitin 2014, ky festival ka pasur 37 grupe rapsodësh, të cilat kanë performuar për 3 net dhe janë vlerësuar nga juria profesionale e festivalit. Festivali në të kaluarën është mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Skenderajt dhe sponsorizimet eventuale. Pjesën më të madhe të financimit e ka bërë Komuna e Skenderajt, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa aktiviteti tjetër ose projekti tjetër - Takimet e Teatrove Shkollore, është një aktivitet tradicional që promovon dhe nxit të rinjtë në fushën e teatrit. Ai i mbledh të rinjtë e shkolluar nga të gjitha trevat shqiptare, e jo vetëm nga Kosova. Aktiviteti ka karakter garues dhe nxit kreativitetin e nxënësve dhe mësimdhënësve në artin dramatik.

Gjatë viteve me aktivitete ka mbledhur shumë teatro shkollore dhe numër të madh të publikut, i cili nga afër ka ndjekur paraqitjen artistike të fëmijëve në skenë. Prandaj, mospërkrahja e këtyre projekteve do të rezultojë në mosmbajtjen e tyre, edhe pse të dyja tashmë janë projekte që janë realizuar nga DKRS-ja dhe përkrahur tradicionalisht nga MKRS-ja. Unë shpreh shqetësimin tim dhe shpresoj shumë që ministri i Kulturës do ta përmirësojë këtë gabim që e ka bërë dhe të paktën festivalit “Rapsodia shqiptare” do t'i dalë në përkrahje, sepse ai tashmë është bërë ikonë e kulturës në qytetin e Skenderajt. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj deputeten Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Edhe mua më duhet të them që më vjen mirë që më në fund, pas shumë mandateve parimi i barazisë gjinore, i kërkuar në Kushtetutë, po respektohet në Kryesinë e Kuvendit dhe e shoh një kryesuese, pra një grua në ulësen e kryesuesit.

Fusha për të cilën do të flas sot dhe vetëm në aspektin e Programit qeveritar, pra jo për 100-ditëshin e Qeverisë, është fusha e politikës së jashtme dhe duke pasur parasysh që ky dokument, pra Programi qeverisës duhet të jetë një dokument i gjallë, që varësisht nga nevojat dhe varësisht na zhvillimet edhe mund të kërkojë ndryshime, dua t'i jap një sërë rekomandimesh, sepse në radhë të parë prioritetet e politikës së jashtme, që dje i dëgjuam nga ministri i Punëve të Jashtme dhe zëvendëskryeministri Thaçi, dallojnë në masë të madhe nga ato që janë paraqitur në Programin qeverisës dhe po i përmend disa: dje, ministri i Jashtëm tha që prioriteti numër një është diplomacia ekonomike, gjë që në fakt unë do të doja të ishte ashtu, sepse besoj që ka ardhur koha që Republika e Kosovës po fokusohet pikërisht në diplomaci ekonomike, duke e bërë në radhë të parë një rregullim të imazhit ndërkombëtar të vendit, që do të nxiste investimet e jashtme.

Megjithatë, përderisa dje u paraqit si prioritet numër një në Programin qeverisës, është prioriteti numër shtatë, pra një dallim jashtëzakonisht i madh. Dhe, përderisa në fushat e tjera është krejtësisht normale që prioritetet të ndryshojnë shumë shpesh, në fushën e politikës së jashtme ato zakonisht nuk ndryshojnë shpesh brenda një mandati, por ajo që po shohim këto ditë, në intervistat e ndryshme, ndryshim i vazhdueshëm i prioritetëve, që në politikën e jashtme nuk do të duhej të ndodhte.

Prioriteti numër 2, që u paraqit dje nga ministri i Jashtëm, ishte procesi i njohjeve, përderisa vazhdimisht është thënë gjatë këtyre viteve që agjenda multilaterale, pra anëtarësimi në organizata ndërkombëtare tashmë duhet të jetë mbi procesin e njohjeve, gjë për të cilën edhe unë po ashtu pajtohem, por ajo duhet të reflektohet edhe në Programin qeverisës.

Mirëpo, në qoftë se flasim për njohjet, është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për të cilën besoj shteti i Kosovës tashmë ka ardhur koha të tregojë seriozitet dhe kjo është saktësimi i numrit të njohjeve, pra cilat janë të konfirmuara dhe të cilat janë nuk janë të konfirmuara, sepse Republika e Kosovës duhet ta dijë se në cilat shtete duhet të shkojë dhe të llojë më tej, dhe në cilat nuk ka nevojë të shkojë.

Po e përmend vetëm një diskrepancë këtu, për shembull në faqen 43 të Programit qeverisës thuhet se Kosova ka 108 njohje, që automatikisht nënkupton që këtu janë përfshirë edhe Uganda dhe Nigeria. Megjithatë, menjëherë në faqen 44, Nigeria përfshihet në numrin e shteteve mosnjohëse, pra përmendet me emër si shtet që nuk e ka njohur Kosovën. Kjo është një çështje që domosdoshmërisht duhet të sqarohet, sepse mbi të gjitha tregon seriozitet të Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, në përgjithësi, por edhe me shtetet përkatëse, siç janë Uganda dhe Nigeria, në veçanti, sepse ne kemi pasur edhe deklarata nga ish-shefja e Politikës të Jashtme Evropiane, Ketrin Eshton, pastaj nga ish-sekretarja e Shtetit amerikan, zonja Hilari Klinton, të cilat kanë konfirmuar që këto dy njohje kur nuk kanë ardhur, prandaj edhe Republika e Kosovës, në partneritet me partnerët e saj strategjikë, duhet t'i bëjë përmirësimet e nevojshme që të tregojë seriozitet në politikën e jashtme.

Sa i përket agjendës multilaterale, ne kemi dëgjuar tani katër e vjet që prioriteti kryesor i kësaj agjende duhet të jetë anëtarësimi në Këshillin e Evropës, gjë që po shpresoj se më në fund do të ndodhë, sepse votat janë aty, mbi 2/3 e anëtarëve të Këshillit të Evropës tashmë e kanë njohur Republikën e Kosovës. Mirëpo, së fundi, në disa intervista, po dëgjojmë se ky proces, pra procesi

i aplikimit, sepse nuk do të thotë domosdoshmërisht që në momentin e aplikimit hyhet edhe në votim, ai zgjat dy deri në katër vjet përafërsisht, do të shtyhet pas nënshkrimit të MSA-së, gjë që unë nuk e shoh të nevojshme, përveç në qoftë se ministri i Jashtëm ka informata të cilat ne si Kuvend nuk i kemi, sepse nuk ka arsye më të shtyhet, siç e thashë, shkaku që i kemi votat dhe, e dyta, shkaku që Kosova tashmë në mënyrë unilaterale veçse i ka bërë të aplikueshme një numër të konventave të Këshillit të Evropës nëpërmjet të Kushtetutës së saj dhe zbatimi i tyre në praktikë ka filluar dhe zbatohen në masë edhe më të madhe se shumë anëtarë të Këshillit të Evropës, siç është Rusia.

Pra, nuk ka arsye që anëtarësimi në Këshillin e Evropës të përzihet me hapat që ne po i bëjmë drejt Bashkimit Evropian, sepse Këshilli i Evropës nuk është pjesë e BE-së fare, e para dhe, e dyta, nuk ka arsye që të shtyhet më tej kjo çështje sepse përfitimi që do ta kishin qytetarët e Kosovës nga anëtarësimi në këtë organizatë do të ishte jashtëzakonisht i madh, sepse do të kishin qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Strasburgut për shkeljet që institucionet e tyre publike bëjnë ndaj të drejtave të tyre të njeriut.

Pra, përderisa ne po dëgjojmë që anëtarësimi në Këshillin e Evropës është prioritet afatshkurtër, Programi qeverisës, në fakt, nuk e përmend anëtarësimin në këtë organizatë, por anëtarësimin në Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe në UNESCO si prioritete afatshkurtra. Këto janë në Programin qeverisës, mirëpo ministri i Shëndetësisë në pyetjen time parlamentare para një kohe e ka konfirmuar që këtë vit nuk do të aplikohet për anëtarësim dhe Asambleja Parlamentare e OBSH-së takohet brenda 26 deri 28 maj dhe aplikim tjetër për anëtarësim nuk mund të ketë deri në vitin e ardhshëm, një çështje tjetër që unë mendoj që pa kurrfarë nevojë po shtyhet dhe po prolongohet. Kurse për UNESCO-n, siç e dini, pas anëtarësimit të Palestinës, kanë dalë disa problematika të cilat unë shpresoj se me partnerët tanë, në veçanti me SHBA-në, i keni diskutuar para se të përfshihet ky si prioritet afatshkurtër.

Dhe, përfundimisht, sa u përket partnerëve strategjikë, më vjen mirë që Programi qeverisës i kualifikon Shtetet e Bashkuara të Amerikës si partnerin kryesor strategjik dhe disa vende tjera të BE-së, mirëpo thuhet që partner strategjik konsiderohen edhe shtetet e tjera evropiane. Besoj është një përmirësim që duhet të bëhet, sepse shtet evropian është edhe Bjellorusia, dhe nuk besoj që Kosova ka ndonjë interes ta konsiderojë këtë shtet si partner strategjik, përderisa më vjen mirë që po ashtu edhe Shqipëria është cilësuar si një ndër shtetet me të cilin Kosova synon partneritet strategjik, por, siç e dini, deri tani investimet strategjike kanë shkuar drejt një shteti tjetër, pra drejt Turqisë, por besoj që, varësisht nga implementimi i këtij programi, do të shohim edhe ndryshime.

Krejt në fund, e shoh që diplomacia parlamentare është një ndër prioritetet e politikës së Jashtme, edhe pse nuk është shtjelluar gjatë në program, krejtësisht normale, unë shpresoj shumë që pas shumë viteve të funksionimit të këtij Kuvendi, Qeveria vërtet do ta kuptojë rëndësinë e diplomacisë parlamentare. Dhe, një çështje shumë e rëndësishme është që Kuvendi i Kosovës, nëpërmjet diplomacisë parlamentare, në bashkëpunim me MPJ-në, nuk mund të ndihmojë vetëm te shtetet të cilat tashmë e kanë njohur Kosovën, por në veçanti mund të ndihmojë me parlamentet e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, sepse qasja e Kuvendit të Kosovës, praktika e tregon, te shtetet jonjohëse është shumë më e lehtë sesa qasja e institucioneve qeveritare. Kjo është krejtësisht normale në diplomaci, sepse zakonisht kur një kryeministër e

pret kryeministrin homolog, i bie që e ka njohur Kosovën, por jo domosdoshmërisht edhe kur e pret një parlament në parlamentin e vet homolog, sepse kështu fillojnë komunikimet e para dhe mund të vijë deri te njohja.

Rasti më i mirë është Egjipti, ku Kuvendi i Kosovës nëpërmjet diplomacisë parlamentare ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm kryesor, do të thosha, që t'i qojmë argumentet e Kosovës dhe të popullit të Kosovës në Egjipt dhe përfundimisht edhe ta kemi një vendim pozitiv. Prandaj, shpresoj edhe që do t'ketë zhvillim më zëmardh të raporteve MPJ-Kuvend, në mënyrë që të kemi avancim të diplomacisë parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj deputetin Albin Kurtin që ta marrë fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Këto 100 ditë kanë qenë ditët më të mira të Kosovës me këtë qeveri. Ditët pas këtyre do të jenë gjithnjë më të këqija. Pra, ditët më të mira me këtë qeveri tashmë i kemi parë. Ato njëmend ishin shumë të këqija, por ditët në vijim do të edhe më të këqija. Mbase nuk mund të jetë ndryshe me një qeveri, e cila është themeluar me marrëveshjen e Rashkës së 9 dhjetorit 2014. Atje pra e gjejmë këtë qeveri, e jo këtu në Programin e saj qeverisës.

Kjo Qeveri do të hapë pakrahasimisht më shumë vende pune në Serbi sesa në Kosovë. Dhe, këtu nuk e kam fjalën për transportuesit e shqiptarëve nëpër Serbi për në Hungari, e as për hotelet e restorantet në Suboticë, ku lajmërimet jepen edhe në gjuhën shqipe. E kam fjalën për lejimin që këta do t'ua bëjnë mallrave të Serbisë në Kosovë. Serbia për çdo ditë i merr së paku një milion euro në ditë nga Kosova, sipas shifrave zyrtare. Në këto 100 ditë i ka marrë më shumë se 100 milionë euro.

Mustafa tha se fluksi i migrimit në dy muajt e parë të këtij viti ka mbetur ende i pashpjegueshëm në pikëpamje të faktorëve që e kanë shkaktuar. Mirëpo, kjo është dëshmi e asaj thënies popullore se i ngopuri të uriturit nuk ia di. Nga kolltuku qeveritar, në zyrë, ose në xhip, ose nga dhoma e ngrohtë në pallat nuk mund ta kuptosh as atë që e sheh: ikjen e atyre që janë të varfër, e po varfërohen, dhe fëmijët e të cilëve nuk kanë shans të hapin biznese me kompani sigurimesh, gurthyes apo shitblerje veturash, sado i lirë e i hapur të jetë tregu, sepse as ushqim të mjaftueshëm nuk kanë në baza ditore.

Është interesante qysh në raportin për 100-ditëshin e punës së Qeverisë, Mustafa nuk e përmendi shkarkimin e Jablanoviçit fare. Shtrohet pyetja: pse? Kjo është e vetmja e arritur e tij reale. Si bëhet që kryeministri nuk e përmend vendimin e tij më të madh e më të mirë? Natyrisht, pa ato 20 protesta nëpër Kosovë dhe pa protestat e 24 dhe 27 janarit, e sidomos pa paralajmërimin për protestën e 4 shkurtit, pa dyshim që nuk do të shkarkohej Jablanoviçi më 3 shkurt. Mirëpo, është një padrejtësi e madhe që Mustafa ia bën edhe vetvetes kur nuk e përmend të arriturën e tij kryesore. Unë do ta kisha pyetur pse nuk e përmendi suksesin e tij real, ndërkohë që flet për suksese përgjithësisht të dyshimta?

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ky program qeverisës është prozë e dobët e premtimeve të përgjithësuara. Po them prozë e dobët dhe jo shumë e dobët, për shkak se nuk është kollaj që t'i shkruash plot 84 faqe, e të thuash kaq

pak. Pra, e do kjo punë njëloj talenti, sado pervers që mund të duket ai. Është e natyrshme që kur shkruhen 84 faqe të shpërfaqet një përmbajtje e substancë sado kudo e konsiderueshme - gjithsesi pra nevojitet ca talent që kjo të mos ndodhë, siç është bërë në këtë program.

Në tekstin e këtij programi dhjetëra gjëra nga më të ndryshmet thuhet se do të jenë prioritet këtu e atje, kjo prioritet, ajo prioritet, pra: prioritet gjithçka! Kur ka shumë prioritete, kjo është një mënyrë tjetër për të thënë se nuk ka fare prioritete. Mbase edhe një dëshmi më shumë se kësaj qeverie prioritete do t'ia caktojë dikush tjetër: burokratët ndërkombëtarë e qeveritarët e Beogradit, Gjykata Speciale në Holandë e Gjykata serbe në Mitrovicë.

Sigurisht që nuk mungojnë as formulimet, le t'i quajmë ekzotike, si p.sh. dallimi ndërmjet 'shtyllave kryesore' dhe 'shtyllave të rëndësishme', siç thuhet në këtë program, apo edhe shprehjet si 'një ndër prioritete parësore', thua se kjo nënkupton që ka prioritete joparësore dhe se ka joprioritete parësore, dhe, atë, disa sosh, natyrisht.

Se ky nuk është program për treg, por se tregu është vetë programi të cilit i nënshtrohem i pranoi vetë kryeministri Mustafa kur tha dje që nuk ka shifra e numra në program, sepse ato na i përcakton tregu i lirë. Vetëm në paragrafin e parë të Programit qeverisës përmendet ekonomia sociale e tregut, e më vonë kjo harrohet tërësisht: fjala 'sociale' zhduket dhe mbetet gjithandëj vetëm ekonomia e tregut. Kjo qeveri është në treg, është në pazar, prandaj ajo do që edhe Kosova, edhe shteti e vendi ynë të jenë veçse në treg. Pra, në njërin anë, kemi të bëjmë me një fundamentalist të tregut të lirë. Mirëpo, në anën tjetër, kemi të bëjmë edhe me hipokrizi. Apo, jo? Sepse, shtrohet pyetja: si bëhet që në fushatë zgjedhore jepeshin premtime me shifra, p.sh. 120 000 vende pune, kurse tash nuk bën të jepen numra, sepse ato i jep tregu në fund?

Ky program i shkruar në kohën e ardhme është përplot premtime - kjo qeveri do të promovojë, do të forcojë, do të angazhohet, do të insistojë, do të stimulojë, do të marrë parasysh, do të reflektojë, do të sigurojë, do të punojë, do të përkushtohet, do të funksionalizojë, do të operacionalizojë, do të rrisë, do të mobilizojë, do të ndërtojë, do të adresojë, do të hartojë, do të trajtojë, e deri te do t'i shikojë mundësitë, por s'ka as shifra të sasisë, e as të afate kohore askund për asnjë çështje për të cilat premtohet se "do të..."

Edhe atëherë kur fjalët i paralajmërojnë numrat, sërish nuk i gjen ata. Në program thuhet se do të bëjnë: caktimin e një kuote, caktimin e një përqindjeje për aplikimin e pushimeve tatimore, Fond të veçantë për zhvillimin e teknologjisë informative dhe komunikuese, së shpejti do të sigurohet financimi për fabrikën e trajtimit të ujërave në Pejë, të rritet ndihma për invalidë, familje të dëshmorëve e veteranëve, do të themelojnë Fond për bursa për studime të avancuara, do të themelohet dhe funksionalizohet Agjencia për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim, do të themelohet Qendra Nationale e Kërkimeve të Avancuara, do të ketë rritje të buxhetit për Teatrën Kombëtar, për Qendrën Kinematografike, Filarmoninë, Baletin, Ansamblin 'Shota', për skenën e pavarur kulturore, për librin dhe veprimtarinë botuese, për teatrot dhe bibliotekat e qyteteve, për prezantim në festival e panairë në Kan, Berlin, Venedik e Frankfurt, për gërmime arkeologjike, për restaurim të monumenteve të trashëgimisë kulturore, do të ndërtohet Teatri i Operës dhe i Baletit dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor, do të rinovohet plotësisht Teatri Kombëtar, Muzeu i Kosovës, i Bibliotekës "Pjetër Bogdani", i objekteve të artit e kulturës nëpër komuna, mandej fond për ndërmarrësi të rinisë, për subvencionim të organizatave rinore për aktivitete rinore, për

KQVR, për KLVR, për qendrat rinore, modernizim i infrastrukturës sportive, palestrave, pishinës olimpike, shtigjeve të atletikë, stadiumit me standarde të UEFA/FIFA-s, poligone sportive në shkolla dhe lagje, më tej rritje e mbështetjes financiare për Komitetin Olimpik, për Komitetin Paraolimpik dhe federatat e sportit, fond i veçantë për bursa për studentë të mjekësisë në universitetet perëndimore, si dhe mbështetje e projekteve të hulumtimeve shkencore etj., etj.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

As buxheti i Zvicrës nuk i mbulon dot këto përralla të Qeverisë, e lëre më ai i Kosovës.

Në faqen 7 thuhet që “Qeveria do të aplikojë një politikë tatimore të thjeshtë, me procedura të thjeshta të deklarimit të tatimeve...” dhe, më tutje, “kujdes i veçantë do t’i kushtohet ruajtjes së thjeshtësisë së sistemit tatimor të Kosovës, faktor ky me të cilin është karakterizuar Kosova deri më tani”. Deputetë e qeveritarë të Kosovës, thjeshtësia në politika shtetërore nuk është vlerë. Budallai është i thjeshtë. I mençuri është i sofistikuar. Thjeshtësia përveçqë nuk është vlerë, nuk është as fuqi. Shtetet e thjeshta nuk janë të fuqishme. Shtetet e sistemet e sofistikuar janë të fuqishme. Nuk ka më thjesht se shteti ynë me tatime përgjithësisht të sheshta, me buxhet që kryesisht mbushet në kufi, e jo në brendi, e me Forcën e Sigurisë që rregullisht rri në brendi, e jo në kufi. Kjo është shumë thjesht, porse edhe shumë dobët njëkohësisht. Thjeshtësia nuk është as seriozitet. Sepse, thjeshtësia është pandjeshmëri. Në Kosovën ku është rritur shumë pabarazia, të kesh sistem tatimor të thjeshtë do të thotë të jesh i pandjeshëm, sepse do të thotë të mos kesh ndjeshmëri ndaj atyre që janë në gjendje më të rëndë dhe të cilët ia kanë nevojën më së shumti shtetit.

Veriu i Kosovës në këtë program përmendet për herë të parë vetëm në faqen 38, pra gati te gjysma e programit, ndërsa në faqe 50 tregohet që Forcat e Armatosura të Kosovës do t’i kemi për jashtë vendit, pra në misione të huaja. Në faqe 48 thuhet se do të luftohet terrorizmi dhe ekstremizmi fetar nëpër botë, por jo edhe ai i Serbisë në veri të Ibrit. Kjo politikë e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit i përngjan atij airbag-ut në veturë, për të cilin thuhej se funksionon në mënyrë të përsosur, përveç në rast aksidenti. Pra, në rast aksidenti nuk funksionon, a përndryshe funksionon në mënyrë të përsosur. Komunitet me shumicë serbe përmenden, merreni me mend, vetëm në faqen 82 nga 84 faqet e programit. Mbase, ato mendojnë t’ia lënë Asociacionit të komunave dhe shteti i Kosovës s’ka pse i konsideron ato pjesë të Kosovës më.

Një teoricien i psikanalizës dinamike thotë që shakaja është gjithmonë për diçka tjetër. Kjo Qeveri është një shaka, sepse kjo Qeveri nuk është për këtë program qeverisës. Kjo Qeveri është për Gjykatën Speciale, për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, dhe për rehatim të qeveritarëve me klikat e tyre partiake e biznese. Kaq dhe vetëm kaq! Andaj kjo mazhorancë njëmend i ka numrat, por me një kësi programi që gjithsesi s’ka se si të ketë numra. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër i Financave, zoti Hoti.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit! Unë shumë shkurt dëshiroj t’i adresoj disa prej çështjeve, sepse pak është i pakuptueshëm edhe monologu që po bëhet tash prej zotit

Kurti këtu, sidomos për politikat ekonomike dhe për politikat fiskale që i kemi prezantuar. Pakoja fiskale veç ka ardhur te ju dhe është aplauduar edhe disa prej disa deputetëve të partisë suaj. Tash ndoshta është mirë t'i koordinohen ndërmjet vete se është i mirë apo i keq një sistem i thjeshtë tatimor, se praktika ndërkombëtare tregon që një sistem i thjeshtë tatimor është më i miri. Nuk është budallallëk, është efikasitet. Nëse këtë ju nuk e kuptoni është tjetër gjë, por korniza brenda së cilës ju i shihni gjërat është ndryshe, normalisht. Ne flasim do të bëjmë këtë, e do të bëjmë këtë, kjo çon tek kjo dhe kjo çon te kjo.

Ne nuk themi që duhet të zgjohesh në 7 të mëngjesit, e në 8 duhet të hash mëngjes, duhet të shkosh në këtë drejtim në fakultet dhe në shkollë të mesme dhe do të jesh i punësuar aty, sepse ajo është ekonomi e planifikuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, kundër-replikë zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Askund nuk e përmenda ekonominë e planifikuar, as në sa duhet të zgjohen qytetarët nga gjumi. Nuk është punë e imja ajo. Askund nuk e përmenda centralizimin, kontrollin, ekonominë nga shteti, mirëpo shteti nuk bën të jetë spektator. Nga tregu i lirë ndërmjet Gjermanisë dhe Francës përfitojnë të dyja, mirëpo nga tregu i lirë ndërmjet Gjermanisë dhe Somalisë, dihet rezultati. Tregun e lirë e duan ata që ia dinë rezultatin dhe tregu i lirë realisht është mit, ka pafund rregulla aty, të cilat nuk i gjejmë këtu.

Meqenëse në shoqëri kemi pabarazi, trajtimi i barabartë i njerëzve të pabarabartë është padrejtësi. Pra, unë nuk po them që të kemi ekonomi të planifikuar, mirëpo po them që shteti të jetë aktiv, të jetë aktor e faktor, të nxisë, të orientojë, të inkurajojë zhvillimet e caktuara në drejtimet e caktuara për të mirën e përgjithshme. Pra, askund nuk thashë që bëhet fjalë për ekonomi të planifikuar.

KRYESUESI: Faleminderit! fjalën e ka zoti Ferati!

SADRI FERATI: Faleminderit! Përshëndetje i nderuari kryesues,

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë shpreh kënaqësinë time që edhe pas 7 orëve debat ne kemi interesim që të diskutojmë për Planin e punës dhe raportin 100-ditor të Qeverisë. Ajo çka është një dallim nga herët e kaluara, sa herë kemi biseduar për periudha të caktuara të raporteve të punës, ka qenë që ne kemi vlerësuar nga ajo që ne kemi parë në raportet e punës, por gjithmonë kemi qenë të hendikepuar, ngase nuk i kemi pasur planet e punës paraprake, të cilat kanë shërbyer si një referencë, pra si një pikë orientuese dhe krahasuese në raport me të arriturat, një plan i punës në raport me një plan të punës, e që këtë herë e kemi.

Është pak befasia ime që shumë pak është biseduar për planin e punës dhe shumë pak është diskutuar për të parë nëse kjo Qeveri ka prezantuar vizon në planin e punës, se a i ka definuar qartë se cilat do të jenë prioritetet. A janë këto prioritetet që bazohen dhe në nevojat e vendit dhe në mundësitë që ato të implementohen në tërësi.

E di se gjithmonë, edhe pas një viti, kur të vijë raporti njëvjeçar, ne prapë do t'i kthehemi dhe të shikojmë se çka është dashur të ketë një plan pune dhe të cilat janë nevojat dhe dëshirat tona, mirëpo mendoj se ky është momenti më i mirë që të diskutohet më shumë për planin e punës, ndërsa unë përshëndes të gjitha të arriturat, ato që janë thënë në 100-ditorin, por gjithmonë dihet se 100-ditëshi është një orientim, është një bazament fillestar, mbi të cilin po zhvillohet puna e mëtejme.

Unë, përveç kësaj që e thashë, do t'i theksoj edhe tri pika, që unë mendoj se janë të rëndësishme në këtë moment derisa po flasim. E para është që vendosja e prioriteteve mbi prioritete në vullnetin dhe përkushtimin e Qeverisë për ta zbatuar ligjin, për ta krijuar një disiplinë financiare dhe për ta krijuar një racionalitet në shpenzimin e parasë publike, mendoj se janë shenjat e para të mira dhe mendoj se kjo ka herë është dashur dhe do të duhet patjetër të ndodhë në shtetin tonë, në institucionet tona.

Pastaj, shihet se ekziston një frymë evidente, shumë e dukshme që zhvillimi ekonomik, gjenerimi i vendeve të punës është nevojë emergjente dhe mendoj se në shumë ministri, duke e kuptuar pra se ky është një problem multisektorial, është vendosur në prioritete dhe kemi propozime konkrete në kuadër të planit të punës dhe mendoj se kjo bën mirë, së paku në nivelin e kthimit të optimizimit të qytetarëve në drejtimin e realizimit në plotëni të këtij plani të punës.

Ndërsa sa i përket trajtimit të ndërmarrjeve publike, unë mendoj se kjo qasje reale e Qeverisë është në nevojat që i kemi, në dëshirat që i kemi, por në mundësitë reale dhe sidomos përcaktimi që në afat sa më të shkurtër të kompletohen bordet e ndërmarrjeve dhe të rregullatorëve, si dhe të nxjerrë ligjin e veçantë për "Trepçën" me çka do t'i mundësohet një autonomi e veprimit dhe një mundësi e hyrjes në partneritete të saj, por edhe në përgjithësi të pasurive të Kosovës, pra është një optimizëm dhe një shenjë e mirë për qytetarët e Kosovës.

Dhe, në këtë drejtim, meqenëse nuk jemi në situatë që tash të themi më tepër, na mbetet në fund që të gjithë t'i shprehim dëshirat e mira që ky plan i Qeverisë të realizohet në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fisnik Ismaili e ka fjalën.

FISNIK ISMAILI: Hera e parë në foltore, ma bëni për hair!

Të nderuar qytetarë, si njëri kureshtar që jam, e mora Programin qeverisës ta shikoj se qysh e ka ndërmend të na marrë në qafë kjo Qeveri gjatë këtij mandati dhe nuk u dëshpërova.

Ky dokument i ngjan më shumë materialit propagandues të një fushate zgjedhore sesa një programi, që është dashur të na bindë se ju vërtet keni për të punuar kësaj here, posaçërisht duke ju njohur se si keni punuar këto 16 vjetët e fundit, ani pse edhe PDK-ja, edhe LDK-ja, ishin në pushtet më herët, madje edhe bashkë keni qenë një herë, kur po ashtu na keni marrë në qafë.

U përqendrova më shumë në dy fushat që kam interes të veçantë, për të cilat ju s'jeni interesuar asnjëherë, e që të dyja kanë rëndësi të posaçme, jo vetëm për mirëqenien e qytetarit, por edhe për zhvillimin ekonomik dhe imazhin e Republikës së Kosovës, këto janë teknologjia informative dhe sporti.

Kur u votua buxheti, para pak muajsh, në dhjetor më saktësisht, unë e pata një kritikë serioze për faktin, se nuk ishte ndarë pothuajse asgjë për zhvillimin e mirëfilltë të teknologjisë informative, pos fondeve që i kishit rezervuar për të blerë llap-topë, Ipad-a, Iphone-a, tonerë, printerë për zyrtarë të lartë për fotokopjim.

Këtë herë po e shoh tek përmbajtja në fillim të dokumentit, kishit harruar ta fusni, por brenda kishit shtjelluar disa paragrafë për rëndësinë e teknologjisë informative në botë dhe zbatimin e saj në Kosovë, duke krijuar një fond të veçantë, pa treguar as si, as kur, as tek, do ta zbatoni këtë ide, kur e dimë që as mjete s'keni ndarë në buxhet për ta zbatuar këtë ide, kur e keni votuar buxhetin...

Me fjalë tjera, ku doni t'i merrni paratë dhe si saktë doni ta zhvilloni fushën e teknologjisë informative, kur as vetë idenë më të vogël s'e keni se si duhet të bëhet kjo punë, e që shihet qartë në dokumentin që pretendon të jetë program qeverisës, e i ngjanë veç një fletushke me premtime, që s'i keni realizuar kurrë. Ama, dorën në zemër, duhet pranuar se më erdhi shumë mirë, që teknologjia informative u përmend deri tash, dje kryesisht, së paku pesë herë nga deputetët e mazhorancës, madje edhe prej çiftit të Ismet Beqirit, i cili sigurisht ende e lëpinë gishtin kur e shfleton Iphon-in e tij. Ky është fillim i mirë, ju përgëzoj për këtë punë.

Sa i përket sportit, në këtë dokument që shumë po keni qejf ta quani program qeverisës, ju flisni për ndërkombëtarizimin e sportit, rritjen e mbështetjes financiare për federata e komisione sportive, me ndërtime të stadioneve, pallateve olimpike, pishina olimpike, po që se e lexojnë këtë program, lakmi na marrin edhe grekët, komshi, të cilët para pak vjetësh ishin nikoqirë të Olimpiadës në Athinë, e shihni sot qysh i kanë punët.

Veç e kam një problem të vogël, qysh t'ju besohet juve më, kur 16 vjet pas lufte, sot është më rrezik të jesh refero futbollit, se sa prokuror. Kur pas 5 minutash ndeshjes së futbollit, më as nuk dihet kush me kënd po luan, se të gjithë janë ngjyrë kafe prej lloçit. Kur ndeshjen e nisin duke luajtur me top, e përfundojnë duke u rrahur 'kung fu'.

Si mund të na bindni që do ta zhvilloni një sport, kur çiftët e Kamishit i kanë zaptuar komisionet e federatat sportive, e kjo nënkupton edhe manipulimet financiare, buxhetet e të cilave jo po doni t'i rrisni. Zvicra, me 200 mijë shqiptarë i prodhoi shtatë lojtarë në kombëtaren e saj. Sa lojtarë të këtij kalibri saktë, i prodhoi Kosova 16 vjetët e fundit? Se mos paska më pak talent në Kosovë? Përkundrazi, Majlinda Kelmendi është dëshmia se ka sportistë potencialë për kampionë bote, por kur dallaveraxhinjtë si ju e mbysni vullnetin politik për ta zhvilluar sportin, me këtë i mbysni edhe shpresat e perspektivën e shumë talenteve, për të cilët sherri juaj bota s'ka për të dëgjuar kurrë.

Sukseset për pranimin në Komitet Olimpik, në FIBA e ato në tenis evropian, rishtazi, janë për t'u përgëzuar, por puna më e madhe është bërë prej individëve entuziastë të këtyre federatave, ngjashëm si entuziazmi i Majlindës, trajnerit të saj e ekipit të saj, se sa që është përkrahur ndonjëherë prej Qeverisë, si ajo e kaluar, njësoj si kjo aktualja, që na ofendon të gjithëve inteligjencën, duke menduar që ne po hamë bari. Pata qejf me pritë, se mos po lexoj diçka të hajrit prej juve, po tu e ditë çfarë jeni edhe veç për të shpresuar ishte shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, zoti Hoti, e keni fjalën.

ABDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Unë po drejtohem me epitetin zoti Fisnik Ismaili, e jo me “çiftat” e zotit Ismaili.

Po jap dy sqarime, sepse nuk është në kulturën time dhe s’do tu isha drejtuar kurrë deputetëve me “çiftat” e kurrkujt, po me emër dhe mbiemër.

Dy sqarime: IT-në e kemi adresuar, pakoja fiskale ka ardhur në Kuvend, e kemi hequr TVSH-në, ngarkesën e TVSH-së prej importit të IT-së për ta zhvilluar këtë sektor. Ministria e Tregtisë ka themeluar fond, por shpejt do të vijë ligji edhe për atë fond dhe besoj se ju do ta mbështesni dhe do e votoni.

Tek sporti, prapë, me dy ligje, është e paraparë prej 5% sa ka qenë lirimi nga tatimi për shkak të sponsorizimit të sportit, kulturës dhe aktivitetet tjera, e kemi çuar në 10%, e kemi dyfishuar edhe me një 10% tjetër, varësisht prej politikave të kulturës nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri ka replikë.

ISMET BEQIRI: Unë vetëm po dua të them shumë shkurt. Edhe nëse unë e lëpij gishtin, i kam duart e lara. Çka bëjnë ata që e mbajnë gishtin e palarë në gojë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë zoti Ismaili.

FISNIK ISMAILI: Heqja e TVSH-së nuk nënkupton edhe zhvillim të teknologjisë informative. Këtë jam duke u munduar t’ua shpjegoj juve, teknologjia informative është term shumë më i thellë, se që juve e çiftit tuaj, do t’ua kapë truri, o zotërinj. A po kupton? Ti po të ishe çifti im, do të jepje para, po të garantoj. E s’di ju ku i shtini hala gishtat, zotni Ismet Beqiri, po ne për atë punë... s’është punë jona, shtini ku të duash, bëj çka të duash!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar deputet Ismaili, unë ju drejtohem si përfaqësues, por meqë ju thoni se jeni dhe kureshtar si përfaqësues dhe si kureshtar do të duhej t’i njihni dokumentet themelore, me të cilat funksionojnë institucionet. Shikoni Ligjin për buxhetin për vitin 2015, investimet në sport do të jenë rreth 9 milionë euro, pjesa më e madhe e të cilave janë të kontraktuara dhe ju si përfaqësues dhe kureshtar do të duhej të dinit që pishina olimpike është projekt i Komunës së Prishtinës, ndërkaq ne do të ndihmojmë, do të financojmë atë projekt sivjet dhe vitin e ardhshëm me rreth 1 milion euro. Pjesa tjetër është investim i Komunës së Prishtinës.

Sa i takon ndërkombëtarizimit, vetëm nga janari ne jemi bërë pjesë e 9 federatave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe FIBA Evropën dhe FIBA botën. Unë pajtohem, që këto s’janë vetëm rezultate të politikës, por unë e di që ka pasur mbështetje, por, ju s’mund të përgëzoni dhe pastaj të bëni karikaturën e asaj që përgëzoni.

Ndërkombëtarizimi nuk është vetëm një proces i sportit, por është edhe një proces politik. Ne duhet të vazhdojmë të mbështesim dhe s'mjafton, unë pajtohem që s'mjafton të mbështesim vetëm financiarisht. Po ashtu, si njeri kureshtar që jeni, ju do të duhej të dallonit ato që ekzistojnë dhe ato që ne do t'i bëjmë, meqë stadiumi olimpiq s'do të ndërtohet, ai ekziston, është në Mitrovicë dhe mjafton të shkoni ta shihni. Ne do të vazhdojmë investimet që të plotësohet, që të mbërrijë standardet.

Me Komunën e Prishtinës ne do të investojmë sivjet 500 mijë euro në Stadiumin e Qytetit dhe ne i kemi përmbyllur procedurat për përcaktimin e lokacionit, prapë bashkë me Komunën e Prishtinës, për fillimin e ndërtimeve të stadiumit nacional dhe punimet do të fillojnë gjatë këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ismaili, replikë.

FISNIK ISMAILI: Mua po më gëzon fakti, që ju po punoni e po shpenzoni para për të krijuar infrastrukturë, po, o zotni, unë s'po di a ma dëgjuat fjalimin, a jo? Çka po ju duhet infrastruktura, kur s'keni sportistë, s'keni ekip ndërkombëtar, s'keni krijuar, ju e mbysni talentin, ju ua keni humbur perspektivën sportistëve! Unë për atë fola në fjalimin tim. Nuk zhvillohet sporti duke ndërtuar stadione dhe kryekëput duke ndërtuar stadione.

Unë shumë mirë e mora shembullin e Zvicrës dhe 200 mijë shqiptarëve, të cilët i kanë 7 futbollistë në kombëtaren e Zvicrës, që janë shqiptarë. Po, kushtet, cilat kushte i ka? Cilat kushte i ka o ti zonjë, pse s'i keni bërë kushtet që 16 vjet? Çka jam duke folur unë që dy orë? Ec, posh Zotin!

KRYESUESI: Faleminderit! Zvicra ka në çdo fshat stadium, kështu që... Zoti zëvendëskryeministër e keni fjalën për kundër-replikë.

ZËVENDESKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e di që njerëzit pëlqejnë të flasin, por ata që flasin për ato që i njohin flasin më saktë dhe janë tepër të dobishëm. Patjetër, që ne kemi klube, që kemi shumë talent. Pos të tjerash, ne presim që pas dhjetë ditësh në finalen e Ligës Ballkanike të takohen Prishtina me Pejën. Janë dy ekipet më cilësore.

Problemi i ndërkombëtarizimit është diçka tjetër. Ne kemi probleme me klubet, sepse s'kanë kushte dhe po krijojmë kushte, e para. E dyta, ne kemi dhe ekip përfaqësues, i cili vlerësohet që është mjaft i mirë, por ekipi përfaqësues s'ka ku luan.

Do të thotë, s'ka qenë problemi i parë mungesa e talentit e mungesa e punës, problemi i parë ka qenë mungesa e kushteve për punë. Dhe, ne duhet të investojmë që t'i përmirësojmë kushtet. Edhe njëherë, sepse unë s'pëlqej të vazhdoj këtë debat kështu... ju nuk e dini sa investon Qeveria te sportistët e formatit dhe tipit të Majlindës, sepse prapë s'i njihni as dokumentet themelore.

Tash po flas unë, meqë Qeveria financon dhe Majlindën dhe aktivitetet e saj dhe të trajnerit të saj, që të gjitha, sipas një rregulloreje që përcakton financimin që duhet të bëjë Qeveria për sportistët kulminantë.

Edhe një herë, unë zgjedh shumë dhe më me dëshirë flas me ata që i njohin problemet. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haliti, e ka fjalën.

MILAZIM HALITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar.

Ne, deputetët e Kuvendit dhe qytetarët e Kosovës u informuam nga kryeministri për punën 100-ditëshe të Qeverisë dhe për programin qeverisës të Republikës së Kosovës, 2015-2018, për të cilat po debatojmë ne sot.

Qeveria e Republikës së Kosovës, edhe pse me një vonesë u konstituua pas zgjedhjeve nacionale ka arritur, që me punën 100-ditëshe të suksesshme të fitojë besimin e qytetarëve dhe të realizojë me sukses pjesën e programit për tre muajt e parë të këtij viti qeverisës.

Fillimi i punës së Qeverisë nuk ishte i lehtë, sepse kjo kohë u karakterizua me greva, me protesta, si të punëtorëve arsimorë, shëndetësorë, që për qëllim kishin rritjen e pagave dhe protesta të tjera, që më vonë u shndërruan në protesta të dhunshme.

Gjatë kësaj kohe vlen të përmendet intervenimi me kohë i Qeverisë për të shpëtuar kombinatin “Trepça” nga likuidimi, kërkesë kjo të cilën e miratoi ky Kuvend, duke marrë për obligim Qeveria që të hartojë një ligj të veçantë për Kombinatin “Trepça”.

Sukseset e Qeverisë për 100-ditëshin janë evidente dhe të vazhdueshme, ku ka arritur që të hartojë programin e Qeverisë për katër vjetët e ardhshme, si dhe planin për ta implementuar këtë program. Ka përgatitur programin kombëtar për reforma ekonomike, pastaj janë bërë ndryshime në sistemin tatimor, është ndryshuar tatimi në vlerën e shtuar, tatimi në fitim, tatimi për të ardhura personale, sidomos është me rëndësi lirimi nga tatimi për importin e makinerisë për prodhimtari, pastaj formimi i Fondit zhvillimor për përkrahjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe programet për zhvillimin rural, ku do t’i jepet përkrahje bujqësisë. Dhe, besoj që këto objektiva do t’i realizojë Qeveria gjatë mandatit të saj edhe pse, dikujt sot këto po i duken si përralla.

Qeveria gjatë kësaj kohe ka bërë një punë të konsiderueshme edhe në hartimin e projektligjeve, ku janë hartuar më se 28 projektligje për shqyrtim dhe miratim. Në këtë drejtim, përveç tjerash duhet të përmendim edhe Ligjin për nivelimin e pagave, i cili do të jetë i rëndësishëm dhe do t’i heqë dilemat për ekzistimin e dallimeve të mëdha të të ardhurave personale, për kategori të njëjtë të të punësuarve.

Puna që po bën Qeveria është për t’u vlerësuar lart dhe të gjitha objektivat programore, ne deputetët i kemi në programin qeverisës të Republikës së Kosovës, 2015-2018, që nga 13 marsi, program i Qeverisë i mbështetur në pesë shtylla kryesore, që janë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia, sundimi i ligjit dhe shtetit ligjor, agjenda evropiane dhe politika e jashtme, arsimi, kultura, sporti, zhvillimi rinor dhe shëndetësia moderne.

I nderuar zoti kryeministër,

Kërkojmë që të vazhdoni me intensitet të shtuar të punës për implementimin e programit qeverisës dhe t'i kryeni detyrat që i keni parashtruar vetes, sepse për këtë edhe e keni marrë besimin, ndërsa ne deputetët në vazhdimësi do të kërkojmë zbatimin e programit dhe, jemi të obliguar që më shumë të punojmë, se sa të kritikojmë. Mbase, kjo nuk po vlen për opozitën, por vetëm vërejtjet dhe kritikët e arsyeshme duhet kuptuar si një nxitje dhe motivim për punë më të mirë të Qeverisë. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kryeministri Mustafa para dy ditësh, në paraqitjen e tij para mediave, për raportin e punës 100-ditëshe të Qeverisë LDK-PDK, herë paraqitej si viktimë për mospunë e punës së tij e herë vetë lavdërohej për punën e Kabinetit të tij.

Edhe këtu në Kuvend Qeveria po flet për punë të mira që janë bërë, por realiteti është ndryshe. Për këto 100 ditë jeta e qytetarëve është bërë më e rëndë, si pasojë patëm largimin masiv të tyre nga vendi e ne i themi kryeministrit, e pyesim: A ik kush prej të mirave, zoti kryeministër?

Edhe në sektorin e shëndetësisë gjendja nuk ka ndryshuar për të mirë. Kemi një “status quo”, që po vazhdon qysh prej Qeverisë së kaluar. Për këto 100 ditë nuk ka pasur furnizim të mirë me barna. Pacientët duhet blerë prej shiringës e deri te penjtë për intervenim kirurgjik. Ende duhet pritur më shumë se dy muaj për ekzaminime ehosonografike dhe rëntgenologjike. Si mund të presë një fëmijë me anomali në zemër, ministër? Kjo po i kushton edhe me jetë, kjo po ndodh, zoti ministër!

Ende pacientët tanë vazhdojnë të mos kenë kushte të trajtohen mirë në institucionet tona, si pasojë numri i atyre që kërkojnë trajtim jashtë vendit dhe regjionit, është shumë i madh.

Korrupsioni në shëndetësi është i madh e sidomos, në prokurim. Këtë na e tha edhe i pari i Agjencisë Antikorrupsion. Ju nuk keni filluar të ndërmerri asgjë në këtë drejtim, edhe pse keni premtuar.

Këto 100 ditë të qeverisjes suaj këtë sektor e kanë përcjell pakënaqësi të shumta, duke filluar nga protesta e pacientëve me veshkë të transplantuar, të cilët kërkonin që Ministria t'u sigurojë barnat të cilat vetë nuk mund ti siguronin, sepse janë të shtrenjta.

Kemi pasur protesta të rrjetit të grave kundër keqtrajtimin të grave në lindje, protestat e specializantëve që të paguhen për punën që e bëjnë. Protestat e Sindikatës së mjekëve kundër uzurpimit pronës së QKUK-së nga spitalet private, skandalet me keqpërdorimin e citostatikëve dhe listës esenciale, e shumë të tjera. Ende nuk kanë filluar të funksionojnë odat e mjekëve, të cilat janë obligim ligjor. Edhe pse, sigurimet shëndetësore është dashur që të fillojnë qysh mandatin e kaluar, sepse ka qenë edhe zotim dhe premtim i ministrit Agani, ende ato nuk i kemi.

Bile, ministri i tanishëm thotë se ato nuk do t'i kemi këtë vit, mirëpo vitin e ardhshëm. Si do t'ju besojnë qytetarët, që do të kenë sigurime vitin e ardhshëm?

Po ashtu, gjithë këto të këqija që kanë përcjell këtë sektor, është një punë të themi e mirë, që është bërë, por edhe ajo është gjysmake, sepse është nënshkruar nga ministri i Shëndetësisë, për implementimin e një pjese të Kontratës Kolektive, që të bëhet pagesa e stazhit të punës, mirëpo ende punëtorët shëndetësorë nuk e kanë marrë këtë dallim.

Sa i përket programit qeverisës për shëndetësi ne e kemi analizuar dhe, përveç titullit që e ka “shëndetësi moderne”, asgjë brenda programit nuk ka të bëjë me shëndetësi moderne.

Të pretendosh të kesh shëndetësi moderne do të thotë, të kesh qasje tjetër ndaj problemeve të shumta në këtë sektor. Pikë së pari buxheti i planifikuar për shëndetësi është shumë i vogël dhe nuk premtan se do të ketë përmirësime në këtë sektor jo vetëm këtë vit, por edhe në vitet në vijim. Ky program nuk ka asnjë përcjellje buxhetore, nuk ka as hapa, as dinamikë se si do të realizohet. Mbi 80% të atyre që i quajnë prioritete, ose orientime programore, janë në fakt përsëritje të punës së përditshme dhe zbatim ligjor e funksional i institucioneve që merren me shëndetësi.

Flitet në program për themelimin e qendrave, agjencive, institucioneve, për të cilat as nuk tregohet qëllimi, as koha, as kompetenca, varësia dhe mbikëqyrja e tyre. Edhe në program edhe në paraqitje publike flitet për sistemin informativ shëndetësor, për të cilin Qeveria e Kosovës dhe Ministria, pra që nga viti 2009 po paguan faturën me mijëra euro për internet, ani pse ky sistem nuk ka filluar ende.

Vetëm për Komunën e Prishtinës, Ministria e Shëndetësisë ka paguar 15 mijë euro për internet, për lidhjen me internet me sistemin informativ shëndetësor dhe ky sistem nuk ekziston fare. Madje, Ministria e Shëndetësisë më herët ka blerë hardwarët apo pjesën e fortë të kompjuterëve, ende pa e blerë programin software. Tani, meqë kanë kaluar më se 4 vjet, sigurisht se këto duhet të ndërrohen. Të gjitha këto janë shpenzime milionëshe. Ne kemi kërkuar dhe ende kërkojmë, të bëhet sa më parë informimi i Kuvendit, i Komisionit Parlamentar në lidhje me fondet milionëshe të dhëna nga Qeveria e Luksemburgut për këtë sistem.

Protokollet dhe hartimi i tyre janë bërë temë diskutimi për ministrin e kaluar dhe ende janë të shkruara në programin qeverisës dhe pjesë e deklaratave të ministrit aktual. Nuk e dimë se sa vjet i duhet një Ministrie t'i hartojë protokollet e mjekimit. Çdoherë që kemi pyetur ministrin e Shëndetësisë kemi marrë përgjigje se janë duke u finalizuar. Ne kemi informacione se këto protokolle janë peng i interesave klienteliste, me gjasë mafioze, të atyre që merren me shpërndarjen dhe kontrabandën e barnave.

Prioritetet e Qeverisë për shëndetësi, thuhet se janë të sinkronizuara me prioritetet e strategjisë sektoriale evropiane për shëndetësi 2014-2020, e ne vazhdojmë të jemi vendi i fundit në BE, por edhe në rajon me buxhetin më të ulët në shëndetësi, me vdekshmërinë më të lartë të foshnjave. E kur i shohim prioritetet si i kanë renditur, po ashtu ka një jo seriozitet, sepse Ministria e Shëndetësisë prioritet e ka, që t'i trajtojë fëmijët me leukemi apo me sëmundje malinje jashtë vendit, në vend se të ketë një prioritet të bëjë një strategji të mirëfilltë për specialistë të kësaj

fushe, të krijojë kushte që këta fëmijë të trajtohen në vendin tonë, apo në Qendrën Klinike Universitare, ajo do që këta fëmijë t'i trajtojë jashtë vendit.

Këta kanë vendosur në program prioritet kryesor plotësimin 100% të listës së barnave esenciale dhe materialit harxhues dhe vërtet është skandaloz se si gjendja për listën esenciale, qoftë me material harxhues jo vetëm pacientët që duhet të blejnë barna, por as gaza dhe maska nuk kanë punonjësit shëndetësorë.

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale tash e sa kohë ka vetëm ushtrues detyre. Gjithë kjo agjenci është nën kontrollin e dirigjimin e interesave të klaneve të atyre që kontrollojnë tregun e barnave në Kosovë.

Me këtë program qeverisës për shëndetësi është një paradoks i llojit të vet, kur thuhet: “Sektori privat i farmacistë bashkë me atë të stomatologjisë janë shumë të suksesshme dhe do të merren si shembull edhe për privatizimin edhe të sektorëve të tjerë të shëndetësisë.” Kjo deklaratë është alarmuese. Për çfarë suksesi flasin këta, për përfitimet që kanë kompanitë e barnave, barnatoret private dhe ambulancat private stomatologjike?

Sektori farmaceutik është plotësisht në kaos dhe i pakontrolluar. Në çdo barnatore mund të blihen pa recetë të mjekut të gjitha llojet e barnave, pavarësisht rrezikut që bartin. Barnatoret në Kosovë janë më shumë shitore, se sa barnatore, ndërsa sa i përket shëndetit oral, atë e kemi në gjendje të mjerueshme.

Kosova zë vendin e parë në Evropë me karies të fëmijëve shkollorë. E ju këtë, zoti ministër, e keni marrë si model. Flitet në program për një lidhje e bashkëpunim midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendrës Klinike Universitare dhe Fakultetit të Mjekësisë. Së pari, Ministria e Arsimit dhe e Shëndetësisë duhet ta dimë se gjithë këto vite ka qenë një respektim absolut i interesave klienteliste, qoftë në Fakultetin e Mjekësisë, qoftë në atë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Derisa në disa sektorë kemi mbingarkesë të stafit, ka të atillë që nuk e kanë edhe një specialist të vetëm. Programi qeveritar dhe ata që e kanë shkruar, sigurisht nuk i adresojnë këto çështje, sepse meqë janë në dijeni të kësaj gjendjeje katastrofale, por njerëzit brenda Ministrisë dhe Qeverisë dhe brenda kësaj mazhorance janë të interesuar që kjo gjendje të mbetet e tillë në Qendrën Klinike Universitare.

Prandaj, ata propozojnë vetëm masa të pjesshme, ndryshime dhe rregullime procedurale, por jo strukturale.

Në program flitet për spitalin e Prishtinës. Edhe këtu është një paqartësi. Derisa në nivelin sekondar, në një paragraf, në programin qeverisës, thuhet se Spitali i Prishtinës, do të jetë prioritet, në anën tjetër, në paragrafin e mëposhtëm, thuhet se gjatë ristrukturimit apo gjatë riorganizimit në Qendrën Klinike Universitare, do të jetë mundësia e formimit të Spitalit të Prishtinës brenda Qendrës Klinike Universitare.

Cilit prioritet duhet besuar, zoti ministër? Në këtë program është shpërfillur ajo çfarë është parësore, shëndeti publik. Në një paragraf të vetëm përmenden epidemitë, uji, ajri, toka, pa

squaruar e programuar çfarë do të bëhet me ato, që tashmë janë të rrezikuara në këtë vend, ndotja e ajrit, uji i pijshëm i kontaminuar dhe pa cilësi, si dhe ndotjen enorme nga sektori privat i “Feronikelit” dhe “Sharr-Cemit”.

Për në fund, programi qeverisës LDK-PDK thotë se do të ofrojë mjekë eminentë nga diaspora për të bashkëpunuar në Kosovë. Së pari, zoti ministër, nga Kosova janë larguar 400 mjekë. Së dyti, rastet e pakta që kanë arritur në Kosovë për të ndihmuar, kanë përfunduar si doktor Dalladaku me Qendrën e Kardiologjisë, në oborr të Qendrës Klinike Universitare, e cila u nis si repart brenda QKUK-së dhe përfundoi si SHPK, e cila iu shit Ekrem Llukës, më pastaj Spitalit Amerikan, proces me plot dallavere të përkrahura nga Hashim Thaçi më 2009, të nisura nga kryeshefi ekzekutiv i Prishtinës, më 2006, Sami Hamiti.

Mirëpo, për këto gjëra ju po heshtni, zoti ministër, po ashtu edhe Qendra Klinike Universitare. Kjo është, në fakt, e vërteta e programit tuaj, hegjemonia e PDK-së kundër asaj të LDK-së, logjikë e njëjtë e klane të ndryshme.

Të nderuar deputetë,

Me këtë përmbajtje, ky program i cili më së paku i ngjason programit, do të jetë i dështuar, andaj, qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës, dhashë Zoti të mos sëmureni! Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Edhe pse, pothuajse në të gjitha paraqitjet publike të viteve të fundit, kryeministri aktual Isa Mustafa dhe LDK-ja, ishin përbetuar se në asnjë variant nuk do të qeverisin asnjëherë me PDK-në, një gjë e tillë ndodhi dhe tashmë jemi para një akti të kryer.

Ndërsa, para vetes, deputetë të nderuar, kemi një program qeverisës, i cili realisht nuk premton zhvillim ekonomik, hapje të vendeve të reja të punës, premtime këto të cilat e sollën në këtë pushtet.

Ky program i Qeverisë Mustafa më tepër është program filozofik i Qeverisë Mustafa. Te parimet dhe shtyllat e programit qeverisës, të nderuar deputetë, po i përmend vetëm disa: promovimi dhe vizioni për Kosovën- shtet i pavarur demokratik dhe i integruar në strukturat euro-atlantike - kjo filozofi ishte edhe e Hashim Thaçit.

Por, të nderuar qeveritarë dhe ju kryeministër, vizioni është gjendje për të parë se ku jemi dhe ku duhet të shkojmë e unë po ju them se Qeveria, as nuk po di ku është e as ku po do të shkojë.

Qeveria do të hartojë strategjinë, është shtyllë tjetër, Qeveria thotë, do të hartojë strategjinë kombëtare të zhvillimit të Kosovës duke bërë që për herë të parë në historinë e saj, pra këtu thirret me pompozitet shumë të madh, të hartojë një strategji që nuk është, pra e cila nuk është e mjaftueshme, pra ne e shohim që nuk është e mjaftueshme për një zhvillim ekonomik dhe, fokus i kësaj strategjie, thonë në program, është ta stimulojë rritjen ekonomike. Se si të stimulohet, nuk e di se dikush ka mundur të shohë diçka.

Pra, këtu është dashur, ju kryeministër, ta bëni të qartë në këtë program edhe për qytetarët e vendit e jo vetëm për ju si ekonomist i diplomuar, për ta kuptuar vetë.

Më tutje shkruan se strategjia do të nxjerrë në pah rëndësinë e potencialit të kapitalit njerëzor, që ka Kosova. Shihni, kanë menduar që po bëjnë një zbulim epokal, këtu. Deri sot nuk e kanë ditur çfarë potenciali ka, pra Kosova.

Tek zhvillimi ekonomik, punësimi dhe mirëqenia, a keni bërë ju, zoti kryeministër, një analizë se sa ka ndryshuar gjendja e qytetarëve në këtë periudhë prej 100 ditësh të qeverisjes suaj? Unë them, që nga ato që i shohim çdo ditë tek qytetarët tanë, gjendja e tyre ekonomike po vështirësohet çdo ditë e më shumë. Dhe, çka është më e keqja në këtë program nuk kanë as shpresë, se do të ndryshojë kjo gjendje derisa ju të jeni kryeministër.

Zoti kryeministër,

Programi juaj, që nga fillimi deri në fund filozofik dhe i thatë, hartimi i tij pa hyrë në periudha kohore, se kur do të fillojë dhe të përfundojë realizimi i atyre premtimeve, që ju keni bërë, është vetëm një dështim i radhës.

Për ta deshifruar këtë, pra, po e paraqes dhe po e deshifroj matematikisht. Askund, të nderuar deputetë, nuk e kam gjetur që në këtë program dy dhe dy bëjnë katër, po herë tre e herë pesë. Ju kujtohet, kur unë i kisha bërë një pyetje kryeministrit, më pat thënë, mësoji numrat. E unë tash, po i them kryeministrit, i nderuar kryeministër, numrat janë ata që nuk njohin gjuhë, është mirë me i ditë numrat, e tash po dihet se kush nuk i di numrat. Pra, thjesht, është dashur të ketë numra në këtë program, është dashur të ketë shifra në këtë program, për ta kuptuar të gjithë qytetarët e jo më ne si deputetë.

Qytetarët kanë pritur, që në 100-ditshin e qeverisjes suaj të kuptojnë sa njerëz janë punësuar nga 120 mijë vende pune të premtuara nga ju, po edhe nga 200 mijë vende pune të premtuara nga zoti Hashim Thaçi, sepse jeni në koalicion, e që bëjnë gjithsej pra, 320 mijë e që për 100 ditë i bie me matematikë, është dashur të punësohen 10 mijë e 15 qytetarë. Qytetarët kanë nevojë të dinë, pra se kur do të fillojë, në fakt e dinë kur ka filluar rruga Prishtinë – Pejë, por nuk e dinë dhe nuk do ta dinë asnjëherë se kur do të përfundojë, e këtë duhet ta dinë. Qytetarët, gjithashtu kanë nevojë ta dinë se kur përfundon rruga Prishtinë - Mitrovicë.

Në program kërkoni nga bashkatdhetarët tanë, që jetojnë në diasporë, që të përfshihen aktivisht në zhvillimin ekonomik të vendit, keni kërkuar edhe që në ditën e parë, duke thënë se 500 milionë euro vijnë nga diaspora. Po kryeministër, kjo është e vërtetë, ndoshta edhe mbi 500 milionë, por po kërkoni shumë nga ata, se jeni mësuar të kërkoni vazhdimisht e unë po ju them, që nuk mund t'i obligoni, sepse ata kanë një barrë shumë të rëndë, kanë pasur familje këtu dhe, besa tash për fat të mirë që janë atje, po merren shumë edhe me ata 100 mijë apo 50 mijë, sa të doni, që është plagë e dhembshme e Kosovës, që shkuan, ikën nga Kosova, pikërisht prej zhgënjimit që ju ishit në krye të Qeverisë.

E unë ju them, çka ju po bëni për diasporën? Vetëm një detaj të vogël po e përmend, asgjë deri më tani, por, po e përmend se vetëm 5% e fëmijëve të bashkatdhetarëve tanë janë të përfshirë në shkollat shqipe. Funksionalizimi i zonave të lira, edhe sot e kësaj dite, prej kur ishte kryeministër

Hashim Thaçi, unë nuk e kam ditur, po edhe shumë qytetarë më kanë pyetur, bre, çka do të thotë ky koncept “zonë e lirë”, e unë po i them kryeministrit, sot është mirë për t’u treguar qytetarëve të Gjakovës, të Prizrenit, të Mitrovicës, të Drenasit, se çka kupton me konceptin “zonë e lirë”, çka përfitojnë ata qytetarë?

Tash kryeministri duhet t’u përgjigjet, sepse e ka obligim.

Po ndalem edhe pak tek çështja e arsimit. Këtu kemi të bëjmë me një vazhdimësi të politikave ‘ad hoc’, pa plan veprimi dhe pa objektiva kohore të përcaktuara qartë. Programi merret me synimin dhe angazhimin në stilin - Qeveria e Republikës së Kosovës synon që të ndërtojë një shoqëri të dijes. Kjo frazë, më besoni, është përsëritur prej 2008-ës.

Mësimdhënësit kanë nevojë të dinë se ku mbetën përvoja e punës, e cila edhe 16 vjet pas luftës nuk po u njihet. Mësimdhënësit e pensionuar kanë nevojë të dinë, se përvoja e tyre prej 40 vjetësh, sot po vlen diku rreth 50-60 euro, për të mos u hyrë në hak, sepse pensioni bazë i dinë që ju takon pas moshës 65-vjeçare. Do të thotë, vlera e tyre për 40 vjet që shkolluan, edukuan gjenerata e edhe neve, vlen diku edhe nga Qeveria e kaluar, po edhe nga kjo Qeveri, diku 50 – 60 euro.

Tek gjithë përfshirja, model besa, e keni pasur Aleancën e u kisha thënë edhe atyre të LDK-së, që e kanë përmendur dje, sikur t’i kishin marrë model 100 ditë, hiq s’kishin mundur, jo kishin gabuar, por kishin pasur çka të ndërtojnë. Tek gjithë përfshirja, pa u bërë nervoz ju PDK-ja dhe LDK-ja, se jeni shumicë, faktet flasin se në arsimin parashkollor, çerdhe dhe kopshte, moshë nga 0 – 5 vjet, janë të përfshirë vetëm 3% të fëmijëve, për ta kuptuar ju, janë të përfshirë vetëm 3% të fëmijëve e që është shifër më e ulët në Evropë, po i referohem Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, 2014.

Situatë e njëjtë është edhe në arsimin parafillor, moshë pesë deri në gjashtë vjet, ku sipas Ligjit të arsimit parauniversitar, pra që nga viti 2015, që jemi në këtë vit, është i obligueshëm e që janë pa përfshirë rreth 8 mijë fëmijë. Tek qasja e barabartë, gjithashtu, kur flasim për përfshirje simbolike të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të grupeve të marginalizuara, si dhe për braktisje të përmasave të mëdha të arsimit të detyruar.

Sa u përket planprogrameve shkollore korniza e re kurrikulit të Kosovës është paralajmëruar të zbatohet, që nga viti 2011-2012, por ende është në procesin e pilotimit me shumë pak shans që të zbatohet. Në shkollat profesionale, sot e kësaj dite, ka mungesë të teksteve shkollore, ku mësimdhënësit ende diktojnë. Premtimet për digjitalizimin e shkollave, premtim i njohur qysh nga ish-ministri Enver Hoxhaj, besa edhe premtim i Hashim Thaçit, që kur u shtronte darka mësimdhënësve, pra u premtonte vazhdimisht, është përmendur fuqizimi i Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, kurse në krye të kësaj agjencie është emëruar, pa konkurs, ish-këshilltari i ministrit Ramë Buja.

Parashihet rritje e cilësisë në arsimin e lartë, përderisa në krye të Agjencisë, merreni me mend, është një zonjë Fetije Zhushi, e cila edhe sot e kësaj dite është në hetime dhe, ky mekanizëm, pra mendoni se si mund të dalë e të tregojë një performancë të lartë. Pra, moralisht do të duhej të

jepte dorëheqje, atëherë gjykata, institucionet do ta vërtetonin a është e fajshme apo jo, por kjo nuk po ndodh derisa jeni ju në pushtet.

Flitet për forcimin e lidhjeve në mes të institucionit të arsimit të lartë dhe ekonomisë, kurse rrjeti i këtyre institucioneve është në shpërputhje totale me nevojat e tregut të punës. Si përfundim, se kisha edhe shumëçka, por po e lë, të gjithë ata qytetarë të Kosovës që kanë besuar në këtë koalicion, me të drejtë sot janë të zhgënjyer, ngase në asnjë moment nuk gjejnë zgjidhje të qëndrueshme dhe konkrete në këtë program të Qeverisë, Isa dhe Hashimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Mendoj u tha mjaft, neve na mbetet t'i reduktojmë edhe ato që i kishim ndërmend, të nderuar kolegë deputetë, kryeministër, ministra.

Në dispozitat e saj themelore Kushtetuta e vendit saktëson, që Republika e Kosovës, qeveriset në mënyrë demokratike përmes institucioneve të veta.

Kuvendi që ushtron funksion legjislativ e jo veç kontratë mbi qeverinë, thotë, gjithëherë duke pasur parasysh së pari t'i kryejë funksionet e veta, qeveris me rolin e saj ekzekutiv dhe natyrisht, gjyqësorit të pavarur. Për këtë secili e ka rolin e vet të madh dhe të pamohueshëm.

Unë sot do të isha ndalur te obligimet tona përballë ekzekutivit, sa ndikon mospuna e Parlamentit në mosfunksionimin e shtetit dhe vështirësive, që ua shkakton ajo edhe Qeverisë edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më konkretisht, atë që dua të them në këtë rast, janë çështje që prekin direkt Komisionin Parlamentar, për të cilin unë kam marrë përgjegjësi në këtë mandat, të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, të Pagjetur dhe Peticione. Ky Komision ka kohë që ka pranuar peticione të ndryshme dhe, do të kisha përmendur që ka ardhur nga punëtorët e "Grandit", i cili petition flet ndoshta për shumë probleme që janë deponuar në mungesë të anëtarëve të Bordit të AKP-së. Dhe, në këtë drejtim po ashtu, petitioni tjetër i cili flet për shtrenjtimin e energjisë elektrike, të cilin do ta keni edhe sot për 32 mijë nënshkrime të qytetarëve dhe po ashtu, ky petition konteston vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, në mungesë të kuorumit për të marrë vendime.

Mendoj se ky Kuvend duhet ta ketë parasysh, që t'i kryejë obligimet e veta, në mënyrë që të mos ketë ngecje në agjendat të cilat pengojnë edhe punën e vet ekzekutivit edhe tonën në përgjithësi dhe shumë borde tjera, të cilat kanë mbetur të paplotësuar, si dhe dje ne po ashtu, edhe me ikjen e vetë deputetëve të tyre, që kanë iniciuar këtë debat, ka dështuar edhe zgjedhja e Avokatit të Popullit.

Prandaj, do të ishte mirë që të vazhdohet me punën dhe detyrat të cilat na takojnë.

Dje, ministri i Kulturës i prezantoi problemet që has kjo ministri vazhdimisht në punën e vet, pikërisht edhe për shumë çështje dhe mospërkrahje politike, që ka e kjo edhe përkundër faktit të politizimit të skajshëm që i është bërë trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Mungesa e Këshillit Nacional për Trashëgimi Kulturorë bën që Kosova të mos e ketë ende listën e përhershme të trashëgimisë, që është tepër e pafalshme për një shtet, të mos ketë listën dhe në çka do t'i bazonte ajo resurset e veta apo potencialin e vet të trashëgimisë kulturore.

Kjo ministri vazhdon të kryejë mirë detyrat e veta, është mirë të mos i pengojë ministrin në qasjet e veta provinciale, apo me interesa më të ngushta, është mirë t'i ndihmojë atij në punën e vet tek anëtarësimi i mekanizmave ndërkombëtare, siç është ai në UNESCO, nga se vërtet një politizim i trashëgimisë më tutje po shkakton edhe shumë dëmtime të saj.

Natyrisht se Qeveria i nënshtrohet kontrollit parlamentar, por është tejet e rëndësishme t'i ndihmojmë asaj, që t'i vendosë lart në agjendën politike edhe çështjet e ndjeshme. Në këtë rast, si Komision për të Drejta të Njeriut kishim kërkuar adresimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, insistim më i madh për të pagjeturit, mbështetjen ligjore të viktimave të dhunës e të trafikimit dhe tek barazia gjinore, i nderuar kryeministër, është mirë të shikohen mjaft... ju keni agjenci dhe mekanizma të ndryshëm, disa kanë mbetur relikte të administrimit të UNMIK-ut dhe, mendoj këto mekanizma, jo që bashkëpunojnë, por i krijojnë paralelizma njëra-tjetrës, e aq më tepër, e shpenzojnë buxhetin e Republikës së Kosovës.

Është mirë në amendamentim të ligjeve që vijnë tani, ne do t'i shikojmë këto, po edhe ju si Zyre të shihni që nuk ka nevojë të mbahen zyrë mbi zyrë pa punë konkrete.

Dhe për fund, Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës, bashkë, të bëjnë më shumë në respektimin e të drejtave të shqiptarëve edhe në vende fqinje, standarde të njëjta nga faktori ndërkombëtar dhe kjo edhe gjatë bisedimeve dhe gjatë prezantimeve tona në shumë nisma rajonale, në konferenca të ndryshme e që nganjëherë, ndoshta shkojmë e flasim edhe atje me gjuhë opozitare, pra duke harruar që prezantojmë shtetin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Do të fokusohem në dy aspekte, ose dy shtylla të qeverisjes. E para është ajo e Administratës Publike, e cila vazhdon të mbetet një nga hallkat e qeverisjes, që ka nevojë për ndryshim rrënjësor dhe përmirësim thelbësor.

Por, në programin qeverisës asaj i është kushtuar vetëm një faqe e gjysmë. Problemet me të cilat ballafaqohet Administrata Publike, njëri ndër më të mëdhenjtë vazhdon të mbetet politizimi i tejskajshëm i saj dhe, kjo tashmë është theksuar në disa raporte, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Por në fakt, kjo çështje pothuajse nuk është adresuar fare në programin qeverisës.

Ajo përmendet në faqen 38 dhe titullohet "Vazhdimi i reformës së Administratës Publike". Pra, çdoherë kur flitet për Administratën Publike, gjendet pranë saj edhe fjala: "reformë" edhe "strategji" por në fakt Qeveria e kaluar ka harxhuar mijëra euro në hartimin e një strategjie të tillë, për të cilën nuk dimë se çfarë po ndodh. Bile, disa nga zyrtarët e Qeverisë kalonin më shumë kohë në Durrës, në vilën Belvederë, se sa në zyrat e tyre në Qeveri. Mirëpo, tani nuk po

dimë se çfarë ndodhi me këtë reformë, me këtë strategji, sepse tash në program po flitet për hartimin e një strategjie të re.

Por, edhe këtu nuk flitet se cilat janë objektivat e kësaj reforme dhe deri kur, derisa është përmbushur, edhe sa para duhet të harxhohen nga buxheti i varfër i shtetit, për hartim të strategjive të tilla, e të cilat në fund prapë po mbetin në sirtarët e zyrave nëpër Qeveri.

Ndonëse është vetëm një faqe e gjysmë e programit, ku flitet për administratën, sërish ka një mospërputhje. Përderisa në fillim thuhet, se është plotësuar korniza ligjore për avancimin e proceseve në Shërbimin Civil, në strategjinë legjislative të Qeverisë, që ne e kemi miratuar, janë të paktën 10 ligje, të cilat e prekin Administratën Publike, përfshirë këtu edhe Ligjin për Administratën Shtetërore.

Po ashtu, ky program nuk ka përputhje edhe me Ligjin për Buxhetin. Për shembull, Qeveria në këtë program flet për digjitalizim të shërbimeve, por më duket kemi harruar se kur është miratuar buxheti, i është zvogëluar Ministrisë së Administratës Publike dhe atë, duke i prekur ose duke i hequr fare financimin e projekteve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, e cila është përgjegjëse për zbatimin e këtyre projekteve, do të thotë projekteve që kanë të bëjnë me digjitalizimin e shërbimeve.

Dhe, një çështje tjetër është fakti se as edhe një fjalë e vetme në programin qeveritar, nuk flitet për qeverisjen lokale. Është e qartë, se komunitat kanë pavarësi në ushtrimin e funksioneve të tyre, megjithatë ne kemi një ministri të tërë, e cila merret me administrimin e pushtetit lokal. A do të thotë kjo, se pasi që aktualisht nuk kemi në detyrë ministër të Administrimit të Pushtetit Lokal, ne nuk kemi as plan qeveritar, se si do t'i adresojmë çështjet që kanë të bëjnë me pushtetin lokal. Në një raport të zëvendësministrit Gecaj, tek Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, ai ka përmendur se Ministria është duke hartuar një strategji dhjetëvjeçare për reformën e pushtetit lokal.

Hartimi i kësaj strategjie a është synim i Qeverisë dhe pjesë e programit qeveritar apo kjo Ministri po e bën këtë krye më vete? Nga kush dhe si qenka marrë vendimi për reformimin e pushtetit lokal, nëse një gjë e tillë nuk është fare pjesë e programit qeveritar? Tani, siç e thashë, kjo reformë u prezantua tek Komisioni nga zëvendësministri Gecaj, sepse po të prezantohej nga ministri Lubomir Mariq, e meqë ra fjala, ne nuk e dimë ende a vazhdon të mbetet ministër në këtë kabinet apo jo dhe, pasi që ai më shumë po i përgjigjet kryeministrit Vuçiq, sesa kryeministrit Mustafa dhe, nuk e dimë zëvendësministri Gecaj po ashtu nëse e ka njoftuar Qeverinë për hartimin e kësaj reforme, apo edhe ky ka harruar se tash punon për Ministrinë e për Qeverinë e jo për ambasadën, për të cilën ka punuar më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvaženi premijeru,

Predstavnicu Vladinog kabineta,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Nadam se da će buduća vlada ispoštovati napokon sve one probleme koje ima bošnjačka zajednica u kosovskom društvu iako smo po broju stanovnika na trećoj poziciji, odmah posle albanske nacionalne zajednice i srpske nacionalne zajednice, ali nismo integrativni deo Kosovskog društva onako kako bi trebalo po zakonu i ustavu Republike Kosova.

Uvaženi premijeru, želim da vam sugerišem samo na određene globalne probleme, sa kojima se suočava bošnjačka zajednica a odnosi se na proces decentralizacije, odnosno na lokalnu samoupravu iako ispunjavamo sve adekvatne uslove i kriterijume, koje ministarstvo za lokalnu samoupravu traži od jedne geografske površine. Opština Rečane i opština Vitimirica i dalje čekaju taj problem, već 15 godina posle rata.

Zašto je to tako i koji je vaš plan u budućem periodu?

Zatim želim da, s obzirom da je ovde danas prisutan i ministar za obrazovanje, želim da iskoristim priliku, gospodine Bajrami, da malo više skrenete pažnju na naše učenike, odnosno na problem udžbenika, to jest samo 50 hiljade evra. Naši srednjoškolci i dalje nemaju knjige, bez obzira što smo u dva mandata imali zamenike ministre ispred bošnjačke zajednice, taj problem uopšte i dalje je nepokretan i nerešiv. Zašto je to tako?

Problem oko nostrifikacija diplome, nadam se da ste u toku rešavanja tog problema sa gospodinom premijerom a ono što najviše interesuje našu zajednicu i najveći problemi sa kojima se suočavamo jeste velika nezaposlenost naše populacije, što direktno utiče na migraciju našeg stanovništva, odnosno ne poštuje se zakon o zaposlenosti manjinskih zajednica u kosovskom društvu u javnim institucijama.

Takođe moja sugestija je, zahvaljujem se uvaženom premijeru na dobijanje ministarstva, koje je po prvi put dobila bošnjačka zajednica iako je to ministarstvo bez portfelja bez velikog budžeta i pomoći društvo iako je bez velike nadležnosti i odgovornosti, iako je bez velikog doprinosa celokupnom našem sistemu, želim vam samo skrenuti pažnju, gospodine premijeru, da malo više obratite pažnju oko uzurpacije poštovanog ministra gospodina Rasima Demirija. To nije privatna firma i ne mogu se zapošljavati samo ljudi iz njegove političke opcije.

Nadam se da ćete to imati u vidu! Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë nuk do e zgjas shumë, meqenëse edhe deputetët më duket se janë mërzhitur, sidomos ata të cilët kanë kërkuar këtë debat dhe shumica e gjërave u thanë.

Së pari, dua t'ju përgëzoj juve, zoti kryeministër, për ekspozenë e dhënë dhe, i cili ishte një ekspozitë shumë e mirë dhe të cilin e përkrah, që në mënyrë shumë gjithëpërfshirëse e përmbledhi gjithë programin e juaj qeveritar dhe punën 100-ditëshe.

Unë nuk dua të ndalem shumë në programin, dua vetëm t'i jap disa vërejtje të mia në lëmin, të cilin mendoj se jam kompetent për të dhënë ndonjë vërejtje, në lëmin e shëndetësisë dhe atë shumë shkurt.

Në program janë shumë mirë të parapara prioritetet, siç është themelimi dhe funksionimi i Fondit për sigurime shëndetësore dhe unë në këtë moment përkrah arsyetimin tuaj për shtyrjen e hyrjes në fuqi të këtij fondi dhe implementimit të fondit, me arsye të cilat i dhatë. Por, mendoj se shtyrja e mëtutjeshme pas vitit 2016, pas një janarit 2016, është shumë e dëmshme.

Së dyti, si prioritet i juaji kryesor, meqenëse unë nuk vij nga zyrat, por vij nga spitali, ku përditë ballafaqohem me problemet, problemi kryesor është mosfunksionimi i sistemit informativ shëndetësor, i cili është një burim i të gjitha të metave, mendoj në planifikimet, si në harxhimin e barnave, si në planifikimet e resurseve humane dhe planifikimin në infrastrukturë.

Dhe, si vërejtje e imja e tretë, ishte që të filloni sa më herët të punoni në lidhje me përgatitjen e spitaleve dhe institucioneve tona shëndetësore për licencim dhe akreditim, sepse kjo është një punë shumë e mundimshme, e madhe dhe e gjatë dhe kërkon punë të punëtorëve shëndetësorë, të cilët punojnë në institucionet shëndetësore dhe nuk mund të bëhet vetëm në ministri dhe nëpër zyra.

Këtë po e them nga përvoja ime, sepse kemi punuar me një Agjenci gjermane për akreditimin dhe licencimin e spitaleve për gjashtë muaj në spitalin e Prizrenit dhe e kemi parë se sa është një problem i rëndë, i cili kërkon mund dhe angazhim të madh. Dhe, duhet t'ju njoftoj, të gjithë juve dhe qytetarëve, se shëndetësia kosovare nuk vuan nga profesionalizmi dhe në procesin e licencimit dhe akreditimit të spitaleve, problemet kryesore janë në infrastrukturë dhe mungesën e protokolleve të trajtimit të pacientëve dhe të protokolleve lidhur me lëvizjen e pacientëve, bartjen e pacientëve, diagnostikimin e pacientëve dhe kushteve tjera higjienike-sanitare nëpër spitale, të cilat mungojnë.

Këto janë problemet kryesore të cilat pengojnë licencimin dhe akreditimin e spitaleve. Kërkoj falje në qoftë se s'jam dëgjuar.

Dhe, nuk dua të zgjatem atje thashë, por unë s'dua as të jap këshilla, por e di se është e drejtë dhe kushtetuese edhe sipas Rregullores së Kuvendit, që delegatët të kërkojnë debate, të kërkojnë interpelancë për probleme të ndryshme, të cilat i preokupojnë qytetarët. Por, nuk është mirë që këto debate dhe interpelanca të kërkohen, që në ato debate të përgatiten fjalime të thata, fjalime politike, të cilat nuk kanë fare të bëjnë me problemin të cilin e kanë parashtruar. Mendoj, se të gjithë sot jemi dëshmitarë këtu, se 90% të diskutuesve nuk i janë përmbajtur rendit të ditës dhe nuk i janë përmbajtur çështjes të cilën kanë ngritur dhe, çështja të cilën ata kanë ngritur është puna 100-ditëshe e Qeverisë. Dhe, unë po them 90% po 99% të diskutuesve nga opozita nuk i janë përmbajtur kësaj dhe kanë diskutuar çështje teorike, të cilat nuk kanë fare të bëjnë me debatin.

Por, thërrasin debate për të përgatitur fjalime politike, të gjata, shterpe, të thata dhe të cilat nuk kanë asnjë përmbajtje dhe nuk i duhen aspak qytetarit. Nuk përmirësojnë kurrgjë në jetën e qytetarëve, nuk përmirësojnë kurrgjë as në qeverisje. Ju dhe ne, të gjithë, kur të kërkojmë debate

dhe është detyrë edhe e delegatëve të pozitës, jo të opozitës, që të kërkojnë debate, por në ato debate duhet t'i përmbahen rendit të ditës dhe të japin alternativa për problemin, të cilin e kanë ngritur e jo vetëm të mbajnë fjalime politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, por deputetët diskutojnë atë që mendojnë, sidoqoftë, fjalën e ka zoti Mytaher Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar qytetarë,

Deputetë,

Kabinet qeveritar dhe Kryesi e Kuvendit,

Për herë të parë po diskutoj para një numri ministrash, këtu. Pikë së pari, çështja është diskutimi i 100 apo momentalisht janë 114 ditë pune të qeverisjes.

Domethënë, programi qeveritar është një pjesë, domethënë një dokument i cili është bërë gjatë kësaj periudhe dhe normalisht, që do të diskutojmë këtë. Po ashtu, ne shumica e deputetëve po diskutojmë programin qeveritar në mungesë të punës praktike, domethënë në mungesë të punës e cila është bërë, normal, po diskutojmë vetëm ato që e kemi parë e i vetmi send që e kemi parë deri tash është programi qeverisës, i cili na u dha para dy javësh.

Tash nëse i kthehemi, domethënë 100-ditëshit, siç thashë, unë do të koncentrohem vetëm në çështjen e punësimit dhe mirëqenies sociale.

Pra, nuk do t'i them kritikën e njëjta për pjesë të ndryshme, por vetëm për aspektin e punësimit dhe mirëqenies sociale, të cilën edhe kryeministri e përmendi si prioritet qeveritar në fjalimin e tij. Nëse shikojmë këtë pjesë në 113 ditë të kaluara, Qeveria nuk ka bërë asgjë pos fjalimit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavilecit, i cili tha që për të pasur mirëqenie sociale, familjet e varfra nuk duhet të bëjnë fëmijë, e para.

E dyta, tha që për të luftuar papunësinë duhet të bëhet planifikimi i familjes dhe të kemi më pak fëmijë, më pak qytetarë. Dhe, në një anë tjetër, po shohim që numri i qytetarëve po na bie, prandaj Qeveria në një farë aspekti po punon në uljen e papunësisë, duke i çuar qytetarët jashtë Kosovës. Ky ishte aspekti i asaj çka ka bërë Qeveria në 100 ditët e fundit për punësimin e qytetarëve dhe mirëqenien e tyre, ndërsa në aspektin e programit, nëse analizojmë programin për këto dy pika, mund të themi që në çdo vend të botës, programi qeverisës përmban premtime elektorale të partive qeverisëse. Këtë foli kryeministri herën e kaluar, tha që në çdo vend demokratik të botës, Qeveria bën kështu apo ashtu, por në çdo vend demokratik dhe normal të botës, programi qeverisës përmban premtimet elektorale të partive qeverisëse, ndërsa tek ne kjo nuk ndodh. Domethënë, nuk kemi asgjë nga premtimet elektorale, të cilat këto dy parti kanë paraqitur gjatë procesit elektoral.

Në vende normale programi qeverisës duhet të përmbajë dokument ku qytetarëve të tij i tregon se çka do të bëjë Qeveria gjatë mandatit katërvjeçar, me qëllime të qarta, të detajuara me indikatorë, pra ku do të jemi pas katër vitesh qeverisjeje.

Lëre që ne nuk dimë se ku do të jemi pas katër vjetësh në aspektin e qeverisjes, po ne nuk dimë se ku gjendemi momentalisht. Nuk kemi asnjë matje fillestare, nuk kemi shifrat e papunësisë,

nuk kemi shifra të varfërisë, nuk kemi shifra se sa i nevojitet një familjeje për të mbijetuar, e kështu me radhë.

Pastaj, programi qeverisës duhet të përmbajë politika, aktivitete, buxhet të përafërt, në të cilat do të arrihen qëllimet e parashtruara. Programi po ashtu, domethënë në pjesën e punësimit dhe në pjesën e mirëqenies sociale nuk ka asgjë lidhur me aktivitetet apo politikat, që do të bëjë Qeveria për këto dy çështje.

Nëse marrim pjesën - Fondi për investime dhe punësim, e cila është një faqe e gjysmë, nuk ka asnjë qëllim dhe asnjë indikator dhe as matje fillestare e as aktivitete apo politika, se si do të bëhet kjo.

Nëse i kthehemi pjesës së Fondit për investime dhe punësim, nuk tregohen se ku do të bëhen investimet, nuk tregohet se ku do të merret fondi, nuk tregohet se sa do të rritet punësimi me këtë fond. Unë supozoj se do të jetë diku rreth 160 mijë vende pune, ngase PDK-ja ka premtuar 200 mijë vende pune, ndërsa LDK-ja 120 mijë, ndërsa mesatarja e tyre duhet të jetë 160 mijë, por, kjo është dashur të shënohet në programin qeverisës.

Po ashtu, këtu kur flasim për fondin, nuk tregohet se fondi nga do të merret ky fond ose sa i varur duhet të jetë fondi. Gjatë fushatës zgjedhore PDK-ja pat thënë, se fondi do të jetë diku rreth 2 miliardë, por nga do të merren këto 2 miliardë, këtë ne vetëm mund ta supozojmë, ngase programi i Qeverisë nuk shënon kurrëgjë këto dy pika.

Në aspektin e investimeve, ku do të bëhen këto investime? Unë duke lexuar këtë pjesë të programit e pash aty që do të fondi do të përkrahë sektorë strategjikë. Cilat janë këta sektorë strategjikë, të cilët Kosova i ka e të cilët do të zhvillojnë punësimin, nuk shënon në program. Besoj që as Qeveria nuk din cilat janë sektorët strategjikë.

Për pjesën për mirëqenie as nuk po flasim. Këtu i kemi tri faqe, të cilat janë më shumë shkrim skizofrenik, mund të them, ngase tri faqe e gjysmë është një “copy - paste”, ku thuhet politika sociale, mirëqenia sociale dhe solidariteti ndërsqojëror, por brenda asaj nënpika nuk ka kurrëgjë për këto.

Në njërin prej nëntitujve shënon se Qeveria do të angazhohet, që asistenca sociale t’i plotësojë nevojat elementare. Mënyerisht, sipas buxhetit të paraparë për sivjet edhe sipas të gjitha gjërave që janë bërë, për një familje asistenca sociale është 65 euro, për një familje 4-anëtarësh. Nëse e ndajmë këtë për 30 ditë, kjo do të thotë sigurohet 2 euro për një person, nëse e ndajmë për çdo person, atëherë do të thotë 50 centë për ditë për një person. Çfarë dinjiteti ose çfarë nevojë elementare mund t’i plotësojë një person me 0,50 centë? Mund të pijë një makiato dhe aq.

Pra, siç thashë edhe në këtë pjesë nuk ka indikatorë, nuk ka matje fillestare, nuk ka qëllime, nuk ka as politika dhe aktivitete se si do të adresohet mirëqenia e qytetarëve në katër vjetët e ardhshëm.

Prandaj, unë duke u bazuar në këtë program qeverisës, po i them Qeverisë që të mundohuni të punoni më mirë programin, rivedojini ato, nuk është vonë. Shënoni qëllimet që doni t’i arrini për

katër vjet, shënimi indikatorët, po nën ato shënimi edhe aktivitetet se çka doni të bëni për të arritur atë qëllim. Çka duhet bërë për ta rritur punësimin ose për të arritur mirëqenien sociale?

Si ju thashë, unë nuk kuptova kurrë nga ato 3 faqe e gjysmë të mirëqenies sociale apo 1 faqe e gjysmë për Fondin për investime dhe punësim.

Së fundi, programi qeverisës do t'u ndihmojë edhe juve në punën tuaj të përgjithshme. Do të thotë do të keni më lehtë të punoni, do të dini se ku jeni, cilat aktivitete i keni bërë dhe cilat aktivitete do t'i bëni në të ardhmen. Kjo është mirë edhe për ju, por edhe për qytetarët që nesër a pasnesër të mund të kërkojnë llogaridhënie, por edhe për juve për t'i adresuar kritikën dhe nesër a pasnesër kur dikush thotë pse nuk e keni bërë këtë, i keni arsytet dhe mund t'i shpalosni se çfarë keni paramenduar me ato pika.

Kjo, normalisht se mund ta revidoni këtë program, nëse me të vërtetë qëllimi juaj është që të krijoni vende të reja të punës dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ju falënderoj për konsideratë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Kolege deputete dhe kolegë deputetë të nderuar,

Në këtë debat i cili po vazhdon nga dita e djeshme, përveç se kemi të debatojmë, po debatojmë dhe për 100-ditëshin e punës së kryeministrit Mustafa, e kemi edhe fushën tjetër të cilën dje kryeministri e paraqiti, edhe programin qeverisës gjatë këtij mandati.

Por, para se të ndalem, qoftë te puna e kryeministrit gjatë 100-ditëshit apo plan-programit qeverisës, unë mendoj që edhe ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës apo në përgjithësi si Kuvend i Kosovës, duhet të jemi më aktivë dhe në nivel të përgjegjësisë më të madhe, për faktin se duhet të kërkojmë më tepër llogari dhe transparencë nga Kabineti qeveritar. Pra, unë i propozoj drejtpërdrejt Kryesisë së Kuvendit, që një ditë në javë, qysh se është e caktuar e dita e enjte për pika të ndryshme dhe projektligje të ndryshme, të caktohet një ditë në javë, për shembull mund të jetë ditë e mërkure që çdo ministër të raportojë para deputetëve për punën në kabinetin e tij, kështu që do të ketë mundësinë që një ministër së paku gjatë një sesioni vjeshtor të raportojë një herë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Në këtë mënyrë, ne do ta mbajmë më aktive edhe Qeverinë edhe do të kërkojmë më shumë llogari dhe transparencë se sa të lihet vetëm kur inicion ndonjë grup parlamentar.

Prandaj, i propozoj drejtpërdrejt Kryesisë së Kuvendit, të caktojë një ditë në javë për raportimin e secilit ministër, një herë në javë nga secili, ngase ne e pamë, shpejt na përfshiu plogështia dhe dje, ende pa u bërë ora 19, veç përfundoi debati. Pra, unë mendoj që ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës, pavarësisht të ardhurave të majme që i marrim dhe privilegjeve të ndryshme, nuk po jemi në gjendje më shumë se një seancë në javë dhe atë kur bëhet ora 19 po dorëzohemi para kohe dhe, duke pasur që puna e deputetëve apo e parlamenteve në rajon është shumë më aktive dhe dinë të zgjasin edhe pas orës, pasmesnatës.

Në anën tjetër, kur jemi te puna e 100-ditëshit të kryeministrit Mustafa dhe plani qeverisës, unë mendoj se është një fazë shumë fillestare, shumë e hershme, dhe ndoshta të lëshohemi në kritika për faktin se i kemi vetëm 100 ditë të kaluara.

E para se të kaloj në fazën e kritikave, unë kam propozime apo këshilla konkrete për kryeministrin Mustafa, fillimisht duke filluar nga Kabineti i tij, kërkoj që qysh në fillim, pasi që është fillim i mandatit të tij, me automatizëm ta ndërpresë emërimin e zëvendësministrave nëpër ministri të ndryshme, ngase jam plotësisht koshient dhe i vetëdijshëm se kryeministri Mustafa e din një gjë të tillë, se zëvendësministrat pothuaj se nuk kanë fare rol ekzekutiv në proceset vendimmarrëse. Pra, ata janë më shumë për plotësimin e apetiteve partiake se sa për fuqi vendimmarrëse, dhe një zëvendësministër i kushton buxhetit të Kosovës në muaj, me kabinetin e tij, 2 000 deri në 3 000 euro, e që në vit paraqet një shumë deri në 2 milionë euro, prandaj gjatë elaborimit të temës më tepër, mund të jap edhe propozime konkrete se ku është më mirë të alokohen ato mjete, prandaj kërkoj nga kryeministri që së paku në këtë fillim të mandatit të ndalojë emërimin e zëvendësministrave të mëtutjeshëm.

Sa i përket punës dhe programit qeverisës, unë mendoj se për këtë Qeveri dhe Kabinet qeveritar, sfidë kryesore në këtë mandat lufta kundër krimit të organizuar e cila njëherit është edhe kërkesë e Bashkimit Evropian, duke i pasur parasysh se në vitet e kaluara, çdo vit me radhë, kemi parë nga Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian se Kosova, fatkeqësisht ballafaqohet me shkallë të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend, prandaj unë mendoj se kjo mbetet sfida kryesore e kësaj Qeverie, përkrah sfidës tjetër që është zhvillimi ekonomik i vendit.

E shfrytëzoj edhe prezencën e ministrit të Punëve të Brendshme, që ta inkurajojë për punën që e ka bërë javën e kaluar me arrestimin e një grupi fajdexhinjsh në komunën e Vushtrisë, por ministri, mendoj edhe pse është fillimi i mandatit të tij, një gjë të tillë e din që fatkeqësisht në Kosovë kemi shumë fajdexhinj, jo vetëm në Vushtrri, por në tërë Kosovën. Kemi edhe njerëz të përfshirë në grupe të ndryshme kriminale, qoftë në vrasje, qoftë në haraç, rrëmbime dhe të gjitha këto të cilat Ministrinë e Brendshme e përballin me një sfidë jo të lehtë, po flas në kuptimin e plotë, me një krim mjaft mirë të organizuar në Kosovë dhe ministër i nderuar i Brendshëm, unë mendoj se e ke një sfidë mjaft të rëndë përballë të gjithë ministrave tjerë - kolegëve tuaj në Kabinetin qeveritar.

Dhe ajo çka kërkoj nga ti, është se në zonat që veçanërisht janë të ndjeshme dhe të përfshira kohë më parë dhe në kohën e tashme nga krimet dhe vrasjet e ndryshme, të rritni potencialet dhe kapacitetet njerëzore të policisë dhe të themeloni njësi speciale.

Ministër i nderuar,

Është paradoksale ajo çka ndodhur në mandatin e kaluar. Për shembull, rasti konkret në komunën e Pejës, është pezulluar Njësia Speciale, kështu që ne e dimë se komuna e Pejës, fatkeqësisht po ballafaqohet ende, edhe pse në shkallë më të vogël, me vrasje dhe forma të ndryshme të krimit të organizuar, prandaj unë e kam një propozim konkret për ju që ta shqyrtoni këtë çështje dhe komuna e Pejës të mos të mbetet pa Njësia Speciale.

Ne e dimë që Gjakova e ka, kurse Gjakova fatmirësisht, qëndron në shkallën më të mirë në raport me komunën e Pejës sa i përket krimit dhe vrasjeve, prandaj mos e injoroni një gjë të tillë.

Jam i bindur se nuk do ta injoroni, por edhe të keni parasysh këtë propozimin tim, sepse është mjaft thelbësor dhe substancial për sigurinë në Kosovë.

Dhe, propozimi konkret, apo shqetësim kryesor kur jemi te krimi i organizuar, është paradoksale se një vend me një numër kaq të vogël të banorëve, në një pozitë strategjike mjaft të mirë, pozitë gjeografike siç është Kosova në Evropën Juglindore, në Ballkan, me një popullatë mbi 2 milionë banorë ka aq shkallë të lartë të krimit të organizuar, trafikim me qenie njerëzore, prostitucion, droga, pastrim parash, dhe dihet se në qendrat kryesore të pastrimit të parasë janë kazinot.

Në kohën pas lufte, një ndër burimet kryesore ku bëhet shpëlarja e parave janë kazinotë, prandaj mos i neglizhoni këto dhe merrni hapa konkretë në mbylljen e tyre dhe luftimin e krimit të organizuar.

Dhe, kur jemi te krimi i organizuar, unë mendoj, edhe pse një pjesë e madhe e ministrave mungojnë këtu, në shumë sektorë të tyre është prezent krimi i organizuar. Ministri aktual, për momentin nuk është këtu dhe i cili doli, e ndoshta e dëgjon mbrapa atje, ministri i Arsimit dhe i gjithë sektori i arsimit fatkeqësisht është i përfshirë nga krimi i organizuar.

Ka të dhënat të ndryshme se krimi i organizuar ka shkuar aq në shkallë të lartë sa janë dhënë diploma pa e pa kandidatët kurrë fakultetin me sy. E keni mega-skandalin në komunën e Pejës ku flitet se mbi 500 diploma janë dhënë, ndërsa argument për këtë, se vërtet ka pasur diçka aty, është edhe djegia e objektit të Fakultetit të Biznesit në vitin e kaluar. Do të thotë, aty kur është djegur ajo godinë, ajo djegie e qëllimshme dhe jep të kuptojë diçka që ka dashur të fshihet pas asaj djegie diçka, prandaj prapë po ju referohemi që si Qeveri e Kosovës keni mjaft përgjegjësi, keni mjaft sfida përballë krimit të organizuar dhe unë ju inkurajoj në punën e mëtutjeshme.

Dhe, fakti se shumë ministra po mungojnë, dhe po më hendikepon të flas në mungesë të tyre, ndoshta në seancat e ardhshme do ta kam mundësinë ta shfrytëzoj një gjë të tillë, por desha t'i kthehem dhe referohem asaj kur në fillim thashë pse është më mirë mos të emërohet një zëvendësministër dhe të alokohen mjetet tjetërkund, desha ta ndërlidhi me Ministrinë e Punës, sepse ne e dimë që në Kosovë shkelen të drejtat thelbësore të punëtorëve, veçanërisht në sektorin privat. Dhe, duke qenë vetë pjesë në mandatin e kaluar, si deputet e anëtar i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kemi inspektuar punën e Inspektoratit të Punës dhe kur kemi kërkuar nga Inspektorati i Punës të ndëshkohen ato ndërmarrje private të cilat shkelin të drejtat e punëtorëve konkretisht, nuk respektohet Ligji i punës që është 40 orë në javë dhe punëtorët punojnë mbi 40 orë, punojnë edhe vikendeve, dhe nuk paguhen me kontrata dhe përmes transaksioneve bankare. Arsyeja e Inspektoratit ka qenë që nuk kemi kapacitete njerëzore, me një fjalë nuk kemi njerëz dhe nuk mundemi për t'i inspektuar të gjitha bizneset në Kosovë.

Dhe në këtë rast, e kam propozimin konkret, në vend të zëvendësministrave, rriteni kapacitetin e inspektorëve të punës, të inspektohet Ligji i punës, mos të shkelen të drejtat e punëtorëve dhe të hapen vende e mundësi të reja të punës me afatgjatë dhe të shihet produkti i tyre në mirëqenien dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Faleminderit, për kureshtjen tuaj!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përshëndetje i nderuar kryeministër, ministra prezentë,
Kolegë deputetë,

Nuk desha ta marrë fjalën, sepse shumë është thënë mbi 8 orë debat në lidhje me raportin nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por shumë pak u diskutua për çështjen e komuniteteve. Mbi 70 votues, mbi 70 anëtarë këtu të Kuvendit diskutuan, por shumë pak u morën me jetën e komuniteteve, e morën edhe me plan-programin e Qeverisë, por edhe debatet e deputetëve, këtu, kjo do të thotë se nëse përfaqësuesit e komuniteteve nuk do të jenë këtu prezent, ndoshta një ditë, asnjëherë nuk do të diskutohet për jetën e tyre e që janë në Kosovë.

Unë dua të lidhem pak te migrimi dhe dua ta quaj migrim legal, sepse mbi 8 mijë anëtarë nga komuniteti ynë kanë dalë nga Kosova, sepse atë e quaj legal, sepse askush s'i ka ndaluar ata për të dalë, por tash na brengos rasti, sepse është duke u bërë kthimi i dhunshëm i tyre nga vendet që kanë dalë, pra në vendet e treta, dhe ata qytetarë neve po na mbetin në rrugë.

Prandaj kërkoj nga ministri Hyseni që së paku të mos merret me kthimin e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian nga këto vende që kanë migruar, sepse një numër i madh i tyre i kanë shitur pronat, kanë hyrë borxh, ndoshta, dhe kanë obligime të mëdha dhe ata nëse kthehen në Kosovë, do të mbetin në rrugë, mirëpo, unë besoj që me kohë duhet parë gjendjen sociale të tyre.

Në të njëjtën pikë thuhet sot se lidhur me plan- programin për 100-ditëshin, është diskutuar për punësim. Unë kërkoj nga ministrinë relevante të cilat do të merren me punësim t'i kanë parasysh edhe komunitetet, sepse deri më tani asnjëherë nuk janë marrë punëtorë për punë sezonale nga komunitetet dhe asnjë numër nuk e kemi që janë të punësuar edhe më herët. Këtu i kam disa shifra, të cilat i kemi dëgjuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenia Sociale se do të punësohen disa punëtorë sezonalë, ndoshta edhe në vendet e treta, por unë kërkoj që prej tash të merret numri dhe të merren për bazë edhe i komuniteteve të cilat jetojnë në Kosovë, pra komunitetet jo serbe.

Në fillim nga kjo Qeveri apo nga çdo ministri kemi kërkuar me shkrim që së paku nga komuniteti ashkali, apo nga komuniteti rom që jemi këtu dy kolegë, së bashku u jemi drejtuar ministrive, që së paku nëpër këto ministri të jenë të punësuar nga një nga komuniteti ashkali, po edhe nga komuniteti rom. Pra, këta të jenë pjesë e ministrive, këtë kërkesë e kemi bërë të qëllimshme, sepse për deri sa nuk i kemi përfaqësuesit tanë nëpër ministri apo nëpër disa dikastere tjera të punësimit, shumë pak bëhet përfaqësimi i tyre dhe shumë pak është interesimi për të ndihmuar komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe po flas në veçanti për komunitetin ashkali dhe për komunitetin rom.

Desha të ndalem te një pikë tjetër, te asistenca sociale. Ne dy muajt e fundit kemi shumë probleme me këta qytetarët që i kemi këtu në Kosovë dhe që e gëzojnë asistencën sociale, por e cila iu është ndërprerë shumë qytetarëve pa kurrfarë ligji, duke ditur se edhe Ligji për asistencë sociale shumë është i rëndë të cilët nuk munda ta gëzojnë, sepse kriteret janë shumë të rënda, por edhe ata që janë duke e gëzuar, një numri të madh të tyre u është ndërprerë dhe me këtë secilës familje u janë ndërpre nga 20 euro, apo 30 euro, pa kurrfarë udhëzimi administrativ dhe pa kurrfarë vendimi nga qendrat për punë sociale, por edhe nga Ministria. Pra, kemi kontrolluar shumë qendra dhe ata nuk kanë asnjë udhëzim administrativ apo vendim për çfarë arsye, edhe ata 70 euro, të cilën e marrin familjet, u është copëtuar në 30 euro apo 40 euro. Dhe unë mendoj se

duhet të mendohet të mos plotësohet arka e shtetit me ndërprerjen e asistencës sociale për këto kategori që i kemi ne për barrë, këtu si deputetë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sa i përket shëndetësisë, kemi dëgjuar shpeshherë se shumë mjete, shumë miliona ndoshta janë ndarë në Ministrinë e Shëndetësisë, për trajtime jashtë vendit dhe ne shumë pak kemi njerëz tanë që e kanë përfituar ndonjëherë atë drejtë, edhe pse kërkesat tona janë të shumta dhe njerëzit tanë nuk po kanë mundësi ta shfrytëzojnë edhe atë buxhet nga Ministria e Shëndetësisë.

Nëse flasim për Ministrinë e Arsimit, e dimë se nga ky Kuvend më herët është nxjerrë një udhëzim administrativ sipas të cilit komunitetet e kanë të drejtë për disa vende të rezervuara që të regjistrohen në fakultet dhe në vend të tyre shumica, nga komuniteti shumicë, i kanë shfrytëzuar ato vende dhe prapë komunitetet nuk kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë, dhe sot ndoshta figurojnë atje shumë studentë që janë të regjistruar në emër të komuniteteve.

Unë kërkoj nga kryeministri, së paku të kenë konsideratë ndaj komuniteteve që ne i përfaqësojmë këtu që të kenë përfaqësim edhe komunitetet. Është një shkelje duke u bërë për shumë vjet, jo vetëm tash, dhe unë e di që Zyra lokale e komuniteteve do të thotë se komunitetet janë të punësuar, por është e punësuar popullata shumicë në shumë vende duke e ditur se këto zyra lokale të komuniteteve janë hapur me qëllim që pjesëtarët e komuniteteve të jenë edhe shef të zyrës apo drejtorë, të tjerë dhe punëtorë.

Kërkoj pra nga Zyra e kryeministrit, nga Ministria përkatëse që të merret me këtë problem, sepse në shumë qytete nuk kanë mundësi për t'u punësuar në ato zyra lokale për t'i mbrojtur interesat e komuniteteve.

Unë falënderoj pra edhe kryeministrin që në kohën e fundit na ka premtuar se do të jenë disa zëvendës- ministra nga komunitetet tona dhe unë besoj që këta do të jenë nga këto komunitete, pra nga komuniteti ashkali dhe nga komuniteti rom, do të jenë zëvendësministrat. Pra, mbi të gjitha kisha kërkuar që së paku atje në rreshtin tuaj ku jeni të gjithë ministrat dhe janë nga të gjitha komunitetet, e keni komunitetin serb, keni komunitetin turk, keni komunitetin boshnjak dhe, për çfarë arsye, i nderuar kryeministër, nuk patët mundësi që ta zgjidhni edhe një ministër nga komuniteti ashkali, nga komuniteti egjiptian apo nga komuniteti rom dhe të jenë në mesin tuaj dhe së paku të përzihen ngjyrat aty përpara dhe të shikojmë..., dhe se përfaqësimi të jetë i njëjtë, pra sikur edhe të gjitha komunitet të jetë edhe komuniteti ynë. Faleminderit!

KRYESUESI: E fundit është Aida Dërguti.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Pasi që kjo Qeveri u vonua të formohej për gati një muaj me arsyetimin se është duke përpiluar një program premtues dhe me harmonizim të plotë me partnerët e koalicionit, plani qeverisës me të cilin kryeministri na njoftoj, është një dokument qesharak prej 84 faqeve, me të cilin mendohet të qeveriset në katër vitet e ardhshme.

Kapitulli i dytë që ka të bëjë me sundimin e ligjit i përmbledhur në 4 fletë, më së miri e tregon seriozitetin e Qeverisë. Po të lexohet ky program, kuptohet se këta qeveritarë nuk kanë ... as vullnet për sundimin e ligjit, e shtet ligjor.

Në këtë kapitulli, respektivisht pikën 2.4 të dokumentit, ju keni trajtuar integrimin e komunave veriore në sistemin e drejtësisë vetëm me një paragraf. Këtë problem kompleks ju e paraqitët kaq thjeshtë, ashtu siç edhe e zgjidhët, duke lidhur Marrëveshjen për drejtësinë me Vuçiqin, duke e kontestuar sovranitetin e një pjese të territorit, duke thelluar ndarjen dhe duke plotësuar disa nga kërkesat që përmbushin parakushtet për themelimin e asociacionit të komunave serbe.

Nëntitull tjetër i këtij kapitulli është aprovimi i Ligjit për parandalimin e pjesëmarrjes në konflikte e jashtme. Ky projektligj është miratuar në Kuvend një ditë para se të na dorëzohej ky program qeverisës.

Për më tepër ky projektligj ka kaluar në lexim të parë qysh në legjislaturën e kaluar, por ka ngecur në lexim të dytë për shkak të shpërbërjes së Kuvendit.

Pra, ky ligj nuk ka qenë risi dhe duket e pakuptimtë futja e tij në këtë program qeverisës.

Çka ka dashur të thotë Qeveria me këtë, që do ta votojnë një ligj të iniciuar nga qeveria e kaluar.

Pika 2.2. flet për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përveç deklarimeve se janë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nuk ka asgjë konkrete se si duhet luftuar këto dukuri, me përjashtim të paragrafit të fundit ku flitet për trajnime dhe ngritje profesionale në fushën e prokurimit.

Dhe pikërisht në këtë pikë, ku do të duhej të përfshihej strategjia legjislative për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, nuk ka asgjë tjetër përveç parullave.

Pse nuk e keni përmendur Ligjin antimafia, që do të mundësonte hetim efikas, konfiskim të pasurisë dhe burgosjen e të gjithë politikanëve dhe zyrtarëve të korruptuar, apo do të vazhdohet me avazin e vjetër, të flitet për korrupsionin e krimin e organizuar dhe jo për luftimin e tij.

Nuk është ndryshe as nëntitulli i po këtij kapitulli që ka të bëjë me transparencën në pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Këtu i keni shkruar 3 paragrafë me fraza boshe.

Ju assesi nuk keni paraqitur një kornizë organizative se kur dhe si do ta bëni këtë. Madje, në njëfarë mënyre, qysh në paragrafin e parë të këtij nëntitulli, ju e bëni të përgjegjshëm qytetarin për pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, se sa të merreni me ndërgjegjen e organeve vendimmarrëse për të afruar qytetarët në vendimmarrje.

Më tej, për çfarë sundimi të ligjit dhe shtet ligjor po flasim kur po e cenoni edhe atë pak sovranitet shtetëror me anë të tentimit të funksionalizimit të Gjykatës Speciale, të cilës po ashtu ia keni kushtuar një paragraf në këtë kapitull.

Po ashtu në këtë program qeverisë askund nuk përmendet angazhimi i Qeverisë për zbardhjen e krimeve të Serbisë, gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe vënia para drejtësisë e atyre që kanë kryer krime.

Prandaj, se sa të interesuar jeni për sundimin e ligjit më së miri tregon ndarja e buxhetit për sistemin e drejtësisë e që është më e ulët se 2% e totalit buxhetor.

Dhe, për fund, në kapitullin e tretë, që flet për agjendën evropiane dhe politikën e jashtme, në faqen 43 dhe faqen 52, kemi një paragraf në fund i cili është kopy-paste, po i njëjti. I vetmi dallim është që në faqen 43 paragrafi fillon me “ Qeveria e Kosovës”, ndërsa në faqen 52 fillon” me - Kosova”

Ky paragraf flet për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë, pa asnjë kritikë, pa asnjë vërejtje rreth asaj çka është bërë deri sot dhe më tej thotë se synohet të finalizohet me njohjen e ndërsjellë që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes këtyre dy vendeve dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike dhe të mira fqinjësore në frymën evropiane. E për këtë nuk ka garanci, sepse mund të ndodhë që shtetet edhe të kenë njohje reciproke, sepse Serbia e njeh Bosnjën, mirëpo e dimë se çfarë janë marrëdhëniet në mes këtyre dy shteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Qeverisë. Fjalën e kanë ministrat shkurt për të dhënë ekspozë, pastaj kryeministri. Zoti Skender Hyseni e ka fjalën.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar deputet Kelmendi,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Pajtohem me pjesën dërrmuese të observimeve tuaja, dola vetëm për të dhënë një shpjegim.

Në Pejë nuk kemi të bëjmë me shuarjen e Njësitit Special, por kemi të bëjmë me një reformë që ka ndodhur në vitin 2013 dhe të gjitha njësitet speciale në kuadër të drejtorive rajonale të policisë janë centralizuar në nivel nacional dhe është Njësia Speciale e Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, në njësitë, përkatësisht drejtoratet rajonale të Policisë, tashti i kemi njësite të reagimit të shpejtë. Dhe një njësit të tillë e ka edhe Qendra, përkatësisht Drejtoria rajonale në Pejë. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse koha është e kufizuar do të mundohem shpejt t’i them dy-tri çështje të cilat besoj se do të ilustrojnë gjendjen.

Shkuarja e punëtorëve shëndetësorë, respektivisht e mjekëve në vendet tjera, është trend edhe në

shtetet më të zhvilluara. Shtrohet pyetja pse u krijua mundësia e shkuarjes së mjekëve nga Kosova në Gjermani, dhe përgjigja është se ata shkojnë në vendet tjera ku kërkojnë jetë më të mirë dhe pagë më të madhe.

Unë them se nuk është shkuarja e mjekëve mospasja e mundësisë së punësimit, sepse këtë kisha për ta argumentuar, nuk është vetëm ky shkaku, sepse nga Spitali rajonal i Gjilanit së paku nja 6-7 veta janë kanë të punësuar dhe e kanë lëshuar dhe kanë gjetur punësim në Gjermani. Domethënë nuk ka qenë kjo.

E dyta. Kisha t'i them dy argumente tjera, dhe e kisha lutur deputeten Baftiu, nëse brengoset kaq shumë për të pa punësuarit, pse nuk po e liron vendin në Spitalin rajonal të Gjilanit, por po i bën dy pagesa, sikur që kam bërë unë dhe kanë bërë disa kolegë deputetë, këtu.

Dhe e dyta, që kisha të them, është ulja e vdekshmërisë që lidhet direkt me kontributin që e ka dhënë zonja Baftiu, në punën e saj profesionale bashkë me kolegët e vet në Neunatologji në Gjilan dhe të gjithë neunatologët tjerë në Kosovë.

Ulja e vdekshmërisë prej rreth 30 promilëve në tash 12 – 13 është ulja e admirueshme edhe nga institucionet ndërkombëtare.

E treta, që kisha për ta cekur, është aty ku zakonisht shëndetësia nuk ka shumë sukses, Shërbimi i Onkologjisë. Lista e pritjes për kimioterapi nuk ekziston dhe brenda 3 muajve janë bërë 4.500 aplikime të kimioterapisë dhe tash për tash 75% e nevojave me citostatikë mbulohen.

Ndërsa, lista e pritjes për radioterapi është 3 javë, që aktualisht është më e shkurta në rajon. Dhe, edhe kjo është një porosi që shëndetësinë duhet ta shohim pak më ndryshe, jo vetëm zi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Baftija.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë do t'i përgjigjem ministrit të Shëndetësisë, sa i përket punës time që e bëj në Spitalin regjional të Gjilanit, këtë ma lejon ligji dhe unë fillimisht kam investuar në profesionin tim të bëhem mjek. Në politikë jam futur duke e parë qeverisjen tuaj tash e 15 vite, politikat shëndetësore të cilat janë në sistemin shëndetësor dhe në tërësi.

Ndërsa, sa i përket pritjes, unë nuk e ceka këtu pritjen që po bëhet dhe ajo është kah bëhet te terapia me cistostatikë. Unë thashë se pritja po bëhet për në diagnostifikim rengelgjik dhe eho-sonografikë.

Kjo është më se e saktë, dhe nëse unë nuk e them të vërtetën ose ju nuk e thoni, janë qytetarët ata të cilët e dinë më së miri se sa presin për një ultrazë të zemrës. Një ultrazë i zemrës për fëmijët në Klinikën Pediatrie duhet pritët dy-tre muaj, sepse në spitalet private kushton 50 euro, e kjo është shumë, shumë e kushtueshme për shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ministri!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Është e vërtetë që ligji ta ka mundësuar, por edhe mua ma ka mundësua të jem anëtar i Kuvendit komunal, e kam lënë sikur koleget e tua të spitalit që e kanë lëshuar vendin e punës, por ato nuk po brengosen, ti po brengosesh për të papunët.

Dhe e dyta, është mirë që të marrësh pakon ligjore e cila mbulon apo rregullon sektorin e shëndetësisë dhe t'i konsultosh ligjet më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bajrami.

QERIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë pak me vonesë u lajmërova dhe kërkoj ndjesë, por nuk do të jam i gjatë.

Dëshiroj t'ju informoj se javën e ardhshme, më 8 prill është Ditë Ndërkombëtare e Romëve. Dëshiroj që me 8 prill të dal para opinionit, para mediave të Kosovës dhe të Evropës, me statistika të cilat reflektojnë pozitivitetin e komunitetit rom në Kosovë, në Ballkan dhe në Evropë.

Dëshiroj që më 8 prill të kemi mburrje ne qytetarët, gjegjësisht romët e Kosovës në të gjitha poret apo dikasteret e Qeverisë së Kosovës. Jo larg, një grup intelektualësh romë vizituam Ministrinë e Arsimit, zotin Bajrami dhe mund të them që është shembull i ministrave tjerë se si bën një pranim të komuniteteve, i cili na i ofrojë të gjitha mundësitë që edhe komuniteti rom të ketë perspektivën e tij, por nuk do të ndalemi këtu. Unë i bëra vizitë edhe ministrit të Shëndetësisë, do t'i bëjmë vizitë edhe ministrive tjera të Punëve të Brendshme, të Diasporës, të Infrastrukturës ku do t'i kërkojmë të drejtat tona të punësimit, sepse deri më sot 0,01% të komunitetit rom janë të punësuar në institucionet vendimmarrëse.

Kolegu im Ademi tha se në zyrat për komunitete nuk punojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë në zyrat lokale. Kjo duhet të evitohet dhe të na jepen mundësi të barabarta të punësimit.

Unë me këtë, dëshiroj t'ju them edhe këtë se Dita e 8 prillit do të jetë pasqyrë e gjithë Kosovës se sa respektohet komuniteti rom në Kosovë. Me fjalët "ovennista ste" – "bëhuni shëndosh", ne ju përshëndesim, jeni të mirëseardhur në festën e romëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa, e keni fjalën për ekspozenë tuaj. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë e konsideroj të rëndësishëm këtë debat, i cili është zhvilluar lidhur me programin qeveritar dhe me punën 100-ditëshe.

Natyrisht që të gjithë ne që kemi punuar në përgatitjen e këtij programi, jemi munduar që programi të jetë një dokument që mund të implementohet, nuk është program i cili është punuar

në prag të themelimit të Qeverisë, është një program të cilin ne si subjekte politike, unë flas tash për pjesën e LDK-së, që e kemi punuar së paku 2 vjet, kanë punuar ekspertët e ndryshëm nga të gjitha fushat, kanë punuar bashkë po mendoj edhe në Partinë Demokratike. I kemi ulë ekspertët e dy fushave, e kanë bashkërenditur programin, janë pajtuar që në disa objektiva në të cilat kemi pasur dallime t'i bëjnë objektiva të përbashkëta.

E kemi shpërndarë programin në të gjitha ministrinë dhe agjencinë, i kemi marrë inputet nga të gjitha ministrinë në mënyrë që programi të jetë i implementueshëm, është bërë pastaj amza e realizimit të çdo objektivi nëpër ministri, për të gjitha fushat që i ka programi, dhe të gjitha ne i kemi dhe mënyra se si do të impletohet programi. Unë mendoj se programi është i realizueshëm dhe se programi i përgjigjet nevojave aktuale të Republikës së Kosovës.

Nuk them se është një program ideal, sepse idealen nuk mund ta arrijmë tani, por është një program i cili mund të bëjë ndryshime dhe unë vlerësoj se në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në këtë koalicion të të gjithëve, ka vullnet që të bëhen ndryshime.

Unë vlerësoj se kjo Qeveri e ka misionin e vet që duhet ta realizojë, e ka vizionin e vet që duhet ta arrijë dhe i ka objektivat e veta të cilat i ka qarta se si do t'i arrijë.

Unë mendoj se misioni ynë themelor i kësaj Qeverie është që ne t'i kthehemi problemeve të brendshme të vendit, t'iu kthehemi problemeve të zhvillimit ekonomik, problemeve të punësimit, të krijimit të vendeve të punës dhe të luftimit të korrupsionit, por jo të luftimit të korrupsionit përmes deklaratave, por përmes politikave aktive ekonomike, në mënyrë që të lemë hapësirë sa më të vogël për korrupsion dhe në mënyrë që pastaj prokuroria, gjyqësia dhe organet e tjera ta bëjnë punën e vet që duhet ta bëjnë dhe ne të mos përziemi atje. Dhe mendoj se ne do të angazhohemi në këtë pjesë të zhvillimit ekonomik, do të merremi me problemet e brendshme dhe ky është misioni që ne duhet ta arrijmë tash dhe ky është ndryshimi ynë që ne mendojmë ta bëjmë në këtë Qeveri.

E dyta është që ne t'i bëjmë të gjitha përpjekjet dhe ta arrijmë që ta ushtrojmë sovranitetin në tërë territorin e Republikës së Kosovës, edhe në komunat në veri të Kosovës, në të gjitha fushat.

Është e saktë deklarata që e kam dhënë lidhur me FSK-në dhe lidhur me Forcat e Armatosura, por, ky nuk është qëndrim i imi.

Ne kemi pasur përkrahjen e NATO-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe anëtarëve të NATO-s në çlirimin e Republikës së Kosovës dhe në themelimin e shtetit tonë dhe ne dëshirojmë ta zhvillojmë një partneritet me NATO-n, me anëtarët e NATO-s dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ne, këtë partneritet do ta ndërtojmë edhe në ndërtimin e Ushtrisë së Kosovës, në Forcat e Armatosura të Kosovës, ne, Forca të Armatosura të Kosovës jashtë këtij partneriteti nuk shohim. Ne e kemi KFOR-in këtu, i cili ka mision paqësor, ne e kemi një pajtueshmëri që unë e kam trashëguar, që themelimi i Ushtrisë së Kosovës të bëhet në bashkëpunim me NATO-n, dhe në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me aleatët tanë strategjik, dhe unë si kryeministër e vlerësoj si rrugë të cilën ne duhet të vazhdojmë, dhe këtë rrugë do ta vazhdojmë.

Kjo, assesi nuk nënkupton që një ditë Forcat e Armatosura të Kosovës, të mos dalin në tërë territorin e Republikës së Kosovës, por nënkupton që në zhvillimin e këtyre forcave do ta bëjmë në bashkëveprim dhe në bashkëpunim me NATO-n, dhe me partnerët tanë strategjik, por assesi nuk nënkupton që tash ne po heqim dorë nga sovraniteti jonë, por nënkupton që në këtë pjesë të përgjegjësisë tonë do ta zhvillojmë me partnerët tanë strategjik, veçmas me NATO-n.

E dyta. Sa i përket Programit Qeverisës dhe punës, unë kam pritur të themi një qasje më pragmatike dhe më reale të të gjithëve, veçmas të opozitës, sepse në asnjë punë dhe në asnjë fushë nuk mund të shohim vetëm zi.

Unë kam parë që më është thirrur emri prej disa deputetëve nga 20 deri 30 herë, ajo mandej ka kaluar thuhet në ritual fetar ose në ritual të sektit, por po i lëmë ato gjëra, unë e konsideroj veten kryeministër të këtij vendi dhe e konsideroj veten përgjegjës para këtij Kuvendi, e konsideroj veten si njeri i cili duhet të krijoj bashkëpunim dhe bashkëveprim së bashku me ju dhe mos t'i ndaj njerëzit a janë të pozitës a të opozitës, sepse sukseset tona kanë me qenë suksese tona të përbashkëta, humbjet humbje të përbashkëta dhe ne pastaj kemi për të dhënë llogari para votuesve tanë dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe, unë nuk konsideroj se e gjithë ajo që është në Program Qeverisës dhe e gjitha ajo punë që është bërë për 100 ditë është më e mira dhe është më idealja, por konsideroj se Programi Qeverisës ka punë, ka fusha shumë të mira, ka komponentë shumë të mira dhe ato mund t'i realizojmë së bashku, duhet të gjejmë gjuhë të përbashkët që të punojmë bashkë, sepse është në interesin e Republikës së Kosovës që në këto punë t'i bëjmë bashkë.

Unë i pranoj dallimet që i kemi, që kanë të bëjnë me konceptin programor dhe me konceptin politik, jemi parti të ndryshme dhe kemi dallime. Kemi dallime edhe brenda koalicionit që janë shumë të natyrshme, por programi ynë qeverisës bazohet në orientimin kah ekonomia e tregut, më saktësisht kah ekonomia sociale e tregut, që është koncept i partive të qendrës së djathtë, që nënkupton se ne i respektojmë të gjitha rregullat e ekonomisë së tregut, por e respektojmë po ashtu edhe komponenten sociale të ekonomisë së tregut dhe nuk konsiderojmë se në këtë ekonomi të tregut janë vetëm ata të cilët prodhojnë dhe vetëm ata që blejnë, ose vetëm ata që shesin dhe blejnë, por konsiderojmë se pjesë e kësaj ekonomie janë edhe ata që nuk mund të punojnë, janë të papunët, janë pensionistët, janë të paaftit për punë, për të cilët ne duhet pasur kujdes dhe duhet të krijojmë politika aktive sociale si pjesë të ekonomisë së tregut dhe këtë jemi munduar ta përvijojmë në të gjitha pjesët e programit tonë qeverisës. Unë pajtohem me këtë që zoti Kurti e tha këtu, se ajo është thënë vetëm njëherë në fillim dhe nuk është thënë në pjesët tjera, mirëpo natyra e programit që ne në orientimin tonë e kemi për ekonominë sociale të tregut si koncept i partive të qendrës së djathtë.

Unë shoh dallime këtu sepse ne shohim tash orientimin që promotor i zhvillimit ekonomik të jenë biznesi privat dhe jo sektori publik, por po ashtu të pajtohem që privatizimi i kompanive publike të mos bëhet shkel e shko, por për këtë privatizim ne të gjejmë një gjuhë të përbashkët, ta bëjmë një analizë të përfitimit dhe të kostos, të kos-benefitit të asaj se a kemi më shumë llogari që ta mbajmë një kompani publike në pikëpamje të efijencës ekonomike, në pikëpamje të qeverisjes koorporative edhe në pikëpamje të ekonomisë së shkallës, që nënkupton koston ose çmimin që do ta paguajnë konsumatorët për shërbimin e një kompanie publike, a ofron PTK-ja si

kompani publike çmime më të ulëta për konsumatorët dhe shërbime më të mira për konsumatorët si kompani publike apo si kompani e privatizuar.

Në qoftë se këtu ne gjejmë llogari të përbashkëta, atëherë s'kemi asnjë arsye që të mos kemi edhe qëndrim të përbashkët së i përket kësaj.

Sa i përket “Trepçës”, unë vlerësoj se ne kemi bërë një punë të mirë për “Trepçën” për arsye se e kemi penguar që “Trepça” të shkojë në falimentim. Ka qenë rrezik të shkojë. Tash për “Trepçën” ne duhet të mendojmë mbi baza ekonomike në këtë fazë dhe jo mbi baza pronësore. Asnjëri këtu nuk ka argumente të thotë se më mirë “Trepça” të jetë kompani publike ose dikush tjetër thotë më mirë është që “Trepça” të jetë në komponentin dhe në autoritetin e AKP-së, dhe që të vazhdojë të jetë kompani shoqërore ose që nesër të bëhet partneritet publiko-privat.

Por, të gjithë ne mendojmë që “Trepçën” duhet ta shohim në aspektin ekonomik, të shohim se a përfiton më shumë Kosova që “Trepça” të jetë kompani publike, a përfiton më shumë Kosova që “Trepça” të jetë në partneritet publiko-privat, apo në çfarë forme ne përfitojmë më shumë dhe përgjigjen në këto e jep Strategjia dhe e jep një studim i cili do të bëhet për “Trepçën”, i cili nuk guxon që të vonohet. Unë pajtohem me të gjithë ata që kërkojnë që ne duhet ta afatizojmë, edhe do ta afatizojmë, do t'i japim afatet AKP-së tashti themelohet, dhe që strategjia të bëhet, dhe që në bazë të strategjisë pastaj ne të vendosim.

Pasuritë tona natyrore nuk na i merr askush, sepse ato janë pronë e shtetit të Kosovës. Ato që janë mbi tokë, makineria, pajisjet, ndërtesat, e kanë statusin tash të kompanive shoqërore, përkatësisht statusin shoqëror, dhe unë jam për atë që ne t'ia lëmë çështjen strategjisë dhe do të bëhet ligji. Ne obligohemi që ta biem Ligjin e veçantë për “Trepçën”, dhe me këtë ligj pastaj ne e rregullojmë statusin pronësor dhe ekonomik të “Trepçës”.

Unë kam pritur që në këtë debat ne do të kemi edhe alternativa, sepse në qoftë se deputetët thonë se diçka nuk vlen nga programi, atëherë është e arsyeshme të thonë se çka është ajo që vlen. Si duhet një masë ose një objektiv që e kemi paraparë ne me program, ta zëvendësojmë me një objektiv tjetër i cili është më dobiprurës, më i realizueshëm, dhe që i jep Kosovës më shumë efekte se sa që i jep tash.

Ne dëgjuam kritika pse ne jemi bërë bashkë për të themeluar një Qeveri, dhe kryesisht pikënisja ishte aty.

Tash unë pajtohem me ju, se edhe unë kisha dashur dhe për mua zgjidhja ideale kishte me qenë që LDK-ja për t'i fituar mbi 50 për qind të votave, dhe që LDK-ja ta bëjë Qeverinë, por, nuk i kemi fituar. Asnjë parti nuk i ka fituar në këtë vend tonin, e cila mund vetë ta themelojë Qeverinë. Dhe secili jemi të detyruar të bashkëpunojmë njëri me tjetrin dhe të gjejmë gjuhë të përbashkët njëri me tjetrin. Edhe tjerët nuk ishin pajtuar me mua, por kishin thënë “ne është dashur të dalim të parët”. Dhe kjo na ka prurë këtu, do të thotë është një zgjidhje përfundimtare në të cilën ne kemi ecur, jemi munduar të gjejmë zgjidhje dhe kemi ardhur këtu, dhe tash këtë zgjidhje ne duhet për ta përdorur. Qeveria tash duhet të punoj tash për realizimin e synimeve që kanë qytetarët tanë, dhe unë ju garantoj pa marrë parasysh vlerësimet që jepen, sepse unë s'kam pritur që dikush të thotë që për 100 ditë ne e kemi shpëtuar Kosovën. Për 100 ditë, as nuk

mundemi për ta shpëtuar, e as nuk mundemi për ta fundosur. 100 ditë janë që ne për t' i parë letrat aty. 100 ditë janë që ne ta konsolidojmë buxhetin dhe... çështjet të cilat mundësojnë që ky shtet të funksionojë. 100 ditë është për t' i pru disa vendime emergjente, në mënyrë që të bëjmë një kthesë dhe të orientohet zhvillimi se për 100 ditë as s'mundemi të themi që ne bëmë punë të mëdha, dhe të gjithë ata që thonë që për 100 ditë kanë qeveris mirë apo kanë bërë punë të qeverisjes së mirë, unë s'e them këtë, unë them se për 100 ditë jemi munduar të bëjmë, në kemi stabilizuar ecuritë në disa fusha, mirëpo neve na nevojitet të punojmë shumë, për t'i bërë ndryshimet të cilat i presin qytetarët tanë.

Por, po ashtu jam i gëzuar as askush nga ju nuk munda të thotë që kjo Qeveri është e korruptuar, kjo Qeveri ka skandale, ose që kjo Qeveri ka bërë shkelje të ligjit. Aty po mundohem për t' u ndalur, të mos lejojmë, dhe do të mundohemi që mos të kemi raste korruptive, sepse nuk është pastaj punë e Qeverisë, është punë e jona, e Kosovës në përgjithësi, për arsye se po synojmë të integrohemi në Bashkimin Evropian, të bëjmë liberalizimin e vizave, dhe të ofrohemi nga Bashkimi Evropian, dhe maksimalisht do të mundohemi që këto çështje t'i respektojmë.

Unë vetë thashë në fjalën e djeshme, që unë vetë kam vërejtje, që disa shërbyes civilë akoma vazhdojnë të punojnë në disa ministri tona, ndaj të cilëve janë ngritur procese penale. Ata s'mund të punojnë dhe duhet nxjerr masa që mos të punojnë. Edhe në agjenci kemi të tillë. Dhe këtë gjë ne do ta bëjmë. Do të thotë nuk do të lejojmë që të kemi raste të tilla, dhe që po ashtu do të mundohemi që të jemi transparentë sa të mundemi.

Ne në Qeveri, me program qeveritar, edhe me zotime qeveritare, prej që e kemi themeluar Qeverinë, nuk kemi thënë që do t' i punësojmë as 200 mijë as 250 mijë, as 240 mijë, e as se do ta kemi buxhetin 2 miliardë e 500 milionë. E kemi trashëguar atë buxhet që e kemi trashëguar, por kemi thënë se do t' i krijojmë të gjitha kushtet ekonomike, do t' i marrim masat sistemore, të cilat e nxisin sektorin privat, dhe të cilat mundësojnë që ne atë objektiv që e kemi thënë gjatë fushatës, ta realizojmë përmes një programi qeverisës të cilin ne e kemi premtuar, për arsye se nuk mundemi që në mënyrë arbitrare t'iu themi tash bizneseve private që ti tash ke për t' i punësuar 50, ti 1.000, ti 1.500, dhe krejt këta do të bëjnë, ose s'mundemi ne tash të mbledhim numrat e të punësuarve nëpër firma, sepse së pari duhet të themelohen firmat. Atë që duhet ne ta bëjmë fillimisht është që të tërheqim investime nga jashtë.

Ne po punojmë në një Ligj për investime strategjike të cilin do ta sjellim në Kuvend do ta diskutojmë me ju bashkë, i cili do t' i mundësojë Qeverisë, që në qoftë se neve na paraqitet ndonjë partner, ndonjë investitorë strategjik nga jashtë për të investuar në Kosovë, pajtohemi dhe themi se ne do ta pranojmë këtë investim, do ta marrim një pronë nga AKP-ja, do t' ia japim këtij investitori dhe do të punësojmë 500, 1000 a 1500, sepse kështu nuk shkon. Nuk janë investitorët e jashtëm ata që po qëndrojnë në rend për të investuar në Kosovë, asnjëri nuk është. Por ne tash duhet që t'ua krijojmë kushtet atyre, që ata të vijnë në Kosovë dhe të investojnë, edhe këtë ne do të mundohemi ta bëjmë.

Pa tërheqjen e investimeve të jashtme, me kapitalin financiar që ne kemi në banka komerciale, me kushtet e kreditimit nga bankat komerciale, me përkrahjen që kemi pasur deri më tash nga Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Banka Evropiane për Investime, ne nuk mund të zhvillohemi, sepse nuk ka

kredi që janë të përshtatshme për sektorin e prodhimit. Dhe ne duhet t'i sigurojmë këto kredi, për arsye se ne pa e nxitur sektorin e prodhimit, nuk mundemi vetëm me shërbime dhe tregti për ta zhvilluar Kosovën. Ne tash duhet t'i bëjmë këto ndryshime, dhe unë ju premtoj që do të punojmë maksimalisht që t'i bëjmë këto ndryshime.

Tash unë vlerësoj se ne mund të gjejmë gjuhë të përbashkët dhe mund të gjejmë interesin e përbashkët tek ky program, sepse nuk është interes i një ane që të bëhen kursime, të mos shpenzojmë për nevoja që ne tash nuk kemi mundësi t'i përballojmë në këtë fazë të buxhetit dhe në këtë fazë të zhvillimit.

Nuk është interes i përbashkët që ne të luftojmë që aty ku është kapur shteti për ta shkapur shtetin, sepse duhet ta bëjmë këtë. Duhet ta bëjmë që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të punojnë në mënyrë të pavarur dhe që të gjitha të japin përgjegjësi para ligjit dhe para Kushtetutës.

Nuk është në interesin tonë që mos ta përkrahim faljen e borxheve, për të cilën ne jemi orientuar, nuk jemi orientuar që t'i falet një grupacioni, por që të pastrohen llogaritë, për t'i liruar njerëzit nga kompleksi se ata kanë borxh dhe nuk munden kurrë që ta paguajnë këtë borxh, dhe të krijohet një situatë e tillë kur njerëzit fillojnë në mënyrë normale t'i përballojnë borxhet e reja dhe detyrimet e reja ndaj shtetit.

Nuk është Fondi për Zhvillim, ose për Punësim, ose Fondi për garantim të kredive, një fond i cili nuk meriton përkrahjen e të gjithë neve, sepse është fond i cili orientohet për zhvillimin e vendit.

Nuk është disiplina financiare, që ne po bëjmë përpjekje maksimale, edhe ministri i Financave, ta vejmë një çështje në të cilën ne nuk mundemi të gjejmë interes të përbashkët dhe që nuk duhet ta përkrahim në Kosovë.

Nuk është ulja e evazionit fiskal ajo që ne nuk duhet ta bëjmë bashkërisht. Duhet të nisët nga kufiri brenda, dhe të bëhet maksimumi që të gjithë të paguajnë tatimet, të bëhet një shtrirje më e thjeshtë dhe më e gjerë e bazës tatimore, të krijohet kultura e pagimit të tatimit, dhe të ulet ky evazion fiskal.

Nuk është tërheqja e investimeve të huaja direkte ajo që neve nuk na lidh, ose investimeve strategjike që nuk na lidh. Dhe unë mendoj se këto investime strategjike duhet t'i zhvillojmë në tri fusha të caktuara: në energjetikë, sepse nuk kemi energji elektrike për investitorët që vijnë në Kosovë. S'ka. Ne me këtë kapacitet të energjisë nuk mund të presim që dikush të vijë dhe të investojë në Kosovë.

Duhet të kërkojmë investime strategjike në miniera, veçmas në "Trepçë", në aktivizimin e tyre dhe në përdorimin ekonomik të tyre, jo vetëm të konsiderojmë se jemi të pasur se kemi xehe, por të konsiderojmë se jemi të pasur se mund t'i finalizojmë këto xehe në produkte finale, dhe mund t'i eksportojmë dhe mund ta ndryshojmë bilancin tregtar me jashtë, dhe ta rrisim GDP-në në bazë të eksportit tonë, e jo ta ulim në bazë të importit që ne e bëjmë.

Dhe, si investim strategjik tani për tani është investimi në kanalet e ujitjes, sepse kemi tokë bujqësore të cilën ne e shfrytëzojmë në mënyrë ekstensive, dhe duhet ta shfrytëzojmë në mënyrë intensive, me më shumë kultura, dhe me më shumë përfitueshmëri, edhe të jemi konkurrent, në mënyrë që mos të importojmë, por t'i plotësojmë nevojat.

A mundemi ne të eksportojmë apo jo produkte bujqësore, qofshin primare, qofshin ato të përpunuara, është punë tjetër.

Dhe po ashtu është një fushë strategjike investimi në arsim dhe në shëndetësi, sepse të dy këto fusha produktive, njëra siguron që të kemi popullatë të shëndoshë, produktive, tjetra siguron që të kemi popullatë të dijshme edhe e cila është në gjendje që t'i aplikojë teknologjitë e reja dhe që të mos kemi investime suplementare apo investime shtesë, në kuadrin që e mësojmë, e që duhet ta rimesojmë nëpër shkollat tona.

Unë bëj apel te ju që ne të gjejmë një përkrahje të përbashkët, për arsye se ky nuk është program që i shërben një subjekti ose një koalicioni, ose një partie politike, është program që ne dëshirojmë t'u shërbejë qytetarëve të Kosovës, dhe puna që ne po e bëjmë, është punë e orientuar në atë drejtim.

Unë ju falënderoj për gjithë debatin që e keni bërë, pa marrë parasysh pozicionet dhe pozicionimet, por vlerësoj se neve debati na shërben dhe se bashkërisht duhet të punojmë. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Tani radha është e zotit Konjufca lidhur me propozimin që e ka për rekomandimet dhe debatin e sotëm.

GLAUK KONJUFCA: Për nevoja të këtij debati, grupet, subjektet politike opozitare e kanë përgatitur një mori rekomandimesh, të cilat nëse i referohen zotimeve të kryeministrit që i bëri këtu në foltore, atëherë mendoj se do ta marrin edhe votën pozitive nga ana e deputetëve të mazhorancës.

Pse po e them këtë, do ta marrin votën nëse i referohemi fjalimit të kryeministrit? Sepse, rekomandimi i parë ka të bëjë me përgjegjësinë dhe kryeministri thirri në përgjegjësinë më të madhe të deputetëve, të mazhorancës, dhe jo vetëm të mazhorancës, por edhe të ministrave këtu të cilët duhet t'i përgjigjen, të japin llogari përpara Kuvendit, të jenë të përgjegjshëm në dëgjimet publike që ua bëjnë komisionet dhe të gjitha pyetjet parlamentare, debatet parlamentare që zhvillohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe rekomandimi i parë ka të bëjë me këtë kategori. Pra, me kategorinë e përgjegjësisë së ministrave të këtij Kabineti qeveritar përpara Kuvendit.

Mendoj se do ta marrë votën pozitive edhe rekomandimi i dytë, sepse, rekomandimi i dytë thërret për transparencë.

Çfarë lloj transparence? Transparencë që çdo marrëveshje paraprake që është e nivelit ndërkombëtar apo që Qeveria e kategorizon si marrëveshje ndërkombëtare, të mos ndodhë më që në këtë Kuvend të na vjen sikur Marrëveshja e drejtësisë.

Çka po dua të them me këtë?

Që Kuvendi të jetë krejtësisht jashtë procesit, prej fillimit deri në fund, që këtë ta dijë se çka po ndodh vetëm Qeveria;

Të shkojë atje ta konkludojë një marrëveshje të cilën e ka filluar Qeveria e mëhershme;

Kuvendi të jetë i përjashtuar nga ky proces përgjatë gjithë kohës dhe ne si deputetë vetëm kur e çelim atë rutinë që e kemi në hollë atje, rutinë e deputetëve për materiale tona, ta gjejmë një marrëveshje të cilën e ka konkluduar kryeministri me një shtet tjetër, i cili nuk na njeh dhe thotë – deputetë të Kuvendit të Kosovës, kjo është marrëveshja, ja urdhëroni.

Kështu nuk kemi qejf më të na ndodh. Dhe kjo është kërkesë plotësisht e arsyeshme. Kjo ka të bëjë...

(Ndërhyrje)

Jo, rekomandimet i kam lexuar, unë po i shpjegoj rekomandimet.

Tash po të çuditshëm jeni edhe ju. Domethënë, në këtë kohën e fundit, që më takon me Kushtetutë dhe me Rregullore të Kuvendit, po mundoheni të ma merrni. Zoti Mustafa, e keni njëfarë kulture elementare dhe nuk po mund të flas prej juve. A po më kupton? Nuk është kjo fer, dhe i thoni vetes profesor! Turp duhet t' ju vjen.

Rekomandimi i tretë, ka të bëjë me ato që po ndodhin në fushën e drejtësisë. Do të ishte mirë që në njërën prej seancave të ardhshme, ministri i Drejtësisë t'i sqarojë të gjitha këto çështje që ngritën në rekomandimin e tretë.

Rekomandimi i katërt ka lidhje me kontrollin mbi Doganat dhe evazionin fiskal. Për këtë na u tha që është i përkushtuar edhe kryeministri, që të mos na ndodhin më gjëra të tilla, siç po i shohim disa kompani me evazionin e tmerrshëm fiskal duke e dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës dhe rekomandimi i katërt flet për një kontroll më të shtuar në Doganat e Kosovës.

Rekomandimi i pestë - Të fillojnë së zbatuari disa taksa doganore për prodhime të cilat i subvencionojnë shtetet tjera, që kur të vijnë këtu në Kosovë, të mos i mbysin prodhimet tona vendore, por ato të jenë të konkurrueshme. Dhe kërkojmë zbatimin e masave të tilla.

Edhe Qeveria po më duket që është e përcaktuar për këtë drejtim, kështu po na thonë me deklarata dhe me fjalë. Këtë mund ta vërtetoni edhe me votën tuaj si deputetë të mazhorancës.

Rekomandimi i gjashtë është po ashtu për transparencë, të publikohet kontrata për autostradën Prishtinë-Hani i Elezit.

Rekomandimi i shtatë- të jetë se sa i përket premtimeve dhe zotimeve të Qeverisë për “Trepçën”. “Trepça” të përfundojë statusi i saj, ashtu sikur që u keni premtuar minatorëve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Rekomandimi i tetë ka të bëjë me bërjen transparente të gjitha procedurat të tenderimit sa i përket Termocentralit “Kosova e Re”.

Rekomandimi i nëntë ka të bëjë me rritjen e buxhetit në sektorin e furnizimit me ujë. Këtu po besoj se pajtohem të gjithë, se ka nevojë.

Rekomandimi i dhjetë - Që ta bëni më konkrete këtë strategjinë e punësimit, me një dokument të veçantë, dhe

Rekomandimi i njëmbëdhjetë - të bëhet publike ky vendimi për shkarkimin e Jablanoviqit.

Këtu mendoj se mund të ketë zhvillime më pozitive, kështu që duke iu referuar edhe fjalimit të kryeministrit, mendoj se të gjitha zotimet e tij ishin në përputhje me këto rekomandime.

Dhe, tash për ta vërtetuar këtë gjë, a ishte kjo vetëm retorikë apo ishte e vërtetë, ju këtë e vërtetoni me votën tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, do të lus regjinë t’i bjerë ziles për t’u futur deputetët në sallë, ata që donë të votojnë, e nuk janë në sallë.

Në sallë janë 67 deputetë. Vazhdojmë me votimin e propozim- rekomandimeve lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe programin qeverisës të propozuara nga deputeti Glauk Konjufca.

Lus regjinë dhe ju të nderuar deputetë, që të përgatitemi për votim dhe votojmë tani.

Atëherë, konstatoj se 20 vota janë për, 6 abstenime dhe 38 vota kundër, Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe programin qeverisës të propozuara nga deputeti Glauk Konjufca.

Tani është bërë vonë dhe a të vazhdojmë në orën 16. Zoti Grabovci e ka fjalën, nëse doni ta shtyjmë për një ditë tjetër...

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Ne kishim vërtet një debat të gjatë dhe kemi konsideratë se kolegët e opozitës janë të lodhur dhe kisha propozuar që pjesa tjetër të mbetet për seancën e ardhshme, pra të shtyhet seanca për ditën e marte dhe të vazhdojmë me pjesën tjetër, sepse vërtet jemi të lodhur dhe duhet të shkojmë në drekë. Prapë po e them Glauk, ne kemi konsideratë që keni nevojë të pushoni, sepse i keni dëgjuar duhet përpunuar mirë këto informacionet që i keni marrë, shumë të qarta, shumë të thukëta prej Qeverisë për perspektivën vërtet evropiane të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Po, edhe ne jemi që seanca të jetë të martën meqë ka disa pika, të hënën është festë dhe jemi për atë që kjo seancë të shtyhet dhe të vazhdohet javën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po Ademi, në emër të mazhorancës dhe në emër të Qeverisë tha ne jemi të lodhur. Nuk kam çka t'i shtoj asaj thënie gjeniale të tij, e që e përshkruan këtë Qeveri më së miri. Dhe unë mendoj që ne jemi për të vazhduar. Pra, si opozitë ne jemi për të vazhduar, ne nuk jemi lodhur fare. Secili e thotë atë mendimin e vet, por mos na projektini lodhjen këtu, sepse tash ky brenda tri fjalive tri kundërthënie i bën. Së pari, opozita është e lodhur, pastaj tha ne jemi të lodhur. Nuk po e di që është në opozitë ky. Dhe pastaj që opozita po kërkon për të pushuar. Unë po flas në emër të grupeve opozitare, ne jemi për të vazhduar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Gjithashtu edhe Grupi Parlamentar i Aleancës, janë shumë të pushueshëm dhe janë për të punuar. Po shihet kush është i lodhur dhe jo vetëm që ishin të lodhur se vërtet janë lodhur me një program të cilin e panë edhe vetë më në fund që s'pati kurrëgjë konkrete dhe ashtu i lodhshëm sikur është edhe vetë Qeveria, kështu që mundemi të vazhdojmë.

KRYESUESI: Atëherë, meqenëse s'ka konsensus, unë e hedh në votim, kush është për ta shtyrë të martën. I numëroni votat, ju lutem!

Kush është kundër? Numëroni votat.

Atëherë shumica janë që seanca të shtyhet për të martën, dhe vazhdojmë në orën 10:00. Mirupafshim!

* * *

E premte, më 7 prill

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 2 dhe e vazhduar më 3 prill

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 2 dhe 3 prill 2015.

Sipas rendit të mbetur, vazhdojmë:

2. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni Funkcional, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Zharku, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta paraqes Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës është miratuar nga Qeveria me vendimin numër 01/12, datë 5 shkurt 2015.

Nxjerrja e këtij projektligji ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale, si dhe krahaskimin dhe zgjidhjen e dallimeve ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit të vitit 1999 dhe dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Arsyeja tjetër për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në përcaktimin, funksionimin dhe organizimin e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, me të cilën synohet dhe lehtësohet zbatimi, zgjidhja e kërkesave, zbatimi i skemës së qirasë, pranimi, krahaskimi, si dhe verifikimi i dokumenteve kadastrale.

Me këtë projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shqyrtuar një sërë opsionesh të mundshme.

Opsioni i rekomanduar është nxjerrja e ligjit të ri me qëllim të zbatimit të konkluzioneve të dialogut teknik që kanë të bëjnë me dokumentet kadastrale dhe krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si rezultat i konkluzioneve operative nga dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me lehtësimin e BE-së, për

kthimin e dokumenteve kadastrale para vitit 1999 të marra nga Kosova, si dhe konkretizimin e disa normave juridike.

Marrëveshja për kthimin e dokumentacionit kadastral që është marrë nga Kosova gjatë luftës së vitit 1999 është arritur në shtator 2011 në Bruksel, në kuadër të dialogut teknik që është zhvilluar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Marrëveshja parasheh kthimin e 12 milionë dokumenteve nëpërmjet Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Ajo përfundimisht mbyll ekzistimin dhe funksionimin e qendrave ilegale paralele të kadastrës që funksionojnë në Republikën e Serbisë, si dhe mundëson që në Kosovë ta kemi një sistem kadastral të kompletuar dhe të besueshëm konform Kushtetutës së Kosovës dhe standardeve evropiane.

Marrëveshja në fjalë gjithashtu është në interes të qytetarëve të shtetit, sepse riparohen dëmet e krijuara nga lufta në këtë fushë, mundëson zgjedhjen e kontesteve pronësore të pronave private dhe publike në Republikën e Kosovës.

Kjo agjenci është e pavarur dhe e përkohshme, e rregulluar edhe sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Projektligji po ashtu i rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, si dhe funksionimin dhe organizimin e Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë, Sekretarisë ekzekutive, Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona.

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë dhe me standardet e BE-së.

Të nderuar deputetë,

Ju propozoj që projektligjin ta miratoni në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me të të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Zharku!

Tani hap diskutimin në parim lidhur me ligjin. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funksion për Legjislacion, zonja Albulena Haxhiu. Atëherë, Komisioni paska vendosur që të raportojë zonja Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2015, e shqyrtoi Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës, pasi ky projektligj i plotëson kushtet për t'u proceduar në parim në Kuvend.

A mund të flas edhe në emër të Grupit?

KRYESUESI: Sërish e merr fjalën zonja Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SALEVIJE HALIMI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe e mbështet në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, zoti Zemaj është paraqitur.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj, që ka të bëjë për themelimin e Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës.

Edhe arsyetimi që e paraqiti në emër të Komisionit për Legjislacion, është bazuar në atë që ne e kemi shqyrtuar edhe në legjislaturën e kaluar sa i përket themelimit të Agjencisë Kosovare për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe që ka të bëjë me librat kadastralë, por edhe me marrëveshjet teknike që janë arritur nga Qeveria e Kosovës në raport me Serbinë.

Ky projektligj tash ka kaluar dhe e ka atë historinë e vet, edhe pse Kuvendi e ka rikthyer një herë për shqyrtim, duke u thirrur në atë që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur.

Grupi Parlamentar i LDK-së në shqyrtimin e saj ka vendosur ta përkrahë për shkak se janë plotësuar dhe janë eliminuar ato dyshimet tona, duke u mbështetur në marrëveshjen ndërkombëtare, që është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës, e që ka të bëjë me misionin e BE-së në Kosovë dhe letërkëmbimin e Presidentes me ish-baroneshën Eshton.

Duke marrë parasysh që Kosova ka nevojë që ta ketë një Agjenci Kosovare të tillë për Krahaskim dhe Verifikim të Pronës dhe çështjet e ndërlikuara që kanë ndodhur me pronat, qofshin ato shoqërore, qofshin ato private, në Kosovën e pasluftës, ne japim përkrahjen në parim. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Fillimisht duket sheshit se ky projektligj derivon direkt nga marrëveshja për kthimin e kopjeve kadastrale dhe synon themelimin e një agjencie që shumë më tepër është ndërkombëtare, dhe atë jo vetëm në përbërje, por edhe në bazën juridike të funksionimit, financim të veçantë dhe vendimmarrje jashtë sistemit ligjor të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, me miratimin e këtij ligji, nëse ndodh, sikur edhe me marrëveshjen me Serbinë për çështjen e pranimin të kopjeve në vend të origjinalit të dokumentacionit kadastral, Kuvendi po e legalizon aktin e vjedhjes dhe të plaçkitjes së dokumenteve të Kosovës dhe për pronat e Kosovës.

Ndërsa me themelimin e kësaj agjencie po nis edhe funksioni në bazë të rregullave dhe interesave të Serbisë si plaçkitëse e këtyre dokumenteve.

Për një shtet sovran, si ky projektligj, ashtu edhe agjencia që ky themelon janë absolutisht të panevojshme. Ky projektligj është rrjedhojë dhe e formalizon pranimin kriminal që librat kadastralë të Kosovës t'i mbajë Serbia.

Është kriminal, pasi Serbia i ka vjedhur këta libra kadastralë nga Kosova, e në anën tjetër për shkak se administrimi i dhunshëm që Serbia ia ka bërë pronës private të shqiptarëve në Kosovë prej se e ka uzurpuar këtë ka qenë kriminal.

Pas tërë atij pompoziteti të përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë, tash po e themelojmë një agjenci, e cila edhe formalisht do të jetë nën kontroll të plotë të përfaqësuesit special të Bashkimit Evropian.

Janë disa çështje shqetësuese në këtë projektligj dhe sigurisht që edhe deputetët tjerë të grupit parlamentar do t'i adresojnë. Unë po i përmend vetëm disa.

E para ka të bëjë me përbërjen e Bordit prej 5 anëtarësh, nga të cilët tre emërohen nga PSBE-ja, ndërsa financimi respektivisht kompensimi financiar nuk do të jetë i njëjtë për të gjithë anëtarët e tij.

Lihet e paqartë se çfarë ndodh për rastet kur hasen mospërputhje ndërmjet kopjeve kadastrale nga Serbia dhe dokumenteve kadastrale të Kosovës.

Po ashtu, pesë anëtarët e Komisionit për Karahasim dhe Verifikim të për Pronës dy do të emërohen nga Kuvendi, tre nga PSBE-ja, duke përfshirë edhe përfaqësuesin e komuniteteve joshumicë.

Ky komision nuk obligohet t'i marrë për bazë vendimet përfundimtare të institucioneve gjyqësore dhe administrative, por vetëm i sugjerohet t'i marrë parasysh.

Dhe, tjetra, ankimimi ndaj vendimeve të këtij komisioni, jo vetëm që është i kufizuar, por ato janë edhe të kontrolluara. Kjo konsideroj që bie ndesh edhe me parimet themelore të drejtësisë, që palët kanë të drejtë ta ankimojnë çdo vendim.

Me këtë ligj, kur bëhet fjalë për ankesat e palëve ndaj vendimeve të këtij komisioni, ato mund të parashtrojnë ankesë vetëm nëpërmjet Sekretarisë së kësaj agjencie. Po ashtu, Paneli i Gjykatës Supreme që do t'i shqyrtojë këto ankesa do të jetë i veçantë, si në mandat, ashtu edhe në përbërje, meqë në panelin prej tre gjyqtarësh dy emërohen në bazë të marrëveshjes me BE-në për sundimin e ligjit, e vetëm një nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Një kufizim tjetër ka të bëjë edhe me pamundësinë e shfrytëzimit të fakteve të reja nga palët.

Gjithashtu, gjatë interpretimit të këtij ligji apo akteve nënligjore me të cilat zbatohet ky ligj, Gjykata Supreme e Kosovës mund t'i marrë parasysh dispozitat e ligjit për kompetencat e Gjykatës Supreme për procedurat civile, por nuk obligohet që t'i marrë parasysh ose për bazë, siç do të duhej të ishte në fakt.

Në fund, konsiderojmë që pushteti ekzekutiv për administrimin e pronës është thelbësor për sovranitetin, është thjesht e paprecedent për një shtet që të mos e ketë regjistrin historik të evoluimit të transaksioneve pronësore.

Ne konsiderojmë që me këtë aranzhim të kompletimit të regjistrit kadastral shqiptarët rrezikojnë përsëri t'u merren pronat që i kanë blerë dhe paguar shumë më shumë se një herë.

Janë mbi 6 procese të kolonizimit të Kosovës me kolon serbë që nga viti 1912. Në vend se të korrigjohet padrejtësia historike e këtij kolonizimi, ne me ligj po i hapim derë një kolonizimi të ri potencial.

Për këtë arsye, ne si subjekt politik e kundërshtojmë fuqishëm këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Po ashtu, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se janë disa vërejtje kritike në këtë projektligj, të cilin nuk do ta përkrahim, për arsyet në vijim:

Sipas këtij ligji, do të zgjidheshin kërkesa pronësore dhe zgjidhje dalluese ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale të sekuestruara padrejtësisht nga shteti serb para qershorit të vitit 1999 dhe të dokumenteve aktuale në Kosovë.

Objektivi i tillë i ligjit në shqyrtim është në kundërshtim me aktet ligjore, juridike Civile, sipas të cilave rregullohen dhe realizohen çështjet pronësore, ndryshe nuk është praktikë e mirë që çështjet pronësore të trajtohen e të rregullohen me procedurë administrative, siç është konceptuar me këtë ligj.

Të dhënat kadastrale origjinale kurdoherë duhet të jenë valide e të pakontestueshme dhe ndryshimet në to duhet të pranohen nëse janë bërë në bazë të procedurave ligjore.

Andaj, përballë ekzistimit të gjykatave kompetente, madje edhe të disa organeve administrative të autorizuara për çështje pronësore juridike, rezulton se nuk ka asnjë nevojë për ta krijuar edhe

një agjenci për krahasim e verifikim të pronave, sepse na krijohet edhe një strukturë e panevojshme institucionale dhe shumë e kushtueshme.

Sipas këtij ligji, do të formoheshin dy komisione:

1. Komisioni për kërkesat pronësore dhe
2. Komisioni për verifikim dhe vendosje për pronë.

Mirëpo, autorizimet dhe fushveprimtaria e tyre nuk janë veçuar, e as përcaktuar më mënyrë të qartë. Madje, në nenin 3 të po këtij ligji për Komisionin për Verifikim dhe Vendosje për Pronë nuk verifikohen as nuk definojnë autorizimet dhe fushëveprimtaria e tij.

Teksti e përmbajtja e këtij ligji është shprehimisht nën nivelin e standardeve juridike. Konkretisht, nëse e shihni nenin 9 të këtij ligji është dhënë një formulim juridikisht i paqëndrueshëm, kur theksohet se, “pos nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj, ose më ndonjë akt nënligjor tjetër në zbatimin e këtij ligji”, që do të thotë se dispozitat e miratuara të këtij ligji nga Legjislativi do të mund të ndryshoheshin, apo do të mund hiqeshin me dispozita të ndonjë akti nënligjor, të miratuar nga Ekzekutivi. Pra, sipas kësaj dispozite, Ekzekutivit do t’i jepeshin autorizime mbilegjislative.

Dhe, duke marrë parasysh që e kemi edhe një marrëveshje, e cila absolutisht nuk e përkrah të drejtën e qytetarëve të Kosovës për pronën e tyre, ky është një absurd.

Me këtë ligj, nëse do të miratohej kështu siç është propozuar, cenohen rregullat referuar të dy shkallëve administrative, si dhe ato të konfliktit me Gjykatën Supreme të Kosovës, sepse:

1. Nuk caktohet e drejta e palës në procedurë administrative, që çështja e saj të trajtohet sipas ankesës si mjet juridik i rregullt në instancën administrative të shkallës së dytë, por drejtpërdrejt kalohet shkalla e dytë dhe ajo i procedohet Gjykatës Supreme, të cilën praktikisht e bën organ administrativ të shkallës së dytë.
2. Gjykata Supreme, në çdo kohë e kudo, në shtetet e përparuara të kohës, i gjykon me procedurë konfliktet administrative, por asnjëherë e askund nuk shndërrohet në organ të administratës së shkallës së dytë duke vendosur ankesa në vend të gjykimit, sipas kërkesë-padive në konfliktin administrativ.

Këto janë vetëm disa nga vërejtjet shumë serioze në këtë ligj, i cili, si i tillë, së paku nga Aleanca për ardhmërinë e Kosovës dhe ne i thërrasim edhe deputetët e grupeve tjera parlamentare që ta kthejnë në ripërpunim, sepse nëse kalohet sot si i tillë do të ketë pasoja afatgjate për çështjen e pronës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar “Nisma”, zonja Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne e kemi shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës dhe duke i parë vërejtjet, të cilat u cekën nga anëtarët e Komisionit për Legjislacion, por edhe vërejtjet të cilat edhe ne i kemi parë gjatë shqyrtimit të tij, po ashtu edhe ne jemi kundër dhe nuk do ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+” nuk është paraqitur askush. Ju lus që kur doni të paraqiteni për diskutim, shtypeni butonat, për atë punë i kemi vendosur. Zoti Paqaku e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlament “6+” në parim do ta përkrahë këtë ligj, por duke pasur parasysh që pjesëtarët e komunitetit rom i kanë humbur pronat e tyre duke u larguar nga Kosova që më herët, mendojmë se te pronat e komuniteteve pakicë duhet të fokusohemi më tepër nëpërmjet ligjit, duke pasur parasysh se shumë prona të komunitetit rom tani janë inekzistente në Pejë, Prizren, Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan, e kështu me radhë.

E them edhe një herë, ne në parim do ta përkrahim këtë ligj, por duke u fokusuar më tepër në pronat inekzistente të komunitetit rom, të cilët tanimë i kanë humbur ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet ose shefat e grupeve i kanë shteruar diskutimet e tyre. Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka zoti Aliu.

AGIM ALIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër Zharku,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës është një projektligj jashtëzakonisht i rëndësishëm duke u bazuar në fushëveprimin e tij, që është zgjidhja e kërkesave për pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën private bujqësore dhe komerciale, pronën private të bashkësive fetare, si dhe krahësimin e dokumenteve kadastrale origjinale nga viti 1999 me gjendjen aktuale të regjistruar në zyrat komunale kadastrale.

Çështjet pronësore janë ato të cilat kanë shkaktuar dhe shkaktojnë konflikte ndërmjet njerëzve, e nuk janë të vogla rastet kur këto konflikte kanë përfunduar me humbje të jetës së qytetarëve tanë, edhe pse e drejta e pronës është një e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Problemet pronësore janë të kategorive të ndryshme, duke filluar nga të qenët pronarë në gjendje faktike, mirëpo juridikisht asnjëherë nuk janë regjistruar si pronarë për faktin që kriteret e regjistrimit si pronarë në ish-sistemin e kanë humbur të drejtën e pronarit në disa benificione, si ndihmat e dhëna, si shtesat për fëmijët që ndjekin shkollat, ngarkesa të tatime e të tjera.

Lufta në Kosovë e ka komplikuar edhe vështirësuar procedurën e regjistrimit të pronave për mungesën e dokumentacionit kadastral për shumicën e komunave të Kosovës, për të cilat shënimet kadastrale janë marrë nga ish-okupatori serb në vitin 1999.

E drejta e pronësisë i ka penguar investimet në periudhën e pasluftës, e ka stimuluar ndërtimin ilegal, sepse dihet që për t'u pajisur me leje ndërtimi, dokumentacioni primar është dëshmia mbi pronësinë, që ka krijuar shpenzime shtesë për qytetarët të cilët janë detyruar t'i marrin dokumentacionet kadastrale origjinale nga Serbia për pronën e tyre për ta reregjistruar dhe për të vazhduar investime me leje sipas ligjeve në fuqi.

Mungesa e dokumentacionit kadastral po ashtu e ka vështirësuar punën administrative komunale, e cila e ka në përgjegjësi regjistrimin dhe evidentimin e të drejtave pronësore. E ka vështirësuar punën e organeve të drejtësisë për marrjen e vendimeve në lidhje me të drejtën e pronësisë.

Ky ligj i përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave, procedurat prej paraqitjes së kërkesave, shqyrtimit, marrjes së vendimeve dhe deri në të drejtën e ankesës.

Konsideroj që miratimi i këtij ligji dhe implementimi i tij do t'i ndihmojë shumë qytetarët në zgjidhjen e problemeve pronësore, në regjistrimin e tyre si pronarë, do ta plotësojë dhe kompletojë bazën e të dhënave kadastrale në administratat komunale, si dhe do ta ndihmojë dhe lehtësojë punën e gjykatave, të cilat janë shumë të ngarkuara me kërkesat për zgjidhjen e çështjeve pronësore.

Jemi të vetëdijshëm që implementimi i këtij ligji do të kërkojë angazhim shumë të madh, kohë për t'i shqyrtuar kërkesat dhe për t'i verifikuar ato kur paraqiten me mospërputhje të dokumentacionit, mirëpo do t'i ndihmojë qytetarët dhe do t'u mundësojë ta shfrytëzojnë të drejtën e garantuar për t'u regjistruar pronat e tyre që ata i posedojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milazim Haliti e ka fjalën.

MILAZIM HALITI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Projektligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, i propozuar nga Qeveria e Kosovës, i cili e ka opinionin ligjor të përputhshmërisë dhe ligjshmërisë të Bashkimit Evropian, është i hartuar në mënyrë të duhur dhe i përmban dispozitat e nevojshme, duke filluar nga përcaktimi i organizimit të detyrave dhe përgjegjësiive të Agjencisë për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Është ky projektligj si obligim që del nga marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e BE-së dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Projektligji ka për qëllim zgjidhjen dhe vendosjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme private, bujqësore, komerciale dhe të bashkësive fetare.

Nëpërmjet këtij projektligji bëhet krahasimi dhe dallimi ndërmjet dokumenteve kadastrale origjinale, të cilat i kanë marrë autoritetet e atëhershme serbe nga Kosova, do të thotë para vitit 1999, përkatësisht në periudhën ndërmjet 27 shkurtit të vitit 1998 dhe 20 qershorit të vitit 1999, dhe dokumenteve kadastrale, që janë aktuale në vend dhe që ekziston një mospërputhshmëri ndërmjet tyre sa u përket pronave të paluajtshme.

Këto çështje do të rregullohen dhe vërtetohen nëpërmjet organizimit me rastin e formimit të agjencisë, në kuadër të së cilës do të jetë Bordi Mbikëqyrës, Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa dhe Komisioni për Verifikim dhe Vendosje.

Me procedurat që do të zhvillohen për vendosjen e këtyre rasteve do të konstatohen dallimet dhe do të vërtetohen mospërputhjet e dokumenteve origjinale me gjendjen aktuale sipas dokumenteve kadastrale të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, parashihen edhe procedurat ankimore lidhur me vendimet me rastin e konstatimit real të fakteve dhe e tërë kjo procedurë zhvillohet nëpërmjet ankesave dhe në instanca gjyqësore nëpërmjet Gjykatës Supreme të Kosovës, e mendoj që në këtë drejtim duhet të bëhen ndryshime dhe procedura ankimore duhet të rregullohet me procedurë administrative, e pastaj të kalohet në instancën e Gjykatës Supreme të Kosovës, e mendoj që gjatë amendamentimit kjo çështje do të rregullohet.

Duke e vlerësuar se ky projektligj është i domosdoshëm dhe i rëndësishëm për zgjidhjen e rasteve të përmendura më lart dhe se do ta rregullojë një sferë të rëndësishme, unë e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në pikën 2 të memorandumit shpjegues të Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dialogu në Bruksel quhet dialog ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Pra, ky dialog quhet ashtu siç e quan Serbia, e cila nuk e njeh shtetin e Kosovës. Natyrisht që kështu dialogun e quan edhe Brukseli, mirëpo në këtë projektligj edhe vetë Qeveria e Kosovës po heq dorë nga cilësimi i dialogut si Kosovë-Serbi.

Në pikën 4 të memorandumit shpjegues thuhet që, “natyra e pavarur e AKP-së, strukturat e saj aktuale me ndryshime të kufizuara dhe me përkrahjen e vazhdueshme të donatorëve ishin paraparë që të mbeten siç janë, në mënyrë që dëshira e palëve për zbatim të shpejtë dhe për funksionim të konkluzioneve të dakorduara nga dialogu teknik i datës 2 shtator 2011 të plotësohet”.

Së pari, konkluzionet e dialogut teknik të datës 2 shtator 2011 e bënin Kosovën shtet-kopje, sepse Qeveria pajtohej që t’i marrë kopjet e dokumentacionit kadastral, i cili paraqet element thelbësor të shtetndërtimit dhe sovranitetit.

Së dyti, Qeveria e Kosovës mund ta shprehë dëshirën për plotësim të konkluzioneve të dakorduara, por nuk mund të flasë për dëshirën e palëve, sepse nuk ka pasur as dëshirë, e as vullnet të Serbisë për këtë.

Dhe, së treti, nuk ka kuptim të flitet për dëshirë për zbatim të marrëveshjeve, siç bëhet këtu, por vetëm për obligim, ose detyrim të zbatimit të tyre.

Neni 6 i këtij projektligji parasheh që Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë të përbëhet prej pesë anëtarëve, tre prej të cilëve i emëron përfaqësuesi special i BE-së, ndërsa dy anëtarë Kuvendi i Republikës.

Mandej, në nenin 8, pika 2, thuhet që Komisioni për Kërkesa Pronësore përbëhet prej tre anëtarëve, nga të cilët dy janë ndërkombëtarë, që u vazhdohet mandati, kurse vetëm njëri emërohet nga Kuvendi i Republikës, pas propozimit nga kryetari i Gjykatës Supreme.

Më tutje, në nenin 9, Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona thuhet se do të përbëhet prej 5 anëtarëve, nga të cilët tre emërohen nga PSBE-ja, ndërsa dy nga Kuvendi i Republikës, pas propozimit nga kryetari i Gjykatës Supreme.

Rrjedhimisht, ky projektligj e nënshton Kuvendin e Republikës dhe Kosovën të shpallur shtet i pavarur ndaj përfaqësuesit special të BE-së për shkak të dialogut në Bruksel. Me këtë nënshttrim, i cili shihet në raportet 1:2 dhe 2:3 vendorë ndaj ndërkombëtarëve, sipas emërimeve, Kosova edhe është Republikë e pakicës, edhe vend të cilit nuk po i zvogëlohet diktati ndërkombëtar, por po i shtohet ai. E thënë ndryshe, kësi projektligji nuk sjellin shtetet e pavarura e republikat parlamentare, por kolonitë vasale e krahinat e varura.

Pika 3 e nenit 10 tregon që jo vetëm emërimi, por edhe shkarkimi i anëtarëve të komisioneve mund të bëhet vetëm nga autoriteti përkatës që i ka emëruar, e që do të thotë se ky projektligj e vulos përgjithnjë dyzimin institucional përbrenda Kosovës me komplet Kuvendin e Republikës, të dominuar nga një zyrtar i vetëm ndërkombëtar, përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian.

Në planin praktik, dështimi i garantuar i këtij trupi të instaluar vërtetohet më së miri me funksionimin e paraardhëses së tij, Agjencisë Kosovare të Pronës. Gjatë gjithë mandatit prej se është themeluar kjo agjenci, ajo shquhej si vendtakim i pazarllëqeve ndërmjet palëve, asaj posedueses dhe pretendueses, për të drejtën e pronësisë. Jo pak zyrtarë të kësaj agjencie kanë shërbyer si ndërmjetësues të këtyre pazarllëqeve për transferimin e pronave. Tani, me natyrën konfirmuese për kopjet e librave kadastralë, kësaj agjencie i mundësohet që nga ndërmjetësuesi ta marrë edhe rolin e ekzekutorit. Kjo agjenci, krahas asaj që në kuptimin politik dhe juridiko-kushtetues paraqitet si mutacion brenda sistemit tonë shtetëror, do të paraqesë edhe pengesë në procesin e zbatimit të së drejtës.

Në planin teorik, i cili do të aktualizohet në praktikë, kjo agjenci paraqet cenimin e vetë kuptimit që në konceptin e së drejtës quhet e drejta subjektive. Pra, Komisioni për Verifikim dhe Vendosje të Pronës, bazuar në nenin 13 të këtij projektligji, sipas fuqisë ligjore ‘ex lege’, vihet në veprim të vërtetimit të krahasimit të gjendjes faktike dhe asaj juridike të servuar me kopjet e dokumenteve kadastrale që janë dërguar nga Serbia. Kjo qasje vjen në kundërshtim me të drejtën

në diskrecion të qytetarëve, që të drejtën e tyre subjektive të karakterit absolut ta mbrojnë sipas vullnetit të tyre. Mirëpo, ky karakter që i është instaluar kësaj agjencie tregon më së miri se letërkëmbimi ndërmjet presidentes Jahjaga dhe baroneshës Eshton është bërë burim kushtetues dhe ligjor. E, ky burim, në kuptimin material, nuk e paraqet vullnetin e forcës që e krijon të drejtën, por vullnetin e Serbisë që ta harmonizojë normativën e Republikës së Kosovës me kërkesat e brendshme kushtetuese dhe ligjore të saj në një raport ku ajo veten e konsideron si republikë, ndërsa Kosovën si krahinë.

Përfundimisht, dialogu teknik e politik me Serbinë, jo vetëm që e ka shtuar fuqinë e Serbisë në Kosovë, duke e bërë Serbinë palë për aq shumë çështje e gjëra të brendshme të Kosovës, por edhe e ka zvogëluar fuqinë e Kuvendit të Republikës karshi instancave ndërkombëtare mbi Kosovën, të cilat, me këso ligjesh, vetëm sa po trashen, dy vjet e gjysmë pas asaj që u quajt përfundim i mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti. Fjalën e ka zoti Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës vjen si rezultat i përpjekjes së qeverive të deritanishme të Kosovës, të cilat nuk kanë qenë në gjendje ta rregullojnë një problem thelbësor, siç është problemi i pronës.

Më lejoni që me këtë rast të jua përkujtoj që pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Qeveria e atëhershme Jugosllave arriti që këtë problem ta zgjidhë brenda 10 vjetëve, ndërsa Qeverisë së Kosovës nuk i kanë mjaftuar 15 vjet për t'i siguruar regjistrat e nevojshëm për regjistrimin e pronës.

Konsideroj që deri tani ka pasur mungesë të vullnetit për ta rregulluar këtë çështje. Njëra prej arsyeve pse mungon vullneti politik është edhe fakti që kjo situatë është përdorur për ta plaçkitur pronën publike, sidomos tokën bujqësore.

Unë nuk kam fakte, por flitet që ka edhe politikanë që kanë përfituar shumë nga kjo gjendje.

Nëse u referohemi fakteve, dihet që dokumentet kadastrale prej vitit 1983 deri në vitin 1999 janë vjedhur nga pushteti serb.

Kjo, përveç shumë problemeve të tjera, ka shkaktuar edhe një problem, për të cilin, me sa di unë, nuk është folur pak në media, siç është plaçkitja e pronës publike bujqësore.

Ju e dini të gjithë se para luftës ka pasur këmbim të pronave ndërmjet kooperativave dhe qytetarëve. Sa për ilustrim, po e përmend një rast konkret.

Qytetari X ka kërkuar ta këmbëjë një parcelë të veten me një parcelë të kooperativës. Të dyja palët janë pajtuar për këmbimin. Qytetari X e ka marrë dokumentin e pronësisë për pronën e re të këmbyer. Edhe kooperativa e ka marrë pjesën që e ka këmbyer.

Pas përfundimit të luftës, personi X, në mungesë të dokumentacionit kadastral, e ka shfrytëzuar rastin dhe e ka regjistruar pronën e këmbyer përsëri si pronë të veten, duke prezantuar dokumente të vjetra si dëshmi. Kooperativa nuk ka pasur gojë të flasë dhe ta kthejë pronën që i ka takuar asaj para këmbimit. Në këtë mënyrë, personi X e ka shtuar pasurinë për 100% brenda ditës.

Të gjitha këto janë bërë duke e shfrytëzuar, në njërën anë, mungesën e dokumentacionit dhe, në anën tjetër, mungesën minimale të ekspertizës nga pushteti kur janë vërtetuar pronat e pronarëve të tillë.

Kështu, zonja dhe zotërinj, janë tjetërsuar mijëra hektarë të pronës bujqësore publike, ndërsa shteti herë në mënyrë të tërthortë, e herë të drejtpërdrejtë, është vënë në funksion të mashtrimit.

Dëmet e shkaktuara kështu, për shkak të korrupsionit, në mungesë të ekspertizës minimale, për shkak të mendjelehtësisë dhe mungesës së profesionalizmit, e kanë dëmtuar jashtëzakonisht shumë pronën publike. Kjo që unë them është vetëm maja e akullnajës. Përmasat e mirëfillta të këtij do të shihen gjatë viteve në vijim.

Ligji që ne e kemi para vetes, përveç faktit që është i panevojshëm, dhe mendoj që kjo është shumë e rëndësishme të thuhet, nuk e parasheh ngritjen e padisë prej Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona në rastet kur vërehet që prona publike është dëmtuar, pavarësisht nëse nuk është ngrehur ndonjë kërkesë më parë.

Përmasat e këtij problemi janë të mëdha dhe shpresoj që komisioni përkatës në diskutimin e tij të mos i injorohet.

Problemi tjetër që dua të shtroj është problemi që ka të bëjë me punonjësit. Neni 24, pika 1 thotë që “personeli i Agjencisë Kosovare të Pronës do të bartet në agjenci për aq kohë sa pozitat e tyre të jenë ende të nevojshme në agjenci”. Pra, nuk precizon se çka do të ndodhë me personat që do të konsiderohen si të panevojshëm.

Kjo lë mundësinë që disa punonjës të mbeten pa punë, prandaj edhe kjo çështje duhet të rregullohet me ligj.

Neni 24, pika 5, thotë që anëtarët ndërkombëtarë nuk do të marrin kompensim nga Buxheti i Kosovës. Praktika e përgjithshme njerëzore tregon që zakonisht punonjësi i përgjigjet atij që e paguan, në këtë rast jo institucioneve të Republikës së Kosovës.

Në raport me Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, karshi atyre që shtruan kolegja Albulena dhe Albini, dua të shtroj edhe dy çështje që lidhen me këtë ligj, por që kanë të bëjnë me vlerat fundamentale për një shtet të pavarur: Vlerën e sovranitetit shtetëror dhe vlerën e drejtësisë.

Sovraniteti i vendit si vlerë fundamentale për shtetet e pavarura nuk vjen nga emërtimi dhe nga deklaratat “jemi shtet sovran”, por nga normat shtetërore, të cilat e sigurojnë sovranitetin e vendit.

Si duket, koalicioni qeveritar e ka një përshtypje të çuditshme dhe të panjohur për sovranitetin, çka më shtyn t'i përsëris ato që thamë në ditën e parë të kësaj seance:

Thoni që jeni për zhvillim ekonomik, por të gjitha shpresat e zhvillimit ekonomik i keni lënë tek investimet e huaja!

Thoni që jeni për sovranitet territorial, por ruajtjen e sovranitetit territorial ia keni lënë KFOR-it për shkak që nuk e keni themeluar Ushtrinë e Kosovës!

Thoni që jeni për dënimin e krimeve të luftës, ndërsa këtë çështje ua keni lënë gjykatave të huaja!

Thoni që jeni për zgjidhjen e problemit të pronave, ndërsa këtë çështje po ia lini prapë të huajve!

Atëherë, cilat shtylla të sovranitetit përfaqësoni ju?! Çfarë sovraniteti përfaqësoni ju?! Ju nuk përfaqësoni sovranitet! Ju përfaqësoni përlulje dhe në fakt jeni përlulur më shumë se sa është përlulur Lidhja Komuniste e Kosovës gjatë viteve të '70-ta dhe të '80-ta.

E dyta dhe e fundit që dua ta shtroj ka të bëjë me dokumentet e vjedhura kadastrale nga pushteti serb në Kosovë.

Është pak e habitshme për drejtësinë mënyra e trajtimit nga Bashkimi Evropian e rastit të plaçkitjes së dokumenteve kadastrave, meqë Serbisë i mundësohet ta dorëzojë një kopje të presë së grabitur, por i lejohet që origjinalin ta mbajë.

Në njëfarë mënyre, Qeveria e Kosovës dhe Bashkimi Evropian thonë që nuk ka ndonjë rëndësi nëse dikush e ka origjinalin e Mona Lizës, apo kopjen e saj.

Njerëzit e artit për këtë krahasim do t'i linçonin ata që do të mendonin se është njësoj, si kopja, si origjinali.

Tani, deputetë të nderuar, ju keni për të votuar për miratimin e këtij ligji në parim.

Paramendojeni për një moment që juve u është vjedhur makina, dhe ju sot do të votoni për t'ju dorëzuar makinën e vjedhur apo origjinalin. Jam i bindur që në rastin tuaj personal-privat, ju do të votoni që të ju kthehet makina origjinale.

Tash është fjala për një ligji, i cili ka të bëjë me Kosovë. Ta shohim si do të votoni për këtë ligj: do të votoni për origjinalin, apo për kopjen?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Topalli. Fjalën e ka zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përsëritje për të gjithë,

Në arsyetimin e ministrit në lidhje me këtë projektligj, u tha: "Këtë projektligj duhet votuar, sepse Kosova e ka obligim". Nuk tha që ky ligj është në interes të Kosovës. Unë nuk e di deri kur

ne do të votojmë ligje për të cilat dikush ka marrë obligime diku, e që janë në dëm të Kosovës. Dhe, po ashtu, me krijimin e kësaj agjencie edhe një herë konfirmohet që institucionet e Kosovës po heqin dorë nga dokumentet kadastrave, të plaçkitura nga Serbia.

Mendoj se në vend të angazhimit për hartimin e ligjeve që janë si pasojë e plaçkitjes së dokumenteve nga Serbia, institucionet e Kosovës do të duhej të angazhoheshin për kthimin e tyre në Kosovë, sepse vetëm ashtu zgjidhja është e drejtë. Me krijimin e këtyre agjencive, edhe një herë vjen në pikëpyetje prona e qytetarëve të Kosovës, të cilët edhe ashtu asnjëherë nuk i kanë pasur të sigurt ato, derisa Serbia dhe ish-Jugosllavia kanë qenë në këto pjesë të vendit.

Prandaj, mendoj që ky ligj sot nuk duhet të aprovet. Duhet të angazhohemi të gjithë që t'i kthejmë dokumentacionet, kur e kemi parasysh edhe faktin se Serbia në shumë faza gjatë pushtimit të Kosovës u ka falë prona të mëdha, e sidomos sipërfaqe të mëdha të tokës, jo vetëm serbëve që kanë jetuar në Kosovë, por të gjithë kolonëve, të cilët kanë ardhur nga të gjitha pjesët e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë këtu edhe kolonët të cilët kanë ardhur edhe gjatë viteve të '90-ta nga Kroacia.

Prandaj, aprovimi i këtij ligji është kontestim i pronës së qytetarëve të Kosovës dhe një gjë të tillë mendoj se nuk ka të drejtë ta bëjë ky Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur nga deputetët. Zoti ministër, e dëshironi fjalën për fund? Atëherë, nëse jo, të futemi në procesin e votimit.

Në sallë janë 73 deputetë, kartelat i kanë vendosur 82. Regjia, bjeri ziles që të vijnë deputetët.

Unë shpresoj që pritëm mjaft. Edhe një herë, ju them që në sallë janë 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë konstatoj që me 50 vota për, 25 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Muhamet Mustafa, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju e keni marrë një raport të detajuar lidhur me aktivitetet që janë zhvilluar për trajtimin e këtij projektligji pas leximit të parë dhe ku e shihni se është inkuadruar një numër i konsiderueshëm i aktorëve të interesuar, i deputetëve, i shoqërisë civile dhe diskutimi ka qenë përmbajtësor dhe i ka përfshirë çështjet kyçe që kanë të bëjnë me materien që rregullon ky ligj, si dhe me disa çështje që kanë qenë brengë e posaçme.

Tek amendamenti një ne e kemi një propozim për një ndryshim teknik, ngase vihet një lidhje ndërmjet këtij projektligji dhe projektligjit, i cili e ka ndryshuar më herët. Domethënë, ky është plotësimi dhe ndryshimi i dytë dhe ne ndërlidhemi edhe me tekstin bazikë, por edhe me ndryshimet që janë bërë me ligjin e plotësuar numër 04/L-111.

Gjithashtu, çështja kyçe që ka qenë në diskutim, e ku është arritur një pajtim i lartë ndërmjet deputetëve të të gjitha forcave politike, ka të bëjë me amendamentin 2, ku ne kemi propozuar që të fshihet paragrafi 2 i pikës 11.3, që ka të bëjë me rolin dhe kompetencat e komunave.

Me këtë rast, grupi që e ka analizuar këtë projektligji, por edhe komisioni, ka konstatuar se në fakt edhe paragrafi i parë i lejon mundësi Qeverisë, por edhe komunave, nëpërmjet Qeverisë, që interesat e tyre lidhur me ndërmarrjet shoqërore, pjesët dhe asetet e këtyre ndërmarrjeve të nisin iniciativa nëpërmjet Qeverisë për t'i shndërruar në ndërmarrje publike dhe pronë publike.

Kështu që, ka mbretëruar mendimi se paragrafi 2 duhet të fshihet për arsye se lejon mundësi për një interpretim dhe interferim të komunave në kompetencat që u përkasin organeve qendrore.

Gjithashtu, te ky amendament, më lejoni të konstatoj, është një gabim teknik, domethënë te neni 3 i projektligjit fshihet pjesa e dytë e paragrafit 11.3. Duhet të fshihen fjalët, se është gabim teknik “të ligjit bazik”, sepse nuk ka të bëjë me ligjin bazik, ngase ka qenë një nen i projektligjit, jo i ligjit bazik. Prandaj, në tekstin përfundimtar fjalët “të ligjit bazik” duhet të fshihen.

Amendamenti 3 ka të bëjë vetëm me një plotësim të tekstit, sepse teksti në gjuhën shqipe nuk ka qenë shumë komplet dhe shumë i qartë, prandaj është redaktuar dhe është harmonizuar që të jetë plotësisht i kuptueshëm.

Amendamenti 4 gjithashtu ka të bëjë me një përmirësim pothuajse teknik, siç është në tekstin e projektligjit “me akt normativ të veçantë”, ne e zëvendësojmë “me akt të veçantë ligjor”. Pra, jo “me akt normativ”, por “me akt të veçantë ligjor”.

Amendamenti 5 i ka dy propozime. Propozimi i parë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Amendamenti i Komisionit Funkcional ka të bëjë me një theksim se pse për “Trepçën” sillet ligj i veçantë, për shkak të interesit të veçantë dhe rëndësisë së saj, se shumë njerëz e kanë theksuar pse të sillet një ligj i veçantë, e arsyeja është për shkak të rëndësisë së saj dhe në këtë mënyrë e theksojmë këtë.

Propozimi tjetër nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funkcional, sepse kërkesa ishte me një amendament që “Trepça” qysh tani të shndërrohet në ndërmarrje publike. Lidhur me këtë kemi

pasur shumë debate dhe kemi sqaruar që vendimi definitiv të merret pas studimit të fizibilitetit dhe strategjisë, e cila do të përvijohet pastaj në Ligjin e veçantë për “Trepçën”.

Prandaj, amendamenti 2 i nenit 37 është pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Tek amendamenti 6 kemi të bëjmë me nenin 5 të projektligjit. Komisioni ka propozuar që të fshihet neni 37, pikë b, sepse hyn në disa ingerenca të organeve gjyqësore, të cilat janë rregulluar edhe me ligje tjera.

Amendamenti 7 dhe amendamenti 10 janë amendamente që komisioni i ka propozuar që të futen në këtë projektligj, edhe pse në tekstin inicial, të dërguar me projektligj nga Qeveria, nuk kanë qenë të përfshira.

Arsyeja se pse komisioni i ka propozuar këto dy amendamente ka të bëjë me faktin se ne e kemi trajtuar në Kuvend një raport të këtij komisioni lidhur me zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. Pra, ky raport është trajtuar më 12 dhjetor 2013 dhe në rekomandimet e Kuvendit është kërkuar që të precizohet më mirë përgjegjësia e Bordit.

Gjithashtu, në një dëgjim që e kemi pasur me ministrin më 3 shkurt 2015 në komision është trajtuar ky problem dhe e kemi pasur një pëlqim të Qeverisë që këto dy nene mund të futen në projektligj, për arsye se thjesht kanë mbetur teknikisht të paadresuara, por janë shumë të rëndësishme për përgjegjësinë e bordeve.

Dëgjimi publik dhe kërkesat e shoqërisë civile kanë qenë në një vijë. Unë kam parë disa sugjerime të komisioneve se kjo mund të jetë ndoshta një çështje e diskutueshme, mirëpo meqë ne i kemi konkluzionet e Kuvendit, e kemi pajtimin e Qeverisë, e kemi një konsensus në komision, unë mendoj se kjo nuk do të duhej të ishte pengesë që ne t'i bëjmë këto intervenime.

Në ndërkohë, anëtarët e komisionit, apo grupet parlamentare, kanë bërë edhe dy kërkesa, siç është propozimi i amendamentit 8, i cili ka marrë një përkrahje të komisionit, që ka të bëjë me faktin se për privatizimin e ndërmarrjeve të rëndësishme publike, edhe ndërmarrjeve me rëndësi për Kosovën, duhet të votojnë 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Lidhur me këtë çështje nuk kemi pasur konsensus në komision. Ka ekzistuar një diskutim. Ata që kanë qenë për të, kanë thënë se këto ndërmarrje janë shumë të rëndësishme dhe duhet të mbërrihet një konsensus politik brenda Kuvendit. Ata që kanë qenë kundër kanë thënë që 2/3 është një numër tepër i madh dhe mund t'i bllokojë proceset e privatizimit, dhe kjo është një çështje që nuk është debatuar mjaft në shoqëri.

Duhet t'i lihet kohë që të debatohet me ligjin që vjen për ndërmarrjet publike, i cili duhet të përgatitet, sa jam informuar, por në këtë vit nuk është në fazën e trajtimit, nuk është në programin legjislativ dhe do të vijë në vitin e ardhshëm, por nuk mendojmë se ata kanë qenë kundër për këtë nuk kanë menduar se është çështje e ngutshme dhe kjo mund të mbetet pas asnjë debati të gjerë, sepse është çështje nëse duhet të votojmë me 61 deputetë, sikur Buxhetin, me 2/3 e të pranishmëve, apo 2/3 e të gjithë deputetëve. Është një çështje që duhet të trajtohet me kujdes.

Megjithatë, në komision ky amendament e ka marrë shumicën, do të thotë 6 anëtarë kanë votuar për, kurse 3 kanë votuar kundër.

Amendamentet 7 dhe 10, siç thashë, e kanë pasur një konsensus dhe nisen nga konkluzionet e Kuvendit. E arsyetova në fillim, ato kanë të bëjnë me precizimin e përgjegjësisë së anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.

Janë tri kritere me të cilat, në bazë të këtyre amendamenteve, bordet do të vlerësohen. Nën 1, performansa e tyre në realizimin e caceve të përcaktuara me planet e biznesit. Nën 2, çfarë është vlera e aseteve, a është duke u rritur vlera e aseteve, apo duke rënë. Dhe, nën 3, niveli i kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimin që e ofrojnë ndërmarrjet publike.

Nëse në këto tri çështje, bordet dështojnë në qeverisjen kooperative, atëherë duhet të bëhet një raport dhe të merren masa korrigjuese, duke përfshirë edhe përgjegjësinë e bordeve.

Pra, amendamenti 7 ka të bëjë me këtë, kurse amendamenti 10 thotë që e precizon mënyrën se si do të matet niveli i kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ndërmarrjeve publike. Deri tash, kjo s'ka qenë e precizuar dhe ndërmarrjet publike e kanë vlerësuar vetë nivelin e kënaqshmërisë.

Me këto ndryshime kërkohet që niveli i kënaqshmërisë të vlerësohet, Bordi të angazhojë...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Ju lutem, regjia, ia jepni mundësinë të flasë!

MUHAMET MUSTAFA: ...një organizatë të pavarur kredibile, e cila do të paraqiste raport për perceptimet e konsumatorëve.

Dhe, amendamenti 9 ka ardhur me propozim të anëtarëve të komisionit, që ka të bëjë me barazinë gjinore.

Me të vërtetë, ne kemi vërejtur se ka problem me barazinë gjinore te bordet dhe ky amendament është aprovuar njëzëri dhe është në harmoni me Ligjin për barazinë gjinore. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa! Tani, siç u njoftuat më gjerësisht nga kryetari i Komisionit Funksional, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 10 amendamente.

Për amendamentin 5 janë dhënë dy propozime, është propozimi i Komisionit Funksional dhe propozimi i Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti 8 është propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Tani futemi në votim. Zoti Ymeri, e dëshironi fjalën? Urdhëro!

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç e kuptuat, janë tri amendamente, por për njërin nuk ka pasur diskutim në komision dhe ai është i pranuar me një vërejtje tonën teknike, ndërkohë që për dy amendamente të cilat u ngrehën këtu, e të cilat i ka propozuar Lëvizja “Vetëvendosje”, njëri nuk ka arritur ta marrë përkrahjen e Komisionit Funkcional, ndërsa tjetri po, dhe desha ta shfrytëzoj rastin e të flas pak për të dyja këto, në mënyrë që të mos flas pastaj para votimit të amendamenteve, veç e veç.

Sa i përket çështjes së shndërrimit të “Trepçës” në ndërmarrje publike, pra të propozimit të dytë të amendamentit 5, është e vërtetë se është diskutuar edhe në komision, por edhe në seancë disa herë rëndësia e shndërrimit të saj në ndërmarrje publike dhe ne konsiderojmë se me këtë amendament të propozuar kjo vetëm sa ia shton peshën ligjit të ardhshëm për “Trepçën” dhe strategjisë së ardhshme për “Trepçën”, duke e drejtuar diskutimin rreth asaj se cilat pjesë do të duhej të shndërroheshin në ndërmarrje publike dhe duke ia shtuar në këtë mënyrë edhe rëndësinë ose seriozitetin e trajtimit të çështjes, kur kihet parasysh që në ndërmarrje publike shteti do të ishte përgjegjës drejtpërdrejt.

Ne konsiderojmë se kjo është mënyra e vetme që do ta rivitalizonte “Trepçën” dhe do t’ia kthente asaj mundësinë e përdorimit të të gjitha kapaciteteve nxjerrëse dhe përpunuese, që do të duhej t’i kishte ky kombinat.

E kemi parë se nëse “Trepça” i lihet kohës, ajo vetëm se shkatërrohet dhe nuk rivitalizohet, ndërkohë që është momenti i fundit kur shteti i Kosovës duhet ta marrë përsipër këtë ndërmarrje dhe t’i mobilizojë të gjitha potencialet që i ka, qofshin ato financiare, kuadrore e tjera, në mënyrë që ndërmarrjen ta zhvillojë për ta shndërruar në atë çfarë do të duhej të ishte, e që është motor dhe promotor i zhvillimit ekonomik të vendit.

Ka pasur dakordim nga të gjitha subjektet politike, konsideroj unë, të paktën verbale, se “Trepça” është një prej aseteve më të rëndësishme që e ka Kosova dhe si të tillë ne duhet ta reflektojmë këtë seriozitet dhe deklaram tonin edhe në ligjet që i miratojmë për të. Pra, nëse është ndërmarrja më e rëndësishme dhe aset i më i rëndësishëm që e kemi si Republikë e Kosovës, atëherë domosdoshmërisht këtë ndërmarrje duhet ta kemi në pronësi publike, në mënyrë që ta trajtojmë siç po themi po e konsiderojmë.

Ndërkohë, sa i përket amendamentit 8, i cili, siç u përmend edhe nga kryetari, e ka marrë përkrahjen e Komisionit Funkcional, desha t’i ngre vetëm disa çështje, të cilat kryetari nuk i përmendi, e që kanë qenë të diskutuara në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, sepse kryetari foli më shumë për atë se çfarë kanë thënë kundërshtarët, por jo edhe çfarë kanë thënë përkrahësit, që në komision kanë qenë shumicë, dhe në këtë drejtim iu bë një pabarazi, mendoj unë, shumicës së komisionit.

Pse duhet që ndërmarrjet publike, ose vendimet për privatizim të ndërmarrjeve publike, të merren me 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, e jo siç është aktualisht në ligjin bazik - me shumicën e thjeshtë. Duhet ta kemi parasysh një gjë, ndërmarrjet publike të cilat kanë mbetur në pronësi publike tash, po flas për ndërmarrjet e nivelit qendror, janë të gjitha të një rëndësie të

jashtëzakonshme, qoftë në aspektin strategjik, qoftë në aspektin e sovranitetit, në aspektin ekonomik e tjera.

Pra, nuk është se kemi ndonjë ndërmarrje, e cila mund të konsiderohet që nuk është e rëndësishë së veçantë për zhvillimin ekonomik, por edhe të shtetndërtimit në Kosovë, e veçanërisht kur e kemi parasysh rëndësinë që këto e kanë si kontribut në të mirën e përgjithshme, apo që do të duhej të funksiononin si kontribut në të mirën e përgjithshme. Dhe, duke e pasur parasysh se këto ndërmarrje e kanë këtë rëndësi, atëherë natyrisht që trajtimi i privatizimit ose mosprivatizimit të tyre do të duhej ta kishte një peshë më të madhe të diskutimit dhe vendimmarrjes nga Kuvendi.

Kur t'ia shtojmë kësaj edhe faktin që këto ndërmarrje publike janë në pronësi të publikut, pra konsiderohen në pronësi të publikut, me gjithë faktin që 100% e aksioneve të këtyre ndërmarrjeve menaxhohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, këto prapë mbeten pronësi e publikut dhe ne mendojmë që 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës do të mund të konsideroheshin vërtetë reflektim i vullnetit politik dhe interesit të përgjithshëm të këtij publiku, i cili është pronar i këtyre ndërmarrjeve publike, ndërkohë që shumica e thjeshtë e deputetëve të Kuvendit, në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si reflektim i këtij opinionit publik.

Sepse, në një rast, në rastin të them kështu minimal, pra nëse seanca dhe trajtimi i një vendimi për privatizimin e ndërmarrjeve publike do të mund të mbahej me 61 deputetë, sa për ta plotësuar kuorumin, atëherë çka na nevojitet me rregullën aktuale të privatizimit të tyre, do të kishte qenë me 31 deputetë, nga 120 sish, të cilët do ta merrnin një vendim për ta privatizuar një ndërmarrje kaq të rëndësishme publike, e kjo as për së afërmi nuk e përmbush reflektimin e mendimit, qëndrimin, vullnetin dhe interesin të qytetarëve të Republikës së Kosovës. 31 deputetë nuk janë përfaqësues të opinionit publik të vendit dhe interesit të përgjithshëm të këtij vendi.

Pra, me 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës do t'i shtohet pesha vendimmarrëse një vote eventuale për privatizimin e një ndërmarrjeje ose aksioneve të një ndërmarrje publike, ndërkohë që me këtë rast do t'i shtohet edhe pesha vendimmarrëse Kuvendit të Republikës së Kosovës karshi këtyre ndërmarrjeve, të cilat, po e përsëris, janë në pronësi të publikut, sepse aktualisht Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rregullat siç i kemi dhe siç është dëshmuar në të kaluarën, pak a shumë është vetëm një lloj lavatriqe e vendimeve të Qeverisë për sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve.

Dhe, çështja e fundit që dua ta ngre - pse është e rëndësishme që ta kemi një votë të cilësuar të deputetëve të Kuvendit të Republikës karshi privatizimit, është edhe për vetë procesin e privatizimit. Mendoj që procesi i arritjes së një konsensusi ndërmjet spektrit politik, pra të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, do t'i sillte dobë edhe vetë procesit të privatizimit, qoftë në rritjen e transparencës, por çka është më me rëndësi në cilësinë e këtij procesi të privatizimit. Sepse, kjo do të nënkuptonte një diskutim shumë më të thellë, më të rëndësishëm publik për sa i përket, nëse duhet të privatizohet ose jo një ndërmarrje e caktuar ose pjesë, një përqindje e caktuar e aksioneve të një ndërmarrjeje publike.

Me shumicën e thjeshtë, e kemi parë në të kaluarën që ky diskutim është banal, sepse Qeveria, ose kushdo që është në pushtet, koalicioni në pushtet, i ka dhe mund ta sigurojë shumë lehtë

minimalen e votave të rëndësishme, ose të nevojshme, për ta privatizuar një ndërmarrje dhe si e tillë nuk e ka fare parasysh nevojën për ta diskutuar një proces të privatizimit dhe për t'ia arritur cilësinë këtij procesi të privatizimit, aq më tepër kur dihet që një konsensus, një bazë më e gjerë e konsensusit publik sa i përket privatizimit do t'u kontribuonte edhe vetë investitorëve, sepse siguria e investimeve të tyre për të ardhmen do të ishte më e madhe, meqenëse, pak a shumë, në momentin e privatizimit, nëse e votojnë 2/3 e deputetëve, nënkupton që një pjesë e konsiderueshme e spektrit politik tashmë e ka pranuar një proces të tillë të privatizimit dhe si i tillë nuk ekziston pastaj rreziku në të ardhmen që forcat politike ta ndryshojnë qëndrimin karshi kësaj çështjeje.

Pra, këto do të kishin me qenë pak a shumë argumentet pse do të duhej të votohej ky amendament dhe pse do të duhej domosdoshmërisht që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ketë këtë të drejtë që të jetë vendimmarrës fundamental sa i përket privatizimit ose jo të ndërmarrjeve publike të nivelit qendror. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ymeri! Zoti Mustafa, keni replikë?

MUHAMET MUSTAFA: Jo replikë, por desha vetëm një sqarim. Sa i përket asaj që unë prezantova në mënyrë të shkurtër, e theksova procesin e diskutimit në komision, por deputetët e kanë në mënyrë shumë detaje, bile thuaja ekstensive gjithë procesin e diskutimit aty. Në raport është e prezantuar gjithçka.

Tash po flas më tepër në emër të qëndrimit të LDK-së lidhur me këtë çështje për këtë amendament që e ka fituar një shumicë në komision. Ne mendojmë se kjo është një çështje mjaft me rëndësi, që ka ardhur si amendament, pa një diskutim paraprak. Ne duhet ta kemi një diskutim më të gjerë paraprak. Domethënë nuk është sikur këto 3-2 amendamentet tjera që i kemi diskutuar në komision. Kemi diskutuar me ministrinë, me shoqëritë civile. Domethënë a duhen 2/3, a duhen 61%, apo duhen 2/3 e deputetëve të pranishëm, kjo çështje duhet të studiohet. Ka argumente për edhe kundër. Unë thjesht nuk mendoj që kjo çështje është e pjekur që sot ta vendosim. Personalisht po edhe në emër të LDK-së, por edhe për nga natyra se si e kemi diskutuar në komision.

Natyrisht që nuk është normale që të vendosim ta privatizojmë një ndërmarrje publike të rëndësishme me 31 vota, ose 40 vota. Kjo nuk është normale, kjo duhet sigurisht të korrigjohet, por do të shkojmë që t'i marrim vendimet në një mënyrë të njëjtë, siç e aprovojmë Buxhetin, apo do të shkojmë me 2/3, apo si, ne duhet ta analizojmë më mirë dhe të diskutojmë më shumë.

Ky është qëndrimi ynë, prandaj në këtë mbledhje, ne mendojmë se nuk do të duhej të nguteshim që ta aprovojmë një amendament të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Shumë shkurt, kryesues,

Është e vërtetë që ne e kemi pasur një diskutim, tash mund të thuhet që nuk ka qenë diskutim i mjaftueshëm për këtë punë në komision, por nuk është se nuk është diskutuar, nuk është se nuk është argumentuar edhe për edhe kundër përbrenda anëtarëve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe në fund është miratuar amendamenti me votat edhe të deputetëve që janë të

koalicionit qeverisës, sepse natyrisht që ky amendament nuk do të kishte kaluar po të mos kishin qenë edhe grupet parlamentare të LDK-së dhe PDK-së në këtë rast për, ose deputetë të caktuar të tyre për këtë amendamenti.

Kështu, që në këtë drejtim tash po e shoh se ka një ndryshim të qëndrimit, ose të grupeve parlamentare, ose nënkupton që deputetët e caktuar si përfaqësues të grupeve në Komisionin për Zhvillim Ekonomik nuk paskan votuar në vijë me grupin parlamentar, sepse unë jam më se i sigurt që ka pasur edhe vota të PDK-së, edhe të LDK-së, në komision për këtë amendamenti pas diskutimeve që i kemi bërë për këtë çështje dhe pas çështjeve të ngrehura edhe nga kryetari i komisionit, por edhe nga deputetët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit zoti Ymeri! Fjalën e ka zoti Agim Ademaj

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë ndoshta më tepër rreth nenit 3 të këtij projektligji, pika 11.3. Kryesues, vetëm...

KRYESUESI: Është mirë që kur të vijmë tek amendamentet përkatëse të diskutojmë lidhur me amendamentin, meqenëse mendoj se u futëm në procesin e votimit dhe duhet ta respektojmë atë. Ndoshta ky debati që u zhvillua ka ngjallur interesim për të debatuar, në qoftë se doni, unë nuk kam asgjë kundër që të debatohet rreth saj. Zoti Beqaj ndoshta keni diçka për të thënë lidhur me këtë që u shtruaë. Zoti Beqaj e ka fjalën.

BESIM EQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha ta paraqes qëndrimin e Partisë Demokratike lidhur me këtë amendament. Është e vërtetë se ne e kemi diskutuar, por një pjesë kemi votuar kundër këtij amendamenti që t'i ketë 2/3 e votave për privatizim. Besoj se argumente për këtë ka të mjaftueshme. Ne sigurisht që në të ardhmen duhet ta diskutojmë çështjen nëse kjo duhet të jetë me shumicën e thjeshtë, apo me shumicë absolute, e jo të shkojë me 2/3.

Si do që të jetë, vërejtja ime edhe në komision ka qenë që ne nuk duhet t'i hapim ligjet pa pasur hapje të ligjeve edhe nga Qeveria. Këtë ligj e kemi hapur në mënyrë të paarsyeshme, konsideroj unë dhe po e them mendimin tim personal tash. Në mënyrë të paarsyeshme e kemi hapur për amendamentet e neneve të cilat nuk na kanë ardhur si të hapura nga Qeveria, por sa i përket kësaj - qëndrimi ynë është që këtë amendament ne duhet ta diskutojmë në një fazë tjetër dhe ta analizojmë shumë më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa deputetë janë në sallë, ju lutem! Në sallë janë 88 deputetë, atëherë:

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

I ka dy propozime. Komisioni Funksional dhe propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Sipas rregullave në fuqi, neni 5 i Projektligjit, neni 37a, teksti i tij, neni në fillim shkohet me propozimin e Komisionit Funksional. Votojmë me elektronikë.

Regjia, votojmë tani! Faleminderit!

Me 41 vota për, 36 kundër, 5 abstenime, miratohet propozimi i Komisionit Funksional dhe e kemi me rregull. Duhet ta votojmë edhe propozimin e Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

Regjia, votojmë me elektronikë! Votojmë tani!

Rregullorja e Kuvendit thotë kështu, mund ta ndryshojmë kur të doni me amendament të veçantë. Faleminderit!

Me 47 vota kundër, 3 abstenime, 21 për, nuk miratohet propozimi i Grupit parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, me përkrahjen e Komisionit Funksional. A doni me elektronikë, apo doni votim kështu? Me elektronikë. Regjia! Votojmë tani!

Me 54 vota kundër, 7 abstenime, 26 për, nuk miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe ju deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Me 75 vota për, 7 kundër, 2 abstenime, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

4. Shqyrtimi i rekomandimit për transferimin e mjeteve nga Buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e komunës së Gjakovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën për transferin e mjeteve buxhetore nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e Komunës të Gjakovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandim. Nëse bënë pak qetësi, ju lutem!

Të nderuar deputetë,
Ju kisha lutur për qetësi në sallë! Zoti Osmani, e keni fjalën!

NASER OSMANI: Faleminderit kryetar!

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës i ka paraqitur kërkesë Kuvendit për t'i lejuar transferimin e mjeteve prej 20 000 eurove nga buxheti i agjencisë - Projekti kapital Kompleksi Memorial "Adem Jashari", Prekaz, Skenderaj - në buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2015, në projektin kapital - Projektet e ndryshme kapitale me bashkëfinancim. Me qëllim të realizimit të projektit, ndërtimi i Lapidarit të Lirisë në parkun e qytetit, për të cilën projekt Komuna ka ndarë 30 000 euro nga buxheti i saj, e në total për realizimin e projektit kërkohen 50 000 euro.

Zoti kryesues, këtu pranë deputetëve kanë qarkulluar disa spekulime, por me përgjegjësi të plotë unë them që kjo është një marrëveshje e nënshkruar vitin e kaluar ndërmjet kryetarit të Agjencisë për mirëmbajtjen e memorialëve dhe e komplekseve të Kosovës dhe Komunës të Gjakovës për ndërtimin e këtij projekti që ka të bëjë kryesisht vetëm për të rënë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Domethënë lapidari në parkun e qytetit u kushtohet të rënëve në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e nuk ka të bëjë me ato spekulime që dikush thotë se jo po ndahen për lapidarin e Fadil Hoxhës. Kjo nuk është fare e vërtetë.

Këtë desha t'ua sqaroj kolegëve të mi. Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, përkatësisht paragrafi 6 i nenit 13 përcakton se për çdo transfer të mjeteve buxhetore ndërmjet organizatave buxhetore kërkohet aprovim paraprak nga Kuvendi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 17 mars 2015, ka vlerësuar se kërkesa për transferin e mjeteve nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e Komunës së Gjakovës është në pajtim me procedurat për transferin e mjeteve buxhetore të përcaktuara në nenin 13, paragrafi 6 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe i rekomandohet Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën për transferin e mjeteve nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e Komunës të Gjakovës për vitin 2015 dhe është i mendimit ta përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet për transferin e këtyre mjeteve për ndërtimin e një kompleksi memorial të një lapidari që u kushtohet të rënëve në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Meqenëse marrëveshja ka qenë ndërmjet Komunës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, atëherë ne si Grup Parlamentar e përkrahim rekomandimin e Komisionit për Buxhet, në mënyrë që të përfundojë kompleksi apo projekti për ndërtimin e Lapidarit të Lirisë për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në komunën e Gjakovës.

Rekomandojmë që edhe deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta miratojnë këtë kërkesë për transferim të mjeteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

E mora fjalën vetëm për të thënë që edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e miraton këtë bartje të fondeve në mënyrë që të përfundojë projekti i Lapidarit të Dëshmorëve në Gjakovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do t'i votojë rekomandimet për transferimin e mjeteve nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në buxhetin e Komunës të Gjakovës në vlerë prej 20 000 euro në vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” i mbështet rekomandimet e Komisionit për ndërtimin e Lapidarit të Lirisë në parkun e qytetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Kujtim Paqaku e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në plotëni këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Mendimi im personal është se është bërë shumë gabim që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar kërkesën e agjencisë në fjalë. Unë mendoj se duhet t'u rikujtohet deputetëve të këtij Kuvendi se sa shumë zhurmë është bërë për t'u themeluar kjo agjenci nga Kuvendi i Kosovës dhe pikërisht zhurma më e madhe ka qenë se mjetet e dedikuara për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz nuk po menaxhohen mirë nga Qeveria, prandaj duhet të themelohet një institucion, një agjenci e pavarur, në mënyrë që t'i menaxhojë më mirë.

Tani për mua personalisht është shumë e pakuptueshme se si kjo agjenci ka arritur të miratojë ose të bëjë një marrëveshje ndërmjet Komunës së Gjakovës, çfarëdo komune qoftë, dhe agjencisë në fjalë për mjetet të hiqen nga Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe të shkojnë e të dedikohen kudo qoftë tjetër në buxhetin e komunës. Nuk jam kundër investimit edhe në memorialët tjerë të lirisë në komunat tjera, por pikërisht pse bëhet në këtë mënyrë, e ne e dimë shumë mirë se ende është i papërfunduar Kompleksi Memorial "Adem Jashari". Përveç që është i papërfunduar, nuk matet as në kuptimin e hapësirës fizike, as në kuptimin e vizitorëve brenda vitit që bëhen në këtë kompleks, dhe ka nevojë ende për mjete shtesë, e jo të hiqen nga ky memorial.

Edhe një tjetër gjë dua t'jua përkujtoj, të nderuar deputetë, se jo fortë larg Prekazit është memoriali në Marinë, i cili është lënë tërësisht në mëshirën e kohës dhe i shkatërruar. Dua t'jua përkujtoj se në atë memorial janë të skalitur emrat e të gjithë dëshmorëve anembanë të Kosovës dhe shqiptarisë, e nuk ka asnjë përkujdesje dhe nuk është ndarë asnjë mjet për këtë memorial. Dua t'jua përkujtoj se jo fort larg Prekazit, në Polac, mes Prellovcit dhe Polacit, janë varrezat e dëshmorëve prej shumë anëve të Kosovës, të cilëve nuk u dihen as shkronjat në emrat e tyre, e të cilat është planifikuar që të barten në Marinë, por nuk është bërë asgjë në atë drejtim.

Personalisht nuk do ta votoj këtë transferim të këtyre mjeteve dhe unë mendoj që asnjëherë nuk ka qenë praktikë që Kuvendi të merret me mjete buxhetore, meqë nuk është edhe një shumë aq madhe, 20 000 euro. Komuna ka mundur të bëjë marrëveshje me dikasteret qeveritare pa ardhur fare në Kuvend dhe të merremi me miratimet e tilla, ka mundur të kërkojë që ky projekt të financohet edhe nga ministritë tjera, të cilat kanë të ndara buxhete tjera, pa pasuar nevojë të na vërë në lajthitje ne si Kuvend. Kërkoj që të mos votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta është ndonjë keqkuptim, por me sa unë jam i informuar dhe besoj që shumica, të paktën ata që vijnë prej qytetit të Gjakovës, e dinë se një lapidar është ndërtuar në qendër të qytetit dhe ka më shumë se një vit dhe do të kishte qenë e udhës të na shpjegohet për çfarë lapidari po bëhet fjalë, nëse domethënë është i përfunduar, dhe të paktën disa herë mua m'u është dhënë rasti të vendos lule kur i kemi nderuar dëshmorët.

Shpresoj që këto tërheqje të buxhetit dhe bartjes në komunë, ndoshta mos e kanë adresë ndërtimin e varrezave të dëshmorëve të qytetit, që tash e 16 vjet akoma askush nuk i ka trajtuar dhe natyrisht se edhe familjarët, edhe njerëzit e tyre të afërt, edhe bashkëluftëtarët, janë të shqetësuar, se pse dikush, ose ajo agjenci e cila është përgjegjëse, tash agjenci në kuadër të Kuvendit të Kosovës, sepse ka qenë në kuadër të Ministrisë të Planifikimit Hapësinor, është

bartur në kuadër të Kuvendit, pse nuk i trajton këto raste. Po ashtu, në të njëjtën kohë, siç u tha edhe më herët, në Polac, në Marinë, e kudo që janë, sepse nuk duhet të ndahen, por do të kisha kërkuar edhe prej kryetarit të komisionit të na shpjeguar se për cilin lapidar bëhet fjalë?

Ku do të shkojnë këto mjete, pasi lapidari në qendër të qytetit ka përfunduar një viti, nëse ka ndonjë lapidar të ri, apo ka ndonjë planifikim të ri për të ndërtuar diçka, apo janë për ndërtimin e varrezave të dëshmorëve të qytetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Parlamentit!

Edhe vota ime do të shkon kudër këtij ndryshimi buxhetor, jo për faktin se unë jam kundër investimeve në memorialë, sepse mendoj se ne si institucione e kemi obligim që të investojmë në memorialët në secilën komunë dhe në secilin vend ku ka të rënë, mirëpo e mbështes plotësisht fjalimin e zonjës Berisha dhe mendoj që një kalim i buxhetit prej Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, një kompleks që ka nevojë për investime shtesë, duke e ditur rëndësinë dhe numrin e madh të vizitorëve që vijnë në Prekaz, mendoj që kjo mënyrë e kalimit të buxhetit nëpërmjet Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në një destinacion tjetër nuk i bënë nder këtij Kuvendi dhe kërkoj nga deputetët që të mos e votojnë.

Është hera e parë dhe praktika e parë në këtë Parlament prej se unë jam deputete që vjen një kërkesë e tillë e transferit të mjeteve, sepse unë mendoj që Projek-buxheti është miratuar një herë dhe deri në rishikim ne kemi mundësi t’i destinojmë mjetet nga ndonjë mënyrë tjetër. Mirëpo, kurrësi që ne në këtë mënyrë ta tejkalojmë buxhetin nga Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në një destinacion tjetër.

Për t’u kthyer aty, siç tha zonja Berisha, memorialët edhe varrezat e dëshmorëve ne si institucione i kemi lënë në mënyrë jo shumë të ndershme. Ka vende që janë për keqardhje, u përmend Marinën, u përmend Polaci, e shumë e shumë varreza tjera, ku vërtet ka nevojë për investime të shtetit dhe të institucioneve tona. Kërkoj nga deputetët që të na përkrahin që këto mjete të mos kalojnë nga Kompleksi Memorial “Adem Jashari”.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Osmani, për sqarim shtesë.

NASER OSMANI: Është çështje e deputetëve nëse e votojnë apo nuk e votojnë, por rregullat dhe zbatimin i ligjit deputetët duhet ta bëjnë.

Neni 13, paragrafi 6 i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës e saktëson transferin e mjeteve prej një organizate në organizatën tjetër buxhetore. Kjo është procedurë që duhet të zhvillohet. Nuk është bërë kjo në bazë të kërkesës së dikujt, por në bazë të asaj qysh e parasheh ligji. Ligji e parasheh që këtë transfer duhet ta aprovojë Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo është rregull, ky është ligj.

Ndërsa çështja nëse e aprovojnë apo nuk e aprovojnë një marrëveshje ndërmjet Agjencisë dhe Komunës të Gjakovës, është çështje e tyre, mirëpo duhet të jemi korrektë - nuk është çështja që ata i kanë ndarë mjetet për ta lënë memorialin e Prekazit keq, por ata e kanë konstatuar që 20 000

euro, të cilat do të transferohen me marrëveshje me Komunën e Gjakovës për të përfunduar, se projekti nuk ka përfunduar zoti Daut, sipas tyre, se është bashkëfinancim i Agjencisë me Komunën e Gjakovës. Gjakova ka ndarë 30 000 euro, Agjencia 20 000 euro, krejt ai kompleks bën 50 000 euro. Domethënë nuk janë paguar edhe 20 000 euro. Nuk dëmtohet, sepse janë ndarë 2 milionë euro për Prekaz, por këto janë marrëveshje të tyre.

A votojnë deputetët a nuk votojnë deputetët, është çështje e tyre, mirëpo procedura duhet respektuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Absolutisht, respektin më të madh për çdo sakrificë të popullit dhe për të gjithë të rënë, sepse dëshmorët nuk i takojnë asnjë partie politike, por i takojnë çdo qytetari të Republikës së Kosovës, por vlerësoj që Memoriali “Adem Jashari” është i veçantë dhe ka nevojë për mjete shtesë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka pasur dhe ka mundësi që të gjejë mjete tjera, pa i prekur mjetet të cilat janë të dedikuara për këtë memorial. Jo vetëm për atë lapidarin në Gjakovë, por unë po e ngre shqetësimin shumë të madh që ndiej për varrezat në Koshare, të cilat, fatkeqësisht, edhe sot e kësaj dite kanë mbetur në një gjendje të mjerë.

Dëshmorët e kombit i kanë kufomat e tyre në morg për shkak të mosangazhimit, neglizhencës dhe të papërgjegjësisë së dikujt, që ato varreza vërtet të rregullohen ashtu siç e meritojnë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës dhe agjencia konkrete duhet vërtet të ketë një qasje shumë më serioze në menaxhimin e këtyre mjeteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sadriu!

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Parimisht rreth transfereve unë e kam një qëndrim që më të duhet të jem me një qasje pak më të matur.

Kemi të drejta, por këtë të drejtë e rregullon ligji, që kjo mund të ndodhë dhe duhet vendimi i Kuvendit, nëse shuma totale nga projekti është mbi 40% e përealizuar atëherë këtë duhet ta bëjë Kuvendi. Dhe, unë besoj se propozimi ka ardhur në harmoni me atë rregullativë.

Por, unë parimisht jam kundër asaj që të ndodhin transfere të tilla, sepse jam i vetëdijshëm që kërkesat janë dy herë më të mëdha se mundësitë në trajtimet buxhetore, dhe atje janë zhvilluar tre rrathë qarkore buxhetore, janë shoshitur të gjitha projektet. Çfarë dua të them? Proceset buxhetore nuk janë elemente që mund të ndërrohen brenda një muaj dite, siç pretendojnë disa. E kemi pasur këtë edhe në seancën e kaluar kur biseduam, është marrë buxheti i këtij apo i atij. Buxhetet nuk mund të ndërrohen aty për aty, sepse për prioritetet zhvillohet një diskutim shumë i gjërë, shumë i argumentuar për të përcaktuar se cilat projekte duhet të kenë prioritet.

Prandaj, nga kjo, unë apeloj që para çdo transferi që bëjmë prej kujtdo qoftë, ta bëjmë një analizë pse është kërkuar ai? Pse nuk është realizuar? Cilat janë shkaqet që ai projekt nuk është realizuar. Pse kanë ngelur ato mjete? E, tek pastaj të bisedojmë se ku do t'i plasojmë ato mjete.

Kjo praktikë te ne nuk po ndodh dhe unë apeloj që në të ardhmen propozimet e tilla kur të vijnë do t'u kërkojmë përgjegjësi pse mjetet që kanë qenë në atë projekt nuk janë realizuar.

Unë nuk di as për këtë rast, as rastet tjera, por pikërisht pse nuk i di dua, dua t'i di unë dhe të gjithë ju, në mënyrë që të vendosim me kompetencë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sadriu! Fjalën e ka Dauti, për një sqarim shtesë.

DAUT HARADINAJ: Vetëm sqarim, domethënë nuk po i replikoj askujt.

Më 14 qershor të vitit të kaluar është inauguruar lapidari në qendër të qytetit të Gjakovës, kur kemi marrë pjesë të gjithë.

Sa u përket monumenteve, vendeve të historisë, kjo vlen për shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, i cili është në pushtet prej vitit 2007, dhe më vjen mirë që ka filluar të mendojë pak më seriozisht për sakrificën, sepse e kanë pas harruar krejt.

Premtimi publik i ish-kryeministrit të Kosovës më 9 prill të vitit 2009 ka qenë që vitin e ardhshëm, varrezat në Koshare do të jenë të përfunduara, lapidari, kompleksi dhe rrugët. Tash jemi në vitin 2015 dhe, ju them sinqerisht edhe një herë, e kjo vlen edhe për Qeverinë ekzistuese, edhe për qeveritë e kaluara, se trupat e dëshmorëve të Koshares ende janë në morgun e Rahovecit për shkak të neglizhencës së Qeverisë së kaluar, e cila nuk e ka bërë asnjë gjë.

Tash kur flasim për lapidarin e Gjakovës, edhe për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, nuk janë shumë e madhe, janë vetëm 20 000 euro, Agjencia qenka dakorduar bashkë me Komunën, ajo agjenci së cilës i kemi dhënë besim të gjithë si deputetë, nuk mendoj se do të dëmtohet asnjë kompleks për shkak se ka edhe parashikime buxhetore në qershor, pastaj është viti i ardhshëm.

Pra, unë mendoj që nuk është shumë e madhe dhe lus deputetët ta mbështetin, sepse, siç duket, ndërtuesi i atij kompleksi nuk i ka marrë mjetet e veta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Grabovci, replikë!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti Daut, me gjithë respektin që e kam, unë kam dëshirë vetëm t'u referohem fakteve.

Deri në vitin 2007 keni qenë në pushtet, e dëshmorët e dimë se janë shumë më herët. Ju kisha lutur ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës le të ndalen dhe të këqyrin se çfarë ka ndodhur para vitit 2007, qoftë me dëshmorët, varrezat e dëshmorëve, me memorialët dhe me familjet e dëshmorëve, me invalidët, e kështu me radhë.

Pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike të Kosovës është ndërmarrë, e them me përgjegjësi të plotë, një aksion apo një përkushtim i jashtëzakonshëm që në momente të caktuara edhe jashtë

mundësive që ka pasur Qeveria e udhëhequr nga zoti Thaçi, të gjitha këto kategori janë marrë në mbrojtje. Është bërë një përkujdesje e shtuar për varrezat, për memorialët dhe me këtë ua të them se nuk është bërë krejt ajo që e meritojnë, edhe pse kemi pasur dëshirë. Ka hapësira ende për të bërë, dhe vërtet e thashë dhe po e përsëris, është për të të ardhur keq, është shqetësuese që dëshmorët e kombit të mos prehen në vendin e tyre, në varrezat e tyre, siç është rasti i varrezave të Koshares, por të jenë në morg.

E, kjo është pa përgjegjësi e të gjitha qeverive, pa përjashtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kisha propozuar të mos futemi në debat për komplekset memorialë tani, edhe pse ndoshta ka nevojë dhe unë jam i bindur që ka nevojë, por kërkesa për të diskutuar për komplekset memorialë të të gjitha kohërave dhe të gjitha natyrave që mund të jenë ato të bëhet zyrtarisht. Është një kërkesë thjesht që u është drejtuar deputetëve dhe mendoj që mund të votohet për ose kundër. Mendoj që edhe zoti Sadriu e dha një mendim të vlefshëm për seancën, pra mendimin tim, ndoshta dikush tjetër nuk dakordohet, por do të vazhdoja me fjalën sipas radhës...

Naser, s'ta ka përmend askush emrin! OK! Urdhëro, fjalën e ka Naser Osmani për sqarim, e pastaj Ganimete Musliu e merr fjalën dhe ndoshta do të duhej t'i tërheqim, se janë paraqitur edhe 6 veta. Urdhëro, zoti Naser!

NASER OSMANI: Nuk kisha dashur që të shkojë në një debat politik. Unë vetëm ta plotësoj atë që ndoshta edhe zoti Aliu e përmendi.

Marrëveshja është lidhur në vitin e kaluar. Meqenëse s'kanë funksionuar institucionet, ajo nuk ka mundur të realizohet prej vitit të kaluar, prandaj tash është bartur që në këtë kohë të hyjë në procedurë. Nuk është marrëveshje e këtij viti dhe ajo nuk është lidhur duke u bazuar në buxhetin e 2015, por në buxhetin e 2014.

Meqenëse projekti ka vazhduar dhe obligimet nuk kanë përfunduar, atëherë procedura duhet të bëhet tani. Domethënë, kemi të bëjmë me një marrëveshje të vitit 2014.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht dua ta përgëzoj çdo iniciativë, e cila merret me përkujdesjen dhe thjesht identifikimin ose përkujtimin e të gjithë dëshmorëve të lirisë, kudo qofshin ata, qoftë në Gjakovë, Kaçanik, Deçan, Skenderaj, apo kudo tjetër.

Mirëpo, unë personalisht, si deputete e këtij Kuvendi, jam e befasuar faktikisht me këto rekomandime, me të cilat kërkohet transferimi i mjeteve nga Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Komunën e Gjakovës, për arsyen e vetme se kam pritur që Agjencia për Mbikëqyrjen e Memorialëve do të vijë me një kërkesë për të shtuar buxhetin për Kompleksin Memorial "Adem Jashari", sepse unë konsideroj, që investimet në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" nuk duhet të ndalen vetëm në lule e barishta, siç po ndodh deri më tani, por ju e dini se atje kemi

dy objekte, të cilat janë nën mëshirën e kohës dhe nëse ato nuk konservohen në një afat shumë të shpejtë, vjen deri te shkatërrimi dhe ne do të humbim pasurinë më të madhe trashëgimore të shtetit tonë, aty ku u vunë edhe themelet e lirisë, aty ku u vunë edhe themelet e shtetit të Kosovës.

Unë do ta përkrah propozimin e Sala Shala-Berishës, sepse me të vërtetë unë në këtë Kuvend kam diskutuar disa herë për gjendjen jashtëzakonisht të keqe të Memorialit në Marinë. Fjala ime e parë ka qenë më 21 tetor të vitit 2011, pastaj për herë të dytë e kam ngritur këtë çështje në vitin 2014, saktësisht më datën 10 prill dhe sot kur po diskutojmë është një vit prapa, që është 7 prill 2015.

Edhe njëherë dua të sqaroj për të gjithë të pranishmit, se investimet e para në Memorialin në Marinë, ku aty janë të skalitur të gjithë emrat e dëshmorëve të Kosovës, i ka bërë një donator nga Amerika, Benito Mares. Fazën e dytë të investimeve e ka përfunduar Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa faza e tretë, kur do të duhej të bëhej përrurimi i këtij kompleksi, fatkeqësisht u bë mbyllja dhe shkatërrimi i atij kompleksi.

Unë ju ftoj të gjithë juve deputetë, që kurdo që keni kohë dhe mundësi të vini deri tek varrezat e dëshmorëve në Polac dhe të shihni gjendjen e mjerueshme të atyre atje që janë. Fatkeqësisht, sa herë që kaloj andej pari, më bie ndërmend refreni: “dëshmori pa emër”. Mirëpo, fatkeqësisht, dhe fatmirësisht do të thosha për familjarët, ata dëshmorë nuk janë pa emër, ata kanë emër, kanë familje dhe e kanë Kosovën, Kështu që unë personalisht nuk do ta përkrah transferimin e këtyre mjeteve, sepse unë konsideroj që buxheti duhet të rritet për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në rend të parë, sepse me mos konservimin e shtëpive- muze atje, do të humbë Kosova në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Zoti kryesues,
Sinqerisht më vjen shumë keq prej kolegëve të mi deputetë, që e kanë plotë gojën që duhet për t’i respektuar të gjithë dëshmorët e këtu e shfrytëzojnë rastin për këtë pikë kaq të ndjeshme, për të bërë vërtet politikë dhe atë folklorike.

Të gjithë i respektojmë të gjithë dëshmorët, mua po më vjen shumë keq dhe çudi që në Komision për Buxhet dhe Financa, që jemi në radhë të parë të gjithë deputetë dhe të gjitha partive politike, unanimisht kemi votuar dhe e kemi analizuar pse dhe si edhe e arsyetuar edhe sot këtu, ndërsa kolegët deputetë nga subjektet politike, të cilët kanë votuar këtë kërkesë, sot dalin këtu edhe flasin tërësisht demagogji, tërësisht demagogji për gjithçka.

Unë edhe njëherë i lus kolegët, që ta votojnë kërkesën e cila ka ardhur në Kuvend, sepse edhe ne jemi deputetë, edhe ne i duam dëshmorët, anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, ne jemi ekspertë të fushës të caktuar për financa, i kemi analizuar, e kemi marrë pëlqimin edhe të Ministrisë dhe nuk kemi për të lënë asnjë memorial, për t’ia marrë të drejtën e për të anuar te tjetra, por i kemi dhënë arsyet komplet pse i kemi marrë ato mjete dhe duhet të kalojnë ato mjete, sepse ato janë aranzhuar punët vitin e kaluar dhe nuk kemi kah shkojmë, pa i paguar.

Kështu që, i kisha lutur deputetët, OK u tha çka u tha, mjafton dhe këto pika, të kursehemi pak, sepse puna jonë flet, nuk kemi nevojë këtu të flasim çka kemi bërë e çka s’kemi bërë . Puna jonë flet, edhe e dimë çka kemi bërë atje edhe çka s’kemi bërë, kështu që, ju lutem t’i lëmë këto gjëra anash dhe ta votojmë kërkesën, sepse krejt këto çka u thanë, për mua janë demagogji.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Për mua është shumë e habitshme, që na del nga ky diskutim, që disa dëshmorë dhe disa komplekse memorialë janë më të vlefshme, se sa disa të tjera. Mendoj që kjo është e turpshme për mënyrën e trajtimit të dëshmorëve.

E dyta, është që kur është ndarë buxheti i Republikës së Kosovës, në vlerë prej 1.6 miliardë eurosh, është dashur t’u bie ndërmend si përfaqësuesve të PDK-së, ashtu edhe të LDK-së për dëshmorët. Nuk u ka rënë ndërmend fare e tani po diskutojmë për 20 mijë euro, për të cilat unë mendoj se pa asnjë diskutim të gjatë është dashur t’u jepen atyre që i kanë kërkuar këto mjete.

Kjo mënyrë kështu e sjelljes dhe e trajtimit të dëshmorëve është një çarje kështu, me “lot krokodili”, e cila nuk u shërben dëshmorëve, sepse ky Kuvend hiq më larg se para 15 minutash votoi kundër idealeve të dëshmorëve, duke iu dhënë një pjesë të sovranitetit të vendit të huajve.

Dhe, krejt në fund, kolegë të nderuar, deputetë, para përfundimit të diskutimit tim të fundit, disa prej jush u ngritët dhe thanë: “shko në Zvicër”. Unë nuk po u drejtohem tash juve, por po u drejtohem mërgimtarëve.

Shikoni, kur këta një deputeti i thonë: “shko në Zvicër”, ju e merrni me mend dhe e dini se si u presin juve. Kjo është e turpshme. Deputetët e tillë le të shkojnë në Republikën e Serbisë, sepse vetëm atje mund të jenë me këto qëndrime që kanë deputetët e dinjitetshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të them të drejtën, unë desha të kyçem në këtë temë, po ja që për një shumë tepër simbolike, që kushton barabartë me një drekë të Qeverisë, po bëhet kaq shumë zhurmë. Në fakt, zhurma nuk ka të bëjë me diçka që është reale, por ka të bëjë më shumë me prezantimin e mentalitetit lokalist dhe mua po me vjen keq, që Parlamenti i Kosovës po bjerë në këtë nivel, sepse për tema të ngjashme edhe kur është miratuar buxheti, domethënë, ka pasur ndërhyrje të këtij niveli, që nganjëherë të bën të ndihesh keq, që je pjesë e një debati, ose një forumi që bie në këtë nivel.

Meqë, sipas zotit Osmani, marrëveshja është bërë vitin e kaluar, atëherë faktikisht është dashur të jetë në buxhet kur është miratuar buxheti, por një gjë që për të satën herë nuk po mund ta kuptoj, është se zonja Hadërgjonaj e mbështeti dhe të tjerët nuk po e mbështesin nga i njëjti grup. Tash, unë nuk po e kuptoj, kur vijmë në seancë a merremi vesh se çka do të mbështesim e çka jo?

Përndryshe, unë jam ithtar që për shuma simbolike, për çështje tepër të ndjeshme të mos diskutohet, ose, ose në fund të fundit, të tërhiqet krejt nga rendi i ditës, po mos të shprehim patriotizëm të panevojshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Pasi që jam deputet dhe vij nga komuna e Gjakovës, unë desha ta bëj një sqarim.

Bëhet fjalë për lapidarin e lirisë në Parkun e Qytetit të Gjakovës, projekt tash i përfunduar, projekt që ka pasur kosto 50 mijë euro, ka pasur një procedurë paraprake të tenderimit të bazuar në marrëveshjen e vitit të kaluar mes Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe ky projekt tash ka përfunduar.

Ne jemi të vetëdijshëm se Kompleksi Memorial “Adem Jashari” ka rëndësi të veçantë për vendin dhe të gjithë shqiptarët, por ne si deputetë, nëse ka mjete të pamjaftueshme për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” kemi mundësi me rishikim të buxhetit, ta analizojmë dhe t’i shtojmë mjetet, kurse sot, pasi që bëhet fjalë për një shumë tejet simbolike, konsideroj se nuk duhet të debatojmë dhe ka mundur ndoshta, as të mos vijë në këtë formë, që mjetet të transferohen nga Projekti “Adem Jashari” apo të gjenden edhe forma tjera direkt nga Ministria e Financave apo është ajo buxheti rezervë.

Unë si deputet, kisha thënë se është mirë sot ta votojmë këtë shumë simbolike, se është projekt i përfunduar dhe ka mbetur borxh Komuna e Gjakovës ndaj kompanisë, e cila ka realizuar projektin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqa! Fjalën e ka zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Vetëm desha ta bëj një ndërhyrje të shkurtër lidhur me këtë që po ndodh.

As këto akuza, as këto kundër akuza nuk do të ndodhnin në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sikur kjo problematikë të konceptohej më mirë. Do të thotë, që të mos vinim ne deputetët dhe të mos ndodheshim në këto situata të padëshirueshme, kur krijohet një alternativë e cila të vendos përpara dy zgjidhjeve. Pra, përpara zgjidhjes nëse je për ndërtimin e lapidarit të dëshmorëve në Gjakovë, atëherë qenke për t’ia marrë paratë Memorialit “Adem Jashari” dhe, e kundërta, nëse je që Memoriali “Adem Jashari” ta ketë atë shumë buxhetore, atëherë po i hyn në hak lapidarit të dëshmorëve në Gjakovë.

Unë mendoj, se në vend se ne si deputetë, ta kishim mundësinë që të ndjeheshim shumë mirë për dedikimin e mjeteve për memorialët e dëshmorëve, ne po ndjehemi tash disi në siklet, për arsye se po vendosemi përpara këtyre situatave të padëshirueshme.

Mendoj se përpara këtyre situatave kështu vendos vetëm një Qeveri e papërgjegjshme. Kjo do të mund të ishte konceptuar ashtu që, për shembull, kjo shumë e parave të mos i merrej një memoriali tjetër të dëshmorëve dhe të mos i hyjmë në hak asnjë vendi të shenjtë të kombit shqiptar në këtë mënyrë, por që paratë të bëheshin më herët kërkesa, që të mos bëhej zhvendosja

nga kategoria e njëjtë, nga memorialët e dëshmorëve, që kush kujt po i merr prej përmendoreve apo prej memorialëve të dëshmorëve, por që ta zëmë, të bëhej një kërkesë, që vetëm nga ai premtimi i Qeverisë, për reduktimin e veturave luksoze, për shembull, apo të reduktimit të derivateve, të shkonin paratë në ndërtimin e më shumë memorialëve të dëshmorëve të UÇK-së.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet në situatën në të cilën na ka pru Komisioni për Buxhet dhe Financa, që pasi që kemi trajtuar Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, të trajtojmë kërkesa buxhetore dhe atë, të zgjedhim në mes komplekseve, nuk është as dinjitoze prej Komisionit e as prej neve deputetëve të trajtojmë në këtë formë.

E kemi miratuar buxhetin dhe dua sinjerisht një përgjigje prej anëtarëve të Komisionit. Nëse marrëveshja ka qenë e lidhur vitin e kaluar, atëherë është neglizhencë e komisionit, apo e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, pse kjo kërkesë nuk është futur në Projektbuxhetin e vitit 2015. E kujt është neglizhenca, nëse marrëveshja është e vitit të kaluar, atëherë e kujt është neglizhenca?

Edhe dy muaj jemi përpara se të futemi në rishikimet buxhetore dhe edhe në rishikimet buxhetore kjo ka mundur të trajtohet dhe, jam që të trajtohet dhe të përfundojë edhe obligimet financiare, të cilat janë ndaj operatorit që e ka kryer punën në lapidarin e Lirisë në Gjakovë. Dhe, nuk do të duhej fare të na sfidonin në këtë formë, asnjëherë, si rast nuk bëhet ndonjë neglizhencë e punëve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, për 20 mijë euro. As atje nuk do të ngecin punët për 20 mijë euro e as këtu nuk do bëhej ndonjë punë më e madhe për 20 mijë euro nëse procedohet dy muaj më përpara dhe duhet të jemi të sigjertë edhe njëri- tjetrin.

Ne mund të bëjmë edhe akuza politike edhe ndaj Qeverisë edhe ndaj kujtdo, por arsyeja pse e kemi themeluar Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, ka qenë mu kjo, që ajo të menaxhohet nga Kuvendi e jo nga Qeveria. Dhe, është e padinjitetshme dhe joserioze, që tani Qeveria të akuzohet për menaxhimin e mjeteve për komplekse memorialë, për arsye se tani këto mjete janë në përgjegjësi të vetë Kuvendit dhe ne deputetëve.

Dhe vërtet, kërkoj një qasje më serioze edhe më të përkushtueshme nga drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë dhe nuk ka nevojë, për shkak të papërgjegjësisë së tij dhe mospunës së tij, neve të na sfidohet këtu se për cilin kompleks jemi. Të gjithë dëshmorët kanë rënë për Kosovën janë të barabartë dhe duhet të trajtohen të barabartë nga Kuvendi dhe nga të gjithë ne. Dhe, drejtori këtu ka bërë një shkelje edhe të Ligjit edhe të procedurave dhe, ne mendojmë që edhe në raportin që do ta trajtojmë për këtë Agjenci, që e miraton ky Kuvend, do ta kemi prapë në konsideratë këtë shkarje dhe këtë lëshim të vetë drejtorit për menaxhimin e komplekseve memorialë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrin!

Kolegë deputetë,

Kur e kemi miratuar Ligjin për Agjencinë e Kompleksëve Memorialë, kemi planifikuar edhe buxhetin me formën me angazhimin që ai do të merret, me menaxhimin e kompleksëve. Drejtori i Agjencisë ka bërë edhe më herët një shkelje, kur ka përcaktuar ujësjellësin pikërisht për 1,5 km, vitin e kaluar dhe shkelja e dytë është po ashtu, e mos planifikimit si duhet e drejtorit të Agjencisë, pikërisht për heqjen e 20 mijë eurove nga buxheti i Kompleksit “Adem Jashari”.

Heqja e 20 mijë eurove nuk është një shumë, por është një shumë simbolike, por që tregon shumë se kemi një menaxhim të dobët nga Agjencia, kemi një papërgjegjësi dhe kemi një qëllim, që vazhdimisht të krijohet një precedan, heqja e buxhetit nga komplekset në një kompleks.

Ne e kemi përcaktuar buxhetin e tij dhe ai duhet ta menaxhojë ashtu dhe, është një shkelje për të cilën ne kemi kërkuar dhe kërkojmë që ky buxhet mos t’i kalojë, për shkak se është një shkelje që vazhdimisht do ta kemi edhe në të ardhmen. Prandaj, heqja e 20 mijë eurove nga një kompleks që do edhe miliona e miliona euro për realizimin e projektit “Adem Jashari”, ka lindur me një projekt me një simbolikë 20 mijë euro, këtë mund ta bëjë Qeveria vetë, drejtpërdrejt nëse do. Përndryshe, kjo është një shkelje për të cilën unë mendoj, se drejtori i Agjencisë ka bërë një shkelje që e ka pru këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ana ligjore është arsyetuar nga Komisioni, ana emocionale u dëgjua. Lus regjinë dhe deputetët, që të përgatiten për votim lidhur me propozimin në fjalë. Votojmë tash.

Faleminderit! Atëherë, konstatoj se me 56 vota për, 8 kundër, 7 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferimin e mjeteve buxhetore nga Kuvendi i Agjencisë për Menaxhimin e Kompleksëve Memorialë të Kosovës në Buxhetin e Komunës së Gjakovës, për vitin 2015.

5. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Ju lus për vëmendje! Keni për të votuar dhe ju lus, që të jeni të sqaruar për një çështje. S’po doni të dëgjoni? Në rregull!

Komisioni ad hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportet me rekomandime.

Ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc deputeten Xhevaire Izmaqu që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk është. Atëherë, fjalën e merr zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 4, 5, dhe 6 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbledhjet

e mbajtura më 13 dhe 19 mars 2015, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim.

Pra, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë zgjedhjen, ose përzgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me votim të fshehtë.

Për dy anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar propozohen kandidatët si në vijim: Flutura Hoxha, Malësore Gashi - Bajraktari, Eshref Shabani dhe Faton Morina.

Kuvendi bën përzgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nga katër të propozuar, të paktën njëri i përzgjedhur duhet të jetë i gjinisë femërore, kështu e kërkon ligji. Andaj, shpresoj që tash administrata do t’i bëjë gati dhe të votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues, me përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, me përbërje të zyrtarëve të administratës. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues. Zoti Grabovci, e keni fjalën.

ADEM GRABOVCI: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, si anëtare të Komisionit, propozoj Blerta Deliu.

KRYESUESI: Faleminderit! LDK, Zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë Sali Morinën.

KRYESUESI: Zoti Morina. Në emër të “Vetëvendosjes”, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Shqipe Pantina.

KRYESUESI: Shqipe Pantina, në rregull. Zoti Haradinaj, në emër të AAK-së, kënd e propozoni?

DAUT HARADINAJ: E propozojmë Time Kadrijajn.

KRYESUESI: “Nisma”?

VALDETE BAJRAMI: “Nisma” propozon Enver Hotin, për anëtar të Komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”-i, zonja Shinik.

MYFERA SHINIK: Alti Arti Parlamentar Gurubu, Qerim Bajrami ynerior.

KRYESUESI: Qerim Bajrami, në rregull. Atëherë, ju lus që t’i zini vendet tuaja.

Lus anëtarët e komisionit që t'i zënë vendet e tyre. A i keni listat e votimit? Tani, meqenëse Komisioni për Mbikëqyrjen e Buxhetit ka mbledhje i kisha lutur anëtarët e Komisionit, që të votojnë të parët, me qëllim që të kenë mundësi ta vazhdojnë punën.

Zoti Ali Sadrija, qenka në telefon. Ali, thirri anëtarët e Komisionit le të votojnë menjëherë! Votoni të parët, ju që shkoni.

Atëherë, po fillojmë me procedurë të rregullt. Anëtarët e Komisionit, thanë janë të privilegjuar që të votojnë menjëherë.

Zoti Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Syla, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu,

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, zonja Duda Balje.)

KRYESUESJA: Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq,

(Ndërprerje e incizimit)

Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj – Bujupi, Doruntinë Maloku – Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica,, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismail Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinote Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj - Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Myfera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashić, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Çela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha - Shala, Sali Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljević, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simić, Sllobodan Petrović, Synavere Rusha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti...

(Ndërprerje e incizimit.)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Atëherë, po fillojmë me raportimin dhe numërimin e votave.

BLERTA DELIU-KODRA:

E pavlefshme, s'ka asnjë votë,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Faton Morina
Flutura Hoxha,

Eshref Shabani
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
E pavlefshme,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani
Flutura Hoxha
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,

Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Faton Morina
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,

Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Malsore Gashi – Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Eshref Shabani,
Flutura Hoxha,
Eshref Shabani,
Faton Morina,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari.

BLERTA DELIU-KODRA: Pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit, për zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 7 prill 2015, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 92 deputetë.
Të pavlefshme janë 2 votime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Flutura Hoxha ka fituar 44 vota;
- Malësore Gashi-Bajraktari ka fituar 41 vota;
- Eshref Shabani ka fituar 43 vota;
- Faton Morina ka fituar 26 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit numër 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Eshref Shabani zgjidhet anëtar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me mandat pesëvjeçar.

Në raundin e dytë, hyjnë në procedurën e votimit zonja Flutura Hoxha dhe zonja Malësore Gashi-Bajraktari, kurse kandidati Faton Morina huqet nga lista e votimit.

KRYESUESI: Atëherë, ftoj Komisionin që t'i zërë vendet dhe të përshpejtojmë çështjen e votimit në vazhdim.

Atëherë, po e fillojmë votimin:

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Dedaj, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinote Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmetkollari, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama...

Është mirë të votoni kush të dojë, se s'po merret gjë vesh kjo punë, ata të parët po vijnë të fundit, të fundit të parët, hallakamë u bë!

... Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljević, Selvi Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petrović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Vetton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Regjia, fjalën Komisionit!

BLERTA DELIU-KODRA:

Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
E pavlefshme,
Flutura Hoxha,

Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Flutër Hoxha,
Flutër Hoxha,
Flutër Hoxha,
Flutër Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutër Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutër Hoxha,
Flutër Hoxha,

Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha
Flutura Hoxha
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
E pavlefshme,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutura Hoxha,
Malësore Gashi-Bajraktari,
Flutër Hoxha.

KRYESUESI: Regjia, fjalën Komisionit!

BLERTA DELIU-KODRA: Në votim kanë marrë pjesë gjithsej 80 deputetë. Të pavlefshme janë gjithsej 10 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar, janë si në vijim:

- Flutura Hoxha, ka fituar 27 vota;
- Malësore Gashi-Bajraktari, ka fituar 43 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit numër 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zonja Malësore Gashi-Bajraktari zgjidhet anëtare e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me mandat pesëvjeçar.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konstatoj se është zgjedhur zonja Malësore Gashi, në bazë të raportimit dhe zoti Eshref Shabani. Ju urojmë punë të mbarë në mandatin e anëtarëve të

zgjedhur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe mandati i tyre është pesëvjeçar.

6. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike

Për këtë pikë kam pasur një kërkesë nga komisioni, anëtarët e Komisionit, respektivisht kryetarja e Komisionit, meqë ka shkuar në një takim të paracaktuar, fjalën ia ka dhënë dhe e ka autorizuar për fjalë zonjën Salihe Mustafa, që në emër të Komisionit të kërkojë mocion lidhur me pikën e gjashtë të rendit të ditës. Faleminderit! Zonja Mustafa, e keni fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 62 pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 10 shkurt 2015 lidhur me peticionin numër 01/2015 kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike, të parashtruar më 20 janar 2015 nga koalicioni i qytetarëve konsumatorë, Sindikata dhe organizatat joqeveritare, i ka rekomanduar Kuvendit, që në njërën nga seancat plenare të radhës ta radhisë si pikë të veçantë të rendit të ditës.

Njëra nga rekomandimet e komisionit ka qenë që Zyra e Rregullatorit për Energji, në afat prej një muaji nga dita e miratimit të këtij rekomandimi, t'ia paraqesë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës një raport të veçantë për të gjitha çështjet e ngritura në peticion lidhur me dy rritjet e fundit të çmimit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe analizën e detajuar të çmimeve.

Të nderuar kolegë,

Duke pasur parasysh se Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka sjell një raport sot në kutitë e deputetëve, ne si Komisioni unanimisht kemi marrë qëndrim që kjo pikë e rendit të ditës të radhitet në njërën nga seancat e radhës së Kuvendit për arsye se do t'u ndihmojë deputetëve ta shqyrtojnë raportin dhe kontributin tonë ta japim më mirë kur e kemi të analizuar raportin.

Pra, është vonë që e kemi marrë sot raportin dhe kërkojmë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shefat e grupeve parlamentare duhet të deklarohen lidhur me mocionin ose përfaqësuesit e grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mendon që mocioni është plotësisht i arsyeshëm, sepse pasi që ka ardhur me vonesë shumë të madhe raporti, deputetët nuk kanë pasur mundësi ta shohin dhe mund të analizojnë, ta lexojnë, ta përpunojnë dhe në një seancë të ardhshme mund të diskutohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën në emër të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Ne si Grup Parlamentar i LDK-së e mbështesim një mocion të tillë që të shtyhet kjo pikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, në emër të Vetëvendosjes.

VISAR IMERI: Faleminderit kryesues,

Së pari, me aq sa e pashë nga anëtarët e Komisionit – përfaqësuesi i Lëvizjes “Vetëvendosje” në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, është një problem këtu me vetë rekomandimin ose rekomandimet që i ka nxjerrë ky Komision, sepse mesa e kuptova unë, nuk janë diskutuar fare në Komision dhe as nuk janë votuar në Komision, dhe rrjedhimisht ky është një problem jashtëzakonisht i madh, sepse këtu është, po supozoj tash nga kjo, që e mora vesh se është qëndrim subjektiv i njërit prej anëtarëve aty, ose kryetares në këtë rast, po jo i Komisionit, si të tillë dhe neve na ka ardhur si rekomandim i Komisionit.

Çështja e dytë është se ne domosdoshmërisht duhet ta diskutojmë peticionin e qytetarëve dhe rekomandimet që i japin qytetarët dhe kjo të hidhet në votim, e jo të kemi këtu rekomandime të komisioneve pastaj, të cilat na vijnë si rekomandime për t’u votuar. Këto mund të jenë votime të komisioneve, ne i diskutojmë si deputetë, mirëpo e rëndësishme është që peticioni i qytetarëve të jetë baza e diskutimit kurdo që të bëjmë diskutimin.

Dhe çështja e tretë është që unë pajtohem që në këto rrethana ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës, pra ta tërheqim nga rendi i ditës, sepse nuk janë plotësuar kushtet as objektive e as formale institucionale për ta diskutuar. Mirëpo, insistoј që kjo të radhitet në seancën e ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës në mënyrë që në ndërkohë Komisioni për të Drejtat e Njeriut ta mbajë mbledhjen e tyre, ta diskutojnë këtë punë dhe ta sjellin, nëse duan ta sjellin me plotësim në rekomandime për atë që e kanë diskutuar ose për vendimin e Komisionit.

Unë këtu po e shoh nga peticioni se ky është dorëzuar më 20 janar të vitit 2015 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërkohë që sot jemi me 7 prill të vitit 2015. Pra, ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe nuk mund ta shtyjme këtë çështje në pafundësi, dhe do të kisha kërkuar edhe mirëkuptimin e deputetëve tjerë që të dakordohemi tash që në seancën e radhës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo pikë të jetë në rend të ditës dhe në ndërkohë deputetët ta kenë kohën e mjaftueshme që qoftë ta shqyrtojnë e të konsultohen për raportin e ZRE-së për çështjet të cilat janë ngritur këtu, qoftë edhe komisionet ose Komisioni në këtë rast të mblidhet dhe të vjen me rekomandime të qarta të votuara në Komision dhe të dakorduara nga anëtarët e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën zonja Haxhiu, në emër të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Për t’iu sqaruar deputetëve, arsyeja pse u dakorduam për t’u shtyrë kjo pikë për një seancë tjetër nuk është te shqyrtimi i raportit i ZRE-së, ai duhet të shqyrtohet në një seancë të radhës. Edhe ne pajtohemi të shtyhet kjo pikë, por me kusht që në seancën e radhës të diskutohet, në fakt të bëjmë debat për çështjen e peticionit.

Mirëpo, arsyetja pse ne kërkuam edhe një herë është se Komisioni ka nevojë t'i shikojë disa gjëra që vërtet janë ardhur disa rekomandime edhe jashtë atyre që i kemi diskutuar ne si Komision.

Pra, pajtohem, me kusht që javën tjetër në seancën e parë të diskutohet kjo çështje, por ndaras me raportin, jo të bëhen të dyja bashkë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shala, e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar "Nisma".

HAXHI SHALA: Edhe ne si Grup Parlamentar pajtohem me Komisionin që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, për seancë tjetër, jo më vonë se në seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë procedurat dihen! Qerim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar "6+".

QERIM BAJRAMI: Edhe ne jemi për ta shtyrë këtë pikë për një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Bajrami! Procedurat dihen cilat janë për t' i bashkuar në një lëndë për debat dhe e cila procedurë është obligative. Mendoj se në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë të diskutohet si çështje dhe të shohim cili variant do t'i propozohet Kuvendit për t'u shqyrtuar në seancën e radhës, kështu që mos ta hapim debatin rreth kësaj.

Atëherë, sipas deklaratave të kryetarëve të grupeve parlamentare, pothuaj se të gjitha grupet janë dakord ta shtyjme, sidoqoftë ne e bëjmë një votim formal.

Kush është për?

Kundër? 1 është kundër.

Atëherë, jemi dakord për propozimin.

Tani i kemi dy pikat që na kanë mbetur, por ka propozime që ndërpritet seanca sot, me qëllim që në seancën e ardhshme të ngritën çështjet. E kemi pikën e shtatë dhe tetë të radhitura, që kanë qenë pikë e parë dhe e dytë, me vendim të Kuvendit janë deklaratat – koha për deklarime jashtë rendit të ditës dhe koha për pyetje parlamentare.

Nëse doni, ne mund të vazhdojmë por edhe ta ndërpremë seancën, dhe është çështje e juaj.

(Ndërhyrje)

Atëherë, urdhëro zonja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Nënkryetar,

Në qoftë se shtyhen këto dy pika unë propozoj që në seancën e radhës le të jetë koha e paraparë për pikën jashtë rendit të ditës të kësaj seance, në të kundërtën Grupi ynë jemi për të vazhduar.

KRYESUESI: I hedh propozimet në votim. A jeni që ta ndërpresim seancën deri në javën tjetër, e pastaj të vazhdojmë normalisht.

Kush është për?

Kundër?

Shumica janë që të ndërpritet seanca e sotme. Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Ani u krye, por zoti kryesues, për ta votuar Rregulloren, është një procedurë tjetër, prandaj mos e qit Rregulloren për ta votuar, me Rregullore këto dy pika janë të përhershme dhe këtu keni bërë një shkelje procedurale që nuk do të duhej herëve tjera ta bëni ju dhe deputetët e kërkojnë një gjë të tillë.

KRYESUESI: Unë jam i gatshëm të vij veç me ju, nëse jeni dakord ju, pas drekës ta zhvillojmë debatin.

ISMAJL KURTESHI: Po, veç Rregullorja nuk votohet në këtë formë.

KRYESUESI: Por, shumica janë kundër. Nëse doni, deklaroni dhe unë vij me ata që donë t'i bëjnë pyetjet dhe e lëmë në orën 15:15 dhe ejani. Pra, unë nuk mund as ta detyroj Qeverinë as presidentin, as kryeministrin për të ardhur këtu, sepse s'është punë imja ajo.

A doni debat për në orën 15:15, a jo?

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*